Klubi i Poezisë
Tiranë

FLORI BRUQI
DËSHMI TË KRIMIT TË PANDËSHKUAR

Klubi i Poezisë
Tiranë

FLORI BRUQI

DËSHMI TË KRIMIT TË PANDËSHKUAR

Klubi i Poezisë
Tiranë

Tiranë, 2017

Titulli : Dëshmi të krimit të pandëshkuar
Autori: Flori Bruqi
Redaktor: Izet Duraku
Recenzent: Rexhep Shahu
Ballina & arti grafik: BoV Desing
Përgatiti: Klubi i Poezisë, Tiranë
© Të gjitha të drejtat janë të Flori Bruqit
ISBN 978-9928-154-67-5
Botuar në Grant Print
Shtypshkronja Vision Print Prishtinë

Tiranë, 2017

FLORI BRUQI

DËSHMI TË KRIMIT TË PANDËSHKUAR

Klubi i Poezisë
Tiranë

Tiranë, 2017

PROF. DR. ESHREF YMERI

NJË PLAGË E HAPUR QË S'PO GJEN SHËRIM

Libri "Dëshmi të krimit të pandëshkuar" i akademik Prof. dr. Flori Bruqit, që po vihet në dorën e lexuesve, shërben si një *"ekranizim"* i fateve të popullit shqiptar të Kosovës në veçanti dhe të mbarë kombit shqiptar në tërësi. Ai është dëshmi e gjallë e tragjizmit të fqinjësisë së kombit shqiptar me kombin serb, i cili, gjatë një harku kohor prej më shumë se një shekull e gjysmë dhe deri në ditët tona, në qëndrimin ndaj kombit shqiptar, ka nxjerrë nga gjiri i vet tufa të tëra egërsirash politike, me nxitjen dhe me mbështetjen e fuqishme të akademikëve të krimit dhe të kishës kriminale serbe. Këta akademikë të krimit, autori i ka nxjerrë lakuriq në faqet e këtij libri. Këto egërsira politike serbe me prejardhje ruse, Perëndimi evropian i ka pasë trajtuar gjithmonë me tërë përkujdesjen e vet, çka solli si pasojë që edhe në fundin e shek. XX, t'i lejojë të organizojnë atë

kasaphanë të tmerrshme kundër popullit boshnjak dhe kundër popullit shqiptar të Kosovës.

As në kohët e largëta të inkuizicionit mesjetar nuk kanë pasë qenë organizuar masakra të atilla, si ato që egërsirat politike serbe organizuan në Bosnjë dhe në Kosovë.

Nëse Perëndimi europian do të jetë në gjendje që, në shekujt pasardhës, të nxjerrë ndonjëherë nga radhët e veta mendje të ndritura, që do të kenë si yll karvani vetëm të vërtetën, kam bindjen se banjat e tmerrshme të gjakut që egërsirat politike serbe organizuan në Evropën Juglindore në fundin e shek. XX, ato do t'i vlerësojnë si një damkë turpi në ballin e qytetërimit europian.

Skenat e masakrave të tmershme që përshkruhen në faqet e këtij libri, janë tej përfytyrimit të mendjes njerëzore: njerëz të pafajshëm të të gjitha moshave, deri te fëmijët e vegjël, të masakruar, të përçudnuar, të vrarë dhe të groposur në varre masive, të djegur me benzinë, të karbonizuar nëpër konteniere fabrikash, të mbyllur nëpër kamionë frigoriferikë dhe të flakur në lumin e Danubit, nuk do t'i trajtonin në këtë mënyrë as tigrat e egër që enden pyjeve dhe brigjeve të Amurit siberian në kulmin e urisë së tyre shtazore në piskun e dimrit. Kur u njoha me ato skena të tmerrshme krimesh në përshkrimin e akademikut Flori Bruqi, kujtesa me çoi larg.

Së pari, më erdhi ndër mend një artikull i Mihal Gramenos, me titull *"Gjakpirësit, katilët dhe*

vandalët", i botuar në gazetën *"Koha"*më 17 prill 1914. Autori shkruante:

"Vetëm prej një kombi barbar, i cili jeton për turp në shekullin e 20-të në Evropë, mund t`i tregojë botës së qytetëruar barbarizmin e tij të pashembullt dhe të veprojë vandalizmat që ngjanë në Korçë dhe ngjasin në Shqipëri të jugës! Dhe ky komb s`mund të jetë veçse kombi grek. Një komb, i cili është gatuar nga llojish lëngërash nuk mund të kuptojë ç`domethënë turp dhe njerëzim, se ay është bërë për gjakpirësi, për katillëqe dhe për vandalizma! Kurrë nuk besojmë të gjendet njeri, i cili të shkruajë historinë e ngjarjeve të fundit në Korçë e të tregojë hollësisht shkaktarët e kësaj lëvizjeje meqenëse shkaktare e vërtetë e kësaj lëvizjeje është qeveria greke, e cila deshte që t`i përvëlonte e t`i shuante vendet e Toskërisë nga faqe e dheut dhe programin e saj e tregoi fort bukur se ka afër një mot që kur konferenca e Londrës vendosi kufinjtë e Shqipërisë, por qeveria greke vendosi të shpërndajë armë.... Gjithë lufta që u bë në Korçë ishte organizuar nga Greqia me oficerë dhe ushtarë grekë… që të mbushnin qëllimin e poshtër dhe barbar e të rrëzojnë themelimin e Shqipërisë..." (Citohet sipas: Kastriot Dervishi. *"Të mos harrojmë atë që na kanë bërë dhe atë që po na bëjnë grekët".* Faqja e internetit *"Forumi shqiptar".* 07 maj 2007).

Së dyti, m'u kujtuan krimet e bishave fashiste greke në Çamëri dhe m'u fanit testamenti i egërsirës me fytyrë njeriu Napoleon Zerva:

"Vdes i qetë se bëra atë që doja. Pas lashë rrëke gjaku, tym, blozë, gërmadha, ulërima fëmijësh, nuse dhe gra të zhveshura, që futeshin në furrat e ndezura, që të mos pillnin më shqiptarë, burra të varur, shpuar me bajonetë, gjuha shqipe nuk do të flitet më në tokën helene. Kjo më kënaq mua, ashtu siç kënaq tërë shpirtrat helenë!". (Citohet sipas: *"Ja amaneti që la Napoleon Zerva, gjenerali famëkeq që masakroi qindra shqiptarë".* Faqja e internetit *"VOAL".* 01 janar 2017).

Akademiku Flori Bruqi nxjerr në pah rolin e pazëvendësueshëm që luajtën Shtetet e Bashkuara të Amerikës për shpëtimin e popullit shqiptar të Kosovës nga shfarosja masiveqë kishin planifikuar egërsirat politike serbe, duke zbatuar planin e tyre barbar me emrin *"Patkoi",* sipas të cilit duhet të kryhej spastrimi tërësor etnik i territorit, kurse banorët që mbeteshin të fshehur nëpër male, duhej të shfaroseshin krejtësisht.

Jo vetëm populli shqiptar i Kosovës, por mbarë kombi shqiptar, duhet t'i jetë mirënjohës në jetë të jetëve Presidentit *Klinton (Bill Clinton - 1946)*, Kryeministrit Britanik *Toni Bler (Tony Balir - 1953)*, Sekretares së Shtetit *Medlin Ollbrajt(Madeleine Albright - 1937)* dhe Kryekomandantit të forcave të NATO-s *Uesli Klark (Wesley Clark - 1944),* nderimi ndaj të cilëve e meriton të përjetësohet me shtatore hijerënda që duhet të ngrihen në kryeqendrat e trojeve tona etnike.

Roli parësor i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në përgatitjen e bombardimeve kundër

Serbisë, ishte i padiskutueshëm. Ndërkohë, ka pasur një kundërshtim të heshtur të Perëndimit europian, sidomos të Francës, por edhe një stepje të ministrit të jashtëm anglez kundër fillimit të bombardimeve, çka dëshmohet fare qartë në një intervistë të gjeneralit rus *Leonid Ivashov (1943)*, ish-këshilltar ushtarak i Kryeministrit *Çernomëjrdin (1938-2010),* dhënë revistës *"Itogi"* dhe botuar në faqen e internetit *"russmir.info"* të datës 27 gusht 2010.

Ndërhyrja e NATO-s, përmes bombardimeve të Serbisë për çlirimin e Kosovës, ishte një leksion me një prapavijë tepër domethënëse për shovinizmin rusomadh, armikun e betuar të kombit shqiptar, mbështetësin e paturpshëm të pjellës së vet të përbindshme serbe, shovinizmit serbokriminal.

Në këtë libër, akademik Bruqi hedh dritë edhe mbi qëndrimin e theksuar antishqiptar të Prokurores së Tribunalit të Hagës *Karla del Ponte (Carla Del Ponte - 1947),* për të cilën avokati anglez i Ramush Haradinajt *Ben Emerson (Ben Emmerson - 1963)* ka ngulur këmbë që ajo t'i kërkojë falje Haradinajt për akuzat e rreme që pati ngritur kundër tij. Ishte pikërisht po kjo *Karla Del Ponte,* e cila, armiqësinë e vet kundër popullit shqiptar të Kosovës dhe veçanërisht kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e pati shpalosur paturpësisht me gënjeshtra të pafundme në faqet e librit të vet me titull *"The Hunt: Me and the War Criminals" (Gjuetia: unë dhe kriminelët e luftës),* në italisht *"La caccia: Io e i criminali di guerra",* të botuar në vitin 2008.

Libri i *Karla Del Pontes* ishte rezultat i vizitave të saj të shpeshta në Beograd dhe i ndërhyrjes së drejtpërdrejtë të Kremlinit, përmes Kryetarit të Komitetit të Këshillit të Federatës Ruse për Marrëdhënie Ndërkombëtare *Konstantin Kosaçov (1962).* Ishte pikërisht ky *Kosaçovi* që vuri në lëvizje edhe anëtarin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës *Dik Marti (Dick Marty- 1945),* i cili e çoi edhe më tej shpifografinë e *Karla Del Pontes,* me akuzën kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për gjoja trafikim organesh tëserbëve të vrarë. Pra, në Perëndimin europian po synohej që kriminelët serbë të shndërroheshin paradoksalisht në viktima.

Në faqet e librit jepet një listë e tërë krimesh dhe kriminelësh, e cila është siguruar pas një pune të pandërprerë hulumtuese, gjatë së cilës autori ka shfrytëzuar më shumë se 200 burime të mediave vendase dhe ndërkombëtare. Kjo është një punë me të vërtetë heroike që ka kryer autori i këtij libri, të cilën jo dokushdo mund ta përballojë për të nxjerrë në dritën e diellit kaq shumë të vërteta tragjike.

Në të njëjtën kohë, të bëjnë përshtypje dhe të tronditin thellë faktet që sjell akademiku Flori Bruqi për përpjekjet e gjithanshme që bëri regjimi kriminal i *Millosheviçit (1941-2006)* për fshehjen e gjurmëve të krimit. Por fshehja e atyre gjurmëve vazhdoi po në atë mënyrë edhe kur *Millosheviçi* u rrëzua nga pushteti, përfundoi i prangosur në Tribunalin e Hagës dhe deri sa iku në botën e përtejme. Nuk mund të ndodhë ndryshe që kjo fshehje e atyre krimeve vazhdon edhe në ditët tona, sepse pushtetin politik në

Beograd e trashëguan bashkëpunëtorët e ngushtë të Millosheviçit që janë në krye edhe sot e gjithë ditën. Prandaj krimet e egërsirave politike serbe ndaj popullit shqiptar të Kosovës, vazhdojnë të mbeten ende të pandëshkuara. Dhe Perëndimi evropian vazhdon të heshtë. Madje po përgatitet ta pranojë Serbinë në radhët e Bashkimit Evropian. Këtë qëndrim shpërfillës ndaj krimeve të bishës fashiste serbe në Kosovë, Perëndimi evropian e manifeston në qëndrimin e tij jo vetëm ndaj popullit shqiptar të Kosovës, por edhe ndaj kombit shqiptar në tërësi. Ky qëndrim shpërfillës doli më shumë në pah edhe gjatë krizës së fundit në Maqedoni dhe në Shqipëri, kur Bashkimi Evropian u tërhoq përfundimisht nga zgjidhja e saj. Madje ambasadorja gjermane, e shtetit më me peshë në Bashkimin Evropian, *Susanne Schütz,* deklaroi para do kohësh pa iu dridhur qerpiku:

"Edhe nëse PD nuk hyn në zgjedhje ne do t'i njohim" (Citohet sipas: *Ambasadorja gjermane: Do t'i njohim zgjedhjet edhe pa PD".* Faqja e internetit e gazetës *"Shqiptarja.com".*02 maj 2017).

Kjo ishte një deklaratë jo vetëm absurde, por edhe skandaloze, e cila, po të mos kishte ndërhyrë Departamenti i Shtetit me përfaqësuesin e vet që dërgoi në Tiranë dhe në Shkup, do të kishte bërë që situata të përcillej me pasoja të rënda, që mund të shoqëroheshin edhe me shpërthimin e luftës civile, si në Shqipëri, ashtu edhe në Maqedoni. Ja, ky është Perëndimi evropian në qëndrimin ndaj kombit shqiptar. Ky është pikërisht po ai Perëndim evropian që soditi me aq shpërfillje vrasjen dhe groposjen në

një varr masiv të 8 000 njerëzve të pafajshmën në Srebrenicënë verën e vitit 1995, një gjenocid i tmerrshëm ky në fundin e shek. XX, në kryerjen e të cilit, përveç bishave fashiste serbe, morën pjesë edhe kriminelë me damkë, të ardhur si vullnetarë nga Rusia dhe nga Greqia.

Tepër prekëse janë faqet e librit që autori ia kushton figurës emblematike të popullit shqiptar të Kosovës, intelektualit të shquar të mbarë kombit shqiptar, Ukshin Hotit, i cili në themel të filozofisë së tij politike kishte ribashkimin e trojeve tona etnike. Të tmerruar nga një filozofi e tillë politike e këtij Prometeu shqiptar, egërsirat politike serbe bënë çmos që Ukshin Hotin ta zhdukin pa lënë asnjë gjurmë. Për këtë hero të kombit shqiptar, akademiku Flori Bruqi ka përfshirë në faqet e këtij libri mbresa të përsonaliteteve të shquara të kulturës shqiptare, si Ismail Kadare, akademik Esat Stavileci, Prof.dr. Agim Vinca, Dritëro Agolli, akademik Bedri Dedja, Adem Demaçi, akademik Rexhep Qosja dhe dr. Moikom Zeqo.

Më kanë bërë përshtypje të jashtëzonshme ca mbresa mjaft të goditura të Ismail Kadaresë për Ukshin Hotin. Siç thekson autori i librit, në një intervistë që Kadarea ka dhënë në vitin 1996, ka deklaruar:

"… e vetmja gjë që për mua ka qenë e qartë sapo kam lexuar fragmentet e para nga mendimet e tij, ka qenë përgatitja e lartë profesionale. Kam frikë se pikërisht ky nivel i lartë ka qenë edhe burimi i fatkeqësisë që e ka ndjekur hap pas hapi këtë martir.

Ka qenë tragjedi e vjetër… e shqiptarëve, përpjekja për të mënjanuar nga udhëheqja e një lëvizjeje, e një populli apo shteti, njerëzit më të zotë. Kur mungon tigri, majmuni bëhet mbret, - thotë një proverb kinez. Kjo logjikë e mbrapshtë, logjika e triumfit të mediokritetit, i ka shkaktuar, e, me sa duket, do t'i shkaktojë ende dëme të ndjeshme çështjes shqiptare… Më fort se kurrë kombi shqiptar ka nevojë për njerëz të aftë e me nivel të lartë. Njerëzit e zotë janë princat e vërtetë të një kombi. Për fat të keq, princat goditen shpesh në mënyrë të vdekshme".

Këto fjalë e detyrojnë lexuesin të përsiatë paksa për atë që ka ndodhur dhe po vazhdon të ndodhë me fatet e kombit shqiptar, në radhët e të cilit nuk vlerësohen dhe nuk nderohen *njerëzit e aftë dhe me nivel të lartë, sipas logjikës së triumfit të mediokritetit,* siç flet dhe qëllon në shenjë Kadarea. Sepse mediokriteti është një tokë pjellore për lulëzimin e djallëzisë, e gënjeshtrës, e hajdutërisë, e hilesë, e hipokrizisë, e imoralitetit, e karrierizmit, e mashtrimit, e mercenarizmit, e pabesisë, e pasurimit pa djersën e ballit, e përçarjes, e smirës, e spiunllëkut, e tradhtisë etj.

Sundimi gati katër shekullor otoman figuron si një njollë e errët në ekranin e historisë sonë kombëtare. Vetëm aty nga fundi i viteve '40 të shek. XIX patën shpërthyer ca kryengritje në jug kundër Reformave të Tanzimatit, pra, kundër taksave të reja që pati vendosur aso kohe Porta e Lartë, dhe asgjë më tepër. Ndërkohë, fqinji ynë jugor kishte gati njëzet vjet që kishte fituar pavarësinë, kurse në katër

vilajetet shqiptare s'kujtohej kush për çlirimin nga zgjedha otomane. Vetëm në gjysmën e dytë të shek. XIX, disa pena të shquara dhe figura politike hodhën themelet e Rilindjes Kombëtare që çuan në krijimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Por edhe gjatë zhvillimit të punimeve të saj, shqiptarët nuk folën me një zë, ishin të përçarë: disa ishin për autonomi, disa ishin për pavarësi nga perandoria otomane. Në ato kushte, Lidhja e Prizrenit nuk qe në gjendje të merrte në dorë fatet e vendit dhe të jepte kushtrimin, sidomos pas vendimeve kriminale të Kongresit famëkeq të Berlinit për fillimin e copëtimit të trojeve tona etnike, të krijonte forcat e armatosura dhe të nxirrte në krye një prijës me autoritet mbarëkombëtar, siç ndodhi në Greqi, prandaj edhe dështoi dhe u shtyp nga perandoria otomane.

Vendi fqinj i përtejdetit nxori në skenë*Garibaldin (Giuseppe Garibaldi - 1807-1882),* i cili, pas betejash të shumta, arriti, më në fund, që të krijojë një shtet të bashkuar italian më 17 mars 1861. Në testamentin për brezat pasardhës, Garibaldi ka shkruar:

"Unë po lë trashëgim dashurinë time për lirinë dhe për të vërtetën dhe urrejtjen time për gënjeshtrën dhe për tiraninë".

Viktor Hygoi (Victor Hugo 1802-1885) ka bërë këtë vlerësim për Garibaldin:

"Ç'është Garibaldi? Njeri. Asgjë më shumë. Por njeri në kuptimin më të lartë të kësaj fjale. Njeri i lirisë, njeri i natyrës njerëzore. A ka ushtri? Një grusht vullnetarësh. A ka municione? Nuk ka. Vetëm

disa fuçi baruti. Armët ia ka rrëmbyer armikut. Po ku qëndron forca e tij? Çfarë ia siguron fitoren? Çfarë qëndron në mbrojtje të tij? Shpirti i popujve".

Vendi ynë asokohe, për fat të keq, nuk qe në gjendje të nxirrte në skenën e historisë një "Garibald" shqiptar.

Po ashtu, *Bismarku (Otto von Bismarck -1815-1898),* të cilin e kanë quajtur *"kancelar i hekurt",* pas betejash të përgjakshme, arriti të realizojë bashkimin e Gjermanisë më 18 janar 1871. Një aforizëm i tij për lirinë, e meriton të shkruhet me shkronja të arta:

"Liria është një luks, të cilin mund t'ia lejojë vetes jo dokushdo".

Përçarja ka qenë shoqëruesja e përhershme tragjike e kombit shqiptar. Faik Konica thotë se Shqipërinë e ka shpëtuar rastësia. Nuk dihet se si do të kishin rrjedhur ngjarjet, sikur Ismail Qemali të mos kishte ngrënë atë dackën në parlamentin turk: vallë a do të kishte dalë ndokush tjetër që të ndërmerrte nismën për shpalljen e pavarësisë? Në Kuvendin e Vlorës, pas shpalljes së pavarësisë nga Ismail Qemali, në praninë e përfaqësuesve nga të gjitha trojet etnike, menjëherë duhej të kalohej në krijimin e forcave të armatosura. Vendimet kriminale të Konferencës së Londrës për copëtimin e trojeve tona etnike, duhej të kishin shërbyer si një kushtrim, si një sinjal alarmi për të ngritur më këmbë të madh e të vogël, që nga Arta e Preveza e deri në Tivar. Fatkeqësisht, nuk u lëshua kurrfarë kushtrimi, kurrfarë thirrjeje për një kryengritje mbarëshqiptare dhe punët morën

drejtimin që dihet. Përçarja ndërshqiptare e bëri të vetën.

Lulëzimin më të shkëlqyer, mediokriteti që thekson Kadarea, e arriti në periudhën e diktaturës komuniste, kur u zhdukën rrënjët e nacionalizmit shqiptar dhe në vitet '80 të shek. XX vendi ynë arriti në nivelin më skandaloz të varfërisë, saqë mbarë Perëndimi evropian e tregonte me gisht. Mediokriteti ka vazhduar të lulëzojë edhe pas ndërrimit të sistemit komunist, kur në Kuvendin e Shqipërisë, kanë zënë dhe vazhdojnë të rrinë në ndenjëset e tij mediokër të të gjitha niveleve, me përjashtim të një pakice nga të dy krahët që shfaqet herë pas herë në foltoren e tij. E njëjta gjë ka ndodhur edhe në Kosovë, ku mediokriteti ka lulëzuar dhe vazhdon të lulëzojë në qejfin e vet…

….Disa faqe të librit, në krye të të cilave është vënë titulli *"Monumenti kulturor i Millosheviçit"*, akademiku Flori Bruqi ia kushton kishës serbe*"Sveti Spas" (Krishti Shpëtimtari")* në oborrin e Universiteti të Prishtinës. Ajo kishë u ndërtua arbitrarisht gjatë viteve '90, kur Kosova ishte e pushtuar nga kolonizatorët serbë, me të vetmin qëllim që t'i zinte frymën Universitetit të Prishtinës, duke ndërhyrë në një mënyrë të jashtligjshme në sistemin kadastral të atij universiteti dhe duke zaptuar një sipërfaqe të përgjithshme prej 4.27 hektarë.

Lind pyetja: si duhet vepruar me këtë ndërtim të paligjshëm? Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, po përcjell paraprakisht një informacion nga Beogradi:

"Një xhami shqiptare që gjendej në Beograd është rrëzuar në mëngjesin e sotëm. Kjo xhami në Zemun të Beogradit, sipas autoriteteve, u rrëzua për shkak të lejes së ndërtimit" (Citohet sipas: *"Rrëzohet xhamia shqiptare në Beograd".* Faqja e internetit e gazetës *"Zëri".* 26 maj 2017).

Pra, xhamia shqiptare në Beograd u rrëzua se ishte ndërtuar pa leje. Po atëherë edhe kisha serbe që është ndërtuar në një mënyrë të jashtëligjshme para Universitetit të Prishtinës, pse nuk rrëzohet nga autoritetet vendore të Prishtinës? Përgjigjja është e thjeshtë:

Xhamia shqiptare u rrëzua në Beograd se Serbia ka në krye të shtetit burra të politikës, kurse kisha e paligjshme sebe para Universitetit të Prishtinës nuk mund të rrëzohet se Kosova ka në krye të shtetit lepuj të politikës…

Por autoritetet e Beogradit nuk pritën sa të bënin "punë më të mëdha", por e shembën menjëherë xhaminë shqiptare që qe ngritur pa leje.

Pra, në sytë e popullit shqiptar të Kosovës, disa liderë mundohet ta reklamojë veten si "atdhetar", ndërsa kur i kërkohet mendim se si duhet vepruar me atë kishë të paligjshme, ai zbulon servilizmin dhe mercenarizmin e tij ndaj Beogradit. Sepse servilizmin dhe mercenarizmin e vet ndaj Beogradit ai e ka faktuar shumë herë me lëshimet skandaloze që i ka bërë shovinizmit serb, në bashkëpunim të ngushtë me Isa Mustafën dhe me Edita Tahirin, që prej 19 prillit të vitit 2013 dhe deri tani…

Mercenarizmit dhe tradhtisë së Lidëreve Kosovarë, ia nxjerr bojën përfundimisht Aleksandër Vuçiçi, i cili para do kohësh ka deklaruar për një marrëveshje të arritur në Bruksel. Në një informacion, të botuar në faqet e internetit, thuhet:

"Aleksandër Vuçiç ka lavdëruar marrëveshjet e arritura në Bruksel, ndërmjet Qeverive të Serbisë dhe asaj të Kosovës".

Ai ka deklaruar:

"Ne e morëm vendimin që të gjithë punonjësit e policisë të jenë të nacionalitetit serb, dhe se asnjë polic shqiptar të mos vërë këmbë në Veri të Kosovës" (Citohet sipas: *"Vuçiç: Marrëveshja e Brukselit është që asnjë polic shqiptar të mos shkelë në veri të Kosovës".* Faqja e internetit *"VOAL",* 30 maj 2017).

Pas kësaj ndërhyrjeje të Vuçiçit në mjetet e informimit masiv, ka reaguar Edita Tahiri, e cila ka deklaruar:

"Serbia duhet ta heqë sëmundjen e nacionalizmit" (Citohet sipas: *"Edita Tahiri demanton Vuçiçin: zëvendësdrejtori i policisë në Veri është shqiptar".* (Faqja e intenetit *"Infopress".* 30 maj 2017).

Ministrja e dialogut kot e akuzon Serbinë dhe Vuçiçin për nacionalizëm! Sikur Serbia dhe Vuçiçi të ishin nacionalistë, ata meritojnë nder dhe respekt, sepse nacionalizmi është mbrojtje me dinjitet e vlerave kombëtare, e gjuhës dhe e trashëgimisë kulturorë. Por as Sebia, as Vuçiçi dhe as mbarë kopeja e egërsirave politike serbe, nuk kanë qenë, nuk janë dhe nuk do të jenë kurrë nacionalistë në qëndrimin ndaj Kosovës. Ata kanë qenë, janë dhe do të

vazhdojnë të jenë vetëm shovinistë të egër, sepse në kushtetutën serbe Kosovën e konsiderojnë pjesë të territorit të Serbisë. Se jo më kot kryepeshkopi Irinej, komisari politik i udhëheqjes serbe, ka deklaruar se Serbia do të kthehet në Kosovë, qoftë edhe pas dy mijë vjetësh. Por është për të vënë duart në kokë që Liderët pa dinjitet kombëtar në bazë të marrëveshjeve që kanë nënshkruar me Beogradin në Bruksel, në heshtje dhe në fshehtësi nga populli shqiptar i Kosovës, Mitrovicën e Veriut e konsideron territor serb. Mirë do të ishte që ministrja e dialogut të thellohej në kuptimin leksikor të fjalëve *"nacionalizëm"* dhe *"shovinizëm",* në mënyrë që të bindej se çfarë dallimi të thellë kanë ato nga njëra-tjetra.

Mjaft interes ngjallin faqet e librit, ku autori shtron pyetjen: *"A do të bashkohen shqiptarët në një shtet?".*

Çështja e ribashkimit të trojeve tona etnike vazhdon të mbetet e ankthshme që asokohe kur Perëndimi evropian, nën diktatin e shovinizmit rusomadh, i copëtoi në mënyrën më barbare nga trungu amë. Kjo Çështje Madhore e kombit shqiptar kërkon zgjidhje, kërkon zhbërjen e padrejtësisë që atij iu imponua me dhunë nga fuqitë e mëdha evropiane.

Akademik Flori Bruqi ka parashtruar në faqet e këtij librit ecurinë e kësaj Çështjeje, me një nëntekst të qartë: kombit shqiptar duhet t'i kthehet borxhi që i është marrë më shumë se një shekull më parë. Kërkesa për kthimin e atij borxhi ushton në vargjet

poetike, në këngët e artistëve të talentuar apo në intervista dhe artikuj publicistikë.Ja ç'vargje ka hedhur në letër Princi i Polifonisë Lefter Çipa: *Ne s'kemi ëndërr të madhe,/ Aq sa hap krahët shqiponja,/ Shqipërinë Natyrale,/ Katër vilajetet tona.*

Politikanët shqiptarë, këta servilë të regjur të Beogradit, të Athinës dhe të Brukselit, politikanë pa dinjitet kombëtar, le të kërkojnë në *youtube* këngën me titull *"Kurrë s'i ndan shqiptarët kufini",* një këngë kjo me vargje bubulluese që ekzekutohet aq mjeshtërisht nga këngëtarët e talentuar Marie Lajçaj dhe Pëllumb Vinca. Duke pasur parasysh vëllezërit tanë përtej kufirit të Shqipërisë Londineze, kënga ushton: *Na ndan zjarri e na ndan pragu, /na bashkon gjuha dhe gjaku./ Trojet thrrasin me nji za:/ Pa u bashku s'durohet ma,/Ka ardh koha që kem dasht,/Kangë e zemra me i ba bashkë. /Kurrë përjetë s'i qajmë do halle,/Për pa ithanë Shqipni e Madhe,/Pa na kthy borxhin Evropa/Që na ndau në copa-copa.*

Për të theksuar kotësinë e përpjekjeve të politikanëve shqiptarë për pranimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, pa realizimin paraprak të ribashkimit të trojeve tona etnike, akademiku Flori Bruqi ka cituar Dritëro Agollin. Duke vlerësuar lart figurën e Ukshin Hotit për vënien në jetë të idealit të tij kombëtar për ribashkimin e trojeve etnike, Dritëroi ka deklaruar:

"Ne flasim e themi se do të hyjmë në Evropë, do të evropianizojmë Shqipërinë, etj. Të gjitha këto janë fantazira, janë gjysmake. Shqipëria evropianizohet kur të jetë një, e plotë, dhe jo kështu

dy copësh, se kështu nuk evropianizohet kurrë. Kë do të evropianizosh ti, tre milionë banorë do të evropianizosh? Po tre milionë të tjerë? Domethënë, problemi është tepër i ngatërruar për sa i përket evropianizimit të Shqipërisë, civilizimit të saj etj. Civilizim do të thotë kur të jesh një. Po s'qe një nuk je i civilizuar plotësisht. Dhe Ukshini e trajton këtë problem".

Çështja kombëtare shqiptare vazhdon të mbetet e pazgjidhur. Ajo përbën një plagë të madhe që s'po gjen dot shërim për faj të politikanëve shqiptarë, të cilët i gënjen mendja se me servilizmin e tyre para Perëndimit evropian gjoja do të fitojnë simpatin e tij. Në të vërtetë, me qëndrimin e tyre pa dinjitet kombëtar, ata janë shpërblyer me përbuzjen e tij të heshtur.

Me botimin e librit të ri me titull *"Dëshmi të krimit të pandëshkuar",* akademiku Flori Bruqi ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për ndriçimin e shumë të vërtetave tragjike për popullin shqiptar të Kosovës në veçanti dhe për kombin shqiptar në tërësi. Shumë nga këto probleme të mprehta që ai ka parashtruar në këtë libër-monument, duhej ta kishin shqetësuar me kohë e me vakt Akademinë e Shkencave në Tiranë dhe në Prishtinë dhe mbarë klasën politike shqiptare në trekëndëshin Tiranë-Prishtinë Shkup. Atyre u takonte t'i grumbullonin këto fakte tronditëse, të përgatitnin dosjet përkatëse, t'i përkthenin në gjuhët kryesore dhe t'ua nisnin kryeqyteteve të Perëndimit evropian, Brukselit, Departamentit të Shtetit, Kongresit dhe

Senatit Amerikan dhe Këshillit të Sigurimit të OKB-së, në mënyrë që të zhvlerësonin tërësisht gjithë literaturën shpifografike kundër kombit shqiptar, me të cilën Beogradi dhe Athina kanë përmbytur bibliotekat e institucioneve të lartpërmendura ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, kryepolitikanët shqiptarë le të mundohen që, të paktën, një herë të vetme në jetën e tyre, ta kësibëjnë nga vetja servilizmin para të huajve, të bëhen burra të politikës dhe, nga folëtoret e Brukselit, e Departamenti të Shtetit, e Senatit dhe e Kongresit Amerikan, deri në folëtoren e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të ngrenë zërin për ribashkimin e trojeve tona etnike

Mendoj dhe propozoj që akademiku Flori Bruqi, në perspektivë, të përgatitë dhe të botojë një tjetër libër interesant, ku, me mjeshtërinë që e karakterizon, të trajtojë kodin moral të egërsisë grekoserbe përballë kodit moral të fisnikërisë shqiptare, në mënyrë që të dalë mirë në pah e vërteta se shqiptari, tradicionalisht, as hasmin e vet, as armikun që ia ka behur si pushtues, pasi e ka vrarë, nuk e ka pasur zakon ta poshtërojë, ta përçudnojë, ta groposë në varre masive, t'ia djegë kufomën me benzinë apo t'i përdhunojë vajzat dhe gratë dhe aq më pak të vrasë fëmijë, gra, pleq dhe plaka. Dukuri të tilla barbare kanë qenë dhe mbeten të papërfytyrueshme për kodin moral të fisnikërisë shqiptare. Por duhet të theksojmë se kodin e shëndetshëm të moralit fisnik shqiptar, na e ndoti keq krimineli Enver Hoxha, sipas urdhrave që merrte nga emisarët kriminalë jugosllavë gjatë viteve të

luftës. Në një radiogram që i dërgonte Korparmatës I më 21 shtator 1944, ky kriminel dhe agjent i regjur i Beogradit, urdhëronte:

"Zai Fundon ta torturoni deri në vdekje dhe pastaj ta pushkatoni" (Citohet sipas: *"Dokumenti, si u vra Llazar Fundo me urdhër të Enverit".* Faqja e internetit e gazetës *"Panorama".* 02 tetor 2014).

Kodin e egërsisë morale serbosllave, krimineli Enver Hoxha e praktikoi gjerësisht kundër përfaqësuesve të shquar të nacionalizmit shqiptar gjatë tërë periudhës së sundimit të tij dikatorial. Ndonjë shfaqje e shëmtuar e atij kodi moral barbar u vu re edhe në ngjarjet tragjike të vitit 1997, kur me kufomën e oficerit të vrarë të SHIK-ut Lek Qoku, tallej një turmë studentësh të ndërkryer në njërin nga auditoret e Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës dhe kur një femër e përbindshme mundohej t'i pinte gjakun.

Gjithsesi, akademiku Flori Bruqi, si një figurë e shquar me përgatitje enciklopedike, si një intelektual i nderuar erudit, e ka kryer dhe do të vazhdojë ta kryejë gjithmonë me nder detyrën e shenjtëruar para kombit shqiptar.

Nderim dhe respekt të thellë për këtë punëtor të palodhur të letrave shqipe me vlera të rralla shkencore, intelektuale.

Santa Barbara, Kaliforni,
më 8 qershor, 2017

KUR NATO GJUNJËZONTE SERBINË

Në 9 korrik 1998, Presidenti i SHBA, Bill Clinton, deklaroi "emergjencën kombëtare" (gjendje e jashtëzakonshme) për shkak të "kërcënimit të pazakontë dhe të jashtëzakonshëm të sigurisë kombëtare dhe politikave ndërkombëtare të Shteteve të Bashkuara" imponuar nga Jugosllavia dhe Serbia mbi Luftën e Kosovës.

Në 23 shtator 1998, nën Kapitullin VII të Kartës së OKB-së, Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, pranoi Rezolutën 1199. Kjo shprehte një "shqetësim të madh" me raportet që i arrinin Sekretarit të Përgjithshëm që mbi 230 000 njerëz janë dëbuar nga shtëpitë e tyre nga "përdorimi i forcës së tepërt dhe diskriminuese nga forcat e sigurisë serbe dhe Ushtria Jugosllave", duke kërkuar që të gjitha palët në Kosovë dhe në Republikën Federale të Jugosllavisë (Serbia dhe Mali i Zi) të ndalojnë armiqësinë dhe të mbajnë një armëpushim.

Në 24 shtator, Këshilli i Atlantikut të Veriut (NAC) i NATO-s, lëshoi një "paralajmërim aktivizimi" (ACTWARN) duke e çuar NATO-n në një nivel më të lartë gatishmërie ushtarake si për një mundësi të limituar

ajrore ashtu edhe për një fushatë ajrore me faza në Kosovë.

Problemi i madh për ata që shihnin si zgjidhjen e vetme përdorimin e forcës ishin mbi 250 000 shqiptarë të dëbuar, 30 000 prej të cilëve ishin në qiell të hapur në pyje, pa veshmbathje apo strehim, dhe me dimrin që afrohej shpejt.

Ndërkohë, ambasadori amerikan në Republikën e Maqedonisë, Christopher Hill, po drejtonte diplomacinë ndërmjet delegacionit shqiptar, të drejtuar nga Rugova, dhe autoriteteve jugosllave dhe serbe.

Në këto mbledhje po bëhej një plan paqeje pas planifikimit të NATO-s për pushtimin e Kosovës. Gjatë një periudhe prej dy javësh, kërcënimet u shtuan, duke kulmuar në dhënien nga NATO të Urdhërit të Aktivizimit.

NATO ishte gati të fillonte sulmet ajrore, dhe Richard Holbrooke shkoi në Beograd me shpresën se do të arrinte një marrëveshje me Millosheviçin. Zyrtarisht, komuniteti ndërkombëtar kërkoi të ndaloheshin luftimet.

Specifikisht kërkohej që Jugosllavia të pushonte ofensivën ndaj UÇK-së ndërkohë që përpiqej që të bindte UÇK-në të heqë dorë nga pavarësia.

Më tepër, u bënë përpjekje për të bindur Millosheviçin të lejonte trupat paqeruajtëse të NATO-s të hynin në Kosovë.

Në 13 tetor 1998, Këshilli i Atlantikut të Veriut lëshoi urdhërat e aktivizimit (ACTORD) për ekzekutimin e sulmeve të limituara ajërore po ashtu edhe fushatë ajërore me faza në Jugosllavi e cila do të fillonte përafërsisht për 96 orë.

Në 15 tetor, Marrëveshja e Misionit të Verfikimit në Kosovë, (KVM) i NATO-s për armëpushim, u firmos, dhe afati i fundit për tërheqjen u zgjat për në 27 tetor.

Tërheqja serbe filloi në ose rreth 25 tetorit 1998, dhe Operacioni Syri i Shqiponjës (Eagle Eye) filloi në 30 tetor.

KVM ishte një kontigjent i madh i monitoruesve të paarmatosur të paqes nga OSBE (të njohur zyrtarisht si verifikues) të cilët u futën në Kosovë. Pamjaftueshmëria e tyre ishte e dukshme që në fillim.

Ata u quajtën me nofkën "clockwork oranges" (me kuptimin në zhargon anglisht si diçka e pavend dhe të panevojshme) si referencë për makinat me ngjyrë portokalli që përdornin. Luftimet filluan sërisht në dhjetor 1998 pasi armëpushimi u thye, dhe gjatë luftimeve u vra Zvonko Bojanić, kryebashkiaku serb i Fushë Kosovës. Autoritetet jugosllave u përgjigjën me masa të ashpra ndaj ushtarëve të UÇK-së.

Nga janari në mars 1999 lufta solli pasiguri në zonat urbane, duke përfshirë bombardime dhe vrasje. Të tilla sulme u kryen edhe gjatë bisedimeve ne Rambuje në shkurt dhe ndërkohë që Marrëveshja e Verifikimit në Kosovë u zgjidh në mars.

Vrasjet në rrugë vazhduan dhe u rritën. Kishte përplasje ushtarake në Vushtri, në shkurt, dhe zonë e paprekur deri tani në luftime në Kaçanik në fillim të marsit.

Në 15 janar 1999 ndodhi Masakra e Reçakut ku "45 fermerë shqiptarë u rrethuan, u drejtuan drejt një kodre dhe u masakruan”.

Trupat u zbuluan nga monitoruesit e OSBE-së, duke përfshirë edhe Kryetarin e Misionit, William Walker, dhe të dërguarit e huaj të shtypit ndërkombëtar. Jugosllavia e mohoi masakrën.

Masakra e Reçakut ishte kulmimi i sulmeve të UÇK-së dhe reprezaljes së jugosllavëve që vazhduan përgjatë gjithë dimrit 1998–1999. Masakra u ndëshkua nga vendet perëndimore dhe nga Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, dhe më vonë u bë baza e një nga akuzave për krime lufte ndaj Millosheviçit dhe zyrtarëve të tij më të lartë.

Kjo masakër ishte një pikë kthese e luftës. NATO vendosi se konflikti mund të zgjidhej vetëm duke vendosur një mision paqeruajtës ushtarak nën komandën e NATO-s. Prishtina u bë subjekt i përleshjeve me armë dhe dëbimit të popullsisë sipas raporteve të OSBE-së.

Në 30 janar 1999, NATO lëshoi një deklaratë ku Këshilli i Atlantikut të Veriut kishte pranuar që "Sekretari i Përgjithshëm i NATOs mund të autorizojë sulme ajrore kundër shënjestrave në territorin e RFJ", në mënyrë që të arrihej një marrëveshje politike".

Ndërkohë që kjo ishte më shumë një kërcënim për qeverinë e Millosheviçit, ajo po ashtu ishte një sprovë për të gjithë faktorin politik shqiptar.

Po ashtu në 30 janar 1999, Grupi i Kontaktit lëshoi një set "principesh të panegociueshme" gjë që krijoi një paketë të njohur si "Status Quo Plus" efektivisht rikthimin e autonomisë së Kosovës si para vitit 1990 brenda Serbisë, plus futjen e demokracisë dhe vëzhgim nga organizatat ndërkombëtare. Po ashtu kërkohej një konferencë paqeje e cila pritej të mbahej në shkurt 1999

në kështjellën Château de Rambouillet, jashtë Parisit në Francë.

Bisedimet e Rambujesë filluan në 6 shkurt 1999, me Sekretarin e NATO-s Javier Solana i cili negocionte me të dyja palët. Ato ishin përcaktuar të përfundonin në 19 shkurt.

Delegacioni jugosllav drejtohej nga presidenti i Serbisë Milan Milutinović, ndërkohë që Millosheviçi qëndronte në Beograd. Kjo ishte në kontrast me konferencën e Dejtonit në 1995 e cila përfundoi luftën në Bosnje, ku Millosheviçi negocioi personalisht.

Mungesa e Millosheviçit u interpretua si shenjë se vendimet e vërteta po bëheshin në Beograd, një lëvizje që e rriti kriticizmin në Jugosllavi dhe jashtë saj; peshkopi serb i Kosovës Artemije udhëtoi në Rambuje për të protestuar për faktin se delegacioni ishte tejet i papërfaqësuar. Gjatë asaj kohe spekulohej për një padi të mundshme për krime lufte ndaj Millosheviçit, kështu që mungesa e tij mund të jetë motivuar nga frika për arrestimin e tij.

Në fazën e parë negociatat ishin të suksesshme. Në veçanti, një deklaratë e lëshuar nga bashkë-kryetari i Grupit të Kontaktit në 23 shkurt 1999 se negociatat "kanë arritur një konsensus për një autonomi për Kosovën, duke përfshirë mekanizma për zgjedhje të lira dhe të ndershme për institucione demokratike.

Ndërkohë që marrëveshja nuk i kënaqi plotësisht shqiptarët, sipas jugosllavëve ata ishin shumë radikalë, të cilët u përgjigjën duke ndryshuar në mënyrë drastike tekstin të cilën edhe Rusia (aleat i RFJ) e quajti të papranueshëm. Ata kërkonin të rishikonin me kujdes

statusin politik të Kosovës dhe larguan të gjitha masat e propozuara për implementim. Ndërmjet gjithë këtyre ndryshimeve në versionin e ri të propozuar, eleminohej komplet kapitulli për ndihmën humanitare dhe rindërtim, hiqej komplet mbikëqyrja ndërkombëtare dhe nuk përmendej "vullneti i popullit të Kosovës" në vendosjen e statusit përfundimtar të Kosovës.

Në 18 mars 1999, delegacionet shqiptare, amerikane dhe britanike firmosën atë që u bë Marrëveshja e Rambujesë, ndërkohë që delegacionet jugosllave dhe ruse nuk pranuan. Marrëveshja kërkonte për administrimin e Kosovës nga NATO, si një provincë autonome brenda Jugosllavisë, një forcë prej 30,000 trupash të NATO-s për mbajtjen e rregullit në Kosovë; të drejtën e kalimit të papenguar të trupave të NATO-s në territorin jugosllav, përfshirë Kosovën; dhe imunitet për NATO-n dhe agjentët e saj nga ligji jugosllav.

Do të lejohej një prani e vazhdueshme e ushtrisë jugosllave me 1500 trupa për vëzhgimin e kufirit, të mbështetura nga 1000 trupa për qëllime komande dhe mbështetje, po ashtu edhe një numër të vogël policie kufitare, 2500 njerëz nga Ministria e Brendshme për qëllime sigurie të përgjithshme, dhe 3000 policë lokalë.

Megjithëse qeveria jugosllave citoi dispozitat ushtarake të Shtojcës B të dispozitave të Rambujesë si arsyen e kundërshtimeve të tyre, duke thënë se ishte një dhunim i papranueshëm i sovranitetit të Jugosllavisë, këto dispozita ishin thelbësisht të njëjta me ato të zbatuara në Bosnje për misionin SFOR (Stabilisation Force) pas Marrëveshjes së Dejtonit në 1995. Dy palët

nuk i diskutuan problemet me detaje për shkak të mosmarrëveshjeve më thelbësore.

Në veçanti, pala sebe nuk e pranonte idenë e pranisë së trupave të NATO-s në Kosovë duke zëvendësuar forcën e tyre të sigurisë, duke preferuar më mirë vëzhgues të paarmatosur të OKB-së.

Vetë Millosheviçi refuzoi të diskutojë shtojcën pasi informoi NATO-n që ishte e papranueshme, edhe pasi atij iu ofrua të propozojë amendamente për dispozitat në mënyrë që të bëheshin të pranueshme.

Ngjarjet rrodhën shpejt pas dështimit në Rambuje dhe pas propozimit alternativ jugosllav.

Monitoruesit ndërkombëtarë të OSBE-së u tërhoqën më 22 mars, për frikën për sigurinë e monitoruesve që i paraprinte fushatës bombarduese të NATOs.

Në 23 mars, kuvendi serb pranoi principin e autonomisë për Kosovën dhe pjesën jo-ushtarake të marrëveshjes, duke refuzuar praninë e trupave të NATO.

Më 23 mars 1999, Sekretari i atëhershëm i Përgjithshëm i NATO-s Havier Solana ua jepte "go-ahead" (lejen) forcave ajrore për t'i filluar bombardimet mbi makinerinë e luftës të Beogradit.

Të nesërmen, më 24 mars 1999, në orën 19:00, nata ndërmjet kësaj date dhe 25 marsit 1999 u shndërrua në ditë nga bombarduesit e NATO-s.

Pak më vonë, në ekranet televizive në mbarë botën, u shfaq Presidentit i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bill Klinton, i cili, konfirmoi urdhërin e dhënë në cilësinë e Komandantit të Forcave të SHBA, në cilësinë e vendit kampion të lirisë, demokracisë, të drejtësisë, që

makineria e luftës e Millosheviçit dhe e përkrahësve të tij të përballej me aleancën më të fuqishme ushtarake të të gjitha kohërave, NATO-n. Njerëzimi ishte dëshmitari më i mirë se veprimi i atij 24 marsi ishte absolutisht i pazëvendësueshëm në historinë e tij.

Njerëzimi ishte dëshmitari më i mirë i veprës kriminale të cilën Serbia e vazhdoi përgjatë 78 ditëve të fushatës së bombardimeve.

Serbia përzuri nga Kosova gjatë atyre ditëve për në Shqipëri dhe për në Maqedoni 1 milionë shqiptarë, qindra mijë shqiptarë të tjerë u përzunë nëpër pyjet dhe përrenjtë e Kosovës. Gjatë atyre 78 ditëve Serbia e kulmoi egërsinë e saj ndaj kombit shqiptar në Kosovë, duke e mbjellë Kosovën me varreza të panumërta masive.

Mbi dhjetë mijë shqiptarë të pafajshëm u masakruan në mënyra më të pashembullta të barbarisë gjatë asaj pranvere të vitit 1999. Në mesin e qershorit 1999 forcat e NATO-s hynë në Kosovë, duke ia sjellë, bashkë me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, lirinë e merituar këtij vendi dhe këtij populli. Kosova e kaloi me dinjitet edhe periudhën e protektoratit ndërkombëtar dhe më 17 shkurt 2008, në bashkërendim me aleatët perëndimorë, me në krye Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shpalli shtetin e saj të pavarur dhe sovran. Një vit pas kësaj date Kosova dëshmon përditë e më shumë synimet e saj për të qenë sa më shpejt në radhët e NATO-s dhe të Bashkimit Evropian.

24 marsi 1999, një datë prej së cilës ka nxjerrë mësime mbarë njerëzimi, ka nxjerrë para së gjithash mësimin se proceset e pandalshme mund të vonohen, mund të pengohen, por kurrë nuk mund të ndalen.

24 marsi 1999 ia dha njerëzimit mësimin se, pa ua dhënë shqiptarëve peshën e duhur në kuadrin e proceseve rajonale në gadishullin e Evropës Juglindore, nuk do të ketë stabilitet në këtë rajon as në kontinent dhe më gjerë.

Për shqiptarët 24 marsi 1999 është data e pazëvendësueshme e mirënjohjes ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe aleatëve perëndimorë, është data e pazëvendësueshme e përbetimit për integrime të suksesshme fqinjësore, evropiane e perëndimore, për një rol gjithnjë konstruktiv e paqësor, është data e pazëvendësueshme e përbetimit për të qenë të bashkuar përballë të gjitha sfidave.

***

18 vjet nga sulmet e NATO-s kundër Serbisë, të cilat kishin nisur me 24 mars 1999 dhe kanë zgjatur 11 javë, respektivisht 78 ditë.

Ekspertët vlerësojnë se gjatë këtyre ditëve të bombardimeve Serbisë i ishte shkaktuar një dëm prej rreth 30 miliardë dollarë, ndërsa vlerësohet të jenë vrarë disa mijëra ushtarë serbë në Kosovë dhe Serbi. Sulmet janë kryer nga anijet luftarake amerikane nga Adriatiku dhe bazat ajrore italiane në Itali.

Bombardimet kanë përfunduar më 10 qershor me miratimin rezolutës 12 44 të KS. Si rezultat ka pasuar largimi i forcave serbe nga Kosova dhe hyrja e trupave të NATO-s, dhe, fill më pas kthimi i mbi 800 mijë refugjatëve shqiptarë nga Kosova, të dëbuar më parë me dhunë nga ushtria serbe.

Në kuadër të KFOR në Kosovë në vitin 1999 kishin hyrë 37 mijë e 200 ushtarë nga 37 vende. Aktualisht KFOR-i ka mbi 16 mijë trupa në Kosovë.

Lufta e drejtë e popullit të Kosovës, e udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, bëri që aleanca ushtarake më e fuqishme në botë të vihet në mbështetje të mbrojtjes së vlerave më të larta të civilizimit perëndimor në Kosovë, lirisë, paqes dhe demokracisë.

Me rastin e nëntëvjetorit të fillimit të bombardimeve të NATO-s mbi pozicionet ushtarake dhe policore serbe, shprehim ndjenjat më të larta të respektit për Aleancën ushtarake, NATO-n dhe bashkësinë ndërkombëtare, që u vunë në mbrojtje të Kosovës në ditët më të vështira dhe më vendimtare.

Bota demokratike dhe Aleanca më e fuqishme e globit NATO-ja, dhanë kontribut historik në çlirimin e Kosovës, duke bërë që data 24 mars 1999 të jetë fillim i një epoke të re për Kosovën. Populli i Kosovës i është mirënjohës përjetë NATO-s dhe të gjitha shteteve që përkrahën luftën e drejtë.

Kosova është e lirë, ka ndërtuar shtetin e saj të pavarur dhe demokratik, të njohur ndërkombëtarisht, me përkushtim të veçantë për të mbrojtur të drejtave të minoriteteve dhe me synimin për t'u integruar në Bashkimin Evropian dhe në NATO. Shteti demokratik i Kosovës do të jetë gjithmonë faktor i paqes dhe stabilitetit në rajon.

Sot, kur kemi përmbyllur kapitullin e ndërtimit të shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës, kujtojmë me nderim të lartë sakrificën sublime të luftëtarëve të UÇK-

së, të dëshmorëve tanë, të cilët ranë që brezat e ardhshëm të jetojnë në Kosovën e lirë, demokratike dhe të pavarur.

Në këto ditë të përkujtimit të intervenimit të NATO-së mbi caqet serbe, iu shprehim mirënjohje të përhershme Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bashkimit Evropian dhe të gjitha vendeve që ndihmuan çlirimin dhe pavarësimin e Kosovës dhe që sot po ndihmojmë forcimin e institucioneve demokratike të vendit tonë.

Mirënjohje të veçantë ju shprehim liderëve dhe personaliteteve botërore që mbështetën luftën e drejtë të popullit tonë për çlirim dhe demokraci, ish-presidentit Klinton, ish-kryeministrit Bler, ish-sekretares Ollbrajt, z. Solana dhe personaliteteve tjera perëndimore.

Edhe në këtë fazë Kosova mirëpret prezencën ushtarake të NATO-s dhe ndihmën e përgjithshme të shteteve demokratike.

Në këtë përvjetor historik për vendin tonë, iu shprehim falënderim të veçantë forcave të NATO-s në Kosovë, KFOR-it, që garanton lirinë, stabilitetin dhe paqen në Kosovës.

Ish Kryeministri i Serbisë, Vojislav Kostunica, thotë se NATO e bombardoi Serbinë për të krijuar një shtet të vetin "në territor të Serbisë".

Operacionet ushtarake të NATO-s ndryshuan thelbësisht në sulmin e njësive tokësore jugosllave, duke goditur shënjestra si tanket dhe artilerinë, ndërkohë që vazhdohej me bombardimin strategjik. Ky aktivitet gjithësesi, ishte shumë i përmbajtur nga politika, pasi çdo shënjestër duhej të aprovohej nga të gjithë 19 shtetet anëtare. Mali i Zi u bombardua në disa raste por NATO

eventualisht pushoi së përkrahuri pozicionin e pasigurt të liderit të saj anti-Millosheviç, Milo Gjukanoviç.

Përveç shënjestrave të drejtpërdrejta ushtarake, u sulmuan edhe shënjestra që mund ti hynin në dihmë ushtrisë, siç ishin ura përgjatë Danubit, fabrika, centrale energjie, shkolla, shtëpi, spitale, impiante telekomunikimi dhe shtabi i përgjithshëm i të majtëve të Jugosllavisë një parti e drejtuar nga gruaja e Millosheviçit dhe kulla e transmetimit të RTS.

Në fillim të majit, një avion i NATO-s sulmoi një karvan refugjatësh shqiptarë, duke menduar se ishte një karvan ushtarak jugosllav, duke vrarë rreth 50 njerëz. NATO e pranoi fajin pesë ditë më vonë dhe jugosllavët akuzuan NATO-n për sulm me vetëdije ndaj refugjatëve.

Një raport i mëvonshëm i hartuar nga Gjykata Ndërkombëtare Kriminale për ish Jugosllavinë (ICTY) me titull "Raporti Përfundimtar për Prokurorin nga Komiteti i Caktuar për Rishikimin e e Fushatës Bombarduese të NATO-s Kundër Republikës Federale të Jugosllavisë" ku thuhej se "civilët nuk u sulmuan me dashje në këtë incident" dhe se "as ekuipazhi dhe as komandantët nuk u treguan të pamatur për të marrë masa parandaluese të cilat do tu hiqnin akuzat kriminale." Në 7 maj, disa bomba të NATO-s godasin ambasadën kineze në Beograd, duke vrarë tre gazetarë kinezë dhe duke egërsuar opinionin publik kinez.

Shtetet e Bashkuara dhe NATO më vonë kërkuan falje për bombardimin, duke thënë se ishte një gabim i shkaktuar nga një hartë e pasaktë e para shumë viteve. Një tjetër incident ishte masakra e burgut të Dubravës në maj 1999, ku qeveria jugosllave akuzoi për vrasjen e 85

civilëve pas bombardimit nga NATO të kompleksit. Një raport i mëvonshëm i Human Rights Watch arriti në përfundimin se rreth 19 të burgosur dhe gardianë u vranë nga bombardimi, por që një numër i pasaktë – ndoshta më shumë se 70 shqiptarë – u vranë nga forcat qeveritare serbe në ditët që kaluan pas bombardimit.

Nga fillimi i prillit, konflikti ishte shumë larg zgjidhjes dhe vendet e NATO-s filluan të mendonin seriozisht për operacione tokësore në Kosovë.

Kryeministri Britanik Tony Blair ishte avokat i fortë për sulm me trupa tokësore dhe i bënte presion Shteteve të Bashkuara që të pranonin; qëndrimi i tij i ashpër shkaktoi pak alarm në Uashington pasi forcat amerikane duhej të ishin me të larta në numër në çdo mësymje.

Presidenti i SHBA-ve Bill Clinton ishte shumë vendosur për sulm tokësor të drejtuar nga forcat amerikane. Por në vend të kësaj, Clinton autorizoi një operacion të CIA-s për të gjetur metoda destabilizimi për dobësimin e qeverisë jugosllave pa nevojën e trajnimit të UÇK-së. Në të njëjtën kohë, negociatorët finlandezë dhe rusë nisën të provojnë të bindnin Millosheviçin të tërhiqej.

Tony Blair do të urdhëronte 50,000 ushtarë britanikë të bëheshin gati për mësymje tokësore.

Millosheviçi më në fund kuptoi se Rusia nuk do të ndërhynte të mbronte Jugosllavinë pavarësisht retorikës së fortë anti-NATO të Moskës. Kështu që ai pranoi kushtet e ofruara të ekipit të ndërhyrjes Finlandezo-Rus dhe pranoi një prani ushtarake në Kosovë

të drejtuar nga OKB, por me pjesëmarrjen edhe të trupave të NATOs.

Forcat speciale norvegjeze Hærens Jegerkommando dhe Forsvarets Spesialkommando bashkëpunuan me UÇK-në në mbledhjen informacioneve të inteligjencës. Duke u pregatitur për pushtim në 12 qershor, forcat speciale Norvegjeze punuan së bashku me UÇK në zonat malore kufitare me Maqedoninë dhe kryesisht merreshim me zbulim për të monitoruar ngjarjet në Kosovë.

Bashkë me forcat speciale britanike, forcat speciale norvegjeze ishin të parat që kaluan kufirin për në Kosovë. Sipas gazetarit të Sky News, Keith Graves, norvegjezët ishin futur në Kosovë dy ditë para marshimit të forcave të tjera dhe ishin ndër të parët që u futën në Prishtinë. Detyrat e Hærens Jegerkommando dhe Forsvarets Spesialkommando ishte të pastronin rrugën dhe të qetësonin palët, serbët dhe shqiptarët.

Më 3 qershor 1999, Millosheviçi pranoi kushtet e një plani ndërkombëtar paqeje për të ndaluar luftimet, ku në kuvendin kombëtar po pranoheshin propozimet pavarësisht debateve të ashpra dhe përleshjeve me grushta në disa raste.

Në 10 qershor Komiteti i Atlantikut të Veriut ratifikoi marrëveshjen dhe pezulloi operacionet ajërore.

Marinsat e SHBA marshojnë së bashku me fëmijët shqiptarë në rrugët kryesore të Zhegrës në 28 qershor 1999.

Më 12 qershor, pasi Millosheviçi pranoi kushtet, misioni i drejtuar nga NATO, Kosovo Force (KFOR), filloi të futej në Kosovë. KFOR ishte pregatitur të kryente

operacione luftarake, por në fund, misioni i tij mbeti vetëm paqeruajtja.

KFOR ishte i bazuar nën shtabin e Allied Rapid Reaction Corps (Trupat e Reagimit të Shpejtë Aleate) të komanduara nga Gjeneral Lejtnant Mike Jackson i Ushtrisë Britanike.

Ku konsistonte në trupa britanike (një brigadë e ndërtuar nga brigada e IV e blinduar dhe brigada e V e parashutistëve), një brigadë e Ushtrisë Franceze, një brigadë e Ushtrisë Gjermane, të cilat hynë nga perëndimi ndërkohë të gjitha forcat e tjera avancuan nga jugu, me një brigadë e Ushtrisë Italiane dhe një brigadë e Ushtrisë Amerikane.

Trupat e para të NATO-s që u futën në Prishtinë në 12 qershor 1999 ishin forcat speciale Norvegjeze FSK Forsvarets Spesialkommando dhe forcat speciale ajrore Britanike S.A.S. 22 Special Air Service, pavarësisht se trupat ruse ishin të pranishme më parë në aeroportin e Prishtinës. Ushtarët norvegjezë të FSK Forsvarets Spesialkommando ishin të parat që ranë kontakt me trupat ruse në aeroport. Misioni i FSK ishte të implementonte paqen ndërmjet palëve shqiptare dhe serbe.

Kontributi i SHBA, i njohur si Initial Entry Force (Forca Fillestare Hyrëse), u drejtua nga Divizioni i I-rë i Blinduar, i komanduar nga Gjeneral Brigade Peterson, e udhëhequr nga një togë nga Batalioni i II-të dhe nga Regjimenti Parashutisht i 505-të i Këmbësorisë i bashkuar me Forcat Britanike. Të tjera njësi përfshinin Batalionet I dhe II nga Grupi i Forcave Speciale (parashutiste) nga Stuttgarti, Gjermani dhe Fort Carson,

Colorado dhe shumë njësi të tjera të Ushtrisë Amerikane të vendosura në Europë dhe SHBA. Forcat fillestare të SHBA e vendosën zonën e veprimit përreth qyteteve të Ferizajt, më vonë Kampi Bondsteel, dhe Gjilan, në Kampin Monteith.

Gjatë mësymjes fillestare, ushtarët e SHBA u përshëndetën nga shqiptarët me brohoritje dhe lule gjatë kohës që KFOR kalonte nëpër fshatra. Megjithëse nuk kishte aspak rezistencë, tre ushtarë amerikanë humbën jetën në aksidente.

Më 1 tetor 1999, përafërsisht 150 parashutistë të SHBA u parashutuan në Ferizaj si pjesë e Operation Rapid Guardian (Operacioni Gardiani i Shpejtë). Qëllimi i misionit ishte kryesisht për të paralajmëruar Presidentin e Jugosllavisë Sllobodan Millosheviç për aftësinë e shpejtë të veprimit dhe kapacitetet e NATO-s në Kosovë. Një ushtar amerikan humbi jetën gjatë uljes pasi parashuta e tij nuk u hap.

Më 15 dhjetor 1999, një ushtar amerikan humbi jetën, pasi mjeti HMMWV ku ai ishte pasagjer ra në një minë.

Pas fushatës ushtarake, përfshirja e paqeruajtësve rusë rezultoi shumë e tendosur dhe sfiduese për KFOR. Rusët prisnin të kishin një sektor të pavarur të Kosovës, por u surprizuan kur misioni filloi nën komandën e NATO-s.

Pa komunikuar paraprakisht, pa koordinim me NATO-n, paqeruajtësit rusë hynë në Kosovë nga Bosnja dhe Hercegovina dhe pushtuan Aeroportin e Prishtinës para ardhjes së forcave të NATO-s, gjë e cila rezultoi në Incidentin në Aeroportin e Prishtinës ku dëshira e

Komandantit Suprem të NATO-s, Wesley Clark, ishte të bllokonte pistën e aeroportit me mjete të NATO-s, për të parandaluar përforcimet ruse, por u refuzua nga komandanti i KFOR, Gjenerali Mike Jackson.

Më 2010, James Blunt përshkroi në një intervistë se si njësisë së tij i ishte dhënë detyra për sigurimin e Prishtinës gjatë avancimit të forcës paqeruajtëse prej 30,000 trupash dhe se si ushtria ruse ishte futur dhe kishte marrë kontrollin e aeroportit të Prishtinës para se njësia e tij të arrinte.

Blunt ndau një pjesë të detyrës e cila mund të rezultonte një incident i dhunshëm ndërkombëtar. Sipas njohurive të Blunt kishte një përballje pa armë me rusët, dhe Komandanti Suprem i NATO-s, Wesley Clark, dha urdhra paraprake për ti mposhtur rusët. Ndërkohë që kishte një tërheqje nga Blunt, urdhri u tërhoq nga Gjenerali Jackson, me shprehjen tashmë të famshme, "Nuk do ti bëj ushtarët e mi përgjegjës për nisjen e Luftës së Tretë Botërore."

Për shkak të ligjeve censuruese të medias, media jugosllave nuk mbulonte ngjarje që ndodhnin në Kosovë, po ashtu edhe sjellja e vendeve ndaj katastrofës humanitare që po ndodhte atje. Kështu që, shumë pak nga publiku jugosllav prisnin ndërhyrjen e NATO, por mendohej gjërësisht se do të arrihej një marrëveshje diplomatike.

Mbështetja për Luftën e Kosovës dhe, në veçanti, ligjshmëria për fushatën bombarduese të NATOs vinte nga burime të ndryshme. Në një artikull në 2009, David Clark shkruante se "Çdo anëtar i NATO, çdo vend i BE, dhe shumica e fqinjëve të Jugosllavisë, mbështesnin veprimet

ushtarake" me deklarata nga liderët Bill Clinton, Václav Havel dhe Tony Blair respektivisht e përshkruanin luftën si, "një sulm me tanke dhe artileri mbi një popullsi të pambrojtur liderët e të cilëve kishin pranuar paqen", "lufta e parë për vlera" dhe "për të shmangur atë që mund të bëhej një katastrofë humanitare në Kosovë".

Të tjerë, si sekretari i përgjithshëm i OKB, Kofi Annan, i cili i quante veprimet e NATO si të drejta, theksoi se në disa raste përdorimi i forcës është i nevojshëm për të sjellë paqen, megjithëse Annan tha se "Këshilli duhej të përfshihej në vendimet për përdorimin e forcës."

Në një raport të Komisionit Ndërkombëtar të pavarur në Kosovë, me titull The Kosovo Reporti i cili zbuloi se: “forcat jugosllave nisën një fushatë terrori të planifikuar mirë dhe dëbimin e shqiptarëve të Kosovës. Kjo fushatë përshkruhet shpesh si "pastrim etnik", me qëllimin për të larguar shumë, në mos të gjithë, shqiptarët nga Kosova, për të shkatërruar shoqërinë e tyre, dhe për të parandaluar rikthimin e tyre“, ku përfundoi se "ndërhyrja e NATO-s ishte ilegale por e nevojshme".

Një tjetër raport u publikua nga Zyra e Informacionit dhe e Shtypit të NATO-s ku thuhej se, "shkeljet e të drejtave të njeriut në shkallë të gjerë në Kosovë japin një terren të pakundërshtueshëm reference për aspektin humanitar të ndërhyrjes së NATO."

Disa kritikë shtojnë se NATO nuk kishte mbështetjen e Këshillit të Sigurimit të OKB që do të thotë se nuk kishte bazë ligjore, por sipas disa shkollarëve të njohur, "nuk kishte asnjë bazë të sigurtë ligjore për atë veprim, i cili u justifikua."

Përveç politikanëve dhe diplomatëve, komentuesit dhe intelektualët po ashtu mbështesnin luftën. Michael Ignatieff e quajti ndërhyrjen e NATO-s një "përgjigjje moralisht e justifikueshme ndaj spastrimit etnik dhe vërshimit të refugjatëve, dhe jo si shkak për vërshimin e emigrantëve", ndërkohë që Christopher Hitchens tha se NATO ndërhyri vetëm, "kur forcat serbe filluan dëbimet masive dhe spastrim etnik në shkallë të gjerë."

Duke shkruar tek The Nation, Richard A. Falk shkroi se, "fushata e NATO arriti heqjen e forcave ushtarake jugosllave nga Kosova dhe më e rëndësishmja largimin e njësive paraushtarake dhe policore serbe".

Disa kritikuan ndërhyrjen e NATO si shmangie taktike politike, pasi erdhi direkt pas skandalit të Monica Lewinsky, duke nënvizuar se media amerikane zëvendësoi vëmendjen tek lufta.

Gjithashtu, disa theksojnë se para bombardimit, në vend që të ishte një konflikt i përgjakshëm, UÇK nuk u përfshi në luftën civile ndaj forcave jugosllave dhe se shifrat e të vrarëve (përfshirë edhe shqiptarët) u rritën pas ndërhyrjes së NATO.

Gjithësesi, mungesa e luftës nuk do të thoshte se kishte paqe mes serbëve dhe shqiptarëve, siç kanë theksuar burime të tjera, duke cituar vdekjen e 1500 shqiptarëve dhe dëbimin e 270000 të tjerëve para ndërhyrjes së NATO dhe represionin dramatik të popullsisë shqiptare pavarësisht ndryshimeve kushtetuese të regjimit të Millosheviçit që imponontе një "aparteid" në Kosovë.

Presidenti i SHBA Clinton dhe administrata e tij u akuzuan se kishin rritur numrin e të vrarëve shqiptarë nga forcat shtetërore serbe.

Pas bombardimit të ambasadës kineze në Beograd, Kryeministri kinez Jiang Zemin tha se SHBA po përdorte superioritetin ekonomik dhe ushtarak për të rritur progresivisht influencën në vende të tjera. Liderët kinezë e quajtën fushatën e NATO një precedent i agresionit lakuriq, një formë e re e kolonializmit, një luftë agresive e pabazë në moral dhe ligj. U pa si një komplot i SHBA për të shkatërruar Jugosllavinë, të zgjerohej në lindje dhe të kontrollojë të gjithë Europën.

Karta e Kombeve të Bashkuara nuk lejon ndërhyrjet ushtarake në vende të tjera sovrane me disa përjashtime të cilat, në përgjithësi, duhej të vendoseshin nga Këshilli i Sigurimit të OKB; kjo çështje ligjore provoi të ishte kontroverse ndërmjet shumë shkollarëve ligjorë të cilët debatojnë se megjithëse Lufta e Kosovës ishte ilegale, ishte sërisht e drejtë. Çështja u soll në Këshillin e Sigurimit të OKB nga Rusia, në një projekt-rezolutë e cila, inter alia, do të konfirmote "se përdorimi i forcës nga vetëm një palë konstituon në një shkelje flagrante të Kartës së Kombeve të Bashkuara". Kina, Namibia, dhe Rusia votuan për rezolutën, anëtarët e tjerë dolën kundër, kështu që dështoi.

Lufta la shumë të vrarë. Që prej marsit 1999, luftimet dhe shënjestrimi i ndërtesave civile la rreth 1500 –2000 civilë dhe luftëtarë të vrarë. Numri përfundimtar i të vrarëve nuk është isigurtë për çdo palë.

3.24.2017

KËRKO FALJE CARLA DEL PONTE !

E vërteta doli në shesh dhe më shumë u gëzova për Kosovën se për veten, kështu është shprehur ish-kryeministri Ramush Haradinaj, vetëm pak minuta pasi që Tribunali i Hagës e shpalli të pafajshëm në të gjitha pikat e aktakuzës.
Këshilli Organizues për pritjen e Kryetarit të AAK-së dhe ish-Kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, njofton se Haradinaj pritet të arrijë në Aeroportin e Prishtinës në ora 17:00 me një fluturim të veçantë nga Holanda.
Deklarimin e parë para mediave do ta ketë në aeroport rreth orës 17:15. Pritja është e organizuar nën mbikëqyrjen e protokollit të shtetit.
Në ora 19:00 Haradinaj pritet t'u drejtohet qytetarëve në Sheshin "Nënë Tereza".

1.

Ben Emerson, avokat i Ramush Haradinajt, në një konferencë për media ka deklaruar se ish prokurorja e Tribunalit të Hagës, Carla Del Ponte, duhet t'i kërkojë falje Ramush Haradinajt.

"Zonja Del Ponte duhet t'i kërkosh falje Ramush Haradinajt dhe të gjithë kosovarëve për gabimet e

jashtëzakonshme që i ke bërë në këtë proces", ka thënë avokati Emerson, raporton RTV Dukagjini.

Ndërkaq, në një deklaratë me shkrim dhënë Radio Dukagjinit, Ramush Haradinaj është shprehur: "Prej sot shpirti im i takon dhe është i përkushtuar për t'i shërbyer popullit të Kosovës. E kaluara është e kaluar dhe ne duhet të shikojmë nga e ardhmja. Ne duhet të punojmë më shumë për ta ndërtuar një shtet të vërtetë demokratik, ku mbizotëron rendi dhe ligji dhe që do t'u shërbejë të gjithë qytetarëve tanë".

"Ajo çka Beogradi apo kushdo tjetër thotë për fajësinë time është jo relevante. Proceset politike duhet të vazhdojnë. Gjatë viteve në vijim do të ketë shumë mundësi për ta trajtuar dështimin e Tribunalit të Hagës. Tani, fokusi im i vetëm janë njerëzit e popullit tim dhe institucionet qeverisëse", përfundon deklarata e Haradinajt.

2.

Ramush Haradinaj u është drejtuar kosovarëve përmes një deklarate të avokatit të tij, Ben Emmerson.
Aty ai falënderon popullin e Kosovës dhe bashkësinë ndërkombëtare që kanë qëndruar me të gjatë këtij procesi.

Ndër të tjera, avokati i Haradinajt duke përcjellë porosinë e klientit të tij, ka thënë se pas kthimit në Kosovë, me pajtimin e popullit, kreu i AAK- së do të marrë pozitën e liderit politik të vendit.

"Ai më ka lutur të tregoj se do të kthehet këtë mbrëmje në Kosovë dhe me pajtimin e njerëzve, shumë shpejt do ta marrë pozitën që i takon si lider politik i

vendit, duke udhëhequr Qeverinë që përfaqëson të gjithë qytetarët e Kosovës, pavarësisht gjuhës që ata flasin dhe pavarësisht se prej nga vijnë", thuhet në deklaratën e avokatit Ben Emmerson.

"Ai (Haradinaj) më ka lutur të them se si lider i Kosovës së lirë do ta luftojë korrupsionin kudo që gjendet dhe se më të do të merret fuqishëm", shtoi Emmerson.

3.

Sa i përket vendimit të dhënë nga Gjykata e Hagës për pafajësinë e ish-kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, i akuzuar për krime lufte, Sali Berisha tha se ishte lajmi më i gëzueshëm për gjithë shqiptarët në këtë ditë.

Kreu i qeverisë e cilësoi si një triumf të demokracisë dhe ligjit ndërkombëtar, ku e ftoi zotin Haradinaj për një vizitë në Shqipëri në mënyrë që të festohet bashkërisht.

4.

Vendimi i Tribunalit të Hagës, me të cilin shpallen të pafajshëm Ramush Haradinaj, Idriz Balaj dhe Lahi Brahimaj, rikonfirmon pastërtinë e luftës, që e kanë bërë këta luftëtarë dhe shokët e tyre, thuhet në deklaratën për media të kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi.

Më tutje, Krasniqi konstaton se "u dëshmua se drejtësia mund të vonojë, por vjen përfundimisht".

Vendimi i sotëm i Gjykatës së Hagës, sipas Jakup Krasniqit, padyshim është ngjarje e rëndësishme në jetën personale të ish të akuzuarve, të familjeve dhe miqve të

tyre, por mbi të gjitha, përbën një akt madhor me të cilin, për të satën herë, rrëzohen akuzat e pabaza kundër drejtësisë dhe pastërtisë së Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

"Me këtë vendim, drejtësia ndërkombëtare dëshmoi profesionalizmin e saj, kredibilitetin dhe besueshmërinë e lartë që gëzon", tha Krasniqi, për të shtuar se "Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka bërë luftë të drejtë çlirimtare dhe sipas zakoneve e rregullave ndërkombëtare të luftës, prandaj nuk mund të inkriminohet nga asnjë gjykatë", ka thënë Krasniqi, transmeton REL.

Krasniqi ka shprehur bindjen e plotë se edhe në rastet e tjera të luftëtarëve të lirisë, duke përfshirë edhe këtë të fundit me zotin Fatmir Limaj me shokë, drejtësia do të fitojë, duke shpallur pafajësinë e tyre dhe drejtësinë e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

5.

Në reagimet e Komisionit Evropian pas vendimit të Tribunalit të Hagës për të liruar ish-kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj, dhe dy bashkëluftëtarët e tij, vetëm thuhet se "Komisioni ka marrë dijeni për vendimin e sotëm të Gjykatës së Tribunalit në rastin ndaj Ramush Haradinajt, Idriz Baklajt dhe Lahi Brahimajt. Komisioni nuk komenton vendimet gjyqësore të Tribunalit".

Më tej në këtë prononcim të Komisionit Evropian, thuhet se "megjithatë ne do të donim të nënvizojmë edhe njëherë inkurajimin tonë të fuqishëm për të gjithë partnerët tanë në rajon që të vazhdojnë

punën në arritjen e pajtimit dhe forcimin e raporteve të mira fqinjësore.

6.

Familja Jashari nëpërmjet një kumtese ka thënë se, me rastin e kremtimit të Festave të Nëntorit, gjatë gjithë këtij muaji, Kompleksi Përkujtimor "Adem Jashari" dhe familja jonë janë vizituar nga qindra e mijëra qytetarë nga të gjitha trojet shqiptare. Sipas kumtesës, vizitat u intensifikuan 2 ditët e fundit kur ato kanë zgjatur deri pas mesnate, për të kulmuar më 28 Nëntor, kur numri i vizitorëve ka tejkaluar numrin 30 mijë.

"Shfrytëzojmë rastin t'i falënderojmë të gjithë ata që ishin në Prekaz por edhe të gjithë shqiptarët kudo që janë dhe, edhe një herë, përzemërsisht t'ua urojmë Festat e Nëntorit, dhe t'u urojmë të gjitha të mirat në jetë. Me unitet të tillë dhe përkushtim për të nderuar të rënët nëpër shekuj, populli shqiptar po tregon se e ka arsyetuar flijimin e të rënëve, se e meriton lirinë dhe se ka një të ardhme të ndritshme.

Familja Jashari do të vazhdojë të jetë e të gjithëve dhe, në çdo kohë e në çdo rast, për të gjithë shqiptarët pa dallim, në aspiratat tona për të realizuar idealin e atdhetarëve tanë që shqiptarët të jetojnë të bashkuar", thuhet në kumtesë.

7.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka pritur me festë vendimin e Tribunalit të Hagës për lirimin e liderit të saj Ramush Haradinaj.

Nënkryetari i parë i AAK-së, Blerim Shala tha se kthimi i Haradinajt do të sjell zhvillime pozitive dhe dinamike politike në vend.

Sipas tij, skena politike e Kosovës ka ndjerë mungesën e ish-kryeministrit Haradinaj.

Shala nuk e ka përjashtuar as mundësinë e përfshirjes së AAK-së në qeverinë aktuale, siç tha ai, për t'i ndihmuar dhe çuar përpara proceset në interes të Kosovës, siç janë angazhimet për rend e ligj në veri, dialogu me Beogradin si dhe aspektet e politikës së jashtme që nënkuptojnë anëtarësimin e Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

AAK është subjekti më i përfolur për përafrimin e saj me qeverinë Thaçi, kurse nënkryetari i saj Blerim Shala, është emëruar nga presidentja Atifete Jahjaga në postin e koordinatorit të Kosovës për bisedimet me Serbinë.

8.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), përshëndet lirimin e ish-kryeministrit të Kosovës, z. Ramush Haradinaj dhe bashkëluftëtarëve, Lahi Brahimaj e Idriz Balaj.

Lirimi i tyre është dëshmia më e fuqishme që vërteton luftën tonë çlirimtare, si luftë të drejtë dhe të pastër, e cila është zhvilluar në përputhje të plotë më Konventat Ndërkombëtare, thuhet në komunikatën për opinion të GP të PDK-së, i cili shfaq bindjen se "lufta jonë çlirimtare ka qenë luftë e pastër, luftë për lirinë dhe pavarësinë e vendit".

Grupi Parlamentar i PDK-së shpreson se edhe Fatmir Limaj dhe bashkëluftëtarët e tij, do të dëshmojnë pafajësinë e tyre dhe luftën e shenjtë çlirimtare dhe të lirohen sa më shpejt nga gjitha akuzat, që u ngarkohen.

9.

Lëvizja Vetëvendosje përshëndet lirimin e Ramush Haradinajt, Lahi Brahimajt dhe Idriz Balajt, nga akuzat në Tribunalin e Hagës.

Vendimi për pafajësinë e Komandantit të UÇK-së dhe ish luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, është edhe njëherë dëshmi se lufta jonë ka qenë e drejtë, e dinjitetshme dhe çlirimtare, thotë Vetëvendosje nëpërmjet një kumtese.

Mëtutje theksohet se me këtë rast, "përpjekjet për ta zhvendosur dhe transformuar qëllimin e luftës për çlirim nga Serbia u hodhën poshtë si të pavërteta e të pavlefshme" dhe shtohet se "gjejmë rastin të shprehim mirënjohje e nderim të thellë për të gjithë luftëtarët që kontribuuan me jetën, përpjekjet dhe qëndresën e tyre në çlirimin e Kosovës".

11.29.2012

TERRORIZMI VETËVRASËS

Atentatet terroriste vetëvrasëse, rrënjët e të cilave shkojnë deri në antikitet, në mënyrë të padiskutueshme përbëjnë njërin nga instrumentat më shqetësues të terrorizmit të sotëm.

Rastet e këtij fenomeni që pasqyrohen sot qoftë nëpërmjet akteve rastësore, por edhe nëpërmjet një veprimi sistematik të formave veteleminuese, të praktikuara kryesisht nga militantët me frymëzim fetar por edhe nga ata me frymëzim laik, duke vënë në përdorim pothuajse gjithmonë material eksploziv. Sulmet natyrisht janë të shumta. Shpërthimet e ndodhura ndaj dy avionëve me pasagjerë rusë këto kohët e fundit, ku humbën jetën rreth 90 vetë të pafajshëm, apo masakra në shkollën e Osetise, janë të fundit në serinë e gjatë të krimeve.

Në kontestin e terrorizmit të kohës sonë, i pari atentat vetëvrasës i cilësuar nga disa burime të kohës, ndodhi më 15 dhjetor 1981, kur një autokarro e ngarkuar me eksploziv lëshohet kundër ambasadës së Irakut në Bejrut të Libanit, duke vrarë 61 veta si dhe plagosur mbi 100 të tjerë. Hakmarrja qe e mënjëhershme prej armatës për çlirimin e Kurdistanit dhe armata për çlirimin e Irakut, nga Komanda e Përgjithshme. Nga ana e saj, qeveria e Bagdadit ja adresoi autorësinë disa agjentëve sirianë dhe iranianë të cilët i përkisnin, të parët një shteti laik dhe të dytët një shteti teokratik, por që të dy armiq të Irakut.

Megjithatë kurba e këtij lloj terrorizmi vetëvrasës vazhdon të rritet dhe më 23 tetor 1983, po në Liban, në të njëjtën kohë, lëshohen dy automjete të ngarkuara me eksploziv kundër gazermave të një kontigjenti amerikan dhe francez, me pasojë respektivisht, 241 dhe 58 të vdekur. U fol për një akt hakmarrës, shfaqur nën një emër emblematik, ku merrte përgjegjësinë organizata Hezbollah, ose Partia e Zotit, duke protestuar ndaj krijimit të një shteti islamik me shumicë shite në Liban. Ndonëse nuk qenë të parët në kuptimin absolut, atentatet e 23 tetorit 1983 me siguri që inaguruan taktikën e atentateve vetëvrasëse të nxitur shumë herë nga grupe të ndryshme ekstremiste. Atentate të mëtejshme vetëvrasëse kanë ndodhur në Liban, ku radikalët islamik palestinez kanë shkuar drejtë një përfeksionimi të sulmeve me bomba vetëvrasëse. Por kjo taktikë vetëvrasëse zgjerohet dhe futet në repertorin e separatistëve Tamil, me frymëzim laik, në shtetin e Siri Lankës, të cilët vetëm kohet e fundit janë futur në

negocime me qeverinë sengaleze për një zgjidhje paqësore. Eshtë interesant fakti se këta separatist janë përfshirë dhe e kanë përdorur teknikën vetëvrasëse jo vetëm si një instrument terrorizmi diskriminues, por edhe si një instrument të vërtetë ushtarak duke e bërë të vetën në operacionet tokësore e detare, kundër forcave të armatosura dhe objektivave të tjera shtetërore.

Në Izrael, Gaza dhe në territoret e Cisjordanisë, atentati i parë vetëvrasës është bërë në vitin 1993 për të kundërshtuar marrëveshjen e Oslos, e cila pati si qëllim që të vendoste një proces paqe ndërmjet Izraelit dhe Autoriteteve Palestineze. Në vazhdim ky fenomen intensifikohet me të ashtuquajturën Intifada e dytë e cila filloi më 28 shtator 2000, ku u shfaqën atentate jo vetëm nga organizatat, si Hamas dhe Xhihadi Islamik Palestinez, por edhe nga formacionet laike Brigadat Martire të Alaksas. Në fakt, duke përfshirë edhe rreth 40 atentate terroriste vetëvrasëse të kryera në përiudhën 1993-28 shtator 2000, si dhe afro 49 të tjera të ndodhura në periudhën 2000-2004 ky numër arrin në rreth 90 të tilla.

Al Kaeda, organizatë e krijuar nga Osama Bin Laden, si dhe grupe të tjera të afërta ose të lidhura me të i janë bërë pjesë e pandashme të terrorizmit vetëvrasës. Goditjet e këtyre grupeve nuk kufizohen vetën ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por edhe ndaj shteteve të cilët luftojnë për futjen dhe zhvillimin e standardeve demokratike në vendet e pazhvilluara, kryesisht në vendët arabe.

Goditjet e Al Kaedës, nëpërmjet atentateve terroriste vetëvrasëse, vetëm kundër SHBA-së, nga viti 1998, me goditjen ndaj ambasadave te Shteteve të

Bashkuara në Dar Es Salam (301 të vdekur), anijeve të luftës amerikane në gjirin e Adenit (17 të vdekur), Kullat Binjake në Nju Jork dhe Pentagon (mbi 3000 të vdekur), deri në vitin 2004 shkon afro 3500 të vdekur.

Qendra të ndryshme studimore llogaritin sot, se duke filluar nga viti 1980 janë kryer mbi 300 atentate terroriste vetëvrasëse në 14 vende të ndryshme të botës nga 17 grupe terroriste. Nga një studim i detajuar, që i takon përiudhës së lartpërmëndur, del se atentatet terroriste vetëvrasëse i klasifikohen si vijon: organizata Tigrat për Çlirimin e Tamil Elamit, me 171 atentate terroriste vetëvrasëse; organizata Hezbollah dhe Amal (libaneze-politiko-fetare), me 25 atentate vetvrasëse; grupe të tjera libaneze, me 25; Hamasi me 22; partia e Punëtorëve të Kurdistanit (turko-laike), me 21; Xhihadi Islamik Palestinez me 8; separatistët çeçen me 7; Al Kaeda me 4; Dava (organizatë kuvaitiane-politiko-fetare) me 2; grupi Islamik (egjyptian) me 1; grupi Islamik i armatosur (algjerian) m 1 etj.

Kjo përbën thjesht një përmbledhje të terrorizmit vetëvrasës në vështrimin historik bashkohor të këtij fenomeni. Sipas shumë studiuesve bashkëkohor, më komplekse paraqitet tentativa e përcaktimit të shkaqeve dhe karakteristikave, veçanërisht në mungesën e studimeve të thelluara të cilat lidhen me terrorizmin vetëvrasës në nivel botëror. E gjithë "literatura e kohës" në këtë fushë tenton më shume që të përqëndrohet në aspektin palestinez të këtij fenomeni, edhe pse, sikurse tashmë është bërë e qartë, terrorizmi vetëvrasës palestinez përbën vetëm një komponente të këtij fenomeni. Gjithashtu është fakt i qartë se që të gjithë

atentatorët vetëvrasës të 11 shtatorit 2001, gjithsej 19 veta, ishin që të gjithë arab, asnjeri nga ata nuk ishte palestinez. Gjithsesi shumë studiues të kohës vlerësojnë se është me rëndësi që të studiohet evolucioni i profilit të atentatorëve vetëvrasës palestinezë. Kjo flet për vetë faktin se ky fenomen më i përhapur është pikërisht atje dhe konkluzionet e reporterëve analistë të tyre janë si me poshtë: arsimimi i pakët kryesisht i seksit mashkull, mosha shkon nga 16 deri në 23 vjeç, të cilët nuk kanë asnjëlloj përgjegjësie për të mbajtur familje dhe prindër, gjëndje e vështirë ekonomike-shoqërore, të painteresuar në debatet verbale, me shumë prirje për hakmarrje rastësore, me shumë besim tek rezultatet që të jep dhuna, këmbëngulës drejt luftës deri në pikën e fundit të gjakut, me një bindje absolute se do të përkujtohen me shumë madhështi nga pasardhësit dhe besnikët e tyre.

Por, për t'u theksuar është fakti se, kohët e fundit jo vetëm në Palestinë por dhe në vende të tjera, ky profil po vjen gjithmonë e më tepër drejtë një ndryshimi, ku protagonist në këtë skenë po bëhet gjithnjë e më tepër edhe seksi femër. Disa karakteristika të tyre mund t'i përkufizonim më poshtë si: mosha disi më e madhe krahasuar me meshkujt, në shumicen e rasteve të martuara apo të fejuara, të pajisura me diplomë të shkollës së mesme apo edhe diplomë univeristare. Për t'u theksuar është fakti se pjesa më e madhe e atentatorëve terroristë vetëvrasës kanë diploma universitare, kjo ishte karakteristikë jo vetëm për kontigjentin palestinez, por edhe për atentatorët e vendeve të tjera, të cilët studimet i kanë përfunduar në Evropë ose edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Veç të tjerash, atentatori i sotëm terrorist vetëvrasës kërkon një personel të aftë dhe të disponueshëm, me përgatitje informuese, përnjohje të detajuar të terrenit, përgatitje teknike, logjistike, stërvitore dhe operative.

Pra, si rregull, nuk mjafton një atentator i vetëm për të kryer atentatin vetëvrsës terrorist, por është e nevojshme një organizatë dhe një strukturë e veçantë. Kështu duket qartë se sa më kompleks të jetë ky operacion, si në rastin e atentateve të koordinuara vetëvrasëse të 11 shtatorit 2001, aq më të mëdha janë edhe kërkesat organizative.

Por, në të njëjtën kohë, atentati terrorist vetëvrasës sjellë edhe avantazhe të shumta si për shëmbull: një kosto të ulët financiare në shumicën e rasteve; vdekje ose plagosje të sigurta për kundërshtarin (sasia varet nga sofistikimi operativ i atentatit); një mbulim i gjërë nga ana e masmedias, kjo si në nivel kombëtar por edhe në nivel botëror, me shumë avantazhe prapagandistike për kauzën; një goditje intensive me shumë propabilitet në vende të zgjedhura posaçërsht si hotele, kafene, restorante, diskoteka, tregje, stacione hekurudhore, porte, aeroporte etj; një lehtësi, pothuajse totale të rasteve, për fshehjen e eksplozivit si dhe të kalimeve e depërtimeve të atentatorëve vetëvrasës terrorist; një mundësi e thjeshtë përfitimi e atentatorit vetëvrasës nga udhëtimi me mjetet transportuese tokësore, ajrore apo detare të drejtuara dhe të pilotuara nga të tjerët; mungesë e nevojës së atentatorit për të patur një rrugëdalje shpëtimi, pra pamundësia e forcave të sigurimit për ta ndaluar atë; mundësia e alternimit të

atentateve vetëvrasëse terroriste me atentate të natyrave të tjera të tjera terroriste. Megjithë humbjet e mëdha njerëzore nga këto lloj atentatesh si dhe koston e konsiderueshme për ta kundërshtuar atë, mund të jetë inkurajues fakti që në asnjë rast ky lloj terrorizmi nuk ka prodhuar rezultatet e lakmuara nga grupet organizatore të këtyre fenomeneve. I vetmi rast në të cilin është verifikuar njëlloj suksesi, por edhe ky nuk që deçiziv, ishte shpejtësia me të cilën u veprua për të hequr kontigjentet paqeruajtëse amerikane dhe franceze nga Libani, në vitin 1983.

Por në ditët e sotme nuk është inkurajues fakti që, pavarësisht nga specifikat dhe arsyetimet, situatat gjeopolitike, terrorizmi vetëvrasës vazhdon që të shfaqet akoma si një instrument i luftës politike dhe fetare etj.

10.28.2012

AKADEMIKËT E KRIMIT

Sipas legjendës, car Lazari para Betejës së Kosovës paska parë ëndërr që po e humbiste betejën për të fituar një mbretëri në amshim. Për serbët Kosova u bë kjo mbretëria hyjnore. Mungonte vetëm mbreti. Shkrimtari Dobrica Qosiq dhe politikani i ri Slobodan Milosheviq ishin kandidatë për ta marrë fronin..

Serbët e Kosovës, të përkrahur nga kisha ortodokse, kërkonin nga Beogradi mbrojtjen e tyre nga shqiptarët.

Në televizionin e Beogradit paraqiteshin gra që tregonin "hjekat" e tyre në duart e dhunuesve shqiptarë. Me këtë atmosferë të krijuar, Serbia po i tregonte synimet e saj.

"Shpërbërja e Jugosllavisë" është raport i përpiluar nga projekti "Iniciativa e intelektualëve", rreth të cilit janë mbledhur historianë të shumtë nga Ballkani

dhe mbarë bota për të hulumtuar gjenezën e konfliktit në Ish-Jugosllavi.

Ky projekt ka punuar në disa grupe të ndara, të cilat kanë trajtuar aspekte të ndryshme dhe kanë përpiluar raporte të veçanta. Grupi që ka punuar raportin rreth "Shpërbërjes së Jugosllavisë" është udhëhequr nga Sabrina Ramet dhe Latinka Peroviq.

Vitet tetëdhjetë kishin shumëçka në barrë. Titoja kishte vdekur. Në prill të vitit 1981 kishin shpërthyer demonstratat e shqiptarëve në Kosovë.

Kisha ortodokse serbe në Serbi dhe ajo katolike në Kroaci kishin nisur të merrnin një rol të ri.

Boris Kraigher dhe Tihomir Vlashkaliq kishin marrë përsipër të studionin sistemin ekonomik dhe politik. Pakënaqësi kishte që nga Triglavi deri në Vardar.

Sllovenët nuk ishin të kënaqur që duhej të paguanin taksa edhe për rajonet e pazhvilluara brenda Jugosllavisë. Shqiptarët ankoheshin për papunësinë që i kishte kapluar.

Serbët ishin të shqetësuar për zgjerimin e federatës dhe kroatët me idenë e tyre për pranverën kroate.

Në Mal të Zi njerëzit janë ngritur në protesta dhe i kanë thyer dyqanet në Titograd (tani Podgoricë), kur e kanë kuptuar se u ishte shitur detergjent fals. Popullata nisi të kishte dyshime të hapura ndaj sistemit të vetëqeverisjes.

Ndërkohë, serbët e Kosovës shkonin në Beograd për të kërkuar nga udhëheqësit politikë mbrojtje nga shqiptarët.

Kisha ortodokse serbe nxiti madje edhe peticion duke kërkuar mbrojtjen e serbëve të Kosovës dhe trashëgiminië e tyre të shenjtë. Akademia e Shkencave e Serbisë e nxori memorandumin që tronditi gjithë Jugosllavinë.

Historianët serbë nisën të ndryshonin fjalët për historinë, duke thënë se Drazha Mihajloviqi nuk kishte qenë në të vërtetë aq i keq për popujt e tjerë, të cilët i kishte masakruar.

Televizionet e Serbisë nxirrnin pamjet e grave serbe që tregonin se si ishin dhunuar nga shqiptarët gjakatarë.

E gjithë kjo i tregonte synimet e Serbisë. Mungonte vetëm lideri. Ishin dy kandidatë. I pari ishte shkrimtari Dobrica Qosiq, romani i të cilit "Koha e vdekjes" ishte bërë i adhuruar nga publiku. I dyti ishte Slobodan Milosheviq, një politikan i ri e ambicioz.

Lideri duhej të ishte si në legjendat serbe për car Lazarin.

Sipas këtyre legjendave, para Betejës së Kosovës më 1389, car Lazari, udhëheqësi i ushtrisë serbe, e kishte parë një ëndërr.

Në atë ëndërr, sipas këtyre rrëfimeve, një egjëll i ishte shfaqur duke i bërë ofertë: ja ta fitonte betejën kundër turqve e të bënte një mbretëri të fortë në qiell, ja ta humbiste betejën, të vdiste si dëshmor dhe ta fitonte mbretëri të fortë në qiell.

Car Lazari e paska zgjedhur këtë të dytën. Për serbët Kosova ishte diçka e këtillë - një mbretëri hyjnore. Vetëm se pritej se kush do të jetë car Lazari i riinkarnuar.

Slobodan Milosheviqi ende nuk kishte karizmë të një lideri.

Kurva Serbi, historia që përseritet

Sërbia, e cila shkaktoj gjakderdhjen më të madhe në Ballkan, pas Luftës së dytë botërore, në vend se të mendojë seriozisht për antarësimin e saj në botën e civilizuar dhe të qytetëruar, akoma vazhdon të veprojë në frymën mesjetare.

Nuk ka shenja të këndelljës dhe çdo qeveritar sërb, i cili vjen në pushtet mundohet të forcojë pozitën, në kurriz të Kosovës. Kjo tregon se një pjesë e madhe e popullit sërb ende jeton në iluzione për Kosovën sërbe.

Kosova pagoi shumë shtrejtë shkëputjen nga kthetrat e kolonizatorve sërb, u desht me shumë se njëqind vite rezistencë aktive që të arrihet kjo shkëputje, e cila ishte mbrojtë me të gjitha mjetet nga shovenistet serbë.

Në rrethana tjera gjeografike, me popuj më të civilizuar, pa dyshim, deri me tash do të kishte ndodhur shumë e pritura falja publike nga pala sërbe, për krimet dhe plaçkitjet e bëra në Kosovë, sidomos gjatë luftës së fundit.

Një gjë e tillë nuk besohet të ndodhë as gjatë këtij shekulli, për aq sa do të jetë edhe ëndrra e tyre që serish të gllabërojnë tokat shqiptare. Kësaj radhe nuk do të përsëritet fati i Nishit, Prokupljës, Kurshumlisë dhe trojeve tjera shqiptare që u okupuan definivisht nga sërbët.

Është fakt i pa mohueshëm, se në prolongimin e definimit të statusit definitive të Kosovës, rol të madh ka

Beogradi. Janë ende aktive lidhjet dhe koalicionet e vjetra diplomatike pro sërbe të cilat frenuan dhe sabotuan çdo lëvizje pozitive në Kosovë.

Inskenimet që bëhen në Kosovë lidhur me presionet e shqiptarve ndaj pakicës sërbe, janë pjellë dhe rezultat i këtyre lidhjeve.

Ata do të vazhdojnë me këtë lojë intrigante edhe në të ardhmën. Në këtë formë të luftës speciale, blehej koha e cila është aq me vlerë për Beogradin...

Edhe pas pavarësisë së Kosovës, do të aktivizohen demonët, të cilët do të luajn rrolin e viktimës, ashtu si Vuk Drashkoviq, i cili në OKB, kohë më parë, sërbet i cilësoj si populli më i shtypur në botë !

Autori i romanit "Thika", ish ministri i Punëve të Jashtme të Sërbisë, Vuk Drashkoviq është shumë i njohur për fjalët e mëdha dhe patetike, vlenë të kujtojmë thënjet e tij nga filozofia çetnike në mitingun (anti) popullor në Novi Pazar, më 9.09.1990, të organizuar nga partia e tij, i cili ndër të tjera tha: "Kur të vijë në pushtet partia ime, secili që në tokë të Rashkës ngre flamurin turk, ustash, shqiptar ose cilindo flamur tjetër pos atij sërb, do të mbetet pa flamur, pa duar dhe pa kokë". Ky mendim "demokratik" u përsërit dhe në Fushë Kosovë, më 29.9.1990.

Është sukses i diplomacisë sërbe, mashtrimi perfid që i bënë disa qarqeve ndërkombëtare miope dhe proserbe, të cilët me qëllim apo pa qëllim perceptojnë genjeshtrat sërbe si të vërteta. Shifet qartë në çdo hap rezultati i shkollës së babait të kombit sërb Dobrica Qosiq. Rrjedha llogjike dhe dialektike e gjithë asaj çka ndodhi në dekadat e fundit në Kosovë dhe rajon, është pavarësia e

plotë dhe pa kushte. Populli i Kosovës është i lodhur së tepërmi nga intrigat dhe shantazhimet e llojllojshme.

Edhe përkundrejt këtyre problemeve tejet serioze, sidomos në rrafshin social, për hirë të aspiratave shekullore për pavarësi, populli shqiptar tregon dëgjueshmeri qytetare dhe urtësi.

Çdo shtyerje e qëllimt e zgjidhjës së drejtë të çështjës së Kosovës është tendencioze dhe ka për qëllim destabilizimin e rajonit dhe shuarjen e aspiratës së këtij populli për vetëvendosje.

Është koha e fundit që qendrat vendim marrëse të reagojnë në mënyrë preventive dhe racionale. Lajkat sërbe qe iu bëhen disa nga diplomatëve të dërguar si misionarë për vlerësime të standardeve në Kosovë, duhet të demaskohen publikisht.

T'u jepet shansi përfaqësuesve legjitimë shqiptarë, që faktet relevante dhe të pa mohueshme e të arriturave në Kosovë t'i prezantojnë në forumet përkatëse ndërkombëtare, pikërisht aty ku gënjeshtrat sërbe bëhen publike dhe marrin trajtë institucionale.

Shpresojmë që rasti i Kosovës të mos bëhet precedent në historinë e vendeve të kolonizuara në botë, që t'i lejohet kolonizatorit të vendos për fatin e viktimës së tij.

Presidenti i sapozgjedhur i Serbisë, Tomislav Nikoliq, do të udhëtojë për në Moskë, ku ai do të marrë pjesë në kongresin e partisë në pushtet, Rusia e Bashkuar, më 26 maj.

Tomislav Nikoliq, udhëheqësi i Partisë Progresive Serbe, SNS, i cili të dielën u zgjodh president i ri i Serbisë, ka pranuar më herët një ftesë për të marrë

pjesë në kongresin e partisë së Rusisë në pushtet, Rusia e Bashkuar, më 26 maj.

Nikoliqi do të marrë pjesë në këtë ngjarje në kapacitetin e tij si udhëheqës i SNS-së. Ai do t'i drejtohet kongresit dhe pritet të mbajë një takim me presidentin rus, Vladimir Putin, i tha SNS agjencisë së lajmeve Tanjug. Kjo do të jetë vizita e parë e Nikoliqit jashtë vendit, që kur u zgjodh president. Mandati i tij në detyrë do të fillojë kur ai të betohet në një ceremoni në parlamentin e Serbisë, në fillim të qershorit.

Kryetarja Kuvendit të Serbisë dhe njëherit nënkryetarja e Partisë Socialiste të Serbisë Sllavica Gjukiq-Dejanoviq sot konfirmoi se njeriu më adekuat për postin e kryeministrit të Serbisë është Boris Tadiq.

Ajo tha se Tadiqi është i merituari në këtë post sepse sipas saj ai ka komunikim të shkëlqyeshëm me zyrtarët e lartë në rajon, ata evropianë dhe botërorë.

Për këtë arsye, Dejanoviq-Gjukiq, thotë se Tadiq është shpirti i zhvillimeve pozitive në politikë për Serbinë.

5.24.2012

"PATKOI" I MILOSHEVIQIT

Baladë shqiptare

-Oh, shka kan'bjeshkt', o bre, qi ushtojn-e,
shka kan' lugjet', o bre, qi fshajn-e,
shka kan' malet, o bre, qi s'mungullojn-e,
shak ka hana, o bre, qi s'po zdrit-e;
shka ka dilli, o bre, qi s'po ban drit-e,
shka kan' shpent, o bre, qi s'po knojn-e,
shka kan' qyqet, o bre, qi s'vajtojn-e?
-Oh, muhaxhirt, o bre, kah po shkojn-e!
Oh, kan' lan' tok-o, bre, kan' lan' ship-e,
kan' lan' dhen-o, bre, kan' lan' dhi-e,
n'laver, n'zhgjedh, o bre, kan' lan' ki-e,
kan' lan' buken, o n'çerep me hi-e,
kan' lan' çorbën, o në vegsh tuj zi-e;
kan' lan' sofrën, o bre, t'shtrume n'shpi-e,

oh, miqt' kan' shkue, o bre, buk' pa u ngi-e!
Oh kan, lan' zhguj e jana n'vek pa i krye,
kan' lan' çejzin, o bre, çikat pa marue,
kan' met' dor' nuset, o bre, msit pa i çue,
kan' met' krushqit, o bre, pa u kthye,
oh, kan' met' gjemt', o dhandur' pa hi-e!
Oh, muhaxhirt, o bre, kah po shkojn-e,
dru e gur, bre, ç'po vajtojn-e!
-Bari n'tok', o bre, pse s'po bin-e,
shpent e malit, o bre, pse s'po knojn-e;
qyqet e malit, o bre, pse s'vajtojn-e?
-Oh muhaxherin, o bre, po e kajn-e!
Oh muhaxhirt kan' marr' dyjan' n'sy-e:
Desin në bor', o bre, desin në shi-e,
desin pleq, o bre, desin t'ri-e,
desin gra, o bre, desin thmi-e,
u desin thmija, bre, nanav' ngji-e,
jesin gjenazet, bre, n'vorre pa i shti-e!
Bukën pa e ngran', o bre, uj' pa pi-e,
kan' marr udhën, bre, për Allbani-e;...

Historikisht Kosova ka qenë vendi i përplasjeve të njëpasnjëshme të armatosura kryesisht mes serbëve dhe shqiptarëve. Dihet se Kosova është vetëm një nga trevat shqiptare kurse Shqipëria, politika apo shteti shqiptar ka përfaqësuar gjithnjë pas 1913-ës më pak se gjysmën e tyre. Nga ana tjetër problematika e trevave dhe e kombti shqiptar në vitet e Luftës së Dytë Botërore është shumë e gjerë.

Gjithsesi qoftë edhe vetëm në ketë kënvështrim ai ende ka mbetur në diskutim nga histriografia e huaj

dhe sidomos diferencohet dhe shtremberohet nga historiografia serbo-jugosllave, veçanerisht kur është fjala për shqiptarët e Kosovës dhe ato të viseve të tjera të aneksuara në ish-Jugosllavi. Për shkak të pengesave të ndryshme objektive dhe subjektive të cilat në forma të reja gjatë dhjetë viteve të fundit ende janë të pranueshme, sot është e vështirë të pohohet se është rastësisht e ndikuar nga elementet e traditës ose të momentit.

Aktualisht Kosova kufizohet me Serbinë, Maqedoninë, Malin e Zi dhe me Republikën e Shqipërisë. Këta kufij në mënyren më paradoksale e ndajnë edhe sot territorin kompak shqiptar në pesë njësi politike duke dëshmuar rastin unikal në Evropë e ndoshta në botë për copëtimin territorial të një kombi. Lufta për çlirimin kombëtar të popujve të shtypur në kushtet e sotme të zhvillimit ekonomik, politik e ushtarak ka hyrë në një fazë të ndërlikuar dhe tejet komplekse.

Në këto rrethana të brendshme dhe të jashtme u shtrua kërkesa "Kosova –Republikë" si kërkesë minimale në aspektin e çlirimit kombëtar, kërkesë që e bashkoi pupullin shqiptar dhe e tronditi nga themelet Jugosllavinë titiste edhe pse populli i robëruar shqiptar i kishte karakteristikat e kombit dhe ishte i vetëdijshëm që i takonte plotësisht e drejta e kombeve për vendosje deri në shkëputje.

Grupet e organizuara ilegale duke pasur parsysh rethanat ndërkombetare dhe ato brenda jugosllave si dhe forcën jo të mjaftueshme qoftë njerëzore, qoftë ushtarake për realizimin e kërkesave popullore në programet e tyre unanimisht si kërkesë politike dhe i kishte demaskuar hegjemonizmi serb përpara opinionit jugosllav dhe atij

botëror, kishte ndikuar fuqishëm në ashpersimin e luftës klanore benda RSFJ-së, gjë që çoi deri në shkatërrimin e Jugosllavisë si burg i popujve dhe e internacionalizoi deri në maksimum çështjen shqiptare në botë.

Këto sanksione janë të pamohueshme. Në këtë drejtim faktet flasin vetë. Pas ribashkimit të Gjermanisë dhe miratimit të një varg marrëveshjeve ndërmjet shteteve evropiane për integrim ekonomik, në botë u krijuan rrethana të reja politike edhe për Kosovën.

Serbia ose e humbiste Kosovën përgjithnjë ose mund të fitonte një pjesë pasi e kishte zbrazur nga shqiptarët. Jo vetëm zhvillimet historike por edhe situata e brendshme politike në Serbi se zgjidhja më e preferuar e opinionit serb ishte ajo e e zgjidhjes me luftë të çështjes së Kosovës. Pas vitit 1990 kur u shpërbë ish-Jugosllavia shqiptarët i mbërtheu ndjenja pacifiste e bindjes se zgjidhja do të ishte paqësore.

Përgjithësisht ky qëndrim ishte i justifikueshëm. Perëndimi paralajmeronte hapur se nuk do të pranonte një levizje të dhunshme në Kosovë që prekte interesat strategjike të tij. Por periudha pas vitit 1996 do të sfidonte mbështetjen e deritanishme me mjete paqësore duke i hapur rrugën krijimit me shpejtësi të elementeve të para të dhunës dhe përplasjes së armatosur në të gjithë Kosovën, në formën e një lufte guerile drejtuar kundër autoriteteve të shtetit serb.

Deshpërimin nga mungesa e alternatives për zgjidhje dhe mundësitë e lënies përsëri të Kosovës nën regjimin serb nxitën pjesën më aktive të popullsisë shqiptare të Kosovës të radikalizojnë kërkesat e lëvizjet dhe shumë shpejt të transformohet me një strkuture

ushtarake në palë luftuese të mbështetur me veprime të hapura kundër strukturave ushtarake e policore serbe në të gjithë Kosovën. Shumë shpejt ngjarjet në terren do të shikonin aktivitetin e shtetit serb me paralajmërime serioze për një lëvizje gjithë popullore drejt shkëputjes së plotë.

Beogradi vlerëson drejt mjedisin kërcënues dhe del me idenë e pacifikimit të Kosovës që nënkuptonte eliminimin e grupeve të sapoformuara guerrile shqiptare të cilat vepronin nën emërtimin "Ushtria Çlirimtare e Kosovës". Kjo ide i paraqitet edhe përfaqësuesit të palës amerikane dhe deklaratat e Washingtonit se veprimet e disa grupeve në Kosovë janë terroriste, u interpretua në Beograd, si dritë jeshile për të ndërhyrë me mjete të dhunshme.

Në këto rrethana populli shqiptar u gjend në një situatë tejet të rëndë. Shqipëria kalonte një krizë të rëndë ekonomike, ndërsa gjysma tjetër e kombit ishte e pushtuar dhe e copëtuar.

Kjo ushtri është pika kulmore e qëndresës shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore. Luftëtarët e kësaj ushtrie ishin trima dhe besnikë të idealeve të tyre deri në vetmohim dhe arritën të kuptojnë politikën e kohës dhe sensin e zhvillimit që imponoonte kjo politikë.

a)-Tkurrja e territoreve shqiptare nga trungu mëmë.

Ashtu si tërë historia e kombit tonë edhe historia e popullit të Kosovës është njëherazi dhe heroike dhe dramatike. Heroikja qëndron në atë që me sakrifica, luftë dhe gjak, që nga pushtimet e para sllave, ato osmane e më

vonë kundër sunduesve serbomëdhenj pas vitit 1913 ai popull diti të ruajë e të zhvillojë traditat, zakonet kulturën dhe gjuhën e vet amtare.

Gjatë sundimit pesë shekullor, Kosova konsiderohej një nga katër vilajetet e Shqipërisë së nënshtruar nën Perandorinë Osmane. Në fund të rënies së kësaj Perandorie, shqiptarët gjeten mbështetjen e turqve për mbrojtjen e trojeve të tyre nga pushtimi dhe nga copëtimi midis vendeve që bënin pjesë në Aleancën Ballkanike. Shekulli XIX është periudha ku vende si Greqia, Bullgaria e Serbia filluan lëvizjen kombëtare për tu shkëputur nga Perandoria Osmane e për të dalë më vete në kombe.

Në shekullin e XIX shqiptarët u përballën me nacionalizmin gjithnjë e në rritje të vendeve ballkanike si Serbia, Mali i Zi, Greqia dhe Bullgaria. Këto shtete të reja filuan polemikën mbi tokat shqiptare. Veçanërisht serbët e malazezët ishin armiqtë më të pangopur. Fuqitë Perëndimore përkrahën shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë me 1912, me qëllim që të ndalohej përhapja e influencës ruse në Ballakn dhe të ndalohej dalja e saj në Adriatik. Shqiptarët, kombi më i vjetër në Gadishullin Ballkanik, duke filluar nga shekulli i XIX po përpiqeshin të fitonin pavarësinë e tyre.

Përballë vendimeve të Marrëveshjes së Berlinit, të vitit 1878 ku tokat, shqiptare si: Kosova, Shkodra, Manastiri dhe Janina ju dhanë Bullgarisë, Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë. Në qytetin e Prizrenit në 10-25 Qershor 1878 u krijua Lidhja Shqiptare me të njëjtin emër e cila rroku armët për mbrojtjen e tokave shqiptare nga rreziku

i copëtimit. Shqiptarët u bashkuan në luftë për mbrojtjen e trojeve te tyre, që ishin nën Perandorinë Osmane.

Armiqtë e shqiptarëve me ndihmën e Rusisë krijuan lidhjen kundër Turqisë, por në fakt qëllimi ishte copëtimi i Shqipërisë dhe zhdukja e emrit shqiptar. Edhe publicistët shqiptarë të asaj kohe, theksojnë se pregatitjet që po bëheshin për Luftën Ballkanike kishin si objektiv copëtimin e tokave shqiptare.

Në marrëveshjen ballkanike që u bë, u vendos ndarja e tokave shqiptare, pra në këtë mënyrë Malit të Zi do ti jepej veriu dhe verilindja dhe pjesën tjetër do ta merrte Greqia. Nga Lufta që ekzistonte mes Perandorisë Osmane dhe katër shteteve ballkanike, shqiptarët shqetësoheshin dhe kishin frikë se harta ballakanike do të ndryshonte në dëm të tyre. Në realitet serbët e sunduan Kosovën gjatë një periudhe të shkurtër në Mesjetë. (1331-1355). Në kohët moderne Kosova, u vu nën sundimin e Serbisë pas luftërave Ballkanike 1913.

Më 9.10.1912 Mali i Zi sulmoi Shqipërinë. Ushtria malazeze plaçkiti dhe i vuri flakën fshatit të Koplikut. Serbët me 29 nëntor morën Elbasanin, Tiranën dhe Durrësin. Qëllimi kryesor i asaj lufte që quhej Ballkanike, ishte copëtimi i Shqipërisë. Lufta e Parë Ballkanike që u zhvillua më 1912 u shfrytëzua nga shteti serb për të pushtuar Kosovën. Kosova kishte qënë prej kohësh synim i shovinizmit serbomadh dhe i politikës evropiane. Ndërsa qëllimi kryesor i këtij synimi pushtues qëndronte në shfrytëzimin ekonomik të saj.

Popullsia e Kosovë ishte e detyruar shpesh që të shpërngulej nga vatra e saj. Vala e parë e shpërnguljeve me dhunë të shqiptarëve datohet pas Kongresit të Berlinit

më 1878. Në vitin 1878 u zbuan me dhunë 350000 banorë kosovarë me etni shqiptare. Vetëm në periudhën nëntor-djetor 1912 u dëbuan nga vatra e tyre 20359 persona. Shteti jugosllav krahas mohimit të të drejtave njerëzore dhe kombëtare të shqiptareve synonte dhe spastrimin etnik të tyre duke i dëbuar nga trojet e tyre. Për këtë qëllim u përdorën dy rrugë:

-shpërngulja e shqiptareve nga Kosova
-kolonizimi i trojeve shqiptare me kolonë serb dhe malazezë.

Ndryshe nga viset e tjera të mbretërisë Serbo-Kroato-Sllovene, lëvizjet shqiptare, kolonizimi i parapriu Reformës Agrare. Ardhja e kolonëve kishte filluar qysh në vitin 1913. Në bazë të vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve të vitit 1913 bashkë me Jugosllavinë në zgjedhën fashiste u vendosën edhe viset shqiptare që padrejtësisht qenë aneksuar nga Jugosllavia. Shteti shqiptar megjithëse i copëtuar nga Aleanca ballkanike dhe Fuqitë e Mëdha Evropiane, hodhi themelet dhe filloi të marrë rrugën e tij të progresit. Që në çastet e lindjes së kesaj Aleance shqiptarët dhe turqit u gjendën përkrah njëri- tjetrit në mbrotje të Shqipërisë dhe që atëherë e në vazhdim marrëdhëniet mes popujve tanë kanë ardhur duke u forcuar.

Serbia është treguar paranoike në lidhje me çështjen e Kosovës. Ajo ngriti dhe kultivoi brenda dhe jashtë saj një mit absurd dhe e quajti Kosovën: ”Djepi i Serbisë” dhe vendi ku filloi historia e Serbisë.

Gjatë Luftës së parë dhe të Dytë Botërore ndihmuan nga Austro-Hungaria dhe Gjermania, Kosova njihet e bashkuar me Shqipërinë. Gjermania naziste e njihte si shtet neutral.

b)-Zhvillimet në Kosovë para rezistencës së armatosur. Strategjia e përdorur në realitetin kosovar.

E tërë historia e truallit ku kanë jetuar shqiptarët dhe paraardhësit e tyre është e shkruar me gjak. Për ta mbrojtur këtë tokë janë bërë përpjekje të mëdha. Në shekuj armiqtë e shumtë të këtij populli janë përpjekur ta zbojnë nga atdheu që u kanë lënë të parët trashëgimi.

Më 1912 kur u krijua shteti shqiptar gati gjysma e trojeve shqiptare u aneksuan nga shtetet fqinje. Populli shqiptar i Kosovës, i cili jetonte në tokat e stërgjyshërve të tij dhe i ndarë nga trungu mëmë, ndodhet sot përballë represionit serb. Ai është i vendosur që në fund me të gjitha sakrificat që i dalin përpara ta fitojë lirinë e dëshiruar në shekuj.

Duke pasur parasysh se lufta në Kosovë është e domosdoshme dhe në përputhje me rrethanat e brendshme dhe ato të jashtme, është i pashmangshëm, organizimi i popullit në këtë front të përbashkët. Del si detyrë e dorës së parë, si detyrë që nuk mund të lihet për më vonë.

Zjarri i luftës së hapur në Jugosllavi po u afrohet gjithnjë e më tepër edhe trojeve kosovare. Detyrë e çdo shqiptari pavarësisht nga bindjet politike është të mendojë dhe të punojë për luftën që po afrohet dhe që po merr karakterin e një lufte kombëtare.

Intensiteti i kësaj force të popullit varet ekskluzivisht nga organizimi i dhe nga strategjia e luftes së tij. Sot duke pasur parasysh rrethanat ndërkombëtare dhe veçanërisht zhvillimet e ngjarjeve në ish-Jugosllavi, vetëm strategjia luftarake është një strategji e drejtë e cila përveç kryengritjes së armatoshur do të sigurojë çlirimin e plotë të Kosovës.

Këtë forcë populli do ta aktivizojë për luftën e armatosur e cila do ta shpie atë në mënyrë të pashmangshme në kryengritje popullore dhe si rrjedhojë në çlirim të potë të trojeve shqiptare.

Që nga Janari dhe në mes të muajit Shkurt 1997 forcat policore serbe, zhvilluan një fushatë të gjerë bastisjesh dhe arrestimesh në gjithë Kosovën në ndjekje të pjesëtarëve të UÇK-së. Ndaj të arrestuarve dhe familjeve te tyrte policia serbe ushtroi një terror të paparë. Në zyrat e UDB-së vazhdoi një dhunë vazhdueshme dhe të shfrenuar ndaj të burgosurve kosovarë.

Ndërkohë në Shqipëri si pasojë e politikës që po ndiqet, populli shpërtheu depot ushtarake, duke bërë kështu të mundur armatosjen e të gjithë popullsisë. Kjo situatë e paqëndrueshme më tepër u shfrytëzua nga elementet kriminale në Shqipëri. Arsyet klasike të një lufte janë pushtime territoriale, interesat gjeopolitike. Pak arsye dhe aq më pak motivacion kanë serbët për një luftë-aventurë në Kosovë ndaj janë për politikën e paqes dhe e gjithë kjo e ka një shpjegim tepër të thjeshtë: Serbët nuk kanë nevojë për luftë në Kosovë, pasi ata e kanë pushtuar njëherë atë. Duke përdorur politikë paqësore si armë

kundër Kosovës përballë një politike botërore paqësore, ata përpiqen të ruajnë interesat e tyre në Kosovë.

Por ky është një argument i denjë vetëm për ata që kanë shkëputur çdo lidhje me realitetin. Në kohën kur në Bosnjë po vazhdon të ruhet paqja vetëm me ndihmën e forcave shumëkombëshe, në Ballkan ekziston rreziku i shpërthimit të konfliktit edhe në Kosovë. UÇK e panjohur deri tani në arenën ndërkombëtare, nën shembullin e Bosnjës, i ka shpallur luftë të hapur Serbisë duke kërkuar rrespektim e të drejtave të popullit kosovar. UÇK Nuk e fsheu qëllimin e saj: bashkimin e provincës së Kosovës, së banuar nga 90% e popullsisë me etni shqiptare, me shtetin shqiptar. Dalja në skenë e UÇK ishte pretekst për palën serbe për të rifilluar në Kosovë një fushatë dhune dhe represioni.

Të gjitha këto dhunime u maskuan në të ashtuquajturën" Luftë kundra terrorizmit shqiptar". Pasi dihej se dalja në skenë e UÇK-së nuk ishte ndonjë fenomen i ri, por ishte thjeshtë dalja hapur para gjithë botës për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave të popullit kosovar. Gjithë kjo bëri që ngjarjet e fundit në Kosovë të ndiqen me vëmendje në Serbi. Disa analiste si edhe shtypi i pavarur serb tërheq vëmendjen se situata ndëretnike në Kosovë është e tendosur.

Ata e theksojnë se te dy palët, si ajo serbe edhe ajo shqiptare në Kosovë duhet të përpiqen në maksimum per të qetësuar gjendjen dhe pushojnë së akuzuari njëra-tjetrën për vrasjet që ndodhnin. Por as këto thirrje nuk sherbyen për të qetësuar gjendjen. Tashmë në Kosovë gjendja qe aq e tensionuar sa rrezikohej shpërthimi i një

konflikti ndërnacional si ai në Bosnjë. Pushtuesit serbë nuk heqin dorë lehtë nga Kosova.

Ndërkohë sipas burimeve dihet se shtabi i përgjithshëm i UÇK-së ka një strategji të qartë jo vetëm për situatën aktuale por edhe në lidhjë më zhvillimet e mëvonshme. Pjestarët e UÇK-së ishin djemtë më benikë dhe patriotë të Kosovës, të cilët hartuan një plan të saktë për të mbrojtur të drejtat e popullit të tyre. Ata ishin mjaft të qartë si në strategjinë që do të ndiqnin ushtarakisht ashtu edhe në strategjinë politike që do të përbënte mbështetjen e kësaj lufte.

Duhet theksuar kjo politike dhe kjo strategji e ndjekur prej tyre ishte fryt i një pune te palodhur të emigrantëve shqiptarë dhe kosovarë kudo në botë, të cilët përdorën gjithçka mundën (burime financiare dhe intelektuale) për te sensibilizuar opinionin botëror dhe për ti ndërgjegjësuar se një represion kaq i ashpër nuk mund te egzistonte më në Evropen e shekullit te XXI kur kudo flitej për një bashkëpunim reciprok mes popujve. Kështu, organizimi i forcave liridashëse në një organ të fuqishëm sic ishte UÇK dhe sensibilizimi i opinionit bën që veprimet e UÇK-së të mos shiheshin më si një akt terrorist por si një lëvizje për mbrojtjen e të drejtave të një populli të dhunuar në shekuj.

Qeveria e Bullgarisë ia ka dorëzuar Gjermanisë dhe shërbimit inteligjent së NATO-s informatat për “Operacionin Patkoi" - planin e serb të ish diktatorit serb Slobodan Milosheviq, për spastrim etnik të Kosovës në vitin 1999.

Kjo informatë u zbulua nga ish ministrja e Jashtme bullgare Nadezhda Neynski (atëherë Nadezhda

Mihajlova), në dokumentarin "Operacioni Patkoi," të kanalit privat bullgar bTV, transmeton Telegrafi.

"Ia sigurova ministrit të Jashtëm gjerman Joschka Ficsher - respektivisht NATO-s – raportin që posedonte qeveria bullgare dhe që tregonte qartë se ekzistonte plani 'Patkoi', i përgatitur me kujdes nga shërbimet sekrete të Serbisë dhe kreut të atëhershme të shtetit Milosevic, e që kishte dy qëllime. I pari – shkatërrimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës – dhe i dyti, spastrimi i Kosovës nga shqiptarët etnikë. Ky plan gufoi me depërtimin e masave të mëdha të shqiptarëve nga Kosova. Ka filluar në fund të muajit shkurt 1999", ka thënë Neynski, aktualisht deputete, në dokumentarin e titulluar "Historia sekrete e Planit Patkoi".

Dokumentari zbulon informacione se si operacioni "Patkoi" i Milosheviqit u rrëmbye nga zbulimi ushtarak i Bullgarisë dhe iu dha qeverisë bullgare të partisë djathtiste UDF (Unioni i Forcave Demokratike) dhe kryeministrit Ivan Kostov (1997-2001).

Sipas ministres së atëhershme Neynski (Mihajlova), kabineti i Kostovit vendosi që t'ia ofroj NATO-s informatat, të cilat pastaj ajo ia dorëzoi si raport ministrit të atëhershëm të Jashtëm gjerman, Joschka Fischer.

Fushata e pastrimit etnik në Kosovë, ishte arsyetimi formal i NATO-s për intervenim ushtarak në Kosovë në vitin 1999, në kampanjën tremujore të bombardimeve të Serbisë, përmes të cilave u larguan forcat e Slobodan Milosheviqit nga Kosova. Operacioni "Patkoi" i Serbisë (atëherë ende mini-Jugosllavi e përbërë nga Serbia dhe Mali i Zi), besohet të ketë filluar si një

operacion kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të kryesuar nga Kryeministri i tashëm i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi.

Dokumentari i bTV për këtë plan përqendrohet edhe në refuzimin e Bullgarisë për të pranuar refugjatët nga Kosova gjatë krizës së vitit 1999, duke theksuar se qëndrimi i qeverisë ishte "i drejtë".

"Ju e dini se kishte presion të madh në Bullgari që të pranonte refugjatët", thotë Neynski, duke theksuar se autoritetet e atëhershme bullgare ishin të shqetësuara për "palestinizimin" e mundshëm të konfliktit të Kosovës. "Për fat të keq, në Ballkan këta njerëz mund të kishin siguruar lehtë armë, dhe do të mund të bënin sulme në Serbi përmes kufirit tonë, duke përfshirë shtetet fqinje në konflikt dhe duke e ndezë në zjarr Ballkanin. Pra, kjo çështje korrespondon me çështjen e komentuar atëherë dhe sot - nëse Bullgaria bëri gabim që nuk pranoi refugjatët. Besoj se ky vendim ishte kryesori për të siguruar stabilitetin e Bullgarisë", thotë ish-ministrja.

Sipas saj, qeveria bullgare që në vitin 1999 i siguronte NATO-s raporte për planin "Patkoi", edhe pse shërbimi inteligjent ushtarak paralajmëroi se informacioni nuk mund të verifikohet.

"Kur ke të dhëna të tilla, është logjike që ne do t'ua sigurojmë ato partnerëve tanë. Në qoftë se ata e shohin të jenë jo bindëse, kanë të drejtë të mos i përdorin. Por, ky ishte një alarm që ne si politikanë me përgjegjësi kombëtare duhej ta përcillnim me qëllim të mbrojtjes së vendit tonë", thotë Neynski, duke shtuar se ministri i Jashtëm gjerman, Fischer, e mori me seriozitet raportin e zbulimit ushtarak bullgar.

Neynski gjithashtu komentoi pohimet se “Plani Patkoi” i Milosheviqit, për spastrimin etnik në Kosovë, nuk ka ekzistuar por se është fabrikuar nga inteligjenca perëndimore për të arsyetuar bombardimet kundër Serbisë.

"Ky plan ka ngritur shumë emocione, sepse në esencë ka legjitimuar luftën në Kosovë - domethënë, për të gjetur një shpjegim për çështjet për të cilat janë brengosur, nëse shkalla e madhe e eksodit është shkaktuar nga bombardimet apo diçka tjetër. Përgjigja është se ato janë shkaktuar nga diçka tjetër dhe se ky ishte “Plani Patkoi” i shërbimit inteligjent serb”, shpjegon ajo, duke shtuar se dëbimi masiv i shqiptarëve etnikë nga Kosova ka filluar rreth 25 shkurt 1999, “kur nuk kishte logjikë që këta njerëz që të largohen nga Kosova".

"Nuk ka asnjë mënyrë që 400 mijë njerëz të zbresin nga malet e ta braktisin Kosovën. Nuk duhet të jesh politikan ose një oficer i zbulimit që ta dini këtë. NATO dhe koalicioni ndërkombëtar nuk ishin amatorë që do të merrnin thjeshtë një pjesë të informacionit. Ai ishte i verifikuar nga të gjithë dhe u zbulua se ka të vërteta në të”, thotë Neynski.

"Unë përfundimisht besoj se Bullgaria u soll në mënyrë shumë dinjitoze atëherë, dhe arriti të parandaloj ndoshta ngjarjet dramatike në rajon".

Hetim special: mbulimi i krimeve të kryera në Kosovë

IWPR paraqet gjendjen e zhvarrimeve sekrete të viktimave Shqiptare të Kosovës dhe mungesën e deshirës së autoriteteve për të vepruar ndaj fajtoreve.

Nga bashkepunetorët e IWPR në Beograd dhe Londër* (BCR No. 393, 23-Dec-02)

Varret masive në Batajnica nuk janë një vend për ata që kanë nerva dhe stomak të dobët. Nje tendë në formë gjysem rrethi mbulon vendin ku germohet, nga i cili del një erë pothuajse e padurueshme.

Era e rëndë vjen nga trupat e atyre që mendohet të jenë shqiptare të Kosoves të vrarë gjatë konfliktit me forcat serbe në 1999, dhe me pas të transportuara në veri si pjese e një përpjekjeje për të mbuluar gjurmët e ketyre krimeve, dhe për të mos lejuar që bota të njihej me këto krime.

Varri i parë masiv i hapur në kampin e policisë në Batajnica - ku stërviteshin forcat speciale të njesive anti terror, SAJ - gjendet në një fushë pranë bregut të djathtë të lumit Danub. Katër varre të tjera janë aty pranë, njëra pranë tjetrës, në fundin e një poligoni qitjesh, i cili është rreth 300 metra i gjatë. Kjo hapsire është rreth 50 me 30 metra dhe është e rrethuar me një gardh të lartë nga tre anë, i ndërtuar nga shtylla druri dhe dhe. (është gërmuar edhe në dy vende të tjera, por aty nuk janë zbuluar kufoma).

Rruga për në poligonin e qitjes ecën përmes territorit të kazermave të ushtrise Jugosllave dhe fushes së stervitjes së tyre. Në ketë zonë mund të futen vetem ata njerëz të cilët janë kontrolluar imtësisht dhe kanë një urdhër të veçantë nga gjykata. Deri më tani, askush nga mediat nuk është lejuar të futet. Një gazetare është kthyer pas pa u lejuar të futej pavarësisht se shoqërohej nga kryeprokurorja e gjykatës së Hagës, Carla Del Ponte.

Kur një bashkepunetor i IWPR, gazetari i parë që është lejuar të marre pjese në zhvarrimin e kufomave, ka mbërritur pranë vendit ku germohej, po zhvarrosej një prej rreth 300 kufomave të nxjerra nga varri më i madh masiv, i njohur si Batajnica 5. Një masë e zezë, e pa formë, rreth 2.5 metra në thellësi i ka rënë menjëherë në sy gazetarit. Kjo ishte një masë thasësh plastik në të cilët ishin futur trupat. Trupat ishin varrosur në shtresa. Disa prej tyre dukej qartë se ishin vendosur aty nga njerez, ndërsa të tjerët ishin hedhur pa kujdes nga ndonjë kamion ose ekskavator.

Pranë varrit masiv dukeshin ende qartë shenjat e lëna nga gomat apo zinxhirët e buldozerëve dhe kamioneve të rëndë. Sipas një burimi të IWPR – një anëtar i një ekipi të madh ekspertesh të përbërë nga arkeologë dhe stafi i Institutit të Mjeksisë Ligjore të Beogradit, dikush ishte perpjekur t'i digjte trupat perpara se ato të gjendeshin.

Ky ekip është pjesë e Komisionit Ndërkombetar për Njerzit e Zhdukur, i cili është përgjegjës për zhvarrosjen dhe autopsinë e kufomave. Emrat e anëtareve të këtij ekipi mbahen sekret, sepse ka ende njerez në Serbi të cilët janë shumë të pakënaqur me faktin që po hapen varret masive në Batajnica.

Arkeologët kanë filluar procesin e zhvarrosjes së kufomave duke larguar shtresën sipërfaqësore të dheut me mjetet me moderne, dhe pastaj duke përcaktuar pozicionin e trupave. Ato që kanë mbetur nga kufomat dhe që gjenden në këtë hapsire më pas vendosen në një hartë të krijuar në kompjuter.

Me pas trupat nxirren dhe largohen prej andej rrobat dhe ato pjesë të trupit që kanë mbetur. Me pas vijon ekzaminimi dhe autopsia, si edhe analizat antropologjike të skeleteve. Kjo procedure kryhet brenda tendës, rreth 10 metra larg nga varri. Ekipi shkencor punon mbi dy tavolina. Dokumentacioni mjeksor përpunohet në një kompjutër të vendosur në një tavolinë tjetër. Në bazën e të dhënave të krijuar futen shumë të dhëna - si gjinia, mosha, gjatësia, kushtet e dhëmbëve si edhe elemente të tjerë të cilët mund të ndihmojnë në identifikimin e trupave.

Burimi i IWPR-së thotë se "Qëllimi ynë është të përcaktojmë shkakun e vdekjes. Në trupat e nxjerrë nga Batajnica 5, janë gjetur gjurmë plagësh me armë zjarri, kryesisht në trupat e meshkujve. Ne pastaj pergatisim një dokumentacion me foto dhe një regjistrim me video të cilat ia dërgojme gjykatës. Pas ekzaminimeve gjithashtu merren edhe pjesë të kockave, të cilat me një urdhër të gjykatës, mund të përdoren për analiza të ADN-së".

Ky burim i ka treguar gazetarit të IWPR në një ekran kompjuteri fotografi të sendeve të gjetura në varre, si xhaketa, xhupa, pantallona, karta identiteti, patenta shoferi, karta të sigurimeve shendetesore, çelsa, para, kuti cigaresh dhe bizhuteri. Më pas ai ka marrë në dorë një portofol në të cilin ndodhej një kartë identiteti pothuajse e pademtuar, një libër adresash me numra telefonash dhe fotografi të dy djemve dhe një vajze.

Karta e identitetit i përket një meso burri, një shqiptari nga rajoni i Gjakoves. "Ne kemi fotografuar të gjitha këto sende dhe ky album mund tu tregohet të

afërmëve të personave të humbur nëpërmjet Kryqit të Kuq Ndërkombetar," thotë burimi.

Në poligonin e Batajnicas, arkeologët kanë hapur edhe dy vende të tjera ku po gërmohet që prej kësaj vere, Batajnica 4 dhe Batajnica 6, por aty nuk është gjetur asnjë trup.

Dheu i nxjerrë nga Batajnica 4 është përdorur për të mbushur gropën e Batajnica 5, trupat e së cilës janë hedhur në Batajnica 6 dhe janë djegur. Në këtë varr, janë gjendur edhe shumë goma makinash të vendosura pranë stivave të trupave të njerëzve. Ende nuk është përcaktuar me saktësi se sa trupa janë djegur në këtë mënyrë. Goma të djegura makinash janë gjetur edhe në varret e tjera në Batajnica, por metoda e djegies së trupave e përdorur në Batajnica 1 ka qenë e ndryshme nga ajo e përdorur në varret e tjera. Gomat e makinave janë vendosur poshtë trupave në një gropë e cila është rreth 7 metra e gjërë dhe 2.5 metra e thellë, dhe janë mbuluar me qese neiloni. Trupat janë hedhur mbi to dhe janë lagur me benzinë.

Kjo përpjekje për të zhdukur gjurmët nuk qe e skukseseshme. Për shkak se trupat kanë qëndruar me parë për një kohë të gjatë në ujë, ato kanë thithë kaq shumë ujë sa që zjarri nuk i shkatërron dot. Mendohet se disa prej trupave nga kamioni frigoriferik, i cili ka dalë mbi Danub në Prill 1999, kanë përfunduar në Batajnica 1.

Si kanë përfunduar trupat në Batajnica

Mendohet se të gjithë trupat të cilat po zhvarrosen tani në Batajnica janë të viktimave të krimeve të kryera në konfliktin në Kosovë dy vjet më parë.

"Spastrimi" mendohet se është organizuar nga zyrtaret e Sllobodan Millosheviqit për të shkatërruar provat e masakrave të mëdha të kryera nga forcat Serbe në Kosovë në vitin 1999.

Për këto masakra është folur për herë të parë në një shkrim të botuar në Maj 2001 në një revistë të vogël lokale në Zajecarm në Serbinë lindore. Revista Timocka Krimi Revija, ka njoftuar se një kamion frigoriferik me rreth 50 trupa është nxjerrë nga Danubi në Kladovo, në Serbinë lindore, në Prill 1999 dhe se regjimi i Millosheviqit e kishte mbyllur të gjithë këtë histori.

Revista ka thënë se trupat duket se vinin nga Kosova. Në vitin 2001, pronari i revistës, Dragan Vitomiroviq, i cili ka vdekur pak kohë më parë në një aksident automobilistik, ka thënë se ai ia kishte ofruar këtë shkrim një gazete të përjavshme private të Beogradit, të afërt me qeverinë Serbe. Vitomiroviq nuk e ka thënë kurrë emrin e kësaj gazete.

Vitomiroviq ka qenë një ish anëtar i sherbimeve të sigurimit të shtetit të Serbise. Pasi ka bërë këtë propozim, ai është vizituar në Zajecar nga dy zyrtarë të tanishëm të shërbimeve të sigurimit të shtetit nga Beogradi të cilet i kanë thënë atij të mos thotë asgjë rreth këtij rasti dhe të mos botojë asnjë nga informacionet dhe artikujt.

Lajmi i kamionit frigoriferik është shpërndarë me shpejtësi rrufeje pas botimit, sepse publiku nuk ishte informuar kurrë më parë rreth krimeve të serbëve. Ministria e brendëshme e Serbise krijoi një grup pune të ngarkuar për të hetuar rrethanat e kësaj çeshtjeje. Grupi drejtohej nga Dragan Karleusa, zevendës shefi i njësisë

anti krimit të organizuar të policisë. Të gjitha mediat i kanë kushtuar një vëmendje të veçantë këtij lajmi.

Ato janë përpjekur gjithashtu të hetojnë për këtë rast, megjithëse pa shumë sukses. Në Maj 2001, Radio B92 ka intervistuar njeriun i cili i ka dhënë Timocka historinë ekskluzive. Zivojin Djordjeviq ka qenë zhytësi i cili kishte zbuluar kamionin në vitin 1999. Ka folur gjithashtu edhe Milivoje Srzentiq, prokurori i ri i qarkut të Negotin, ku është zbuluar kamioni.

"Ka qenë një kamion Mercedes – në kabinë ishte shkruajtur në shqip emri i kompanisë së përpunimit nga Peja," ka thënë Djordjeviq për B92. "Kamioni ka pasur targa të Pejes. Një gur i madh ishte vendosur mbi pedalen e gazit në menyrë që kamioni të levizte në drejtim të lumit".

Ai ka shtuar se "kur është nxjerrë në sipërfaqe kamioni dhe janë hapur dyert, prej andej kanë rreshqitur trupat e njerëzve. Ka pasur shumë trupa grash, femijësh dhe pleqsh. Disa gra ishin të veshura me çitjane, disa femijë dhe pleq kanë qenë të zhveshur".

Ndërsa tanimë njihet mirë zbulimi i kamionit të parë në Danub, vetem kohët e fundit është marrë vesh se një kamion i dytë frigoriferik me shqiptarë të vdekur është zbuluar në rrethana të ngjashme në të njejten kohë në Prill 1999.

Ky kamion është hedhur në Liqenin Perucac, një liqen artificial pranë Bajina Basta, në kufirin ndermjet Serbisë dhe Bosnje Herzegovines në atë që tani njihet si Republika Srpska. Pak njerez e dinë se kamioni në Liqenin Perucac ka dalë në sipërfaqe pikërisht në të njejtën kohë me atë të gjetur në Zajecar.

Sipas një burimi gjyqësor serb, trupat janë gjetur fillimisht me 8 Prill, 1999, pasi kishin dalë në sipërfaqe të liqenit pak më larg digës së tij. Zyrtarët e parë të cilët janë njoftuar kanë qenë ata të departamentit të policisë në Bajina Basta, dhe shefi i policisë në Uzice.

Shefi i policisë fillimisht ka dyshuar se ata mund të ishin trupa të njerëzve të vrarë në përpjekje në Bosnje, por nuk ka dashur të ndërmarrë asnjë veprim pa u konsultuar me parë me drejtuesit e tij në Beograd. "Ai ka telefonuar Vlastimir Gjorgjeviq, ish shefit të sigurisë publike, duke e pyetur atë se çfarë të bënte dhe i ka sugjeruar që të njoftojë zyrën e prokurorisë dhe gjykatës," thotë burimi.

Gjorgjeviq i ka thënë atij të dërgojë menjëherë dy inspektorë të policisë në Perucac. Ai ka thënë se kërkonte një raportim të menjëhereshëm për ngjarjen, por i ka kërkuar shefit të policisë të mos njoftojë përfaqësuesit e sistemit gjyqësor. Burimi shton se kur inspektorët nga Uzice dhe një zhytes nga Bajina Basta kanë arritur në këtë pikë, ata kanë zbuluar trupat e dy femrave dhe pesë meshkujve të cilët gjendeshin mbi siperfaqen e liqenit.

Atyre u është thënë të zhysin trupat në thellësi të liqenit, dhe ata e kanë bërë këtë gjë duke u lidhur gurë të rëndë. Por më pas është parë se këta kanë qenë vetëm një pjesë e një numri më të madh trupash. Pas 24 orësh pas zhytjes së këtyre trupave, ka dalë në sipërfaqe kamioni frigoriferik megjithëse pa shasinë dhe pjesën e motorrit.

Policia është alarmuar dhe ekipi përgjegjës për të zhdukur provat është përforcuar me njerez të tjerë. Ata fillimisht janë përpjekur të zhysnin përsëri kamionin por kjo ishte e pamundur. Ata janë përpjekur pa sukses për të

nxjerrë kamionin nga liqeni me ndihmën e një vinçi. Si rezultat, trupat janë vendosur në disa kosha metalike të cilat përdoreshin për të pastruar digën, dhe janë nxjerrë në breg dhe me pas janë ngarkuar në një kamion.

Për shkak të erës së rëndë, policët kanë punuar me maska mbrojtëse në fytyrë. Ata kanë parë se disa prej trupave kanë qenë pak të djegur, ndërsa të tjerët kanë qenë pa koka apo pa gjymtyrë, dhe në trupa kishte ende shenja dheu. Burimi ynë nga sistemi i drejtësisë thotë se ka të dhëna se policia ka pasur informacion mbi mënyrën se si kamioni ka përfunduar në liqen.

Një numër rezervistësh të ushtrisë jugosllave, të cilët kanë qenë të vendosur në një hotel aty pranë gjatë bombardimeve të NATO-s, kanë thënë se një natë, ndërsa ata po ruanin kufirin, kanë parë njerëz të sherbimeve sekrete të cilët po shtynin një kamion në liqen.

Trupat mund të jenë djegur në një zonë shkëmbore, në një pikë ku lumi Derventa derdhet në liqenin Perucac. Një bashkëpunëtor i IWPR ka parë një pjesë të gërmuar përgjatë bregut të lumit, rreth 20 metra nga rruga. Gjatë muajve të parë, kjo pamje mund të ketë tërhequr vemendjen e shumë njerzve. Një prej njerzve të cilët kanë marrë pjesë në ketë operacion mendohet të jetë ankuar pranë kolegëve të tij duke thënë se "Ne kishim urdhër ta bënim këtë punë sa më shpejt, dhe të siguroheshim që sa më pak njerëz të merrnin vesh. Por kjo ka qenë e pamundur". Germimi i kësaj zone është bërë në Shtator 2001.

Gjykatësi hetues në gjykatën e rrethit të Uzice, Momcilo Krivokapiq, ka thënë për IWPR se 48 trupa janë zhvarrosur - 26 trupa të plote dhe 22 trupa të gjymtuar.

Një kartë identiteti është gjetur së bashku me disa bizhuteri, një sasi parash dhe një stilograf. Të gjitha këto sende kanë treguar se këto ishin trupat e viktimave nga rajoni i Gjakovës. Krivokapiq ka shtuar se disa mostra të kockave janë dërguar në laboratore për analizat e AND-së.

Regjimi i Millosheviqit ka bllokuar hetimet

Ministria e brendëshme e Serbisë në periudhën e Millosheviqit mendohet se ka bllokuar të gjitha hetimet për kufomat e gjetura në kamionin e parë në Danub. Prokurori nga Negotin, Milivoje Srzentiq, ka thënë se ai kishte kërkuar prej prokurorit të përgjithshëm të asaj kohe, Krsta Majstoroviq, se përse nuk po zhvilloheshin hetimet e nevojshme. Me sa duket Majstoroviq është përgjigjur: "Sepse asgjë nuk ka ndodhur".

Që prej asaj kohe është thënë se Vlajko Stojiljkoviq, ministri i brendshëm i Millosheviqit, dhe Vlastimir Gjorgjeviq, ish shefi i sigurimit publik, kanë udhëzuar shefin e policisë së rrethit, Kolonel Caslav Goluboviq, të mos kryente asnjë hetim.

Ata e kanë urdhëruar atë të transferonte trupat në Beograd, sepse e gjithë kjo çeshtje ishte deklaruar si nje "sekret shteteror". Si Goluboviq, tani në pension, ashtu edhe Bosko Radojkoviq, i cili ka drejtuar hetimin në terren, kanë deshmuar për ketë çeshtje përpara gjykatës së Hagës.

Një ditë pas zbulimit të kamionit, me 7 Prill, 1999, kufomat janë dërguar me kamionë në kampin e stervitjes së policisë në Petrovo Selo, në Serbine Lindore,

ku kamioni është shkatërruar me një ngarkesë prej 30 kg eksploziv. Zyra e prokurorit të gjykatës së Hagës po kryen hetimet e saj, sipas Jim Langdale, zëdhënësit të departamentit të regjistrimit të gjykatës.

Drejtoresha e Qendrës Humanitare Ligjore me qendër në Beograd, Natasha Kandiq, ka dënuar këtë ngjarje si një krim të rëndë. Ajo mendon se njerzit e gjetur në kamionin frigoriferik, mund të jenë ndër ata 1300 deri 2000 shqiptarët të cilët rezultojnë të humbur që prej konfliktit në Kosovë. "Qeveria Serbe duhet të nisë një hetim mbi faktet që ekzistojnë rreth shkatërrimit të provave," ka thënë Kandiq. Ajo ka thënë se ka pasur disa prova të rëndësishme se policia serbe dhe ushtria jugosllave janë përfshirë në shkatërrimin e provave të krimeve të kryera në Kosovë kundër shqiptarëve të Kosoves gjatë bombardimeve të NATO-s.

Trupat mund të jenë djegur në një konvejer fabrike

Një hetim i kryer nga Kandiq ka arritur në përfundimin se ndërmjet 24 Marsit dhe 12 Qershorit, 1999, trupat e të paktën 800 shqiptarëve të vrarë, përfshirë pleq, gra dhe fëmijë, janë transportuar nga vendet ku ishin varrosur fillimisht për në disa vende sekrete në Kosovë dhe Serbi. Kufomat me pas janë djegur ose rivarrosur.

Natën e 17 Majit, 1999, trupat e 87 shqiptarëve të Kosovës janë zhvarrosur nga një varr masiv në Gjakovë. Për më tepër, Kandiq ka thenë se trupat e rreth 130 burrave të ekzekutuar në Izbicë janë transportuar nga varri i tyre masiv në një vend të panjohur.

Deklarime të ngjashme janë përmendur në një dokumentar të transmetuar në stacionin e radios publike Amerikane, ARW me 25 Janar, 2001. Sipas këtij dokumentari, forcat speciale Serbe, duke vepruar me urdhër të "një bashkëpunëtori të afërt të Millosheviqit", kanë djegur trupat e rreth 1500 civilëve shqiptarë të Kosovës në furrat e kompleksit të minierave të Trepçes në pranverën e vitit 1999. "Qellimi ka qenë shkatërrimi i kufomave të njerzve të vrarë," ka thënë një ish anëtar i forcave speciale serbe, i cili është prezantuar vetem me emrin Dusko, gjatë këtij emisioni. "Fshatra të tëra janë shkatërruar dhe banorët e tyre janë vrarë".

Sipas deshmisë së një shoferi të një prej kamioneve të cilët kanë transportuar trupat për në Trepçe, i quajtur Branko, rreth 120 trupa të grave dhe fëmijëve kanë ardhur nga Izbica. Ai ka thënë se trupat, fillimisht janë dërguar në mullinjtë të cilët përdoreshin për të thërrmuar mineralin dhe pastaj janë ngarkuar në konvejerët të cilët furnizojnë furrat. "Ishte një skenë e tmerrshme," ka thënë Branko. "Konvejeri ishte si në të gjitha fabrikat e tjera, por me ndryshimin se ai transportonte pjesë trupash njerzore".

Dy të intervistuarit nuk janë të përgatitur të dëshmojnë në gjykatën e Hagës. Një zyrtar Perëndimor, i cili kërkon të mbetet anonim, ka thënë për IWPR se gjykata kishte prova që Serbët kanë larguar të gjitha provat e djegieve masive nga miniera e Trepçes, por ka shtuar se "Ata të cilët kanë dijeni për këtë ngjarje nuk deshirojnë të deshmojnë".

Qeveria e re nuk heton

Shefi i sigurisë publike të Serbisë, Gjeneral Sreten Lukiq, ka qenë drejtues i policisë në Kosovë gjatë luftës. Kur gazetat kanë botuar njoftimet rreth kamionit të parë të zbuluar, Lukiq ka thënë se ai kishte mësuar për ketë "vetem nëpërmjet mediave" dhe ishte informuar më hollësisht rreth kësaj ngjarje vetem "në fund të muajit Prill 2001".

Pas përfundimit të konfliktit në Kosovë, ushtria jugosllave ka nisur një hetim për sjelljen dhe veprimet e rreth 245 ushtarëve të saj. Ndaj 183 prej tyre janë ngritur akuza për krime të kryera ndërmjet 1 Mars 1998 dhe 26 Qershor 1999. Por IWPR ka mësuar se asnjë prej këtyre akuzave nuk lidhet me ato që kanë ndodhur në minieren e Trepçes apo me kamionin frigoriferik nga Peja.

Asnjë hollësi nuk dihet rreth këtyre akuzave, dhe nuk dihet as identiteti i përsonave të akuzuar. Ekziston dyshimi edhe nëse ata do të dalin ndonjëherë para gjyqit. Zyrtarët e regjimit të ri dhe anëtarët e gjyqësorit nuk kanë komentuar ende rreth çeshtjes së kamionit frigoriferik. Ministri i drejtësisë të Serbisë, Vladan Batiq, dhe ministri i policisë, Dusan Mihajloviq, nuk kanë pranuar të thonë asgjë.

Pasi ministri federal i policisë, Zoran Zivkoviq, i ka thënë radio B92 me 7 Maj 2001, se kjo çeshtje është jashtë përgjegjesisë së tij, ministri i brendëshëm i Serbisë ka njoftuar se një njësi speciale hetimore është krijuar për të hetuar këtë rast nën drejtimin e Dragan Karleusa.

Pas këtij njoftimi u duk sikur kjo ngjarje do të zgjidhej shumë shpejt dhe përgjegjësit për këto krime dhe ata që kishin mbuluar ato do të dilnin para gjyqit. Kjo

shpresë është shtuar pas deklaratave të dhëna nga zyrtarë të policisë, duke filluar nga Mihajloviq dhe Karleusa.

Karleusa ka thënë në një konferencë për shtyp me 24 Maj 2001, se ekipi i tij kishte zbuluar një numër faktesh. Ai ka konfirmuar se "një takim pune është mbajtur në zyrën e Sllobodan Millosheviq në Mars 1999" dhe se përveç Millosheviq, në atë takim kishin marrë pjesë edhe ish ministri i brendshëm Vlajko Stojiljkoviq, shefi i sigurimit publik Gjenerali Vlastimir Gjorgjeviq, shefi i sigurimit të shtetit Radomir Markoviq dhe disa zyrtarë të tjerë. "Në këtë takim Gjenerali Gjorgjeviq ka shtruar problemin e spastrimit të terrenit në rajonin e Kosovës. Në lidhje me këtë, Millosheviq ka urdhëruar Strojiljkoviq të merrte masa për mbulimin e të gjitha gjurmëve të cilat mund të çonin në zbulimin e provave," ka thënë ai.

Gjatë deshmisë së tij të mëvonshme në Hagë, Karleusa ka thënë se grupi i punës ka marrë në pyetje disa gjeneralë të policisë të cilët në atë periudhë kishin poste të larta drejtuese në ministrinë e brendëshme, por të gjithë ata kishin kundërshtuar përfshirjen e tyre në këto ngjarje dhe nuk kishin pranuar të kenë pasur dijeni për varret masive.

Karleusa nuk ka përmendur nëse ka pasur përpjekje për të pyetur komandantin e forcave të policisë Kolonel Zivko Trajkoviq i cili ka qenë drejtues i bazave në Batajnica dhe Petrovo Selo në të cilat janë zbuluar varret masive. Trajkoviq është momentalisht në burg për vrasjen nga pakujdesia të një kolegu të tij gjatë një udhëtimi për gjueti. Një burim i lartë i policisë ka thënë se

Trajkoviq në fakt ka luajtur një rol të dorës së dytë në çeshtjen e varreve masive, sepse ai ka zbatuar vetem urdhërat e superiorit të tij, Djordjeviq.

Që prej ditës kur janë bërë publike këto deklarime, asnjë arrestim nuk është kryer dhe nuk është ngritur asnjë akuzë zyrtare. Mund të gjehet shkak në rastin e Millosheviq dhe të Stojiljkoviq, sepse Millosheviq është transferuar në Hagë me 28 Qershor 2001, ndërsa ish ministri i tij i brendshëm ka kryer vetëvrasje. Por nuk është e qartë se përse policia nuk ka marrë asnjë masë ndaj Gjeneralit Gjorgjeviq, i cili mendohet të ketë qenë përgjegjësi për zhvendosjen e trupave të shqiptareve të vrarë në Kosovë.

Pas rrëzimit të regjimit të Millosheviq, Gjorgjeviq është shkarkuar nga posti i shefit të sigurisë publike. Në Mars 2001, ai është emëruar këshilltar i ministrisë së brendëshme të Serbisë, ndërsa pas gjashtë javësh është marrë vendimi për nxjerrjen e tij në pension. Dy javë më pas, ministria e brendëshme ka kundërshtuar zërat se nxjerrja në pension e Gjorgjeviq ka pasur lidhje me rastin e kamionit frigoriferik.

Në një intervistë me të përjaveshmen e Beogradit, Vreme, në Nëntor 2001, Karleusa ka komentuar mbi rolin e Gjorgjeviq në këtë operacion: "Ne jemi përpjekur të kontaktojme me të. Unë i kam telefonuar dhe i kam thënë “Miku im, a do të vish, kemi një kamion këtu, dhe ka fjalë se ka të bëjë me policinë”. Kur ai ka ardhur unë e kam pyetur atë a dinte gjë për kamionin frigoriferik. Ai ka mërmeritur diçka nëpër dhëmbë, por në fakt nuk më ka thënë asgjë".

I pyetur rreth vend ndodhjes së tanishme të Gjorgjeviq, Karleusa është përgjigjur: "Ne kemi lëshuar një urdhër arresti lokal për të. Ka pasur njoftime se ai është parë në Jugosllavi, Maqedoni dhe në Moskë..." Një gazetar i IWPR është përpjekur ta kontaktojë Karleusan, por atij i është thënë se ai nuk ishte në gjendje të bënte asnjë deklarim për shtypin pas dëshmisë së dhënë në gjyqin kundër Millosheviqit në Hagë.

Identifikimi i trupave vazhdon me shpejtsinë e breshkës

Analizat e para të ADN-së janë kryer në Madrid, ku autoritetet Serbe kanë dërguar disa mostra nga kockat e rreth 36 trupave të zbuluar në varret masive në Batajnica. Një raport paraprak i cili sapo ka mbërritur nga Madridi thotë se dy nga trupat janë identifikuar pa asnjë dyshim. Në mesin e muajit Maj, 2002, Beogradit i është dhuruar laboratori i parë për kryerjen e analizave të ADN-së.

Dr. Dushan Dunjiq, drejtor i Institutit të Mjeksisë Ligjore, ku është vendosur laboratori, ka thënë për IWPR se puna për identifikimin e trupave të tjerë po ecën "me ritme të larta". Dr. Junjiq nuk ka pranuar të thotë se sa analiza janë përfunduar deri më tani, duke thënë se ai nuk mund të bëntë asnjë koment përpara se të zhvarroseshin të gjitha trupat nga varret masive.

Duke ngulur këmbë se asgjë nuk po mbahej sekret, ai ka thënë se problemi më i madh është se analizat e laboratorit të tyre nuk mund të përcaktonin identitetin e njerzve. Ai ka thënë se përpara se të bëhej një gjë e tillë, nevojitej të kryhej një analizë paralele e

ADN mbi mostra të marra nga të afërmit dhe familjarët e viktimave.

Megjithatë, prokurori i Hagës, William Fulton, i cili është caktuar të punojë në zyrën e gjykatës në Beograd, ka dëshmuar në gjykatën për krimet e luftës me 28 Maj 2002, se si rezultat i zhvarrosjes së kryer në varrin e parë masiv në Batajnica të kryer nga ekspertët e Institutit për Mjeksinë Ligjore në Beograd, një numër sendesh identifikuese janë zhvarrosur. Keto sende i përkisnin disa njerezve të zhdukur në bashkinë e Suharekës në Kosovë.

Ai ka dëshmuar gjithashtu se dokumente identifikimi të nxjerra nga varri i dytë në Batajnica u përkisnin tetë përsonave nga Meja të cilët janë zhdukur me 27 Prill, 1999 dhe më pas janë regjistruar si njerez të humbur nga Kryqi i Kuq Ndërkombëtar. Ndërmjet tyre ishin emrat e Ali Bajrami, Simon Sokoli, Sezai Rama, Shyt Hasanaj, Krist Sokoli, Gani Smajili, Qun Bib Krasniqi, Ndue Krasniqi dhe Brahim Gaxherri.

Policia nuk u përgjigjet kërkesave të gjykatës për informacion

Policia duket se e ka bërë njërin vesh të shurdhër ndaj kërkesave urgjente të gjykatësve për identifikimin e fajtorëve për krimet në Kosovë dhe atyre që kanë marrë pjesë në mbulimin e këtyre krimeve. Nuk ka dyshim se policia e ka ditur ekzistencën e varreve masive që në fillim dhe ka filluar të bëjë diçka vetëm në pranverën e vitit 2001 pas një takimi të drejtuesve politik serbë. Në këtë takim është vendosur të zbardhet e vërteta në lidhje

me kamionin frigoriferik me këmbënguljen e ministrit të brendshem, Dusan Mihajloviq. Pas urdhërave të tij, shefi i sigurisë publike, Sreten Lukiq, me 7 Maj 2001 ka krijuar një ekip operativ nën drejtimin e Karleusa të ngarkuar me detyrën për përcaktimin e fakteve rreth kamionit që përmbante trupat e paidentifikuar. Deri më sot, policia nuk ka paraqitur ndonjë akuzë kriminale ndaj njerzve të përmendur nga Karleusa se kanë qënë prezent në takimin e punës të mbajtur në zyrën e Millosheviq në Mars 1999, dhe as nuk ka zbuluar identitetin e "të tjerëve" të cilët ai ka thënë se kanë marrë pjesë në atë mbledhje.

Pas zhvarrimit të varrit të parë masiv dhe nxjerrjes së 450 trupave në vjeshtën e vitit 2001, policia ka lëshuar vetem pak deklarata për këtë çeshtje.

Përveç se nuk kanë qenë në gjendje të identifikojnë njerzit të cilët kanë dhënë urdhërin për të kryer këto krime, policia është treguar çuditërisht me pa deshirë për të dhënë informacione për ata të cilët kanë hapur varret masive në kampet e stërvitjes, i kanë mbushur ato me trupat e njerzve të vrarë dhe i kanë mbuluar ato, kanë thënë burime të IWPR në sistemin gjyqësor serb.

Policia nuk mundet të bëjë një vesh shurdh ndaj këtyre kërkesave, por i kanë këshilluar gazetarët përgjithësisht të pyesin sistemin gjyqësor, duke thënë se policia tashmë e ka përfunduar punën e saj. Në të njejtën kohë, disa qarqe policore kanë thënë se nën presion nga politikanet, gjykatat dhe prokuroritë kanë penguar me dashje hetimet.

Kjo ka shkaktuar një reagim nga zyra e prokurorit shtetëror në pranverë 2002, i cili ka thënë se

ajo nuk ka qenë në gjendje të nisë procedurat ligjore ndaj njerzve të paidentifikuar por mund të vepronte kundër njerzve të cilët akuzohen zyrtarisht nga policia.

Policia ende nuk ka bërë akuza të tilla. Burime të IWPR-së në sistemin gjyqësor serb mendojnë se zyra e prokurorisë mund të kishte reaguar më me forcë pasi policia në mënyrë të përsëritur ka injoruar kërkesat e saj. "Kërkesat e paraqitura nga zyra e prokurorisë janë shumë të qarta në lidhje me ato që duhet të bëjë policia," thotë burimi. "Policisë i është kërkuar të përcaktojë nëse, kur dhe në çfarë rrethanash janë vrarë shqiptarët e Kosovës, si edhe. ekzaktësisht çfarë lloj operacionesh janë kryer nga autoritetet Serbe dhe Jugosllave në territorin në të cilën kanë ndodhur vrasjet e dyshuara".

Burimi i IWPR ka thënë se policisë i është kërkuar të përcaktojë identitetin e atyre të cilët kanë drejtuar këto operacione dhe të përsonave të cilët janë informuar rregullisht për mbarëvajtjen e këtyre operacioneve dhe rezultat e tyre. Zyra e prokurorit kishte kërkuar në mënyrë specifike informacion rreth faktit nëse civilë janë trajtuar në mënyrë jo humane dhe brutale, dhe kush i ka vrarë dhe i ka varrosur viktimat në Kosovë dhe kush më vonë i ka zhvarrosur trupat dhe i ka transferuar ato nga Petrovo Selo dhe Perucac në Beograd.

Mbulimi i rastit të vëllezërve Bytyçi

I njejti burim ka përmendur edhe rastin e vëllezërve Bytyçi si një shembull të mirë të taktikave politike të pengimit të hetimeve. Argon, Vili dhe Mehmed Bytyçi, shqiptarë me nënshtetësi Amerikane, janë

arrestuar në Qershor 1999 në Serbi dhe janë dënuar me 15 ditë burgim sepse kishin hyrë ilegalisht në Jugosllavi. Ata e kanë vuajtur dënimin në burgun Prokupljes nga i cili janë marrë me 8 Korrik të atij viti. Një vit më pas, trupat e tyre janë zbuluar në një prej dy varreve masive në një kamp stërvitor të policisë në Petrovo Selo, në Serbinë lindore. Të tre kanë qenë të lidhur me tela dhe kishin sytë e mbyllur dhe kishin plagë me armë zjarri në kokë.

Identiteti i tyre është përcaktuar në Gusht 2001 në Institutin e Mjeksisë Ligjore në Beograd nga mjekë të FBI dhe një ekip ekspertësh të Institutit të Patologjisë së Forcave të Armatosura të SHBA, AFIP. Policia Serbe ka thënë se ata e dinë se kush i ka marrë vëllezërit Bytyci nga burgu i Prokupljes por emrat e tyre ende nuk janë bërë publik.

Zyra e prokurorisë në Negotin, e cila ka në juridiksion varrin masiv të zbuluar në Petrovo Selo, i ka kërkuar në mënyrë të përsëritur policisë të shtojë përpjekjet dhe të vazhdojë të identifikojë ata të cilët kanë dhënë urdhërin për vrasjen e vëllezërve Bytyci si edhe të identifikojë njerzit të cilët kanë zbatuar këtë urdhër dhe kanë vrarë ata.

Zyra e prokurisë ka paraqitur gjithashtu edhe emrat e njerzve të cilët mund të jepnin informacion të bollshëm për policinë në lidhje me këtë rast. Zyra ka informuar policinë se "ka disa dyshime" se ish shefi i sigurisë publike Vlastimir Djordjeviq ka organizuar rrëmbimin e vëllezërve Bytyçi.

Zyra e prokurorit ka theksuar se policia duhet të gjejë Djordjeviq dhe ta pyesë se përse ka dhënë urdhër që

vellezërit Bytyçi të dërgoheshin në Petrovo Selo, si edhe për transferimin e tyre nga ky vend.

Zyra e prokurorit mendon se ish shefi i sigurisë publike mund të ketë informacione rreth atyre të cilët kanë dhënë urdhër për vrasjen e vëllezërve Bytyçi dhe atyre që i kanë vrarë ata. Prokuroria ka sugjeruar gjithashtu që policia të marrë në pyetje edhe Obrad Stevanoviq, ish ndihmës i ministrit të brendëshëm.

Ai ka qenë komandant i së ashtuquajturës ekip i ndjekjes operative të ministrisë së brendëshme në Serbi, anëtarët e së cilës kanë marrë vellezërit Bytyçi nga burgu i Prokupljes.

Zyra e prokurorit ka kërkuar gjithashtu nga policia që ajo të marrë në pyetje shefin e xhandarmërisë Serbe, Goran Radosavljeviq, të njohur me emrin "Guri", sepse ai ka qenë në kontakt me Djordjeviq dhe kur vëllezërit Bytyçi janë çuar në kampin stërvitor të policisë, Guri ka qenë komandant i kësaj njësie në Petrovo Selo.

Në të njejtën kohë, zyra e prokurorisë ka sugjeruar që policia mund të merrte në pyetje Ljubomir Aleksiq, zevendës shefin e departamentit të administratës së policisë në ministrinë e brendëshme të Serbisë.

Sipas informacioneve që ka zyra e prokurorit dhe IWPR, zevendësi i Gurit në atë kohë, Rade Djeriq, ka marrë pjesë gjithashtu edhe në hapjen e varreve dhe varrosjen e kufomave në Petrovo Selo.

Duke theksuar se policia nuk e ka kryer si duhet detyrën e tyre, zyrtarë nga zyra e prokurorit në Nëntor 2002 janë ankuar se nuk është arritur asnjë progres në rastin e vëllezërve Bytyçi nga Korriku i vitit 2001 deri në Shkurt 2002.

Askush nuk është nxjerrë para drejtësisë

Zhvarrimi i Batajnica 7, varri i pestë masiv i Shqiptarëve të Kosovës, ka filluar në fillim të Nëntorit. Nëse puna nuk pengohet nga kushtet e kqia të motit, zhvarrimi duhet të përfundojë deri në fund të vitit. Kjo do të shënonte edhe përfundimin e procesit të zhvarrosjes së trupave nga të gjitha vendet e zbuluara deri më tani në Serbi.

Rezultati i zhvarrimeve që kanë filluar që prej 18 muajsh janë kufomat e rreth 770 njerzve, përfshirë edhe nëntë fëmijë dhe disa dhjetra gra. Numri ndoshta do të rritet edhe më tepër, sepse mendohet se varri i fundit në Batajnica mund të përmbajë nga 50 deri në disa qindra trupa. E panjohura më e madhe mbetet ende se kush i ka vrarë këta njerëz. Ka qenë policia, ushtria, formacionet paraushtarake, apo serbët e Kosovës?

Shefi i sigurimit publik Sreten Lukiq ka thënë se kur është shpallur gjendja e luftës, është dhënë një urdhër për të gjitha forcat, përfshirë edhe ministrinë e brendëshme të Serbisë, sipas të cilit, të gjitha strukturat duhet t'i bindeshin komandës së ushtrisë jugosllave, dhe se ka dokumenta me shkrim të cilat e provojnë një gjë të tillë. Një deklarim i tillë të bën të mendosh se përgjegjësia kryesore për të gjitha veprimet e dhunshme në Kosovë i bie ushtrisë.

Një burim i rëndësishëm i policisë i cili ka marrë pjesë në luftën në Kosovë thotë se ndërsa do të ishte e lehtë të identifikoheshin fajtorët për disa prej krimeve në provincë, një gjë e tillë do të ishte në shumicën e rasteve e

pamundur. "Ka mbizoteruar një gjendje kaosi," ka thënë ai, "ndërsa NATO bombardonte, forcat tona ndesheshin me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës praktikisht në të gjithë provincën dhe disa forca paraushtarake dhe të policisë speciale të cilat ose vidhnin dhe bastisnin ose kërkonin të merrnin hak. Është e vështirë të thuash se kush ka kryer krime".

Ndërkohë, deshmitarë si Marko, një barman nga Kragujevac, në Serbinë qendrore, vazhdojnë të qendrojnë të heshtur. Ndërmjet viteve 1998 dhe 1999, ai ka shërbyer ne një njësi të rregullt të ushtrisë jugosllave në Kosovë, duke bërë roje në një pikë vrojtimi në Koshare në kufirin ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. "Ne mbronim kufirin tonë nga terroristët shqiptarë - por për fat të keq ka pasur nga ata të cilët kanë zbrazur zemërimin e tyre ndaj popullsisë së pafajeshme civile," thotë ai. Marko thotë se një shok i tij nga e njejta njësi ushtarake, i zemëruar nga vrasja e një shoku tjetër, ka vrarë një grua shqiptare duke e hedhur atë në një pus së bashku me një granatë. Si shumë të tjerë të cilët kanë shërbyer në Kosovë, Marko thotë se Serbia nuk është ende e gatshme për të diskutuar këto krime.

Supërstruktura kriminale shtetërore serbe kishte vetëm një kokë komanduese, ai ishte varrmihësi i Kosovës Sllobodan Milloshevіç

Gjatë luftës në Kosovë (1998 - 1999), regjimi pushtues serb angazhoi një superstrukurë të gjerë forcash ushtarake - policore…, kundër popullit shqiptar

dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Këto forca përbënin një kombinim kompleks të,

- *strukturave policore speciale të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë,*
- *njësive ushtarake speciale të Ushtrisë serbe,- njësive të shumta paramilitare si dhe*
- *të një spektri forcash të tjera vullnetare që vinin nga vendet ish-sovjetike si nga: Rusia, Bjellorusia, Ukraina, pastaj Rumania etj.*

Dhe kjo superstrukturë kriminale kishte vetëm një kokë komanduese, e ai ishte varrmihësi i Kosovës Sllobodan Millosheviç.

Për të argumentuar përfshirjen e kësaj supërstrukture kriminale në veprimtarinë e saj me përmasa gjenocidale, po i referohem një raporti të organizatës "Human Rights Watch". Në raportin e tetorit 2001, kjo organizatë hulumtuese (faktmbledhëse) për krimet e kryera në Kosovë, shkruan: "Ushtria Jugosllave kishte komandën e përgjithshme gjatë periudhës së bombardimeve të NATO-s. Sipas ligjit, ajo kishte nën varësinë e saj policinë dhe forcat paraushtarake, megjithëse zyrtarët e lartë në Ministrinë e Punëve të Brendshme serbe ushtruan dukshëm një influencë të rëndësishme gjatë fushatës. Ushtria kontrollonte rrugët kryesore dhe kufijtë duke koordinuar dhe lehtësuar kështu "spastrimin etnik" (në Kosovë). Policia dhe forcat paraushtarake u përfshinë në mënyrë më të drejtpërdrejtë në dëbimin e civilëve dhe shkatërrimin e fshatrave, për të cilën kishin mbështetjen e artilerisë së ushtrisë. Gjatë këtyre operacioneve burrat veçoheshin

nga gratë dhe fëmijët për t'u marrë në pyetje për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe ekzekutoheshin në vend."

Sipas këtij raporti, Ushtria serbe ishte nën kontrollin e plotë të Këshillit të Lartë të Mbrojtjes, i përbërë nga presidentët e Serbisë, Malit të Zi dhe "Jugosllavisë" dhe që kryesohej nga kryetari jugosllav Millosheviç. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë serbe gjatë luftës në Kosovë ishte Gjenerali Dragoljub Ojdaniç. Gjen. Ojdaniç pas përfundimit të luftës, do të emërohet si Ministër i Mbrojtjes deri në tetor të vitit 2000.

Kush e projektoi operacionin e koduar "Patkoi"

Operacioni i koduar "PATKOI" është projektuar nga Shtabi i ushtrisë jugosllave (lexo: serbe) dhe kreu i politikbërjes serbe Sllobodan Millosheviç, duke pasur përkrahjen e përhershme edhe nga Kisha serbe. Ky projekt për shfarosjen e shqiptarëve, duket se është bazuar plotësisht në platformat e mëhershme antishqiptare, duke filluar nga "Naçertanija" e Ilia Garashaninit e deri te "Memorandumi…" i Akademisë së Shkencave të Serbisë", kreatorë i së cilës ishte shoveni Dobrica Qosiç.

Tri fazat e realizimit të operacionit "Patkoi"!

Operacioni "Patkoi" është planifikuar të zbatohet në tri faza:

- Faza e parë ishte paraparë që të kryhej gjatë muajit janar 1999, e që kishte për qëllim spastrimin etnik nga popullsia shqiptare, pjesën veriore të Kosovës.

- Faza e dytë ishte planifikuar gjatë muajit shkurt, për ta përfshirë pjesën qendrore të Kosovës, përkatësisht Drenicën dhe rajonet përreth, ku përveç vrasjeve dhe dëbimit të popullsisë shqiptare, kishte për qëllim edhe shkatërrimin e njësiteve të UÇK-së.

- Faza e tretë gjatë marsit dhe prillit 1999, kishte për qëllim spastrimin etnik të Kosovës.

Për këtë qëllim strukturat komanduese dhe politike të Serbisë, kishin hapur dy vendkalime kufitare, një me Shqipërinë në Qafë të Morinës dhe tjetrën me Maqedoninë në Bllacë.

Cilat forca ushtarake morën pjesë në zbatimin e operacionit "Patkoi"?!

Në operacionin "Patkoi" ka marrë pjesë korpusi ushtarak i Prishtinës, që përbënte supërstrukturën ushtarake të Armatës së tretë serbe në Kosovë.

Komandant i armatës së tretë ishte Gjen. Kol. Nebojsha Pavkovic, ndërsa Komandant i Korpusit të Prishtinës ishte Gjeneral major Vlladimir Llazareviç.

Korpusin ushtarak të Prishtinës (sipas raportit "Human Rights Watch") e përbënin:

- pesë brigada,
- një njësi policore ushtarake dhe
- një regjiment aviacioni.

Në operacionin "Patkoi" morën pjesë edhe korpuse të tjera nga Serbia dhe Mali i Zi, si:

Korpusi 21 i Nishit i përbërë nga:
- Brigada e Blinduar 211 (Nish) në përbërje prej 1258 trupa, 75 tanke, 13 topa dhe 4 RBV,
- Brigada 150 e Vranjës e përbërë prej 1300 trupa, 72 topa dhe 12 RBV,
- Brigada e motorizuar 78 e Vranjës e përbërë nga 1316 trupa dhe 31 tanka, Brigada e 2-të e Nishit e përbërë nga 1600 trupa dhe 10 tanke,
- Brigada 175 e Leskovcit e përbërë nga 1600 trupa dhe 18 tanke,
- Brigada e motorizuar e 4-të e Pirotit e përbërë nga 1600 trupa, 31 tanke dhe 18 topa,- Njësiti i inxhinierisë 352 i Prokuples nga 1000 trupa dhe
- Njësiti i Logjistikës 85 i Nishit i përbërë prej 1000 trupash.

Korpusi 37 i Uzhicës me:
- Brigadën e 37-të të motorizuar të Rashkës që kishte në dispozicion 1695 trupa, 31 tanke dhe 18 topa dhe
- Brigada 19 e Pozhegës e përbërë nga 1600 trupa dhe 18 topa.

Në Kosovë kishte ardhur edhe:
Korpusi 24 i Kragujevcit, i cili përbëhej nga:
- Brigada 80 e Kragujevcit me 1600 trupa dhe 18 topa si dhe Korpusi 12 i Novi Sadit që në përbërje kishte:
- Brigadën e 18 të Novi - Sadit që në përbërje kishte 1600 trupa dhe 18 topa.

Në Kosovë ishte stacionuar edhe:
Armata e parë e Beogradit, e cila në përbërje të vetë kishte:
- Brigadën 252 të blinduar të Kralevës, me 1121 trupa, 82 tanke, 12 topa dhe 4 RBV.

Këtu ishte edhe:
Korpusi special i Beogradit me
- Brigadën e parë të Blinduar,
- Brigadën speciale 72 dhe
- Brigadën 63 të parashutistëve.
- Brigada e parë e Blinduar kishte 1184 trupa, 112 tanke, 12 topa dhe 4 RBV,
- Brigadën speciale 72 kishte 1189 trupa, ndërsa
- Brigada 63 e parashutistëve kishte 460 trupa.
Në këtë operacion famëkeq, ishte angazhuar edhe:
Korpusi 2 i Podgoricës, ku bënin pjesë:
- Brigada e 5-të e motorizuar me 1478 trupa dhe 31 tanke.
- Brigada 1 Bë4 alpiniste e Kollashinit me 350 trupa dhe
- Brigada 4 e Policisë ushtarake e Podgoricës me 359 trupa.
Skema: Plani 1 + Plani 2 i Operacionit "PATKOI"
Strukturat e MUP'it dhe njësitë paramilitare serbe
Përveç forcave ushtarake, në realizimin e operacionit "Patkoi" në Kosovë, janë përfshirë: strukturat e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, njësitë tjera speciale e paramilitare serbe. Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë (Ministarstvo Unutrashnjih Poslova, apo siç thirrej shkurt MUP), drejtohej nga Ministri Vlajko Stojiljkoviç.

Në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë bënin pjesë:
- policia e rregullt e Kosovës, e komanduar nga Sreten Lukiç

- Forcat policore speciale (Posebne Jedinice Policije, apo PJP) e që komandoheshin nga Gjen. Lt. Obrad Stevanoviç dhe
- Forcat Antiterroriste (Specijalna Antiteroristiçka Jedinica, apo SAJ), të cilat komandoheshin nga Kol. Zhivko Trajkoviç.
- Ndërkaq kreu i sektorit të sigurimit publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme ishte Gjeneral Vlastimir Gjorgjeviç...

Në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë vepronte edhe Shërbimi i Sigurimit, e ashtuquajtura UDB-ë, e cila konsiderohej si syri dhe veshi i regjimit pushtues serbë në Kosovë. Kreu i sigurimit të shtetit serb (UDB-së) gjatë luftës në Kosovë ishte z. David Gajiç. Shërbimi sekret i Serbisë (UDB-a), për të zbuluar aktivitetin e UÇK-së, në radhët e veta ka rekrutuar edhe shumë shqiptarë.

Skema: struktura e mup'it serbë në Kosovë, mars - qershor 1999

Ky shërbim famëkeq në Kosovë dislokoi gjithashtu edhe të ashtuquajturën "njësi operative speciale, JSO-në (Jedinica za Specijalne Operacije)", e cila i ndihmoi në forma të ndryshme njësitë kriminale paramilitare, si:

- "Skorpionët",
- "Tigrat e Arkanit",
- "Beli Orlovi" (Shqiponjat e Bardha) të Voisllav Sheshelit,

- “vullnetarët e ardhur nga Republika serbe e Bosnjes dhe mercenarë nga ish-vendet sovjetike, si dhe

- “Beretat e Kuqe” apo “Djemtë e Frenkit” (emërtim ky që u morë sipas Frenki Simatovic, një personalitet kyç në Ministrinë e Punëve të Brendshme, dhe njihej si themeluesi i këtij grupi). Gjatë luftës kjo njësi speciale.

- Jedinica za Specijalne Operacije (JSO-ja 9 komandohej nga Milorad Lukoviç, i njohur me nofkën “Legija”.

Ndërkaq në njësitë e lartpërmendura paramilitare janë rekrutuar edhe qindra serbë lokal - vendës (kishte edhe njësi të veçanta kriminale nga serbët e Kosovës, siç ishte njësia kriminale “Munja” - Vetëtima, që ka vepruar në rrethin e Pejës etj), të cilat kanë kryer krime mbi popullsinë e pambrojtur shqiptare. Ata, kishin për detyrë të vrasin pamëshirshëm shqiptarë, por edhe të djegin, të plaçkitin dhe ta shpërngulin popullatën shqiptare nga Kosova. Për këtë aktivitet kriminalë flasin shumë argumente. Pas përfundimit të luftës, shumë paramilitarë serbë (por edhe të huaj) u kanë deklaruar hetuesve ndërkombëtarë dhe gazetave të huaja, se gjatë luftës në Kosovë (me theks të veçantë gjatë vitit 1999 kur po realizohet Operacioni “Patkoi“), shpeshherë prej zyrtarëve të lartë të ushtrisë dhe të policisë serbe kanë marrë lista me emra të shqiptarëve, të cilët janë ekzekutuar në forma të ndryshme!

5.19.2012

NJË LISTË KRIMESH E KRIMINELËSH

Lufta e Kosovës ishte një konflikt i armatosur në Kosovë që filloi në 28 shkurt të vitit 1998, pas sulmit jugosllav në fshatrat Likoshan dhe Qirez në Drenicë të Kosovës, deri në 11 qershor 1999.

Lufta u zhvillua mes forcave të Republikës Federale të Jugosllavisë, (në atë kohë, Konfederata e Serbisë dhe Malit të Zi) dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me ndihmë ajërore nga NATO, (nga 24 marsi 1999), dhe mbështetje tokësore nga Shqipëria.

Në këtë luftë u dëbuan 800000 mijë shqiptarë, u vranëe 15000 persona, nga të cilët 2400 luftëtarë të UÇK-së e të tjerët civilë. Gjatë luftës janë zhdukur rreth 5000 njerëz, fati i shumicës prej tyre është zbardhur deri në vitin 2007, por i madh ka mbetur numri i rasteve të pasqaruara.

***

Në 1987, ndodhi masakra e Paraćin pasi një ushtar shqiptar në Ushtrinë Kombëtare Jugosllave (UKJ) vrau katër ushtarë serbë. Kjo ngjarje i rriti akoma më tej tensionet. Pas këtyre ngjarjeve Sllobodan Millosheviçi, akuzoi Dragisa Pavlovic, si kryetar i organizatës së partisë në Beograd, se ishte paqësor me shqiptarët dhe ishte i butë me radikalët shqiptarë.

Sipas disa artikujve, Sekretari Federal i Mbrojtjes Kombëtare, Admirali i Flotës Branko Mamula, thoshte se "nga 1981 deri në 1987, 216 organizata ilegale shqiptare me 1435 anëtarë u zbuluan brenda UKJ". Mamula thoshte se shqiptarët etnikë po pregatiteshin për të "vrarë oficerë dhe ushtarë, duke helmuar ushqimin dhe ujin, sabotim, hapjen e arsenaleve të armëve dhe vjedhjen e armëve dhe municioneve, dezertim dhe shkaktim i trazirave nacionaliste brenda njësive të ushtrisë".

Në një memorandum iu kushtua vëmendje speciale Kosovës, duke thënë që në atë rajon serbët po përballeshin me "genocid fizik, politik, ligjor dhe kulturor" dhe ishin në një "luftë të hapur dhe totale" që vazhdonte nga vjeshta e vitit 1981. Në këtë propagandë thuhej se statusi i Kosovës në 1986 ishte humbja më e madhe historike e serbëve që prej çlirimit nga osmanët në 1804, duke e renditur si më të rëndë se pushtimi Nazist dhe se pushtimi i Serbisë nga Austro-Hungaria në Luftën e Parë Botërore. Autorët e Memorandumit pretendonin se 200000 serbë janë larguar nha rajoni përgjatë njëzet viteve. Memorandumi kërkonte kthimin e serbëve të

larguarve dhe rritjen e sigurisë dhe kushteve të serbëve në Kosovë.

Memorandumi SANU provokoi shumë reagime: Shqiptarët e shikonin si një përpjekje për rritjen e supremacisë serbe, duke thënë që ata pak serbë që u larguan (rreth 2000-5000) u larguan vetë për arsye ekonomike, ndërkohë që Sllovenët dhe Kroatët, e panë si kërcënim. Serbët e pritën mirë por disa prej komunistëve të vjetër e kundërshtuan ashpër.

Në nëntor 1988, kryetari i komitetit rajonal të Kosovës u arrestua. Në mars 1989, Millosheviçi prezantoi "revolucionin anti-burokratik" në Kosovë dhe Vojvodinë, duke ia zvogëluar autonominë dhe duke vendosur shtetrrethim dhe gjendje emergjente në Kosovë për shkak të protestave, ku humbën jetën 24 njerëz. Millosheviçi dhe qeveria e tij pretendonin se këto ndryshime ishin për të mbrojtur serbët e mbetur në Kosovë nga shumica shqiptare.

***

Politikat e rezistencës pacifiste të Ibrahim Rugovës bënë që Kosova të ishte në qetësi gjatë luftës në Slloveni, në Kroaci dhe Bosnje gjatë fillimit të viteve 1990. Gjithësesi, krijimi i UÇK-së, u pa si rezultat i acarimit të popullsisë shqiptare ndaj shtypjes së shtetit serb. Në mesin e viteve 1990, Rugova kërkoi që në Kosovë të vendosej një forcë paqeruajtëse nën komandën e OKB-së. Në 1997, Millosheviçi u ngrit në presidencën e Republikës Federale Jugosllave (e përbërë nga Serbia dhe Mali i Zi që prej krijimit në prill 1992).

Vazhdimi i shtypjes së popullsisë i bindi shqiptarët se vetëm rezistenca e armatosur do ta ndryshonte situatën e rënduar. Në 22 prill 1996, u ndërmorrën katër sulme ndaj personelit të sigurisë serbe në disa pjesë të Kosovës. Sulmet u morën përsipër nga një organizatë e panjohur në atë kohë e quajtur "Ushtria Çlirimtare e Kosovës" (UÇK). Natyra e UÇK-së mbetej e panjohur nga ndërkombëtarët.

Kryesisht ndihmat e para financiare dhe materiale UÇK i mori nga diaspora shqiptare. Në fillim të vitit 1997, qeveria e Shqipërisë u rrëzua si pasojë e armatosjes së popullsisë dhe hapjes së rezervave të armatimeve të Ushtrisë shqiptare. Një pjesë e rezervave përfunduan në duar të bandat kriminale ndërsa një pjesë tjetër ndihmoi në armatosjen e arsenalit të UÇK.

Bujar Bukoshi, Kryeministri në ekzil (në Zyrih, Zvicër), krijoi FARK-un (Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës) e cila u absorbua në shumicën e anëtarëve të saj në UÇK. Qeveria jugosllave e konsideronte UÇK-në si "terroristë" të cilët sulmonin policët dhe civilët.

Në 1998, Departamenti Amerikan i Shtetit e listoi UÇK-në si organizatë terroriste, dhe në 1999 Komiteti i Politikave të Republikanëve në Senatin e Shteteve të Bashkuara shprehu shqetësimin për "aleancën efektive" të administratës Demokrate të Klintonit me UÇK-në për shkak të "shumë raporteve nga burime të besueshme jozyrtare". Në 2004, John Pilger tha se për gjashte vjet deri në 1998, UÇK-ja është trajtuar nga ShBA si grup terrorist...

Në vitin 2000, një artikull BBC shkruan Nato at War (Nato në Luftë) ku shkruan se si Shtetet e Bashkuara, të cilat e quajtën UÇK-në si "terroriste", tani kishin marrëdhënie me grupin. Ndërkohë që SHBA zyrtarisht e quante UÇK-në terroriste, autori Alastair MacKenzie thotë se UÇK stërvitej nga aleati më i mash i SHBA-së në NATO, Mbretëria e Bashkuar, e cila që prej vitit 1998 stëvitej në një kamp stërvitjeje në fshatrat në veri të Bajram Currit...

Ndërkohë, SHBA mbante një "mur të jashtëm sanksionesh" ndaj Jugosllavisë të cilës i krijoi shumë probleme. Ato u mbajtën pavarësisht marrëveshjes në Dejton për heqjen e sanksioneve.

Kriza u përshkallëzua në dhjetor 1997 në takimin e Këshillit të Implementimit të Paqes në Bon, ku komuniteti ndërkombëtar (siç u quajt në Marrëveshjen e Dejtonit) pranoi t'i japë përfaqësuesit të lartë në Bosnje dhe Hercegovinë fuqi pastruese, duke përfshirë shkarkimin e liderëve të zgjedhur. Në të njëjtën kohë, diplomatët perëndimorë këmbëngulën që të diskutohej çështja e Kosovës, dhe që Jugosllavia ti përgjigjej kërkesave të shqiptarëve. Delegacioni jugosllav u largua nga mbledhja menjëherë në protestë.

Kjo u ndoq nga kthimi i Grupit të Kontaktit që pa fazën e fundit të konfliktit në Bosnje dhe deklaratat e fuqive Europiane ku i kërkohej Jugosllavisë të zgjidhte problemin me Kosovën.

***

Sulmet e UÇK-së shtohen, me në qendër luginën e Drenicës në afërsi të banesës së Adem Jasharit. Disa ditë pasi Robert Gelbard e quajti UÇK-në grup terrorist, policia

serbe sulmon UÇK-në në zonën e Likoshanit, dhe ndoqën disa prej luftëtarëve deri në Cirez, duke vrarë 16 luftëtarë shqiptarë dhe u vranë 4 policë serbë.

Pavarësisht akuzave për vrasje selektive dhe vrasjes së civilëve, dënimet e kryeqyteteve perëndimore nuk ishin aq të ashpra sa do të bëheshin më vonë. Policia serbe ndoqi Jasharin dhe bashkëluftëtarët e tij deri në fshatin Prekazi i Poshtëm. Një sulm masiv mbi shtëpinë e Jasharit solli masakrimin e 60 shqipëtarëve, shumica familarë të Adem Jasharit, nga të cilët 18 ishin gra dhe 10 fëmijë. Ngjarja e 5 marsit 1998 shkaktoi irritim të thellë në kryeqytetet perëndimore. Madeleine Albright tha se tashmë "kjo krizë nuk është një çështje e brendshme RFJ".

Në 24 mars forcat Jugosllave rrethuan fshatin e Glloxhanit dhe sulmuan luftëtarët e UÇK-së. Pavarësisht fuqisë më të madhe të zjarrit, forcat jugosllave dështuan në shkatërrimin e njësisë së UÇK-së i cili ishte objektivi i tyre. Megjithëse kishte disa të vdekur dhe shumë të plagosur nga UÇK, Beteja e Glloxhanit ishte një rezistencë e suksesshme.

Një qeveri e re u formua në Jugosllavi, e drejtuar nga Partia Socialiste e Serbisë dhe Partia Radikale Serbe. Kryertari i Partisë Ultra-nacionaliste Radikale Vojislav Sheshel u bë zëvendës kryeministër. Kjo shtoi pakënaqësinë në pozicionin e vendit ndërmjet diplomatëve perëndimorë.

Në fillim të prillit, Serbia organizoi një referendum për çështjen e ndërhyrjes së jashtme në Kosovë. Votuesit serbë refuzuan vendosshmërisht kundër ndërhyrjes së huaj në këtë krizë. Ndërkohë, UÇK fitoi shumë territor përreth Deçanit dhe kishte territore nën

kontroll në Glloxhan. Kështu që, në 31 maj 1998, Ushtria Jugosllave dhe policia e Ministrisë së Brendshme serbe filluan operacionin për spastrimin e kufirit të kontrolluar nga UÇK. Përgjigjja e NATOs ndaj kësaj ofensive ishte operacioni i mesit të qershorit i quajtur Operation Determined Falcon (Operacioni Fajkoi i Vendosur), një parakalim ajëror mbi kufijtë Jugosllavë.

Gjatë kësaj kohe, Presidenti Jugosllav Millosheviç arriti një marrëveshje me Presidentin e Rusisë Boris Jelcin për ndalimin e operacioneve ofensive dhe pregatitjen e bisedimeve me Shqiptarët. Ku më pas u arrit takimi midis Millosheviçit dhe Ibrahim Rugovës në 15 maj në Beograd, dy ditë pasi u njoftua nga Richard Holbrooke. Një muaj më vonë, Holbrooke, pas një udhëtimi në Beograd ku ai kërcënoi Millosheviçin që nëse nuk bindeshte, "çfarë ka mbetur nga vendi juaj do të shpërthejë", ai vizitoi zonat kufitare të prekura nga luftimet në fillim të qershorit, nga ku u fotografua me ushtarët e UÇK-së. Publikimi i këtyre imazheve fotografike i dërgoi një sinjal UÇK-së, mbështetësve dhe simpatizantëve, dhe vëzhguesve në veçanti, se SHBA-të do të mbështesnin vendosshmërisht UÇK-në dhe popullsinë shqiptare në Kosovë.

Marrëveshja e Jelcinit përfshinte lejimin nga Millosheviçi të përfaqësuesve ndërkombëtarë të ngrinin një mision në Kosovë në mënyrë që të monitoronin situatën. Ky ishte Kosovo Diplomatic Observer Mission (KDOM), (Misioni Diplomatik Vëzhgues në Kosovë), i cili filloi të veprojë në fillim të korrikut. Qeveria amerikane e mirëpriti këtë marrëveshje, por denoncoi thirrjen e

iniciativës për armëpushim të përbashkët. Pasi Amerikanët kërkonin tërheqjen e trupave jugosllave.

Gjatë gjith qershorit dhe deri në mes të korrikut, UÇK-ja mbajti avantazhin e vet. UÇK rrethoi Pejën, Gjakovën, dhe kishte caktuar kryeqytet provizor qytetin e Malishevës. Trupat e UÇK-së u futën në Therandë (Suharekë), dhe në veri-perëndim të Prishtinës. Më pas u futën në Rahovec dhe në fshatrat përreth.

Pas disa sulmeve të UÇK-së në mes të gushtit, trupat jugosllave nisën operacione ofensive në jug të rrugës Prishtinë-Pejë. UÇK filloi një ofensivë në 1 shtator në rrethinat e Prizrenit, duke rritur aktivitetin usharak të ushtrisë jugosllave. Në Pejë, një ofensivë jugosllave rrezikoi një karvan njerëzish të dëbuar, veprim i cili u dënua nga oficerët ndërkombëtarë.

Në mes të shtatorit, për herë të parë UÇK-ja arriti në veri të Kosovës përreth Podujevës. Në fund, në fund të shtatorit, një përpjekje e vendosur nga jugosllavët nisi për largimin e UÇK-së nga veriu dhe qëndra e Kosovës po ashtu edhe nga lugina e Drenicës. Gjatë kësaj kohe shumë kryeqytete perëndimore dënuan sulmin, por sulmet u intensifikuan. Në 28 shtator, kur u gjetën kufomat e gjymtuara të një familjeje nga KDOM jashtë fshatit Abria e Epërme. Pikërisht Masakra në Abri të Epërme siguroi ndërkombëtarët për genocidin ndaj shqiptarëve në Kosovë, ky imazh i gjakosur shtyu luftën në një nivel tjetër.

Lista është ndërtuar sipas rasteve shumica e të cilave është shqyrtuar nga hetuesia ndërkombëtare dhe hetuesi i OKB-së për krime të luftës, Dennis Milner i cili thotë se "…Puna e ekipit të tij do të vazhdojë të fokusohet

thuaja tërësisht në rangun e lartë të regjimit të të kryeakuzuarit për krime lufte, kryetarit jugosllavë Sllobodan Millosheviq".

Si do që të jetë ndriçimi i të gjitha rasteve ende nuk është bërë por vetëm i rasteve me rëndësi apo të nivelit të lartë të efektit ndëkombëtar. Për këtë është e udhës edhe mbledhja e të dhënave nga vetë të prekurit nga kriminelët, sidomos femrat të cilat për shkaqe të ndryshme nuk i kanë paraqitur rastet personale duhet që këto ti paraqesin pranë shoqatave që përkujdesen për këto raste. Organizata të tilla ka anë e mbanë Kosovës.

***

Në 9 korrik 1998, Presidenti i SHBA Bill Clinton deklaroi "emergjencën kombëtare" (gjendje e jashtëzakonshme) për shkak të "kërcënimit të pazakontë dhe të jashtëzakonshëm të sigurisë kombëtare dhe politikave ndërkombëtare të Shteteve të Bashkuara" imponuar nga Jugosllavia dhe Serbia mbi Luftën e Kosovës.

Në 23 shtator 1998 nën Kapitullin VII të Kartës së OKB-së Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara pranoi Rezolutën 1199. Kjo shprehte një "shqetësim të madh" me raportet që i arrinin Sekretarit të Përgjithshëm që mbi 230000 njerëz janë dëbuar nga shtëpitë e tyre nga "përdorimi i forcës së tepërt dhe diskriminuese nga forcat e sigurisë serbe dhe Ushtria Jugosllave", duke kërkuar që të gjitha palët në Kosovë dhe në Republikën Federale të Jugosllavisë (Serbia dhe Mali i Zi) të ndalojnë armiqësinë dhe të mbajnë një armëpushim. Në 24 shtator Këshilli i Atlantikut të Veriut

(NAC) i NATOs lëshoi një "paralajmërim aktivizimi" (ACTWARN) duke e çuar NATO-n në një nivel më të lartë gatishmërie ushtarake si për një mundësi të limituar ajërore ashtu edhe për një fushatë ajërore me faza në Kosovë. Problemi i madh për ata që shihnin si zgjidhjen e vetme përdorimin e forcës ishin mbi 250000 shqiptarë të dëbuar, 30000 prej të cilëve ishin në qiell të hapur në pyje, pa veshmbathje apo strehim, dhe me dimrin që afrohej shpejt.

Ndërkohë, ambasadori amerikan në Republikën e Maqedonisë, Christopher Hill, po drejtonte diplomacinë ndërmjet delegacionit shqiptar, i drejtuar nga Rugova, dhe autoritetet jugosllave dhe serbe. Në këto mbledhje po bëhej një plan paqeje pas planifikimit të NATOs për pushtimin e Kososvës. Gjatë një periudhe prej dy javësh, kërcënimet u shtuan, duke kulmuar në dhënien nga NATO të Urdhërit të Aktivizimit. NATO ishte gati të fillonte sulmet ajërore, dhe Richard Holbrooke shkoi në Beograd me shpresën se do të arrinte një marrëveshje me Millosheviçin. Zyrtarisht, komuniteti ndërkombëtar kërkoi të ndaloheshin luftimet. Specifikisht kërkohej që Jugosllavia të pushonte ofensivën ndaj UÇK-së ndërkohë që përpiqej që të bindte UÇK-në të heqë dorë nga pavarësia. Më tepër, u bënë përpjekje për të bindur Millosheviçin të lejonte trupat paqeruajtëse të NATOs të hynin në Kosovë.

Në 13 tetor 1998, Këshilli i Atlantikut të Veriut lëshoi urdhërat e aktivizimit (ACTORD) për ekzekutimin e sulmeve të limituara ajërore po ashtu edhe fushatë ajërore me faza në Jugosllavi e cila do të fillonte përafërsisht për 96 orë. Në 15 tetor Marrëveshja e

Misionit të Verfikimit në Kosovë (KVM) i NATOs për armëpushim u firmos, dhe afati i fundit për tërheqjen u zgjat për në 27 tetor. Tërheqja serbe filloi në ose rreth 25 tetorit 1998, dhe Operacioni Syri i Shqiponjës (Eagle Eye) filloi në 30 tetor.

KVM ishte një kontigjent i madh i monitoruesve të paarmatosur të paqes nga OSBE (të njohur zyrtarisht si verifikues) të cilët u futën në Kosovë. Pamjaftueshmëria e tyre ishte e dukshme që në fillim. Ata u quajtën me nofkën "clockwork oranges" (me kuptimin në zhargon anglisht si diçka e pavend dhe të panevojshme) si referencë për makinat me ngjyrë portokalli që përdornin. Luftimet filluan sërisht në dhjetor 1998 pasi armëpushimi u thye, dhe gjatë luftimeve u vra Zvonko Bojanić, kryebashkiaku serb i Fushë Kosovës. Autoritetet jugosllave u përgjigjën me masa të ashpra ndaj ushtarëve të UÇK-së.

Nga janari në mars 1999 lufta solli pasiguri në zonat urbane, duke përfshirë bombardime dhe vrasje. Të tilla sulme u kryen edhe gjatë bisedimeve ne Rambuje në shkurt dhe ndërkohë që Marrëveshja e Verifikimit në Kosovë u zgjidh në mars. Vrasjet në rrugë vazhduan dhe u rritën. Kishte përplasje ushtarake në Vushtrri në shkurt dhe zonë e paprekur deri tani në luftime në Kaçanik në fillim të marsit.

Në 15 janar 1999 ndodhi Masakra e Reçakut ku "45 fermerë shqiptarë u rrethuan, u drejtuan drejt një kodre dhe u masakruan. Trupat u zbuluan nga monitoruesit e OSBE-së, duke përfshirë edhe Kryetarin e Misionit William Walker, dhe të dërguarit e huaj të shtypit ndërkombëtar.

Jugosllavia e mohoi masakrën. Masakra e Reçakut ishte kulmimi i sulmeve të UÇK-së dhe reprezaljes së jugosllavëve që vazhduan përgjatë gjithë dimrit 1998–1999. Masakra u ndëshkua nga vendet perëndimore dhe nga Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, dhe më vonë u bë baza e një nga akuzave për krime lufte ndaj Millosheviçit dhe zyrtarëve të tij më të lartë. Kjo masakër ishte një pikë kthese e luftës. NATO vendosi se konflikti mund të zgjidhej vetëm duke vendosur një mision paqeruajtës ushtarak nën komandën e NATOs. Prishtina u bë subjekt i përleshjeve me armë dhe dëbimit të popullsisë sipas raporteve të OSBE-së.

***

Në 30 janar 1999 NATO lëshoi një deklaratë ku Këshilli i Atlantikut të Veriut kishte pranuar që "Sekretari i Përgjithshëm i NATOs mund të autorizojë sulme ajërore kundër shënjestrave në territorin e RFJ" në mënyrë që të arrihej një marrëveshje politike". Ndërkohë që kjo ishte më shumë një kërcënim për qeverinë e Millosheviçit, ajo po ashtu ishte një sprovë për të gjithë faktorin politik shqiptar.

Po ashtu në 30 janar 1999 Grupi i Kontaktit lëshoi një set "principesh të panegociueshme" e cila krijoi një paketë të njohur si "Status Quo Plus"—efektivisht rikthimin e autonomisë së Kosovës si para vitit 1990 brenda Serbisë, plus futjen e demokracisë dhe vëzhgim nga organizatat ndërkombëtare. Po ashtu kërkohej një konferencë paqeje e cila protej të mbahej në shkurt 1999

në kështjellën Château de Rambouillet, jashtë Parisit në Francë.

Bisedimet e Rambujesë filluan në 6 shkurt 1999, me Sekretarin e NATOs Javier Solana i cili negocionte me të dyja palët. Ato ishin përcaktuar të përfundonin në 19 shkurt. Delegacioni jugosllav drejtohej nga presidenti i Serbisë Milan Milutinović, ndërkohë që Millosheviçi qëndronte në Beograd. Kjo ishte në kontrast me konferencën e Dejtonit në 1995 e cila përfundoi luftën në Bosnje, ku Millosheviçi negocioi personalisht. Mungesa e Millosheviçit u interpretua si shenjë se vendimet e vërteta po bëheshin në Beograd, një lëvizje që e rriti kriticizmin në Jugosllavi dhe jashtë saj; peshkopi serb i Kosovës Artemije udhëtoi në Rambuje për të protestuar për faktin se delegacioni ishte tejet i papërfaqësuar. Gjatë asaj kohe spekulohej për një padi të mundshme për krime lufte ndaj Millosheviçit, kështu që mungesa e tij mund të jetë motivuar nga frika për arrestimin e tij.

Në fazën e parë negociatat ishin të suksesshme. Në veçanti, një deklaratë e lëshuar nga bashkë-kryetari i Grupit të Kontaktit në 23 shkurt 1999 se negociatat "kanë arritur një konsensus për një autonomi për Kosovën, duke përfshirë mekanizma për zgjedhje të lira dhe të ndershme për institucione demokratike.

Ndërkohë që marrëveshja nuk i kënaqi plotësisht shqiptarët, sipas jugosllavëve ata ishin shumë radikalë, të cilët u përgjigjën duke ndryshuar në mënyrë drastike tekstin të cilën edhe Rusia (aleat i RFJ) e quajti të papranueshëm. Ata kërkonin të rishikonin me kujdes statusin politik të Kosovës dhe larguan të gjitha masat e propozuara për implementim. Ndërmjet gjithë këtyre

ndryshimeve në versionin e ri të propozuar, eleminohej komplet kapitulli për ndihmën humanitare dhe rindërtim, hiqej komplet mbikëqyrja ndërkombëtare dhe nuk përmendej "vullneti i popullit të Kosovës" në vendosjen e statusit përfundimtar të Kosovës.

Në 18 mars 1999, delegacionet shqiptare, amerikane dhe britanike firmosën atë që u bë Marrëveshja e Rambujesë ndërkohë që delegacionet jugosllave dhe ruse nuk pranuan. Marrëveshja kërkonte për administrimin e Kosovës nga NATO si një provincë autonome brenda Jugosllavisë, një forcë prej 30,000 trupash të NATOs për mbajtjen e rregullit në Kosovë; të drejtën e kalimit të papenguar të trupave të NATOs në territorin jugosllav, përfshirë Kosovën; dhe imunitet për NATOn dhe agjentët e saj nga ligji jugosllav. Do të lejohej një prani e vazhdueshme e ushtrisë jugosllave me 1,500 trupa për vëzhgimin e kufirit, të mbështetura nga 1,000 trupa për qëllime komande dhe mbështetje, po ashtu edhe një numër të vogël policie kufitare, 2,500 njerëz nga Ministria e Brendshme për qëllime sigurie të përgjithshme, dhe 3,000 policë lokalë.

Megjithëse qeveria jugosllave citoi dispozitat ushtarake të Shtojcës B të dispozitave të Rambujesë si arsyen e kundërshtimeve të tyre, duke thënë se ishte një dhunim i papranueshëm i sovranitetit të Jugosllavisë, këto dispozita ishin thelbësisht të njëjta me ato të zbatuara në Bosnje për misionin SFOR (Stabilisation Force) pas Marrëveshjes së Dejtonit në 1995. Dy palët nuk i diskutuan problemet me detaje për shkak të mosmarrëveshjeve më thelbësore. Në veçanti, pala sebe nuk e pranonte idenë e pranisë së trupave të NATOs në

Kosovë duke zëvendësuar forcën e tyre të sigurisë, duke preferuar më mirë vëzhgues të paarmatosur të OKB-së. Vetë Millosheviçi refuzoi të diskutojë shtojcën pasi informoi NATOn që ishte e papranueshme, edhe pasi atij iu ofrua të propozojë amendamente për dispozitat në mënyrë që të bëheshin të pranueshme.

Ngjarjet rrodhën shpejt pas dështimit në Rambuje dhe pas propozimit alternativ jugosllav. Monitoruesit ndërkombëtarë të OSBE-së u tërhoqën më 22 mars, për frikën për sigurinë e monitoruesve që i paraprinte fushatës bombarduese të NATO-s.

Në 23 mars 1999 në orën 22:30, Richard Holbrooke u rikthye në Bruksel dhe lajmëroi se bisedimet e paqes dështuan dhe i dorëzoi çështjen formalisht NATO-s për veprime ushtarake. Disa orë para lajmërimit, Jugosllavia lajmëroi në televizionin kombëtar se ka deklaruar gjendjen e emergjencës duke cituar një kërcënim të afërt lufte dhe filloi një mobilizim të madh trupash dhe resurshesh.

Në 23 mars 1999 në orën 23:17 Sekretari i Përgjithshëm i NATOs, Javier Solana, lajmëroi se kishte urdhëruar Komandantin Suprem Aleat të Europës (SACEUR), Gjeneralin e Ushtrisë Amerikane Wesley Clark, që të "nisë operacionet ajërore në Republikën Federale të Jugosllavisë." Në 24 mars në orën 20:00 NATO nisi fushatën bombarduese kundër Jugosllavisë.

Fushata bombarduese e NATOs zgjati nga 24 marsi deri në 11 qershor 1999, duke përfshirë mbi 1000 avionë që vepronin kryesisht nga bazat në Itali dhe në aeroplan-mbajtëset të stacionuara në Detin Adriatik. Raketat kruiz Tomahawk u përdorën gjërësisht, të

lëshuara nga avionët, anijet, dhe nëndetëset. Me përjashtim të Greqisë, të gjithë anëtarët e NATOs u përfshinë sadopak. Në mbi dhjetë javet e konfliktit, avionët e NATOs fluturuan mbi 38,000 misione luftimi. Për Forcat Ajrore Gjermane (Luftwaffe), ishte hera e dytë kishte marrë pjesë në një konflikt që prej Luftës së Dytë Botërore pas Luftës së Bosnjes.

Qëllimi i paracaktuar i NATOs u përmblodh nga zëdhëndësit e saj si "serbët jashtë, paqeruajtësit brenda, refugjatët të kthehen". Kjo ishte, trupat jugosllave duhej të largoheshin nga Kosova dhe do të zëvendësoheshin nga paqeruajtësit ndërkombëtarë në mëyrë që siguronin që refugjatët shqiptarë të ktheheshin në shtëpi. Fushata u caktua në fillim për shkatërrimin e mbrojtjes ajërore jugosllave dhe shënjestra ushtarake me vlerë të lartë. Nuk shkoi dhe aq mirë në fillim, pasi moti i keq i pengonte shumë misionet. NATO e nënvlerësoi seriozisht faktin se Millosheviçi do të rezistonte: shumë pak në Bruksel mendonin se fushata do të zgjaste më shumë se pak ditë, dhe megjithëse bombardimet fillestare nuk ishin me intensitet të ulët, por nuk e arritën intensitetin e bombardimit të Bagdadit në 1991.

Operacionet ushtarake të NATOs ndryshuan thelbësisht në sulmin e njësive tokësore jugosllave, duke goditur shënjestra si tanket dhe artilerinë, ndërkohë që vazhdohej me bombardimin strategjik. Ky aktivitet gjithësesi, ishte shumë i përmbajtur nga politika, pasi çdo shënjestër duhej të aprovoheshte nga të gjithë 19 shtetet anëtare. Mali i Zi u bombardua në disa raste por NATO eventualisht pushoi së përkrahuri pozicionin e pasigurt të liderit të saj anti-Millosheviç, Milo Gjukanoviç. Përveç

shënjestrave të drejtpërdrejta ushtarake u sulmuan edhe shënjestra që mund ti hynin në dihmë ushtrisë, siç ishin ura përgjatë Danubit, fabrika, centrale energjie, shkolla, shtëpi, spitale, impiante telekomunikimi dhe shtabi i përgjithshëm i të Majtëve të Jugosllavisë një parti e drejtuar nga gruaja e Millosheviçit dhe kulla e transmetimit të RTS.

Në fillim të majit, një avion i NATOs sulmoi një karvan refugjatësh shqiptarë, duke menduar se ishte një karvan ushtarak jugosllav, duke vrarë rreth 50 njerëz. NATO e pranoi fajin pesë ditë më vonë dhe jugosllavët akuzuan NATOn për sulm me vetëdije ndaj refugjatëve. Një raport i mëvonshëm i hartuar nga Gjykata Ndërkombëtare Kriminale për ish Jugosllavinë (ICTY) me titull "Raporti Përfundimtar për Prokurorin nga Komiteti i Caktuar për Rishikimin e e Fushatës Bombarduese të NATOs Kundër Republikës Federale të Jugosllavisë" ku thuhej se "civilët nuk u sulmuan me dashje në këtë incident" dhe se "as ekuipazhi dhe as komandantët nuk treguan të pamatur për të marrë masa parandaluese të cilat do tu hiqnin akuzat kriminale."

Në 7 maj, disa bomba të NATOs godasin ambasadën kineze në Beograd, duke vrarë tre gazetarë kinezë dhe duke egërsuar opinionin publik kinez. Shtetet e Bashkuara dhe NATO më vonë kërkuan falje për bombardimin, duke thënë se ishte një gabim i shkaktuar nga një hartë e pasaktë e para shumë viteve. Një tjetër incident ishte masakra e burgut të Dubravës në maj 1999, ku qeveria jugosllave akuzoi për vrasjen e 85 civilëve pas bombardimit nga NATO të kompleksit. Një raport i mëvonshëm i Human Rights Watch arriti në përfundimin

se rreth 19 të burgosur dhe gardianë u vranë nga bombardimi, por që një numër i pasaktë – ndoshta më shumë se 70 shqiptarë – u vranë nga forcat qeveritare serbe në ditët që kaluan pas bombardimit.

Nga fillimi i prillit, konflikti ishte shumë larg zgjidhjes dhe vendet e NATOs filluan të mendonin seriozisht për operacione tokësore në Kosovë. Kryeministri Britanik Tony Blair ishte avokat i fortë për sulm me trupa tokësore dhe i bënte presion Shteteve të Bashkuara që të pranonin; qëndrimi i tij i ashpër shkaktoi pak alarm në Uashington pasi forcat amerikane duhej të ishin me të larta në numër në çdo mësymje. Presidenti i SHBA-ve Bill Clinton ishte shumë vendosur për sulm tokësor të drejtuar nga forcat amerikane. Por në vend të kësaj, Clinton autorizoi një operacion të CIAs për të gjetur metoda destabilizimi për dobësimin e qeverisë jugosllave pa nevojën e trajnimit të UÇK-së.

Në të njëjtën kohë, negociatorët finlandezë dhe rusë nisën të provojnë të bindnin Milloshviçin të tërhiqej. Tony Blair do të urdhëronte 50,000 ushtarë britanikë të bëheshin gati për mësymje tokësore.

Millosheviçi më në fund kuptoi se Rusia nuk do të ndërhynte të mbronte Jugosllavinë pavarësisht retorikës së fortë anti-NATO të Moskës. Kështu që ai pranoi kushtet e ofruara nga ekipit të ndërhyrjes Finlandezo-Rus dhe pranoi një prani ushtarake në Kosovë të drejtuar nga OKB, por me pjesëmarrjen edhe të trupave të NATOs.

Forcat speciale norvegjeze Hærens Jegerkommando dhe Forsvarets Spesialkommando bashkëpunuan me UÇK-në në mbledhjen informacioneve

të inteligjencës. Duke u pregatitur për pushtim në 12 qershor, forcat speciale Norvegjeze punuan së bashku me UÇK në zonat malore kufitare me Maqedoninë dhe kryesisht merreshim me zbulim për të monitoruar ngjarjet në Kosovë. Bashkë me forcat speciale britanike, forcat speciale norvegjeze ishin të parat që kaluan kufirin për në Kosovë. Sipas gazetarit të Sky News Keith Graves, norvegjezët ishin futur në Kosovë dz ditë para marshimit të forcave të tjera dhe ishin ndër të parët që u futën në Prishtinë.

Detyrat e Hærens Jegerkommando dhe Forsvarets Spesialkommando ishte të pastronin rrugën dhe të qetësonin palët serbëve dhe shqiptarëve.

***

Më 3 qershor 1999, Millosheviçi pranoi kushtet e një plani ndërkombëtar paqeje për të ndaluar luftimet, ku në kuvendin kombëtar po pranoheshin propozimet pavarësisht debateve të ashpra dhe përleshjeve me grushta në disa raste. Në 10 qershor Komiteti i Atlantikut të Veriut ratifikoi marrëveshjen dhe pezulloi operacionet ajërore.

Marinsat e SHBA marshojnë së bashku me fëmijët shqiptarë në rrugët kryesore të Zhegrës në 28 qershor 1999

Më 12 qershor, pasi Millosheviçi pranoi kushtet, misioni i drejtuar nga NATO Kosovo Force (KFOR) filloi të futej në Kosovë. KFOR ishte pregatitur të kryente operacione luftarake, por në fund, misioni i tij mbeti vetëm paqeruajtja. KFOR ishte i bazuar nën shtabin e Allied Rapid Reaction Corps (Trupat e Reagimit të Shpejtë

Aleate) të komanduara nga Gjeneral Lejtnant Mike Jackson i Ushtrisë Britanike. Ku konsistonte në trupa britanike (një brigadë e ndërtuar nga brigada e IV e blinduar dhe brigada e V e parashutistëve), një brigadë e Ushtrisë Franceze, një brigadë e Ushtrisë Gjermane, të cilat hynë nga perëndimi ndërkohë të gjitha forcat e tjera avancuan nga jugu, me një brigadë e Ushtrisë Italiane dhe një brigadë e Ushtrisë Amerikane.

Trupat e para të NATOs që u futën në Prishtinë në 12 qershor 1999 ishin forcat speciale Norvegjeze FSK Forsvarets Spesialkommando dhe forcat speciale ajrore Britanike S.A.S. 22 Special Air Service, pavarësisht se trupat ruse ishin të pranishme më parë në aeroportin e Prishtinës. Ushtarët norvegjezë të FSK Forsvarets Spesialkommando ishin të parat që ranë kontakt me trupat ruse në aeroport. Misioni i FSK ishte të implementonte paqen ndërmjet palëve shqiptare dhe serbe.

Kontributi i SHBA, i njohur si Initial Entry Force (Forca Fillestare Hyrëse), u drejtua nga Divizioni i I-rë i Blinduar, i komanduar nga Gjeneral Brigade Peterson, e udhëhequr nga një togë nga Batalioni i II-të dhe nga Regjimenti Parashutisht i 505-të i Këmbësorisë i bashkuar me Forcat Britanike. Të tjera njësi përfshinin Batalionet I dhe II nga Grupi i Forcave Speciale (parashutiste) nga Stuttgarti, Gjermani dhe Fort Carson, Colorado dhe shumë njësi të tjera të Ushtrisë Amerikane të vendosura në Europë dhe SHBA. Forcat fillestare të SHBA e vendosën zonën e veprimit përreth qyteteve të Ferizajt, më vonë Kampi Bondsteel, dhe Gjilan, në Kampin Monteith.

Një ushtar i SHBA shoqëron një civil serb pasi iu gjet një armë automatike, 26 korrik 1999.

Gjatë mësymjes fillestare, ushtarët e SHBA u përshëndetën nga shqiptarët me brohoritje dhe lule gjatë kohës që KFOR kalonte nëpër fshatra. Megjithëse nuk kishte aspak rezistencë, tre ushtarë amerikanë humbën jetën në aksidente.

Më 1 tetor 1999, përafërsisht 150 parashutistë të SHBA u parashutuan në Ferizaj si pjesë e Operation Rapid Guardian (Operacioni Gardiani i Shpejtë). Qëllimi i misionit ishte kryesisht për të paralajmëruar Presidentin e Jugosllavisë Sllobodan Millosheviç për aftësinë e shpejtë të veprimit dhe kapacitetet e NATOs në Kosovë. Një ushtar amerikan humbi jetën gjatë uljes pasi parashuta e tij nuk u hap.

Më 15 dhjetor 1999, një ushtar amerikan humbi jetën, pasi mjeti HMMWV ku ai ishte pasagjer ra në një minë.

Pas fushatës ushtarake, përfshirja e paqeruajtësve rusë rezultoi shumë e tendosur dhe sfiduese për KFOR. Rusët prisnin të kishin një sektor të pavarur të Kosovës, por u surprizuan kur misioni filloi nën komandën e NATOs. Pa komunikuar paraprakisht ose koordinim me NATOn, paqeruajtësit rusë hynë në Kosovë nga Bosnja dhe Hercegovina dhe pushtuan Aeroportin e Prishtinës para ardhjes së forcave të NATOs. Gjë e cila rezultoi në Incidentin në Aeroportin e Prishtinës ku dëshira e Komandantit Suprem të NATOs Wesley Clark ishte të bllokonte pistën e aeroportit me mjete të NATOs, për të parandaluar përforcimet ruse, por u refuzua nga komandanti i KFOR Gjenerali Mike Jackson.

Më 2010, James Blunt përshkroi në një intervistë se si njësisë së tij i ishte dhënë detyra për sigurimin e Prishtinës gjatë avancimit të forcës paqeruajtëse prej 30,000 trupash dhe se si ushtria ruse ishte futur dhe kishte marrë kontrollin e aeroportit të Prishtinës para se njësia e tij të arrinte. Blunt ndau një pjesë të detyrës e cila mund të rezultonte një incident i dhunshëm ndërkombëtar. Sipas njohurive të Blunt kishte një përballje pa armë me rusët, dhe Komandanti Suprem i NATOs, Wesley Clark, dha urdhra paraprake për ti mposhtur rusët. Ndërkohë që kishte një tërheqje nga Blunt, urdhri u tërhoq nga Gjenerali Jackson, me shprehjen tashmë të famshme, "Nuk do ti bëj ushtarët e mi përgjegjës për nisjen e Luftës së Tretë Botërore."

***

Për shkak të ligjeve censuruese të medias, media jugosllave nuk mbulonte ngjarje që ndodhnin në Kosovë, po ashtu edhe sjellja e vendeve ndaj katastrofës humanitare që po ndodhte atje. Kështu që, shumë pak nga publiku jugosllav prisnin ndërhyrjen e NATO, por mendohej gjërësisht se do të arrihej një marrëveshje diplomatike.

***

Mbështetja për Luftën e Kosovës dhe, në veçanti, ligjshmëria për fushatën bombarduese të NATOs vinte nga burime të ndryshme. Në një artikull në 2009, David Clark shkruante se "Çdo anëtar i NATO, çdo vend i BE, dhe shumica e fqinjëve të Jugosllavisë, mbështesnin veprimet ushtarake" me deklarata nga liderët Bill Clinton, Václav

Havel dhe Tony Blair respektivisht e përshkruanin luftën si, "një sulm me tanke dhe artileri mbi një popullsi të pambrojtur liderët e të cilëve kishin pranuar paqen," "lufta e parë për vlera"dhe "për të shmangur atë që mund të bëhej një katastrofë humanitare në Kosovë.".
Të tjerë si sekretari i përgjithshëm i OKB Kofi Annan i cili i quante veprimet e NATO si të drejtai cili theksoi se në disa raste përdorimi i forcës është i nevojshëm për të sjellë paqen megjithëse Annan tha se "Këshilli duhej të përfshihej në vendimet për përdorimin e forcës."Në një raport të Komisionit Ndërkombëtar të pavarur në Kosovë, me titull The Kosovo Report,i cili zbuloi se: "forcat jugosllave nisën një fushatë terrori të planifikuar mirë dhe dëbimin e shqiptarëve të Kosovës. Kjo fushatë përshkruhet shpesh si "pastrim etnik", me qëllimin për të larguar shumë, në mos të gjithë, shqiptarët nga Kosova, për të shkatërruar shoqërinë e tyre, dhe për të parandaluar rikthimin e tyre.“

Ku përfundoi se "ndërhyrja e NATOs ishte ilegale por e nevojshme". Një tjetër raport u publikua nga Zyra e Informacionit dhe e Shtypit të NATOs i cili raportoi se, "shkeljet e të drejtave të njeriut në shkallë të gjerë në Kosovë japin një terren të pakundërshtueshëm reference për aspektin humanitar të ndërhyrjes së NATO." Disa kritikë shtojnë se NATO nuk kishte mbështetjen e Këshillit të Sigurimit të OKB që do të thotë se nuk kishte bazë ligjore, por sipas disa shkollarëve të njohur, "nuk kishte asnjë bazë të sigurtë ligjore për atë veprim, i cili u justifikua."

Përveç politikanëve dhe diplomatëve, komentuesit dhe intelektualët po ashtu mbështesnin luftën.

Michael Ignatieff e quajti ndërhyrjen e NATO-s një "përgjigjje moralisht e justifikueshme ndaj spastrimit etnik dhe vërshimit të refugjatëve, dhe jo si shkak për vërshimin e emigrantëve" ndërkohë që Christopher Hitchens tha se NATO ndërhyri vetëm, "kur forcat serbe filluan të dëbimet masive dhe një spastrim etnik me shkallë të gjerë." Duke shkruar tek The Nation, Richard A. Falk shkroi se, "fushata e NATO arriti heqjen e forcave ushtarake jugosllave nga Kosova dhe më e rëndësishmja largimin e njësive paraushtarake dhe policore serbe"

***

Disa kritikuan ndërhyrjen e NATO si shmangie taktike politike, pasi erdhi direkt pas skandalit të Monica Lewinsky, duke nënvizuar se media amerikane zëvendësoi vëmendjen tek lufta. Gjithashtu, disa theksojnë se para bombardimit, në vend që të ishte një konflikt i përgjakshëm, UÇK nuk përfshi në luftën civile ndaj forcave jugosllave dhe se shifrat e të vrarëve (përfshirë edhe shqiptarët) u rritën pas ndërhyrjes së NATO.

Gjithësesi, mungesa e luftës nuk do të thoshte se kishte paqe mes serbëve dhe shqiptarëve, siç kanë theksuar burime të tjera, duke cituar vdekjen e 1500 shqiptarëve dhe dëbimin e 270000 të tjerëve para ndërhyrjes së NATO dhe represionin dramatik të popullsisë shqiptare pavarësisht ndryshimeve

kushtetuese të regjimit të Millosheviçit që imponontе një "aparteid" në Kosovë.

Presidenti i SHBA Clinton dhe administrata e tij u akuzuan se kishin rritur numrin e të vrarëve shqiptarë nga forcat shtetërore serbe. Pas bombardimit të ambasadës kineze në Beograd, Kryeministri kinez Jiang Zemin tha se SHBA po përdorte superioritetin ekonomik dhe ushtarak për të rritur progresivisht influencën në vende të tjera. Liderët kinezë e quajtën fushatën e NATO një precedent i agresionit lakuriq, një formë e re e kolonializmit, një luftë agresive e pabazë në moral dhe ligj. U pa si një komplot i SHBA për të shkatërruar Jugosllavinë, të zgjerohej në lindje dhe të kontrollojë të gjithë Europën.

Karta e Kombeve të Bashkuara nuk lejon ndërhyrjet ushtarake në vende të tjera sovrane me disa përjashtime të cilat, në përgjithësi, duhej të vendoseshin nga Këshilli i Sigurimit të OK; kjo çështje ligjore provoi të ishte kontroverse ndërmjet shumë shkollarëve ligjorë të cilët debatojnë se megjithëse Lufta e Kosovës ishte ilegale, ishte sërisht e drejtë. Çështja u soll në Këshillin e Sigurimit të OKB nga Rusia, në një projekt-rezolutë e cila, inter alia, do të konfirmote "se përdorimi i forcës nga vetëm një palë konstituon në një shkelje flagrante të Kartës së Kombeve të Bashkuara". Kina, Namibia, dhe Rusia votuan për rezolutën, anëtarët e tjerë dolën kundër, kështu që dështoi.

Lufta la shumë të vrarë. Që prej marsit 1999, luftimet dhe shënjestrimi i ndërtesave civile la rreth 1500–2000 civilë dhe luftëtarë të vrarë. Numri përfundimtar i të vrarëve nuk është isigurtë për çdo palë.

***

Në qershor të vitit 2000, Kryqi i Kuq raportoi për 3,368 civilë (2500 shqiptarë, 400 serbë, dhe 100 romë) ende të humbur, afërsisht një vit pas konfliktit.
Një studim i kërkuesve të Center for Disease Control and Prevention (Qëndra e Kontrollit dhe Parandalimit të Sëmundjeve) në Atlanta, Gjeorgjia publikoi në vitin 2000 në një gazetë mjekësore the Lancet se ka pasur rreth "12000 të vdekur në të gjithë popullsinë" të cilat kanë si shkak luftën.

Ky numër u arrit gjatë vëzhgimit të 1,197 shtëpive nga shkurti 1998 deri në qershor 1999. 67 nga 105 vdekje të raportuara në popullsinë e përgjithshme kishin si shkak trauma të shkaktuara nga lufta, nga kjo del shifra e 12,000 të vdekurve nëse zbatohet kjo shkallë vdekshmërie në të gjithë popullsinë e Kosovës. Shkalla më e lartë e vdekshmërisë ishte te meshkujt nga 15 deri 49 vjeç (5421 viktima të luftës) si edhe për meshkujt mbi 50 vjeç (5176 viktima). Për personat nën 15, përafërsisht 160 viktima për meshkujt dhe 200 për femrat. Për femrat nga 15–49 vjeç rreth 510 viktima; më të mëdhaja se 50 vjeç rreth 541 viktima. Autorët gjithashtu shkruan se nuk mund të ndahen humbjt civile nga ato ushtarake pasi u kryen shumë vrasje ndaj njerëzve të paarmatosur.

Në një studim të vitit 2008 nga Humanitarian Law Center (Qëndra Ligjore Humanitare), Komisionit Ndërkombëtar të Njerëzve të Humbur, dhe Komisionit të Njerëzve të Humbur të Serbisë bënë një listë emër për emër për viktimat gjatë dhe pas luftës. Sipas Librit të Kujtimit të Kosovës, 13,421 njerëz u vranë në Kosovë

gjatë konfliktit, nga 1 janari 1998 deri në dhjetor 2000. Nga ajo shifër, 10533 ishin shqiptarë, 2238 serbë, 126 romë, 100 boshnjakë dhe të tjerë.

***

Jugosllavia raportoi se sulmet e NATOs shkaktuan nga 1,200 deri në 5,700 të vrarë. Sekretari i Përgjithshëm i NATOs Lord Robertson, shkroi se pas luftës "numri i saktë i të vrarëve nuk do të njihet kurrë me saktësi" por gjithashtu ai i dha disa shifra të dhëna nga një raport i Human Rights Watch si përafrimi më i saktë. Ky raport numëronte nga 488 deri në 527 civilë të vrarë (90 deri në 150 prej tyre u vranë nga përdorimi i bombave thërrmuese) në 90 incidente të ndryshme, më i keqi nga të cilat ishte rasti i 87 shqiptarëve refugjatë në afërsi të Korishës.

Sulmet në Kosovë ishin në përgjithësi më shumë vdekjeprurëse për shkak të situatës ngatërruese me lëvizjet e shumta të refugjatëve, vetëm një e treta e incidenteve numëronin më shumë se gjysmën e viktimave.

***

Oficerë të Policisë kanadeze duke hetuar për një varr masiv, në praninë e Marinsave të SHBA. Numra të ndryshëm janë dhënë për vrasjet e shkaktuara nga forcat jugosllave përgjatë viteve. Rreth 800000 shqiptarë të Kosovës u dëbuan dhe rreth 7000 deri në 9000 u vranë. Sipas The New York Times, e cila citoi abuzimet e të drejtave të njeriut si shkaku kryesor i sulmimit të

Jugosllavisë, Departamenti Amerikan i Shtetit numëron rreth 10000 të vrarë.

Ekspertët statistikorë që punonin për Gjykatën Ndërkombëtare Kriminale për ish Jugosllavinë (ICTY) raportojnë për një numër total të vrarësh prej rreth 10000 njerëzish.

Eric Fruits, profesor i Universitetit Shtetëror të Portland, debatoi se analizat e ekspertëve janë bazuar në të dhëna me gabime dhe se asnjë prej përfundimeve të tyre nuk mbështetet nga ndonjë analizë statistike.

Në 2001, 800 trupa ende të paidentifikuar u gjetën në gropa në një terren stërvitor të policisë jashtë Beogradit dhe në lindje të Serbisë.

Të paktën 700 trupa u zbuluan në një varr masiv i gjendur në një kompleks të një njësie policore speciale anti-terroriste në periferi të Batajnicës.

77 trupa u gjetën në qytetin lindor të Serbisë Petrovo Selo.

50 trupa u gjetën në qytetin perëndimor të Serbisë Peručac.

***

Pajimet e një piloti të avionit të rrëzuar F-16C dhe pjesë të avionit F-117A të rrëzuar në Serbi në 1999 të ekspozuar në muzeun e Beogradit.

Humbjet ushtarake të NATOs ishin të ulëta. Sipas raporteve zyrtare, aleanca nuk pësoi asjnë të vdekur si shkak i luftimeve direkte. Gjithësesi, në orët e para të mëngjesit të 5 majit, një helikopter ushtarak amerikan AH-64 Apache u rrëzua afër kufirit mes Shqipërisë dhe Serbisë.

Një tjetër helikopter amerikan AH-64 Apache u rrëzua 64 km larg Tiranës, shumë afër kufirit Shqipëri - Kosovë. Të dy pilotët amerikanë të helikopterit ndërruan jetë në atë incident. Ata ishin të vdekurit e vetëm të NATO-s gjatë luftës, sipas deklaratave zyrtare të NATO-s.

Pati disa të vdekur pas luftës, kryesisht për shkak të minave të tokës. Gjatë luftës, aleanca raportoi humbjen e patë të një avioni stealth (i padukshëm nga radari) i USAF (një F-117 Nighthawk), i vetmi rast ku një avion i tillë është rrëzuar në luftime. Më tej një avion luftarak F-16 u rrëzua afër qyteti të Šabact dhe 32 UAV (mjeta ajërore pa pilot) nga vende të ndryshme u rrëzuan. Mbetjet e UAV-ve të rrëzuara jepeshin në televizionet e Serbisë gjatë luftës. Disa burime amerikane tregojnë për një tjetër F-117A të dëmtuar rëndë, dhe megjithëse u kthye vetë në bazë, ai avion nuk fluturoi më. Avionë A-10 Thunderbolt u raportuan si humbje, me dy të rrëzuar dhe dy të tjerë të dëmtuar. Tre ushtarë amerikan në një Humvee në një patrullë rutinë u kapën nga Forcat Speciale Jugosllave në kufirin me Maqedoninë.

***

Mbetjet e një avioni luftarak jugosllav MiG-29 të rrëzuar në 27 mars 1999, jashtë qyteti të Ugljevik, Bosnje dhe Hercegovinë.

NATO nuk lëshoi asnjë deklaratë mbi humbjet në njerëz nga ana e serbëve. Sipas autoriteteve jugosllave, 462 ushtarë u vranë dhe 299 u plagosën nga sulmet ajërore të NATO. Emrat e të vrarëve jugollavë u shënuan në një "libër kujtimi".

Përsa i përket pajisjeve ushtarake, NATO shkatërroi rreth 50 avionë jugosllavë duke përfshirë 6 MiG-29 të shkatërruara në luftime ajër-ajër. Disa G-4 Super Galeb u shkatërruan që në strehën e tyre nën bunker pas një zjarri të shkaktuar nga një bombë anti-bunker. Në fund të luftës, NATO zyrtarisht raportoi se ka shkatërruar 93 tanke jugosllave. Jugosllavia pranonte vetëm 3 tanke të shkatërruar. Shifrat më vonë u verifikuan nga inspektorët Europianë kur Jugosllavia iu bashkua marrëveshjes së Dejtonit, duke llogaritur numrin e tankeve atëherë dhe gjatë inspektimit në 1995. NATO raportoi se Ushtria Jugosllave humbi 93 tanke (M-84 dhe T-55), 132 APC (transportues personeli të blinduar ose Autoblinda), dhe 52 copë artilerie. Shumë burime i kundërshtonin këto shifra duke thënë se një pjesë e tankeve ishin karrema prej kartoni ose tanke të luftës së dytë botërore të përdorur si shënjestra. Vetëm mbrojtja kundër-ajërore nuk u prek për të mos u rrezikuar pasi avionët e NATO-s shpesh sulmonin në lartësi të sigurta prej 5000 m.

Gjithësesi, humbjet më të rënda për Ushtrinë Jugosllave ishte infrastruktura e dëmtuar dhe e shkatërruar. Pothuaj të gjitha bazat ajërore ushtarake dhe pistat ajërore (Batajnicë, Ladevci, Aeroporti Sllatina, Golubovci dhe Aeroporti i Gjakovës) dhe shumë ndërtesa ushtarake dhe komplekse të shkatërruara dhe të dëmtuara rëndë. Përveç këtyre edhe industria e mbrojtjes u dëmtua rëndë (Utva, fabrika Zastava Arms, qëndra riparuese e forcave ajërore Moma Stanojlović, qëndrat riparuese në Čačak dhe Kragujevac). Moreover, në përpjekje për të dobësuar Ushtrinë Jugosllave, NATO

shënjestroi edhe disa komplekse të rëndësishme civile (rafineria e naftës në Pančevo, rafineria e naftës në Novi Sad, ura, hekurudha, etj.)

***

Qeveria e Serbisë ka bërë shumë pak për tu përballur me serbët të akuzuar për krime lufte; bashkëpunimi me Gjykatën Ndërkombëtare Kriminale për ish Jugosllavinë ende "quhet si detyrim stresues, çmim i nevojshëm për tu futur në Bashkimin Europian".Presidenti Jugosllav Sllobodan Milloshevіç, bashkë me Milan Milutinović, Nikola Šainović, Dragoljub Ojdanić dhe Vlajko Stojiljković u akuzuan nga ICTY për krime kundër njerëzimit dhe duke përfshirë vrasje, zhvendosje me forcë, deportim, dhe "persekutim për shkaqe politike, rraciale dhe fetare". Në 2001,

Problemin e çështjes kombëtare ai e vështron në prizmin filozofik, në prizmin historik dhe në prizmin politik. Nuk thotë vetëm se si është Shqipëria, si është kjo çështja jonë kombëtare, por edhe se si mund të zgjidhet. Dhe kjo është nga meritat më të mëdha, sepse në shumë shkrime për problemet tona kombëtare tregohet vetëm se si ka qenë, sa i vjetër është populli ynë, me kë ka patur të bëjë, me përplasjet me fqinjët, me Evropën etj., por nuk jepen koordinata të sakta se ç'mund të bëhet që populli ynë të bëhet një popull i bashkuar, një komb jo i ndarë, jo i prerë me shpatë siç është sot Shqipëria. Dhe këtu qëndron merita më e madhe e Ukshin Hotit, pra në faktin që jep perspektivën se si duhet bërë... me një fjalë, ky libër është një program, nuk është thjesht një libër për filozofinë politike, por është si një program për shqiptarët, se si duhet të bëhet Shqipëria një vend me të vërtetë i europianizuar.

Ne flasim e themi se do të hyjmë në Evropë, do të eropianizojmë Shqipërinë, etj. Të gjitha këto janë fantazira, janë gjysmake. Shqipëria europianizohet kur të

jetë një, e plotë, dhe jo kështu dy copësh, se kështu nuk europianizohet kurrë. Kë do të europianizosh ti, tre milionë banorë do të europianizosh? Po tre milionë të tjerë? Dmth. problemi është tepër i ngatërruar për sa i përket europianizimit të Shqipërisë, civilizimit të saj etj. Civilizim do të thotë kur të jesh një. Po s'qe një nuk je i civilizuar plotësisht. Dhe Ukshini e trajton këtë problem.
Pastaj dhe një tjetër gjë: unë mendoj që njeriu mund të nxjerr konkluzione jo vetëm nga libri që kemi këtu përpara, po dhe nga gjithë aktiviteti i Ukshin Hotit, se ai nuk është vetëm një filozof, politikan i kabineteve, i zyrave e i arkivave, por ai është një njeri i aksionit, një njeri i luftës për një ideal të madh. Se ka lloj lloj filozofësh, politikanësh, historianësh, edhe ata kanë të drejtën e ekzistencës dhe nuk mund të them se nuk janë të shquar, por tek Ukshin Hoti bashkohen dituria, zgjuarsia filozofike me aksionin, me njeriun aktiv, me patriotin e vërtetë, jo thjesht një patriot librash, po një patriot i madh, që i vë supet Shqipërisë. Dhe fakti që gjëndet në burg, dhe ka kohë që vuan burgimin e nuk del dot nga burgu, tregon se sa patriot dhe se sa njeri i lavdishëm është ai. Po ne shqiptarët fatkeqësisht njerëzit e shquar i kemi pak mëri, nuk i kemi aq shumë në përkrahje, ndonjëherë duam dhe t'i spostojmë nga politika ose nga aktiviteti, siç është puna me Ukshin Hotin. Unë nuk munt të flas me kompetencë të madhe lidhur me mënjanimin e tij, por unë vë re një gjë, që për daljen e tij nga burgu nuk është bërë shumë në Shqipëri, as në Shqipërinë këtej Drinit, ku jemi ne, dhe as në Shqipërinë përtej Drinit, ku janë vëllezërit tanë.

Ukshin Hoti është një hero i gjallë i kombit shqiptar
Akademik Bedri Dedja

Shkrimtari i shquar Bedri Dedja, në një intervistë dhënë gazetës "Zëri i Kosovës" në dhjetor 1997 për të madhin Ukshin Hoti thotë: "Për mua, Ukshin Hoti është një hero i gjallë i kombit shqiptar. Unë madje nuk habitem pse serbët mbajnë në burg Ukshin Hotin dhe jo ndonjë personalitet tjetër madhor të Kosovës. Vepra e tij "Filozofia politike e çështjes shqiptare" të kujton veprat e mëdha, si "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet" e Sami Frashërit, "Çështja shqiptare" e Rexhep Qoses etj.

Vepra të tilla shekulli shqiptar prodhon pak. Unë jam shumë i brengosur që atë po e torturojnë shpirtërisht edhe si prind. Këto tortura kanë synim më të largët. Ato duan të errësojnë horizontin e tij kombëtar dhe politik. Por kam shumë besim se nuk do t'ia arrijnë. Ukshin Hoti do të dalë nga burgu si feniksi.

Hoti është një avokat i përkushtuar i demokracisë
Adem Demaçi

Në vitin 1998, me rastin e nominimit të Mr.Ukshin Hotit për çmimin "Saharov", Adem Demaçi fitues i Çmimit Saharov për vitin 1991, i shkruan këtë letër deputetëve të parlamentit evropian:

"Të nderuar anëtarë të Parlamentit Evropian, të dashura zonja dhe zotërinj,

Me rastin e nominimit të Mr. Ukshin Hotit për çmimin Saharov, jam i lirë t'ju drejtohem me mbështetjen

time për nominimin e tij. Unë jam i bindur se jo vetëm që çmimi do të shkojë në duart e duhura, por duke i dhënë çmimin Saharov një të burgosuri politik që vazhdon të vuajë dënimin e tij, ju do të lartësoni kuptimin e vetë çmimit nga pozita e mirënjohjes së thjeshtë në angazhimin politik.

Një angazhim i tillë sot është më se i nevojshëm për ndërtimin e një tablloje të plotë për Evropën, për theksimin e kontrasteve të mëdha ekzistuese, për shpjegimin e tyre dhe për dhënien e një vizioni të qartë mbi atë se çfarë do të duhej të ishte Evropa.

Në anën tjetër, z. Hoti është një avokat i përkushtuar i demokracisë, i të drejtave të njeriut dhe i paqes. Ai shfrytëzon arsyen dhe njohjen e tij brilante për të shpjeguar kuptimin e vërtetë të paqes dhe zbulimin e rrënjëve të saj në drejtësi. Gjithë jetën e tij ai e ka vënë në shërbim të luftës për paqen për të cilën Kosova sot ka nevojë më shumë se kurrë. Çmimi Saharov e meriton Ukshin Hotin, dhe Ukshin Hoti e meriton atë. Me konsideratat e mia më të thella.

Ukshin Hoti - simbol i martirizimit për lirinë e Kosovës

Akademik Rexhep Qosja

Akademik Rexhep Qosja në një intervistë të vitit 1998 për Mr. Ukshin Hotin deklaron: “Ukshin Hoti po bëhet ajo që ishte dhe është Adem Demaçi sot: simbol i martirizimit për lirinë e Kosovës, e kjo domethënë, simbol i qëndresës shqiptare. Kur është burgosur Ukshin Hoti, para disa vjetësh, gazetat tona e kanë botuar lajmin me

disa ditë vonesë. Mbasi që është burgosur Ukshin Hoti, edhe pse kuadër universitar, Universiteti ynë nuk e ka ngritur zërin kundër mbajtjes së tij në burg. Sot kanë ndryshuar punët. Sot Ukshin Hoti përmendet shpesh në shtypin tonë. Në Rektoratin e Universitetit të Prishtinës është mbajtur promovimi i librit të tij. Për të shkruhet gjithnjë e më shpesh. Diçka ka ndryshuar në shtypin tonë dhe në Universitetin tonë. Diçka po ndryshon në jetën tonë, në politikën tonë. Kemi filluar të vijmë në vete dhe këtë e dëshmon edhe qëndrimi ndaj Ukshin Hotit. Ne po jetojmë "të lirë" nën pushtimin e Serbisë e Ukshin Hoti po vuan burg! Ne po bëjmë "të lirë" politikë, nën pushtimin e Serbisë e Ukshin Hoti po vuan burg! Ne po stolisemi me stoli pushtetore -"president", "deputet', kryetar partie, e të tjera, nën pushtimin serb, e Ukshin Hoti po bën burg Serbie! Ne për lirinë e Kosovës po "luftojmë", duke marrë rroga, duke u vozitur me vetura luksoze, duke pritur e përcjellë mysafirë me dreka e darka zyrtare - si parardhësit tanë politikë komunistë, e Ukshin Hoti po dënohet me burgje, për shkak të përpjekjeve për lirinë e Kosovës! Me mbajtjen në burg të Ukshin Hotit dhe të te burgosurve të tjerë politikë, regjimi serb dëshiron ta arrijë sot, atë që synonte ta arrinte me mbajtjen në burg të Adem Demaçit dhe të të burgosurve tjerë politikë!

Mbajtja e Ukshin Hotit dhe e bashkëmendimtarëve të tjerë në burgjet e Serbisë e rëndon shumë ndërgjegjen e njeriut tonë politik sot, dhe i qet hije të rëndë politikës që bëjnë bashkimet tona politike. Deshëm s'deshëm ta pranojmë, Ukshin Hoti - ky sot është simbol i vetëdijes historike, i ndërgjegjes dhe i

qëndresës së pamposhtur shqiptare. Nuk është e çuditshme pse ky është emri më i kuptimshëm, më domethënës, më frymëzues në jetën tonë politike sot. Dhe kjo tregon se populli ynë e çmon ashtu siç duhet njeriun e gatshëm për sakrifica. Dua të besoj se Ukshin Hoti do të dijë ta mbajë si duhet domethënien gjithëkombëtare që e rrezaton sot emri i tij.

Moikom Zeqo

Studiuesi i shquar Moikom Zeqo, në parathënien e librit"Filozofia politike e çështjes shqiptare" të Ukshin Hotit shkruan si vijon: “Kam ndjerë një tronditje të madhe, të pazakontë, tërësisht njerëzore, kur më sollën dorëshkrimin e kompjuterizuar të librit "Filozofia politike e çështjes shqiptare" të Ukshin Hotit. Kam ndjerë krenari të vërtetë duke e lexuar këtë libër.

Libri i mençur dhe kurajoz i Ukshin Hotit është libri i një tribuni popullor dhe kombëtar. Ukshin Hoti, intelektual dhe politolog i klasit të parë, njeri i kompletuar fuqishëm për nga dijet, për më tepër një trim i pafrikshëm, ka shpalosur në këtë libër kryetemën vigane të çështjes shqiptare. Hoti nuk qëndis ornamente fjalësh. Nuk bën stolira të kota retorikash luksoze e krejt të padobishme. Për Hotin çështja shqiptare nuk është një mit i rrugës. Po as edhe një fantazi e kabinetit intelektual.
Duke e lexuar këtë libër m'u kujtuan fjalët e mrekullueshme të dijetarit të madh shqiptar Frang Bardhit, i cili qysh me 1636 shkruante: "Përkrahni lirinë e natyrshme të njerëzve dhe diturinë e tyre me liberalitetin më të madh. Sepse vetëm kështu, -shton ai, -do ta paraqesin para syve të tu të vërtetën lakuriqe dhe të

panjollosur, sepse e vërteta nuk ka nevojë të lyhet dhe të stoliset me fjalë të bukura."

350 vjet pas Frang Bardhit, Ukshin Hoti ecën në të njëjtën hulli të filozofisë politike të historisë. Ukshin Hoti e konsideron politikën si një modus operandi të pashkëputur nga moraliteti historik dhe i perspektivës. Sipas Aristotelit, vërtetë njeriu është "kafshë politike" po në ato kushte dhe rrethana që e realizojnë historinë, jo si një zoologji instinktive, po si një politikë mbikafshore dhe tërësisht njerëzore, pra të kthimit të kafshës në njeri dhe jo të njeriut në kafshë, rrjedhimisht, të politikës në histori dhe jo të historisë në thjesht politikë.

Ukshin Hoti e di mirë thelbin e politikës, duke e refuzuar politikanizmin e stilit barok, dogmatik, apo të llojit folklorik e të vulgarizuar. Ukshin Hoti në analizat e tij të guximshme dhe aspak konformiste i shikon realitetet politike në optikën shqiptare, por edhe në atë globale-botërore. Për të bota evro-amerikane nuk duhet t'i kundërvihet çështjes shqiptare, pavarësisht nga pengu tragjik i së kaluarës, pavarësisht nga luhatjet dhe marrëzitë e sotme të politikave të liderëve të përkohshëm shqiptarë.

Ukshin Hoti e shtjellon tezën e një demokracie autentike, si tezën e një integrimi universal, ku nuk zhduket dhe nuk humbet identiteti i kombit shqiptar, po afirmohet në bazë të një të drejte ndërkombëtare të përbashkët për të gjitha subjektet etnike të botës, ashtu siç ka një barazi funksionale për elementet e gjuhës të garantuara përjetësisht nga një gramatikë e brendshme e padeformueshme. Demokracia autentike është një gramatikë e lirisë dhe e dinjitetit, e kulturës, por edhe e

kulturave, e së veçantës, por edhe e së tërës. Në një Evropë, apo në një botë dialogjike, kombi shqiptar nuk ka pse të jetë shurdhmemec, një komb handikapat, ose një manekin i skenës.

Kombi shqiptar është i pjesëtuar padrejtësisht në struktura shtetërore të huaja dhe të ndryshme, duke qenë de facto një subjekt etnik i papjesëtueshëm dot. Ky komb po e përjeton në imagjinatë atë që kombet tjera e kanë realizuar prej kohësh. Po duke qenë një komb si të gjitha kombet tjera, shqiptarët nuk kanë pse të përjetojnë gjithçka vetëm në imagjinatë.

Prandaj ky libër me plot argumente është kundër kompleksit të inferioritetit. Prandaj ky libër është një pasqyrë morali për secilin nga ne, një monument sigurie dhe vetëdieje.

Ukshin Hotin kam pasur rastin ta njoh më 23 nëntor të vitit 1992 në Tetovë gjatë një tubimi mbarëkombëtar për çështjen shqiptare. Ai ishte me trupin plot plagë nga të rrahurat e policisë serbe. Po erdhi në tubim, sepse në të shihte një shprehje të ideve të tij politike dhe të jetës.

Sot Ukshin Hoti është i burgosur. Por që nga burgu, ai na i dërgon akoma më i plotfuqishëm dhe madhështor mesazhet e tij të urta dhe afatgjata. Ai është një intelektual i martirizuar dhe kjo ka një kuptim të vërtetë dhe të madh. Është vetë kombi shqiptar një komb i martirizuar…

Ukshin Hoti është shndërruar tashmë në histori.
Ukshin Hoti ka lindur më 1943 në Krushë të Madhe të Rahovecit. Shkollën fillore dhe atë të mesme i kreu në Prizren dhe Prishtinë. Shkencat politike i kreu në Zagreb,

kurse 2 vite pasuniversitare i kreu në Beograd në seksionin për marrëdhënie ndërkombëtare politike dhe ekonomike. Pastaj specializoi një vit edhe në Universitetet amerikane: në Chicago, në Universitetin e Harvardit në Boston si dhe në Washington D.C..

Në vitet e ’70-ta ushtroi detyra të ndryshme në pozita të ndryshme të jetës politike dhe arsimore të Kosovës.

Pas një diskutimi në një mbledhje në Fakultetin Filozofik në Prishtinë më 19 Nëntor 1981, ku ai haptas i mbrojti kërkesat e studentëve shqiptar për Republikë të Kosovës në kuadër të Jugosllavisë, ai u dënua me 9 vjet burg, të cilat nga gjyqi suprem u reduktuan në 3,5 vjet. Pas lirimit nga burgu u kthye në vendlindje ku u izolua.

Më 1990 punoi në Lubjanë (Slloveni) në revistat shqiptare “Alternativa”, "Republika" dhe "Demokracia Autentike - DEA" si redaktor deri më 1991, kur u mbyllën ato. Pastaj u kthye në Prishtinë ku punoi për një kohë në Universitetin e Prishtinës.

Në mars të 1993 u burgos për herë të dytë pasi që një vit më parë kishte organizuar homazh për martirët e demokracisë në Brestovc. Në të njëjtin vit u rrah keq nga forcat speciale serbe pasi që kishte vizituar pjesëmarrësit e grevës së urisë në pallatin e shtypit në Prishtinë.

Po ashtu më 1993 pasi e lëshoi Lidhjen demokratike (LDK) Hoti mori pjesë në tubimin mbarëkombëtar të organizuar nga përfaqësuesit politik në Tetovë (Maqedoni) ku u theksua nevoja e bashkimit kombëtar të shqiptarëve në një shtet të vetëm.

Më 17 maj 1994 e dënuan me 5 vjet burg për arsyen se ishte pjesëmarrës i lëvizjes për Republikën e Kosovës.

Më 16 maj 1999 kishte mbaruar afati i vuajtjes së dënimit politik prej 5 vjetësh. Të burgosurit shqiptarë dëshmojnë se në përcjellje të tre zyrtarëve të sigurimit serb atë ditë ai është nxjerrë nga burgu i Dubravës (Istog, Kosovë), ku ishin sjellë më parë të burgosurit shqiptarë nga burgu i Nishit (Serbi).

Pas bombardimeve të NATO-së më 19 maj 1999, në burgun e Dubravës ka ndodhur masakra më e përgjakshme: janë ekzekutuar e masakruar 173 të burgosur shqiptarë nga forcat serbe.

Babanë e vëllanë e Ukshin Hotit i kanë vrarë kriminelët serbë, bashkë me 30 kushërinj të tij e 174 bashkëfshatarë të Krushës së Madhe të Rahovecit.

Mbi fatin e prof. Ukshin Hotit (prej 1999) nuk dihet më asgjë!

2.23.2014

MIDIS ORAKUJVE DHE PROFECIVE SERIOZE

(Çdo sulm ndaj Kosovës do të thotë luftë e III-të botërore)

Kur kjo gjë u zbulua, në profecitë e fundit të gjetura, sipas Dr. Michael Rathford del e qartë koha se kur zhvillohet Lufta e Tretë Botërore. Aty del qartë dhe emri i Osama Bin Ladenit, sulmi tjetër terrorrist ndaj SHBA-së që do rezultojë me një invazion amerikan të Iranit, konfrontimi midis SHBA dhe Kinës e Rusisë si dhe detaje dhe koha e saktë e zhvillimit të luftës së tretë. Sipas deshifrimit del që kjo Luftë do zhvillohet nga viti 2006 deri në vitin 2012 (çuditërisht viti 2012 përkon dhe me fundin e kalendarit të Majave - Darius).

Fatkeqësisht libri është konsideruar si shumë kontrovers dhe deri tani nuk ka dalë nëpër librari por qarkullon në internet në pdf format për 14 dollarë

amerikanë dhe 24 dollarë plus postimin në versionin e librit të printuar. Pasi që Koreja e Veriut hodhi disa granata në ishullin Yeonpyeng të Koresë së Jugut, shumë njerëz besojnë në parashikimin e Vangas, bullgares e cila kishte parashikuar shpërthimin e luftës botërore në nëntor të vitit 2010.

Vangelia Pandeva Dimitrova, e njohur si Vanga u bë e famshme në Bullgari, por edhe në mbarë botën me parashikimet e saj të sakta. Vanga e verbër vdiq më 1996, megjithatë emri i saj edhe sot përmendet shpesh, ndërsa shumica e krahasojnë atë me Nostradamusin e famshëm.
Që më 1980, Vanga kishte parashikuar se në gusht të vitit 1999 ose në fillim të vitit 2000 Kursk do të mbulohej nga uji dhe e tërë bota do të qante më pas.

Natyrisht, parashikimi i saj atëbotë nuk kishte kuptim. Shumë besuan se ajo po fliste për qytetin Kursk dhe se qyteti nuk mund dhe nuk do të mbytej nga uji. Por parashikimi i saj u përmbush, nëndetësja nukleare ruse e quajtur Kursk u fundos.

Vangelia parashikoi edhe sulmin në Qendrën Botërore Tregtare më 11 shtator 2001, duke thënë se binjakët amerikanë do të bien pas sulmit të zogjve prej çeliku.

Po ashtu Vanga, parashikoi edhe Luftën e Dytë Botërore dhe vdekjen e Princeshës Diana. Flitet se atë e kishte vizituar edhe vetë Hitleri, të cilit ajo ia kishte parashikuar fundin, ndërsa me saktësi të plotë kishte parashikuar edhe vdekjen e saj më 11 gusht 1996.

Por ajo që frikësoi më shumë opinionin ditët e fundit është parashikimi i saj se lufta e tretë botërore do të fillojë në nëntor 2010. Fallxhesha e verbër tha se

kataklizmi i tretë do të fillojë si një luftë e zakonshme, por më pas do të përdoren armët kimike dhe nukleare. Lufta e tretë botërore, sipas parashikimeve të saj do të zgjasë deri më 2014.

Vanga ka paraparë se prej vitit 2014 njerëzit do të vuajnë nga sëmundje të shumta të lëkurës, mu për shkak të luftës kimike. Ajo po ashtu paralajmëroi se më 2016 në Evropë më nuk do të ketë njerëz fare, ndërsa deri më 2018 Kina do të bëhet superfuqi e re.

"Në maj të vitit 2004 disa anëtarë të Bibliotekës Nacionale në Romë bënë një zbulim fantastik. Në mes të arkivave të bibliotekës ata zbuluan një dorëshkrim nga Nostradamus të panjohur më parë. Këtë dorëshkrim ai ia kishte dhënë të birit i cili pas vdekjes së profetit ia dhuroi Papës Urban VIII. Dhe që nga ajo kohë kishte mbetur i fshehur për të dalë përsëri në sipërfaqe mbas 400 vjetësh. Një shkencëtar i njohur për aftësitë e tij në deshifrime dhe kryptografi, Dr. Michael Rathford, ndërtoi një formë deshifrimi që u quajt Kodi i Nostradamit. Mënyra e shkrimit të Nostradamusit është kodim i vetë shkrimit të koduar ose si të thuash dopio kodim.

Miliarderi amerikan, George Soros, është shumë i brengosur për mundësinë e shpërthimit të Luftës së Tretë Botërore, e cila, sipas tij, mund të niste me konfliktin ndërmjet Kinës dhe ShBA.

"Shpenzimi ushtarak në Kinë po rritet dhe atje ka po ashtu tendenca për ridestinimin e ekonomisë për nevoja të vendi e jo për eksport. Nëse ndodh konflikti ndërmjet Kinës dhe aleatëve të Amerikës, si Japonia, nuk është e tepruar të thuhet se jemi në prag të Luftës së Tretë Botërore”, thotë Soros.

"Që kjo të evitohet, ShBA duhet të lejojnë që juani kinez të përfshihet në takimin valutor të FMN-së. Valuta kineze, me këtë rast, do të mund të garonte me dollarin. Kina duhet të japë përgjigje lidhur me transformimin e ekonomisë", ka thënë Soros.

Ai ka theksuar se Kina e ShBA me vështirësi do të arrijnë marrëveshje, por alternativa do të jetë "shumë e pakëndshme".

"Ekziston rreziku serioz se Kina do të krijojë aleancë politike e ushtarake me Rusinë, për ç'shkak edhe kërcënimi nga lufta e re botërore është real", ka përfunduar Soros.

Lideri i radikalëve serbë Vojsllav Sheshel në një intervistë për Klan Kosovën ka deklaruar se Serbia do të kthehet në Kosovë edhe me luftë nëse është nevoja.
Ai ka treguar se në qendrën e paraburgimit në Hagë ka takuar Fatmir Limajn e Ramush Haradinajn dhe se ka kaluar mirë me ata.

"Ne do të kthehemi në Kosovë me ose pa ushtri. Duam ta bëjmë këtë në paqe dhe rezoluta 1244 i garanton Serbisë këtë kthim. S'do të pengojmë jetën e shqiptarëve dhe politikanëve të tyre. Nëse kjo do të thotë luftë, atëherë bëhuni gati, ushtria serbe do të kthehet, o sot, o nesër", tha Sheshel.

Disa javë më parë komandanti i çetnikëve serbë, Bratislav Zhivkoviç, i cili është kthyer në Serbi nga konfliktet në Ukrainë ku ka luftuar përkrahë separatistëve pro-rusë u shpreh se "edhe mijëra rusë janë të gatshëm të vijnë të luftojnë në Kosovë".

Në një intervistë për gazetën serbe "Pravda", duke folur për Kosovën ai ka thënë se rusët janë të gatshëm të luftojnë për të rikthyer Kosovën.

Nëse Rusia do të ndërmerrte ndonjë hap për ta sulmuar Kosovën, ajo duhet ta di që garantues të kufijve të Kosovës është Amerika-Evropa- NATO dhe çdo sulm në Kosovën do të thotë luftë e tretë botërore.

Kështu mendoni eksperti i sigurisë, Hajrullah Tërnava, thotë se Rusia në gjendjen aktuale po i provon politikat kërcënuese për Ballkanin.

"Edhe kjo është një luftë speciale që tani e ushtron Rusia. Në situatë të tillë çfarë gjendet Rusia e rrethuar me sanksione të ndryshme për ndërhyrjen në lufte me Ukrainën respektivisht në Krime dhe në situatën e rëndë që ka filluar ta përfshijë Rusinë tani ajo i provon politika kërcënuese si për kërcënimin në Ballkan. Nëse Rusia do të sulmojë Kosovën ajo duhet ta dijë se garantues të kufijve të Kosovës është Amerika-Evropa-NATO dhe çdo sulm në Kosovë do të thotë luftë e tretë botërore", vlerëson Tërnava.

Tërnava thotë se, Kosova duhet të këtë strategjinë luftarake e cila në situatën në çfarë tani gjendemi është shumë e lidhur me politikat luftarake garantuese të stabilizimit të kufijve.

"Tani kush të dojë me e nxitë luftën e tretë botërore e ka të freskët luftën e dytë botërore dhe nxitësit e asaj lufte dhe përfundimin e saj edhe që tani teknikat luftarake janë avancuar shumë sepse të shumtën bëhet fjalë për armatimin atomike që të dy palët janë mjaftë të armatosura me këtë lloj. Gjithsesi shteti i ynë duhet të këtë strategjinë luftarake e cila në situatën në çfarë tani

gjendemi është shumë e lidhur me politikat luftarake garantuese të stabilizimit të kufijve siç e shpjegova më larte", përfundon Tërnava.

Konflikti i armatosur ndërmjet Rusisë dhe NATO-s mund të ndodhë, edhe atë shumë shpejtë, nëqoftëse nuk gjejnë zgjidhje për një kohë të shpejtë. Shkruan për 'Financial Times' Denis Sandoll profesori për 'Marëdhëniet Ndërkombëtare' i cili ligjëron në Universitetin 'Xhorxh Mejson' në Amerikë.

Sipas tij, është e qartë që NATO punon intensivisht që të përhapet në lindje, planifikon që Ukrainën dhe Gruzinë ti futë në NATO, kështu që Rusia të mbetet në një "qorr-sokak", raporton portali "Webtribune".

Ushtria e NATO-s merrë pjesë në shumë konflikte ushtarake në botë dhe mundohet që ta forcojë dominimin e saj. Ky zgjerim duhet të ketë një pikëpamje tjetër, sepse Rusia nuk është ajo që ishte në vitet e nëntëdhjeta, në Moskë tani mbrohen interesat gjeopolitike, dhe me kërcënimin luftarak do të thotë se do të ketë luftëra të reja në rrethinën e Rusisë, në drejtimin e Europës dhe jugut të Rusisë.

Udhëheqësi ekspert në Qendrën e hetimeve luftarako-politike MIGMO (Institucioni shtetëror për marëdhënie ndërkombëtare në Moskë) Mihaill Aleksandrov, mendon që shanset për të krisur një luftë e vërtetë dhe e madhe janë shumë të mëdhaja, për këtë njerëzit duhet të mendojnë dhe të kërkojnë një menyrë që ta ndalojnë dhe ta anashkalojnë këtë problem.

"Rusia ka potencial që t'i kundërvihet NATO-s dhe ta ndalojë hovin e saj për zgjërimin në lindje por edhe më shumë se kjo.

Dhe padyshim që lufta e cila ka filluar në Ukrainë, mund të përhapet edhe në Ballkan, me një aksion ushtarak Rusia do të shkonte në shkeljen e Bullgarisë dhe Rumanisë." Pastaj thotë: "Nëqoftëse ndodh kjo, është më se e ditur që Rusia do t'i japë përkrahje Sërbisë dhe pastaj së bashku do të hyjnë në Kosovë dhe Mal të Zi dhe kjo do të jetë kërcënim i NATO-s në Ballkan. Do të thotë që në qoftëse lufta e Ukrainës shpërthen nëpër Ballkan, ne në Rusi kemi shansa të mira." thotë Aleksandrov.

Ai thotë që ushtria ruse ka 10000 tanke në zonën e Uralit dhe vetëm për disa muaj ata do të jenë totalisht të gatshëm për luftë. Edhe përkrah faktit që NATO ka mundësinë që të aktivizojë një ushtri prej miliona ushtarësh, rusët këmbëngulin që janë në gjendje t'i mbledhin dhe ta aktivizojnë një ushtri prej dy apo tre milionë anëtarësh. Kuptohet, simbas statistikave që jepen parashtrohet pyetja për angazhimin e armëve nukleare për shkatërrim total, të cilat forcat perëndimore i kanë për të këtilla raste, mirëpo sipas ekspertëve, edhe rusët janë në gjendje që të mbrohen po me të njëjtën armë me të cilën kërcënohen.

Këta ekspertë shpresojnë që NATO ka ndonjë strategji tjetër, ajo metodë është ndeshje me ushtri deri diku të cilat mund të kontrollohen.

Rusia kontrollon shumicën e resurseve energjetike që e furnizojnë botën, ka territor të madh dhe kapacitetin më të madh të armëve nukleare. Nëqoftëse

NATO dëshiron luftë totale, atëherë kjo do ta çojë pothuajse në shkatërrim ekonominë europiane dhe kapacitetet ushtarake, ndërsa shkatërrimet më të mëdhaja do t'i ketë SHBA-ja.

Sipas statistikave të mia, thotë eksperti Aleksandrov, qëllimet e SHBA-ve me NATO-n dhe vendet tjera të Europës për ta sulmuar Rusinë janë më se të qarta. Qëllimi i asaj lufte është edhe në koncepcionin e sigurimin kombëtar Amerikan. Ajo është "Luftë globale qytetare" ka lajmëruar eksperti për akademinë e ndryshimeve gjeo-politike, Konstantin Sokollov, ku lajmëron që në këtë luftë nuk do të ndeshen krye për krye Rusia me SHBA-të mirëpo edhe qytete tjera do të ftohen nga NATO dhe Uashingtoni. Ai thotë që Rusia duhet të ndërmarrë diçka në qoftëse dëshiron t'i ruajë interesat e veta, popullin e vet dhe vlerat tradicionale.

"Ne duhet ta kuptojmë që armiku ynë nuk është një qytetar i thjeshtë apo ushtarë në SHBA apo Angli, armiku ynë janë pronarët e kapitalit global të qendrave financiare të fuqisë botërore. Ata kanë sjellur vendim se interesat e tyre janë shkelur, dhe për t'i mbajtur dhe përforcuar ato interesa, ata krijojnë konflikte në vende të ndryshme në të cilat duhen të dalin më të fortë.

Ushtritë janë vetëm instrumentet e tyre, dhe jo institucionet e qeverisë dhe shtetit. Oligarkia botërore krijon pasiguri dhe konflikte të cilat i shkatërrojnë të gjitha, dhe kësaj gjëje duhet t'i kundërvihet. Ajo është që e shohim dhe e kuptojnë në lëkurën tonë, ne në Rusi, mirë është që këtë ta shohin edhe vendet tjera të Perëndimit." deklaron Konstantin Sokollov.

Paralajmërimi i fundit i nënsekretarit amerikan të Departamentit të Shtetit, Nicolas Burns, se Serbia do të ballafaqohet me reagimin ushtarak të NATO, nëse bën ndërhyrje ushtarake në Kosovë, në rast se shqiptarët e Kosovës do të shpallin pavarësinë në mënyrë të njëanshme, tregon se ndërhyrja ushtarake serbe në Kosovë, nuk është një mundësi për mos t' u konsideruar seriozisht. Serbia, derisa propozon për Kosovën modelin e Hong-Kong, të cilin ajo e di se shqiptarët nuk do ta pranojnë kurrë, në fakt ka adoptuar për Kosovën politikën e Kinës për Taiwan-in.

Ashtu si Kina e pranon për momentin shkëputjen faktike të Taiwan-it nga Kina, por nuk e pranon shkëputjen formale, duke e kërcënuar Taivanin me luftë në rast se shpall pavarësinë, ashtu dhe Serbia, duket qartë se për momentin parapëlqen që Kosova të jetë e shkëputur prej saj faktikisht, por jo edhe formalisht, duke shpallur pavarësinë. Në Beograd shkojnë me mendimin se Taiwani sigurisht që një ditë do t' i kthehet Kinës, dhe atëherë Serbia mendon se do të mund ta rikthejë Kosovën si pjesë të saj. Paralajmërimi i Washingtonit për Serbinë, me anë të Burns, në fakt i ka vënë SHBA-të kundrejt Serbisë në lidhje me Kosovën, në pozitën që ishin SHBA në fillim të viteve nëntëdhjetë të shekullit të kaluar, në raport me Kinën, për çështjen e Taiwan-it, kur dukej se Taiwan-i po shkonte kah pavarësia. Kriza mes Kinës dhe Taiwan-it, që në fakt ishte krizë kino-amerikane, u zgjidh duke u ruajtur statu-quo, pra duke qenë Taiwan-i faktikisht i shkëputur nga Kina, por duke mos e formalizuar këtë me anë të shpalljes së pavarësisë.

Në mënyrë të ngjashme, edhe kriza e tashme e Kosovës, nuk është thjesht një krizë mes Serbisë dhe shqiptarëve të Kosovës, por krizë mes SHBA dhe Rusisë. E tillë u bë ajo që kur Rusia shpalli me anë të Ministrit të saj të Punëve të Jashtme, Sergey Lavrov, në 3 shtator të këtij viti, politikën e saj të "vijës së kuqe", për Kosovën, sipas së cilës pavarësia e Kosovës cënon sigurinë e Rusisë.

Kjo deklaratë ende nuk është analizuar siç duhet. Lavrov u shpreh literalisht: "Duhet gjithashtu të jetë e qartë për të gjithë, se me gjithë natyrën jokonfrontuese të politikës së jashtme të Rusisë, disa vija të kuqe ekzistojnë për ne. Në këtë rast ne sigurisht që nuk mund të bëjmë gjë tjetër, veç që të përgjigjemi dhe të mbështesim plotësisht pozicionin tonë. Midis të tilla çështjeve janë planet e SHBA për të dislokuar sisteme globale të mbrojtjes raketore në Europë dhe zgjidhja në Kosovë.

Rusia nuk po bllofon dhe partnerët tanë ndërkombëtarë duhet ta kuptojnë këtë gjë. Veç parimeve, interesat vitale të politikës praktike janë të prekura në këto çështje". Kur një shtetar i këtij niveli të një fuqie të madhe flet me këtë gjuhë, këtu nuk ka vend për ekuivoke, aq më tepër që ai më tutje në fjalimin e vet, tha: "Rusia nuk ka frikë nga një politikë e frenimit, e ushtruar ndaj saj. Ne do të jemi të aftë t' i përgjigjemi asaj, edhe pse kjo nuk është zgjedhja jonë. Por ne sinqerisht trishtohemi se disa nga partnerët tanë janë të paaftë të kuptojnë gje a gjezën e zero-sum-game".

Politika ruse e "vijës së kuqe" për Kosovën është në praktikë një garanci ushtarake që i jep Rusia Serbisë, për ta mbështetur edhe ushtarakisht në rast se Serbia ndërhyn ushtarakisht në Kosovë, sikur kjo e fundit të

shpallë pavarësinë. Nuk është një gjë e rastit që deklarata nga Berogradi për ndërhyrje ushtarake në Kosovë filluan të vijnë pas kësaj deklarate të ministrit të jashtëm rus. Deklarata e shumëkomentuar e sekretarit të shtetit për Kosovën në qeverinë e Serbisë, Dushan Prorokoviç, për ndërhyrje ushtarake serbe në Kosovë, erdhi në 5 shtator të këtij viti, dy ditë pas deklarimit të politikës së "vijës së kuqe" për Kosovën nga ana e Rusisë.

Pas shpalljes së politikës ruse të "vijës së kuqe" deklarata e Prorokoviç është në fakt një kërcënim rus, përveç se serb. Beogradi e bëri të qartë se Marrëveshja e Kumanovës, në bazë të së cilës forcat e NATO-s hynë në Kosovë, zhvlerësohet në rast se Kosova shpall pavarësinë, dhe se në këtë rast trupat serbe mund të rikthehen në Kosovë.

Washingtoni me anë të Burns deklaroi se në rast se ushtria serbe ndërhyn në Kosovë, asaj do t' i kundërvihet NATO. Kjo nuk duket e besueshme. Në forcën ndërkombëtare (KFOR) prej mbi 16 mijë vetësh të dislokuar në Kosovë ka trupa nga 26 vendet anëtare të NATO-s, por në rast se Kosova shpall pavarësinë dhe në Kosovë hyn ushtria serbe, Këshilli i NATO nuk do të mund kurrë që të arrijën në një konsensus për të reaguar ndaj ndërhyrjes ushtarake serbe. Veprimi i përbashkët ushtarak kërkon që autorizimin nga parlamenti i secilit vend për trupat e veta që do të marrin pjesë në operacion, dhe nëse tentohet kjo do të thotë që në pjesën më të madhe të vendeve anëtare të NATO-s të krijohen konflikte politike shumë serioze të brendshme.

Pjesa më e madhe e vendeve europiane, dhe në rradhë të parë shtetet më të rëndësishme anëtare të

NATO, do të jenë kundër një lufte të re në Europë, e cila veç të tjerash do të sjellë tërmete politike në këto vende, duke u ndodhur përballë protestave masive qytetare. Edhe aleati më i ngushtë i SHBA në NATO, Britania e Madhe, nuk do të mund të ishte pro një aksioni ushtarak kundër Serbisë, aq më tepër kur Britania e Madhe tashmë ka vendosur të tërheqë trupat nga Iraku vitin e ardhshëm. Spanja, Italia dhe Gjermania, të cilat kanë kontigjente të mëdha në kuadrin e KFOR, do të jenë kategorikisht kundër. Edhe Presidenti francez Sarkozy, me gjithë sinjalet e afrimit që ka dhënë me qendrimin amerikan për Kosovën, nuk do ta angazhojë kurrë ushtarakisht Francën për të frenuar një ndërhyrje ushtarake serbe në Kosovë, çka do të bënte që Parisi të ndizej flakë nga protestat dhe do të rrezikonte rënien e qeverisë së djathtë franceze. Një kërkesë amerikane që NATO të ndërmarrë një aksion të ri ushtarak kundër Serbisë, do të çonte automatikisht në atë që pjesa më e madhe e vendeve që kanë trupa në kuadrin e KFOR, t' i tërheqin ato, çka do të çojë praktikisht në shpërbërjen e KFOR.

Është e qartë se për një aksion të përbashkët ushtarak të NATO, për të frenuar Serbinë, as që mund të bëhet fjalë. Nëse do të ketë aksion ushtarak, ky do të jetë i njëanshëm, amerikan. Në rrethanat e tashme, kur SHBA gjenden në një angazhim ushtarak shumë problematik në Irak dhe në Afganistan, për të cilët ka një debat serioz brenda në SHBA, as që mund të bëhet fjalë për një aksion të ri ushtarak, aq më tepër në Europë, aq më tepër në vitin zgjedhor presidencial në SHBA.

Kjo është arsyeja, që nga Washingtoni vijnë sinjale të uljes së vendosmërisë amerikane për të njohur

pavarësinë e Kosovës. Një politikan shqiptar që shihet si përsjellës i kumteve amerikane në politikën shqiptare në dy anët e kufirit, në trekëndëshin Tetovë-Prishtinë-Tiranë, Arbër Xhaferri, para disa vjetësh u shpreh në një intervistë se shqiptarët e Kosovës nuk duhet të shpallin njëanshmërisht pavarësinë, se kjo do të bëjë që të humbin mbështetjen e aleatëve, duke përfshirë dhe SHBA.

Xhaferi sugjeroi që ajo që duhet bërë është një rezolutë ku të konfirmohet vullneti për pavarësi. Deklarata e Xhaferrit, qendrimi i të cilit duhet parë si i ndryshëm nga ai i Behgjet Pacollit që ka thënë të njëjtën por me proveniencë ruse, shpreh nervozizmin amerikan nga ndërlikimet që mund të sjellë shpallja e pavarësisë së Kosovës, pas paralajmërimit rus për "vijën e kuqe", kur gjuha me të cilën është bërë deklarata ruse për politikën e "vijës së kuqe", nënkupton deri edhe ardhje të ushtrisë ruse në Kosovë, në mbështetje të asaj serbe.

Arbër Xhaferi, në një intervistë tjetër në Top Channel para disa vjeesh, deklaroi se në rast se Kosova do të bënte shpalljen e njëanshme të pavarësisë, atëherë kjo do të çonte në palestinizimin e Kosovës. Me këtë Arbër Xhaferri donte të thoshte sigurisht se Kosova do të vihet në pozitën e territoreve palestineze, ku intervenon ushtria izraelite, duke intervenuar ushtria serbe në Kosovë.

Xhaferi ndoshta ka pasur të drejtë, por, në rast se shqiptarët e Kosovës nuk e shpallin pavarësinë pas 10 dhjetorit, por e shtyjnë atë në një termin të pacaktuar, kjo do të thotë që Kosova të vihet në pozitën e Taiwan-it, por pa pasur komoditetin e Taiwan-it, që ka një nga

ekonomitë më të prosperuara të botës, që u ka siguruar një nivel mjaft të lartë mirëqenieje banorëve të tij.

Ndërsa Kosova do të gjendet me status të papërcaktuar, me një ekonomi të botës së tretë, dhe me një situatë sociale që për rreth gjysmën e popullsisë është në kufijtë e katastrofës humanitare, për shkak të varfërisë, dhe që bëhet eksplozive, edhe për shkak të polarizimit që po vjen duke u rritur mes të pasurve dhe të varfërve.

Në rast se klasa politike shqiptare e Kosovës nuk shpall pavarësinë pas 10 dhjetorit, kjo do të çojë në delegjitimimin përfundimtar të kësaj klase politike, e cila nuk ka më asgjë me cka të legjitimohet në raport me popullin e Kosovës.

Në rast se Kosova nuk do të bëjë shpallje të njëanëshme të pavarësisë pas 10 dhjetorit, kjo do të thotë që konflikti gjeopolitik i fuqive të mëdha për Kosovën, të evitohet me çmimin e shkallëzimit të konfliktit politik dhe social ndërshqiptar në Kosovë. Në këtë rast do të ketë një palestinizim të Kosovës, të cilit i druhej Xhaferri.

Këtë e them tha Xhaferi duke pasur parasysh konfliktin ndërpalestinez që ka filluar prej disa kohësh në territoret palestineze, mes krahëve të ndryshme të politikës, si pasojë edhe e situatës eksplozive sociale, të krijuar nga varfëria e skajshme, por që favorizohet nga konflikti i brendshëm për zgjidhjen e çështjes palestineze dhe nga mungesa e shtetit.

Për Serbinë dhe Rusinë është e mirëpritur që në Kosovë të fillojë një konflikt ndërshqiptar, i ardhur si reagim i mosshpalljes së pavarësisë së Kosovës pas 10 dhjetorit, madje Serbia dhe Rusia e shikojnë mosshpalljen

e pavarësisë si ekspedient strategjik të tyre për ta transferuar konfliktin nga një konflikt serbo-shqiptar në një konflikt ndërshqiptar në Kosovë.

Në rrethanat kur Kosova do të shpërthejë, si një konflikt ndërshqiptar, forcat e KFOR do të gjenden në mes të një konflikti të cilin politikanët e vendeve të tyre që i kanë angazhuar në Kosovë nuk e kanë llogaritur. Kjo mund të jetë pretekst për pjesën më të madhe të vendeve që kanë trupa në kuadrin e KFOR, për t' i tërhequr ato nga Kosova.

Në këtë situatë Serbia mund të gjejë përsëri pretekst për të ndërhyrë ushtarakisht në Kosovë, duke inskenuar në këtë situatë incidente si ata që bënë rusët në vitin 1999, për të justifikuar aksionin e tyre të ri ushtarak në Çeçeni, duke simuluar atentate terroriste deri edhe në Serbi, për të cilat do të fajësojnë shqiptarët e Kosovës. Kështu që liderëve shqiptarë të Kosovës, në rast se nuk do ta shpallin pavarësinë pas 10 dhjetorit, u shkon shprehja që i tha Winston Churchill qeverisë britanike pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Munich-ut: "Në mes të luftës dhe turpit, ju zgjodhët turpin, por do ta keni dhe luftën".

Në këtë "nyje gordiane" që është krijuar, kur në perspektivë ka rënë hija e e errët e ndërhyrjes ushtarake serbe në Kosovë, ripërmasohet roli i Shqipërisë së këtej kufirit, i shtetit shqiptar. Republikës së Shqipërisë, kur u vu në tryezë çështja e statusit të Kosovës, ndërkombëtarët i thanë se duhet të ishte aktive, por jo aktore në këtë çështje.

Tashmë që ndërkombëtarët kanë hyrë në dead-line, Shqipëria ka të drejtë që të evoulojë në qendrimin e

saj, duke kaluar nga aktive në aktore, madje në aktore aktive. Para disa ditësh ish-kryeministri Majko deklaroi se Tirana duhet ta bëjë të qartë se ushtria shqiptare do të hyjë në Kosovë, në rast se atje hyjnë forcat serbe. Në botë, analiza mediatike u paraprin politikanëve në qendrime, por në Shqipëri pothuajse nuk ndodh kështu.

Atë që tha Majko në media nuk e ka thënë kurrkush tjetër veç meje, në disa artikuj të botuar në shtyp. Në këto rrethana, mund të pyetet se a do të ketë luftë mes Shqipërisë dhe Serbisë për Kosovën? E vërteta është se konflikti mes Serbisë dhe shqiptarëve të Kosovës është pjesë e konfliktit të hershëm mes Serbisë dhe nacionit (kombit) shqiptar, që ka evouluar edhe si konflikt mes Serbisë dhe shtetit shqiptar pas krijimit të këtij të fundit. Shqipëria shtetërore është e involvuar në këtë çështje, jo thjesht për një sentiment nacional ndaj shqiptarëve të Kosovës, por edhe për interesat e saj jetike të sigurisë. Derisa në Kosovë thotë se ka interesa jetike sigurie Rusia, aq më tepër që ka të tilla Shqipëria.

Serbia Kosovën historikisht e ka parë si një kryeurë për të dalë në Adriatik, duke e ndarë Shqipërinë me Greqinë, me anë të një veprimi të përbashkët ushtarak, të justifikuar me luftën kundër terrorizmit islamik, me ç'rast do të bëhej spastrim etnik i shqiptarëve në dy anët e kufirit.

Si rezultat i kësaj, Serbia do ta përmirësojë në mënyrë të ndjeshme pozitën e vet gjeopolitike. Tentativa të qarta për këtë gjë janë bërë jo më vonë se viti 1997 në Republikën e Shqipërisë, para se të fillonte lufta në Kosovë.

Idea që Shqipëria të ballafaqohet ushtarakisht me Serbinë në Kosovë mund të duket si delir, por nuk është kështu.

Së pari, Serbia e sotme nuk është më fuqia e frikshme ushtarake e kohës së luftrave në ish-Jugosllavi. Armatimi i ushtrisë serbe sot nuk të frikëson shumë. Ushtria serbe sot ka tanke të modeleve M-84 dhe T-72, që janë prodhime të industrisë ushtarake jugosllave të dikurshme, sipas modeleve të vjetra sovjetike. Serbia, pas atij që e quajti riorganizim të ushtrisë dhe që u bë pas vitit 2003, tërhoqi nga ushtria 511 tanke T-55 që po shiten për skrap. Gjithashtu për skrap po shiten dhe 50 nga 65 tanket T-72 që ka ushtria serbe. Ushtria serbe ka sot aktive në forcat e saj të blinduara vetëm 212 tanke të llojit M-84, që është versioni i prodhuar ne Jugosllavinë e dikurshme i modelit sovjetik T-72. Ky lloj tanku serb është përmirësuar me adoptim aksesorësh në vitin 2001. Por tanket serbe M-84 janë verifikuar shumë të cenueshme në luftrat në ish-Jugosllavi, për shkak se municioni e mbajnë në kullë dhe në një depozitë poshtë saj, gjë që i bën mjaft të cënueshëm nga pas kullës. Gjithashtu ushtria serbe ka sot në forcat e saj të blinduara dhe 15 tanke T-72, që përdoren për trajnim.

Sa për automjetet e blinduara luftarake (autoblinda), që kanë qenë aq decizivë në luftrat në ish-Jugosllavi, sot ushtria serbe, pas reformës që bëri duke nxjerrë nga përdorimi shumë autoblinda, ka në përdorim 794 të tilla. Sot ushtria serbe ka në përdorim 526 autoblinda të llojit M-80 A, që janë prodhim jugosllav, tashmë i vjetëruar, dhe që janë të pajisur me nje top 20 mm, si dhe me raketa antitanke. Ky tip autoblinde është

në fakt një prodhim i industrisë së dikurshme jugosllave, i modelit rus, të erës sovjetike, BP-1. Autoblinda M-80 A është mjeti kryesor i lëvizjes së forcave tokësore serbe. Ajo është përdorur me shumë efektshmëri në luftën antiguerrile në Kosovë, dhe në luftrat e tjera në ish-Jugosllavi, por ajo shihet si primitive në raport me tipet e reja në qarkullim në botë, të pajisura me radar dhe raketalëshues modernë, dhe shihet si shumë e paaftë të reagojë përballë kundërshtarëve të pajisur me armë blindëshpuese ultramoderne, të lehta për t' u transportuar. Gjithashtu ushtria serbe ka dhe 84 copë autoblinda BOV-M86, nga të cilat 56 përdoren nga policia ushtarake), 100 autoblinda, BTR-50, që është një automjet i blinduar amfib, 28 autoblinda të modelit BRMD-2, 50 autoblinda të llojit MT-LB, si dhe 6 copë autoblinda të llojit BTR-60. Të gjitha këto janë prodhime të industrisë së dikurshme jugosllave të luftës dhe ato tashmë konsiderohen të vjetëruara.

Artileria në zotërim të ushtrisë serbe, e cila ka qenë një faktor determinant në favor të serbëve në luftrat në ish-Jugosllavi, nuk është më ajo e dikurshmja. Artileria e rëndë, me qitje të largët dhe të mesme, e cila do të ketë një rol të madh në rast të një ndërhyrjeje ushtarake serbe në Kosovë, praktikisht nuk ekziston më. Pjesa më e madhe e artilerisë serbe sot përdoret nga armë të llojit howitzer, që përdoren në distanca të shkurtra, në sens të artilerisë, me qitje të drejtpërdrejtë.

Por kjo gjë i bën ato dhe shumë të prekshme nga një kundërshtar që përdor raketa të lehta tokë-tokë.
Ushtria serbe sot ka 36 topa të kalibrit 152 mm, të markës M-84 "Nora A", që janë të llojit howitzer, dhejanë

prodhim jugosllav i viteve tetëdhjetë, sipas një modeli më të hershëm rus. Ushtria serbe gjithashtu ka 18 topa 130 mm, të llojit M-46, si dhe 303 topa 122 mm, të llojit D-30, që tashmë janë në rezervë, për shkak se konsiderohen si shumë të vjetëruar. Sa i përket artilerisë automatike dhe raketore, ushtria serbe disponon 18 topa të markës M-94 Plamen S, që si prodhimi më i hershëm i industrisë jugosllave të luftës, gjenden në rezervë. Gjithashtu ushtria serbe disponon 60 cope M-77 Oganj (howitzer) të kalibrit 128 mm, që janë prodhim i industrisë jugosllave të luftës, sipas modelit të katjushave ruse, 16 copë Nora B-52, të kalibrit 152 mm, 4 cope M87 Orkan, me 12 tuba, të kalibrit 262, mm, si dhe 72 cope 2S1 Gvozdika, të kalibrit 122 mm (howitzer).

Forcat ajrore serbe sot përbëhen nga 3000 njerëz dhe 170 avionë të vendosur në dy baza ajrore. Na këta 170 avionë, 91 janë avionë luftarakë. Serbia ka 5 avionë gjuajtës Mig-29 të prodhimit rus, për të cilët është thënë se janë përmirësuar kohët e fundit, por ata janë gjithsesi një model që tashmë quhet i vjetëruar. Pjesa tjetër e aviacionit luftarak serb përbëhet nga 33 avionë të llojit J-22 Orao, që janë prodhim i industrisë së dikurshme jugosllave të luftës, sipas modeleve ruse. Nga këta 33 avionë, vetëm 16 janë realisht luftarakë, që përdoren për sulme tokësore, ndërsa 7 të tjerë përdoren për trajnim, ndërsa 10 të tjerët për zbulim.

Aviacioni jugosllav ka 25 avionë G-4 Super Galeb, që janë prodhim i industrisë së dikurshme jugosllave të luftës, sipas modeleve ruse. Nga këta 25 avionë vetëm 14 janë realisht luftarake, duke qenë si gjuajtës, bombardues, ndërsa 8 të tjerë janë të paarmatosur dhe përdoren për

trajnim, ndërsa tre që mbeten përdoren për zbulim. Gjithashtu ushtria serbe ka dhe 28 avionë luftarakë të llojit Mig-21, që janë një model shumë i vjetër sovjetik. Ushtria serbe ka dhe 23 avionë transporti të prodhuar nga industria e vjetër jugosllave e luftës të markave An-2, An-26, Lola Utva, nga të cilët katër janë në shërbim të qeverisë. Qeveria serbe ka parashikuar qe deri në 2010 të blejë së paku 20 avionë luftarakë për të zëvendësuar Mig-21 dhe J-22 Orao që do të tërhiqen. Sa u përket helikopterëve, ushtria serbe ka 94 të tillë, nga të cilët 28 helikopterë M-8, të vjetëruar tashmë, është vendosur të nxirren nga përdorimi për qëllimi ushtrake.

Në ushtrinë serbe , sot si helikopterë luftarakë në përdorim janë 61 copë të llojit Soko-Gazelle, që janë një prodhim i industrisë së dikurshme jugosllave të luftës, sipas modelit francez «Gazelle». Këtë model helikopteri, Franca që e e ka patentën dhe vendet e tjera që u pajisën me të si Britania e Madhe, prej kohësh nuk e përdorin më për qëllime luftarake, për të cilat është zëvendësuar nga modeli "Eurocopter Tiger", por përdoret vetëm për ndërlidhje dhe transport në sasi të vogla. Ata shihen si shumë vulnerabël ndaj raketave moderne tokë-ajër, të kalibrit të vogël dhe lehtësisht të transportueshme Qeveria serbe ka parashikuar të blejë 15 helikopterë të rinj, për të zëvendësuar 28 helikopterët M-8 që do të tërhiqen.

Në fund të vitit 2003 Serbia shpalli se kishte filluar riorganizimi dhe modernizimi i ushtrisë, duke tërhequr teknologjinë e vjetër dhe duke futur të re, por nuk është bërë shumë, për mungesë fondesh. Serbia shpenzon 1 miliard dollarë në vit për ushtrinë, por më

pak se një e treta e kësaj shume përdoret për rinovimin e pajisjeve ushtarake. Pas riorganizimit të ushtrisë, forcat tokësore serbe janë ndarë në katër brigada tokësore, të pajisura me batalione këmbsorie, artilerie, tankesh, mbrojtjes kundërajrore. Nga këto, pranë kufjve të Kosovës janë brigada e dytë, e tretë dhe e katërt. Brigada e dytë tokësore, me bazë në Kraljevë, i ka forcat të dislokuara në Novi Pazar, Rashka, Valjevo. Kjo brigadë është krijuar në mars 2007 dhe përbëhet nga dy batalione kembsorie, nje batalion tankesh, dy batalione te mekanizuara, nje batalion i artilerise howitzer, nje batalion misile-lançues, nje batalion i mbrojtjes kundrajrore. Brigada e Trete tokësore, e formuar ne qershor 2007, e ka bazën në Nish, ndërsa forcat e saj gjenden dhe në Prokuplje, Zajecar, Kurshumlija. Edhe kjo ka të njëtën përbërje dhe armatim si e mësipërmja. Brigada e katërt tokësore, me të njëjtën përbërje dhe armatim, e ka bazën në Vranjë dhe ka forca ne Leskovac, Bujanvc. Veç tyre ushtria serbe ka dhe brigadën e veçantë artilerike, që është e përbërë nga katër batalione, nga të cilët tre batalione të pajisur me howitzer. Veç saj është dhe brigada speciale, me baze ne Pancevo dhe Nish, e perbere nga nje batalion parashutistesh, nje batalion komando, dhe nje batalion i quajtur antiterrorist. Ushtria serbe sot ka si forcë aktive 31 mijë njerëz, ndërsa veç tyre ka dhe 207 mijë njerëz në rezervë.

Ushtria serbe, me armatimin e vjetëruar që ka është shumë vulnerabël para një kundërshtari të vogël në numër, por të armatosur me armë ultramoderne, si armë blindëshpuese dhe raketa antitanke, kundër helikopterëve, apo kundër përqëndrimeve artilerike të

llojit howitzer. Në rast se do të ketë luftë mes Serbisë dhe shqiptarëve të Kosovës, ku do të implikohet detyrimisht dhe Shqipëria, atëherë kjo do të jetë një luftë e ngjashme me luftrat mes vendeve arabe dhe Izraelit, ku pas të parëve qendronte Bashkimi Sovjetik, ndërsa pas të dytit qendronte SHBA, që i furnizonin me armatim. Në rastin e luftës me Serbisë dhe shqiptarëve në dy anët e kufirit, Serbia do të jetë në pozitën e vendeve arabe, duke u furnizuar me armë nga Rusia, ndërsa Kosova, por edhe Republika e Shqipërisë do të jenë në pozitën e Izraelit. Pra, SHBA duhet të furnizojnë me armë shqiptarët në dy anët e kufirit. Tashmë shqiptarët kanë mundësi ta bëjnë këtë gjë drejtpërdrejt në Kosovë, duke ndërtuar një urë ajrore mes Tiranës dhe Prishtinës, për të çuar atje armatimet e sjella në Durrës. Në rast se Serbia intervenon ushtrakisht në Kosovë, Shqipëria duhet që haptaz të deklarojë se këtë gjë e konsideron shpallje lufte ndaj saj nga ana e Serbisë, dhe të angazhohet ushtarakisht, duke çuar armë dhe forca ushtarake në Kosovë.

Futja e ushtrisë shqiptare në Kosovë, ka vlerën më tepër se në aspektin ushtarak, në atë se Shqipëria me këtë shenjon të drejtën e saj mbi Kosovën, dhe në konferencën e paqes që do të pasojë Shqipëria do të jetë palë, duke përfaqësuar edhe shqiptarët e Kosovës. Në këtë luftë Shqipëria do të jetë në pozitë shumë më të mirë se në vitet 1998-1999 në këtë rast se me pavarësimin e Malit të Zi nuk ka një rrezik serb nga veriperëndimi. Në Malin e Zi sot nuk ka ushtarë serbë (Mali i Zi vetë ka 6 mijë ushtarë), kur në 1998 atje kishte 15 mijë ushtarë serbë. Në rast lufte NATO sigurisht që do t' i japë garanca

ushtarake Malit të Zi, dhe nuk do të jetë në interes të Serbisë ta zgjerojë invazionin edhe atje.

Pra, fronti i luftës serbo-shqiptare do të jetë Kosova. Në rast të kësaj lufte SHBA sigurisht që do të shpallin në mënyrë të njëanshme ndalim-fluturimin mbi territorin e Kosovës dhe të Shqipërisë, duke u pamundësuar serbëve që të përdorin aviacionin, deri edhe helikopterët. Në këto rrethana lufta që do të zhvillohet do të jetë tokësore. Në këtë luftë, serbët duhet të llogarisin se shqiptarët e armatosur me armë ultramoderne, do t'u shkaktojnë humbje të mëdha atyre. Serbët nuk janë aq trima sa ç' thuhet, madje nuk janë fare trima. Kjo u pa gjatë luftës në Bosnjë-Herzegovinë, në të cilën, kur boshnjakët muslimanë, ishin ende të paarmatosur, serbët treguan "trimëri" të madhe duke zënë 69% të territorit të Bosnjë-Herzegovinës, në një invazion ku ata ishin të mbrojtur pas blindave, dhe qëllonin nga distanca me artileri dhe avionë.

Por kur bosnjakët, por edhe kroatët, u armatosën mirë, i vunë përpara serbët, duke u shkaktuar shumë humbje në njerëz dhe material luftarak dhe duke bërë që territori nën kontrollin e tyre të zbresë në 43% dhe duke i detyruar të ulen në bisedimet e paqes në Dayton, ku serbët gjithesi fituan më shumë territorin se ç' kontrollonin për momentin. E njëjta gjë vlen dhe për luftën e pritshme. Nëse intervenimi ushtarak serb do të rezultojë me humbje të mëdha sidomos në jetë njerëzore, kjo do të thyejë vullnetin e serbëve për luftë, siç u vërejt edhe gjatë kundërmësymjes së bosnjakëve gjatë luftës në Bosnjë-Herzegovinë. Nëse serbët e fillojnë këtë luftë, ata

mund të humbin dhe pjesën veriore të Kosovës që e kontrollojnë sot, madje edhe më gjerë.

Veç këtyre, në favor të shqiptarëve do të jetë dhe fakti që Serbia do të gjendet në situatën që nuk mund t' i përqendrojë gjithë forcat në Kosovë, pasi fillimi i luftës në Kosovë, me ç' rast pritet dhe një lëvizje e serbëve në Bosnjë-Herzegovinë, mund të nxisë bosnjakët muslimanë, e ndoshta edhe kroatët, për të rifilluar luftën kundër serbëve dhe për të marrë nën kontroll më tepër territore, çka ndoshta do të çojë në zhdukjen nga harta të Republikës Serbe të Bosnjë-Herzegovinës.

Forcat bosnjake do ta ndajnë në dysh Republikën Serbe të Bosnjë-Herzegovinës, duke krijuar korridore në drejtim të Sanxhakut musliman në Serbi, ku do të fillojë një guerrilje antiserbe. Serbia do të ketë probleme dhe në Vojvodinë, ku është bërë një pastrim i heshtur etnik ndaj hungarezëve dhe kroatëve, të cilët do të kërkojnë të përfitojnë nga rati për të bërë revansh ndaj serbëve, me mbështetjen e shteteve të tyre. Intervenimi ushtarak serb në Kosovë mund të provokojë një reaksion zinxhir tepër të dëmshëm për Serbinë (Kastriot Miftaraj).

Nëse lufta botërore e radhës do të ndodhë, me shumë gjasa do të jetë në Azi, në formën e një përplasjeje mes hgejemonit aktual, SHBA dhe sfidantit kryesor, Kinës. Lajmi i mirë është se Kina nuk do luftë tani dhe në të ardhmen e afërt, pikësëpari sepse Pekini e di shumë mirë se shanset nuk janë në anën e tij. Por nëse hedhim sytë 20 vite në të ardhmen, në vitin 2034, rrethanat do të kenë ndryshuar rrënjësisht.

Jo tani

Ka tre arsye përse lufta nuk ka gjasa të ndodhë së afërmi.

Së pari, pavarësisht rritjes ekonomike vjetore dyshifrore në buxhetin për mbrojtjen, ushtria e Kinës mbetet ende shumë prapa asaj të SHBA. Kinës do i duhen 15 deri 20 vite që të barazohet apo pothuajse barazohet me forcat aleate SHBA-Japoni në brigjet e Azisë lindore.

Së dyti, pavarësisht gjithë zërave për ndërvarësi reciproke, Kina varet nga Amerika shumë më tepër se sa Amerika varet nga Kina. Kina vazhdon të ketë varësi të fortë nga SHBA dhe aleatët e saj, BE dhe Japonia, duke qenë se janë tregjet kryesorë të eksporteve të saj si dhe burimet për teknologjinë e përparuar.

Në tërësi, varësia e Kinës ndaj tregjeve të huaj është shumë e lartë, teksa raporti i tregtisë me GDP-në është 53%. Kina importon shumë lëndë të para, si nafta dhe minerali i hekurit.

Duke qenë se mallrat e saj të importit transportohen përmes detit, Kina do të ishte tejet e cënueshme nga një bllokadë detare, e cila ka shumë gjasa të organizohet nga SHBA në rast të një konflikti të madh. Si për arsye ekonomike, edhe për arsye strategjike, qeveria kineze ndjek politika për të reduktuar varësinë e vendit nga tregjet e huaj, duke u përpjekur ta ndryshojë nga një model i orientuar nga eksportet, tek burimet e brendshëm të rritjes ekonomike.

Ajo po bën gjithashtu përpjekje të sigurojë lëndë të para në vendet dhe rajonet pranë Kinës, si Azia Qendrore, Rusia apo Birmania, me qëllim që të ulë varësinë nga transporti detar. Megjithatë, për të paktën 15 apo 20 vitet e ardhshëm, varësia e Kinës nga sistemi

ekonomik global i dominuar prej perëndimit do të mbetet e madhe.

Së treti, Kinës do i duhej të konfrontohej jo vetëm me SHBA, por edhe me aleatët aziatikë të Amerikës, përfshirë Japoninë, Australinë dhe ndoshta Indinë. Kështu që Kina ka nevojë për të paktën një aleat të madh si dhe disa aleatë më të vegjël. Aftësia e Kinës për të paraqitur një sfidë serioze do të varet në një masë të madhe nga formimi i një blloku gjeopolitik euraziatik mes Pekinit dhe Moskës. Kjo gjë po ndodh tani, por do të kërkojë pak më shumë kohë.

Përfundimi: gjatë 15-20 viteve të ardhshëm, një luftë e madhe në Azi nuk ka gjasa të ndodhë, sepse Pekini do të luajë një lojë të matur. Edhe nëse një përplasje ushtarake do të ndodhë, do të jetë e shkurtër, teksa Kina do të frenohet me shpejtësi prej forcës së Amerikës. Megjithatë, rreth vitit 2030, ekuilibri ka gjasa të ndryshojë, nëse Kina do të jetë e suksesshme në: 1) ngushtimin e hendekut ushtarak me SHBA; 2) uljen e varësisë së ekonomisë së saj nga tregjet perëndimorë dhe lëndët e para nga jashtë; 3) formimin e një strukture aleancash.

2034: Koalicioni i indo-paqësorit përballë aleancës euraziatike

Në fakt ka një numër të pafundëm të ardhmesh alternative. Shpërthimi i Luftës së Tretë në Azi mund të mos jetë më i mundshmi, megjithatë nuk është as edhe më i pamunduri.

Të imagjinojmë këtë skenar për 2034-ën.

Kina – e cila 4 vjet më parë përfundoi ribashkimin me Taivanin – është gjithnjë e më e shqetësuar për rritjen e fuqisë së Indisë. Në 2030-ën, India ia kaloi Kinës duke u bërë vendi me popullsi më të madhe në botë. Edhe më e rëndësishme, India me popullsinë e saj shumë më të re në moshë dhe me ekonominë e saj dinamike, ka patur tashmë një rritje më të shpejtë se sa Kina. India me modernizon me shpejtësi forcat e saj të armatosura, që brenda pak vitesh mund të paraqesë një sfidë serioze për të Kinën. Teksa rivaliteti Kinë-Indi për supremacinë në Indi arrin kulmin, Pekini vendos ë sulmojë i pari – përpara se Nju Delhi të ketë një shans për të ngushtuar hendekun. Kjo ngjan me mënyrën se si në vitin 1914, shqetësimet e Gjermanisë për rritjen e vazhdueshme të aftësive strategjike të Rusisë kontribuan për vendimin e Berlinit në favor të luftës, pas krizës së Sarajevës. Mes udhëheqjes gjermane kishte një besim që, në 1917 Rusia do të përfundonte programet e saj të modernizimit të ushtrisë dhe dritarja e mundësive do të mbyllej.

Duke përmendur futjen e hundëve të indianëve në Tibet dhe inkursionet përgjatë kufirit të diskutuar të HImalajeve, forcat kineze hidhen në ofensivë në zonat kufitare dhe godasin bazat detare dhe ajrore indiane. Sulmi ndaj Indisë do të thotë luftë me Japoninë, pasi Tokio dhe Nju Delhi kanë firmosur një marrëveshje reciproke mbrojtjeje në 2031-shin – pikërisht për t'u siguruar nga një sulm i mundshëm i Kinës. Në të njëjtën kohë, me sulmin në Indi, Marina e PLA merr Senkakusin dhe përpiqet të marrë edhe ishujt Ryukyu.

Në vitin 2032, amerikanët tërhoqën forcat e tyre nga Japonia, pasi prisnin që pakti Japoni-Indi dhe fakti që Japonia, në vitin 2029 ishte bërë fuqi bërthamore do të mjaftonte për të frenuar Kinën. Kinezët, nga ana e tyre, kanë vënë një bast që SHBA, pasi është përshkuar nga një frymë izolacioniste, nuk do të ndërhyjë në anën e Japonisë. Megjithatë, pas një farë hezitimi, SHBA hyn në luftë kundër Kinës. Kjo mund të jetë një përsëritje e ngjarjeve të 1914-ës, kur Berlini llogariti gabimisht se Londra do të qëndronte jashtë nëse Gjermania hynte në luftë kundër Francës dhe Rusisë.

Dy prej aleatëve të Amerikës në Paqësor, Australia dhe Filipinet, ashtu si dhe tre anëtarë të NATO-s – Kanadaja, Britania dhe Polonia i shpallin luftë Kinës. Kështu, krijohet koalicioni Indo-Paqësor anti Kinë i SHBA, Indisë dhe Japonisë. Kina nuk është e vetme në këtë luftë. Në vitin 2025, Kina, Rusia, Bjellorusia, Kazakistani, Kirgistani, Taxhikistani, Turkmenistani dhe Pakistani firmosin Marrëveshjen Euraziatike – një pakt kolektiv mbrojtjeje që u shndërrua në krahun politiko-ushtarak të Organizatës së Bashkëpunimit të Shangait. Mongolia u detyrua të hyjë në këtë marrëveshje në vitin 2033.

Rusia siguron Kinën nga veriu, i ofron asaj lëndë të para dhe pajisje ushtarake, si dhe dërgon një numër të kufizuar personeli ushtarak, si pilotë gjuajtësish dhe operatorë avionësh të telekomanduar për të luftuar në njësitë kineze. Përvec kësaj, përfshirja e drejtpërdrejtë e Rusisë në teatrin e indo-paqësorit është minimale. Moska është kryesisht e shqetësuar me Europën Lindore, sidomos Ukrainën, ku forcat properëndimore të mbështetura nga BE dhe NATO janë përpjekur të rimarrin

kontrollin në Ukrainën lindore dhe jugore që, përpara se të shpërthente lufta në Azi, kishin qenë zonë ruse e influencës. Rusia dhe BEëNATO, ndërkohë që nuk janë formalisht në luftë, janë të përfshirë në një konflikt përmes të tretëve në Ukrainë.

Korea, e cila që nga viti 2027 ka qenë një konfederatë e veriut dhe jugut, qëndron e papërfshirë. Vendet e Azisë Juglindore (përvec Filipineve) shpallin gjithashtu neutralitetin e tyre, ashtu sic bëjnë dhe shtetet afrikanë, amerikano latinë dhe të Lindjes së Mesme.

Luftë botërore, version i kufizuar

Në terma luftarakë, Lufta e Tretë do të jetë shumë e ndryshme nga luftërat e shekullit 20. Së pari, palët kryesore do të jenë fuqi bërthamore. Duke qenë se përdorimi i armëve bërthamore do të rezultojë në asgjësimin reciprok, palët do të frenohen. Nuk do të jetë ndryshe nga Lufta e Dytë, ku palët ndërluftuese kishin sasi të mëdha armësh kimike, por nuk i përdorën nga frika e kundërveprimit.

Armët bërthamore do të kenë gjithashtu një efekt zbutës sa i përket akteve tradicionalë të luftës. Një shtet ka gjasa të përdorë armë bërthamore si mjetin e fundit, sidomos nëse qendra e tij është e pushtuar apo nëse qytetet kryesorë bombardohen. Duke kuptuar këtë, pala tjetër mund të preferojë të mos e vërë kundërshtarin pas qoshes. Kjo mund të bëjë që zonat e ndërluftimit të kufizohen kryesisht në zonat periferike, larg prej rajoneve të populluar dhe industrializuar. Po kështu, strategët ushtarakë me shumë gjasa do të kujtojnë mësimet e të kaluarës, se një pushtim masiv nga toka në Azi është një

luftë e humbur. Të gjithë këto do të bëjnë që fushëbetejat kryesore të Luftës së Tretë do të jenë deti, ajri, zonat malore si dhe hapësira kibernetike.

Një tjetër karakteristikë e Luftës së Tretë mund të jetë funksionimi i vazhdueshëm i diplomacisë dhe organeve ndërkombëtarë, që do të shërbejnë si kanale efektivë komunikimi mes kundërshtarëve. Shumë dekada ndërtimi institucionesh ndërkombëtarë mund të mos rezultojnë se kanë qenë të kota. Pasi kanë dështuar në parandalimin e luftës, institucionet ndërkombëtarë të paktën do të kufizojnë shtrirjen dhe zbusin efektet e saj. Edhe tregtia dhe transaksionet financiarë mes armiqve mund të mbijetojnë deri në një farë mase, pasi do të kalojnë mes vendeve neutralë si Korea, Singapori apo Turqia. Kjo do të jetë prova e fundit se ndërvarësia ekonomike dhe lufta nuk e përjashtojnë domosdoshmërisht njëra-tjetrën.

Ndoshta do të jetë një luftë e kufizuar. Si e tillë mund të mos kërkojë mobilizim total të burimeve njerëzorë dhe materialë.

Në këtë kuptim, Lufta e Tretë do të jetë më e ngjashme me luftën e Spanjës apo Luftën 7-vjecare të shekullit 18, se sa luftërat botërore “totale” të shekullit që kaloi.

Fakti që lufta do të ketë një nivel relativisht të kufizuar viktimash dhe nuk do të ketë nevojë për mobilizim total të burimeve mund të ketë pasojën e paqëllimshme që të zgjatet në kohë, në krahasim kjo me luftërat e të kaluarës, që përfundonin shpejt sepse burimet shteronin.

Nëse një luftë nuk i tendos shoqëritë në një masë të papërballueshme, ato mund të mësojnë të jetojnë me të. Kështu që mund të ndodhë që Lufta e Tretë të jetë një tjetër Luftë Tridhjetëvjecare apo Pesëdhjetëvjecare.

Thënë kjo, gjithmonë do të ekzistojë rreziku që, në një moment, lufta "njerëzore" me intensitet të ulët, me zona mosluftimi të projektuara dhe kode sjelljeje mund të degjenerojë në një gjakderdhje më tradicionale me shumë viktima. As edhe përshkallëzimi drejt luftës bërthamore nuk mund të përjashtohet. Cilidoqoftë rezultati, kjo luftë me siguri do i japë fund botës ashtu si e njohim.ëHuffingtonPostë *Profesor, Universiteti Federal i Lindjes se Largme, Vladivostok, Rusië*

Konflikti i armatosur midis Rusisë dhe NATO-s është i mundur në të ardhmen e afërt, nëse palët nuk kërkojnë kompromis. Për këtë shkruan në Financial Times, profesori i konfliktologisë dhe i marrëdhënieve ndërkombëtare në Universitetin George Mason, Dennis Sandole. Sipas tij, zgjerimi i vazhdueshëm i NATO-s në Lindje dhe planet për të përfshirë Gjeorgjinë dhe Ukrainën në bllok, do ta vënë Rusinë në një rrugë qorre, shkruan portali Webtribune. Për këtë paralajmëron edhe eksperti i Qendrës për hulumtime ushtarako-politike në Moskë, Mihail Aleksandrov, që thotë se gjasat për luftë janë të mëdha, porse njerëzit duhet të gjejnë mënyra për t'u shmangur nga kjo.

"Rusia lehtë mund të futet në Ballkan, duke shkelur Bullgarinë dhe Rumaninë. Është e mundur aleanca me Serbinë që bashkërisht të pushtohet Kosova dhe Mali i Zi. Faktikisht, kështu do ta mbyllnim NATO-n

në gjysmëhark. Pra, kemi gjasa të mira", tha ai, transmeton Telegrafi.

Sipas tij, Rusia ka 10 mijë tanke në Ural dhe se i duhet pak muaj për t'i vënë në gjendje gatishmëria. Ai shton se përderisa NATO mund të ketë një milionë ushtarë, rusët mund t'i kenë 2-3 milionë, mund të mbrohen dhe të godasin cilindo cak në Evropë.

"Rusia kontrollon pjesën më të madhe të resurseve të botës, ka territor të madh dhe ka potencialin më të madh nuklear. Po të ishte dëshira e tillë, do të mund të shkatërronim Evropën dhe SHBA-të. Stalini nuk i kishte këto mundësi, por ne i kemi".

Sipas Kostanin Sokolovit, nënkryetar i Akademisë për ndryshime gjeopolitike, duket ashiqare qëllimi i Perëndimit për ta goditur Rusinë.

"Çështja është vetëm karakteri i luftës", thotë ai, duke shtuar se në luftën e re nuk do të ballafaqohen Rusia e Perëndimi, por shumë grupe sociale.

"Armik nuk është amerikani ose anglezi i rëndomtë, por pronarët e kapitalit të madh financiar. Ata kanë zgjedhur të përçajnë popujt. Oligarkia botërore nuk duhet të mendojë se është e sigurt. Këtë duhet ta kuptojnë banorët e Perëndimit dhe të Rusisë", thotë ai.

5.24.2015

A PO PLAKET POPULLSIA NË KOSOVË

Mosha mesatare e popullsisë në Serbi është 41 vjeç, e cila radhitet në grupin e popujve të vjetër, shkruan "Politika".

Para pesë dekadave, në vitin1961, Serbia me Vojvodinën kishte 6678247 banorë, ndërsa në vitin 2010" > 2010, ka numëruar gjithsejt 7291436 banorë.

Derisa në vitin 2002 në Serbi kanë jetuar 7500031 banorë, 8 vite më vonë , kanë qenë më pak për rreth 200.000, u tha në prezantimin e djeshëm të publikimit "Lëvizja Natyrore e popullsisë në Serbi, 1961- 2010" > 2010", të cilën Enti Statistikor i Republikës së Serbisë publikon për herë të parë.

Sa për ilustrim, po japim disa të dhëna dhe krahasuese sipas vlersimeve të vitit 2010" > 2010. Struktura moshore e popullsisë në Serbi sipas

vlerësimëve është: nga mosha 0-14 vjet: 15,2 % (në Kosovë 27.2 %), nga 15-64 vjet: 68,1 % (në Kosovë 66.1 %). Ndërsa 65 vjeç e më tepër: 16,6 % (në Kosovë 6.7 %).

Kosova ka gjithsej 1466 vendbanime, që shpërndahen në 30 komuna.

Komunat me mbi 70 vendbanime: Gjakovë 88, Pejë 79, Besianë 77, Prizren 77, Dardanë 76, Leposaviq 75 dhe Lypjan 70.

Komunat me 40 - 70 vendbanime: Vushtrri 67, Gjilan 63, Zubin Potok 61, Klinë 54, Burim 50, Skenderaj 49, Prishtinë 49, Mitrovicë 47, Ferizaj 45, Malishevë 44, Viti 43, Kaçanik 42, Therandë 41 dhe Deçan 40.

Komunat me nën 40 vendbanime: Sharr 36, Rahovec 36, Drenas 35, Zveçan 35, Shtime 23, Obiliq 20, Fushë Kosovë 18, Shtërpcë 16 dhe Novobërdë 10.

Përbërja etnike

Regjistrimi i vitit 1981 merret si regjistrim i fundit valid në Kosovë.

Në regjistrimin e popullsisë të vitit 1981 dhe vlerësimit të vitit 1991 Kosova kishte numër të popullsisë prej 1584440 respektivisht 1956196 banorë. Gjatë këtyre dy regjistrimeve Kosova kishte këtë strukturë të përbërjes etnike.

Në mes këtyre dy periudhave të regjistrimit struktura etnike ka pësuar ndryshime si në vijim:

Etniciteti shqiptar, Etniciteti serb, Etniciteti turk, Etniciteti rom, të tjerët kanë pasur një rritje prej 8477 banorë apo 8.4 %. ka pasur rritje për 11619 banorë apo 34 %, ka pasur rënie për 2068 banorë apo 16.5 %, ka

pasur rënie 15608 banorë apo 7.4 %, ka pasur rritje prej 369336 banorë apo 26 %

Regjistrimi i fundit i plotë i popullsisë është bërë në vitit 1981, kur Kosova kishte 1.584.000 banorë. Vlerësime të vitit 2011 numri e popullsisë e vendosin në 1.733.872, ndërsa në burime tjera hasen edhe shifra prej 2.200.000; burime të inteligjencës amerikanë paraqesin vetëm 1804838, sipas vlerësimit më të fundit të korrikut 2009. Mërgimet e kosovarëve gjatë kësaj periudhe, si dhe të rënët gjatë luftës, kanë penguar rritjen e pritshme të popullsisë, me gjithë shtimin natyror prej 12,7 për 1.000 banorë.

{Sipas vlerësimit të vitit 1991, në regjistrimin e bojkotuar atëbotë nga shqiptarët, Kosova kishte 1956196 banorë.

Sipas të dhënave të Entit të Statistikave të Kosovës numri i përgjithshëm i banorëve në Kosovë është 1.733.872 (duke përjashtuar Leposaviqin, Zubin Potokun, Zveçanin dhe pjesën veriore të Mitrovicës).

Numri përfshin regjistrimin në 34 komuna, proces ky i cili është kryer në muajin prill të këtij viti, por që ka hasur në rezistencë në komunat veriore të banuara me shumicë serbe.

Numri i banorëve që jetojnë në Prishtinë është 198214}.

Popullsia e Kosovës përbëhet kryesisht nga komuniteti etnik shqiptar, që sipas burimeve formon 88 deri në 92 për qind të banorëve; sipas vlerësimeve të Entit Statistikor të Kosovës shqiptarët përbëjnë 88% të popullsisë. Serbët janë komuniteti i dytë përkah madhësia

me 5,3 %, të përcjellë nga turqit, boshnjakët, romët, ashkalinjtë, egjiptasit dhe goranët.

Në Kosovë jeton edhe një numër kroatësh dhe çerkezësh, ndërsa pjesëtarë që zyrtarisht i përkasin komunitetit serb kanë kërkuar nga qeveria të njihen si komunitet malazias në vete. Ndërkohë, romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit, që shpesh futen në një tog të njohur si RAE ose tradicionalisht si jevgj, vetidentifikohen si etni të pavarura në baza të dallimeve historike ose kulturore.
Niveli i integrimit të pakicave joserbe në shoqërinë kosovare është në përgjithësi i kënaqshëm. Ndërkohë, përkundër përpjekjeve të qeverisë dhe shoqërisë civile kosovare, integrimi i komunitetit serb po ecën ngadalë për shkak të pengesave të grupeve ekstremiste të sponsorizuara nga qeveria e Serbisë dhe qarqe ultranacionaliste serbe.

Veç shtimit të lartë natyror të sipërcekur, Kosova gëzon një popullatë shumë të re. Mosha mesatare është 25,9 vjeç, 70 % e popullsisë janë nën 30 vjeç, ndërsa 33 % i përkasin moshave 0-14 vjeçare dhe vetëm 6% janë mbi 65 vjeç. Jetëgjatësia mesatare është 69 vjet; femrat jetojnë afro 71 vjet, 4 më shumë se meshkujt. Lindshmëria është 16,3 ‰, ndërsa vdekshmëria 3,6 ‰.

Kosova është vendi me shkallën më të lartë të natalitetit në Evropë. Ndërsa, Kosova ka shimin më të made të popullatës në kontinentin evropian, Italia është vendi ku praktikisht vdekjet nuk po zëvendësohen me lindje të reja.

Zyrtarë të Entit të Statistikave të Kosovës kanë bërë të ditur se numri i përgjithshëm i banorëve në

Kosovë është 1.733.872, duke përjashtuar Leposaviqin, Zubin Potokun, Zveçanin dhe pjesën veriore të Mitrovicës. Numri përfshin regjistrimin në 34 komuna, proces ky i cili është kryer në muajin prill të këtij viti, por që ka hasur në rezistencë në komunat veriore të banuara me shumicë serbe.

Tash për tash nuk ka plane për ta bërë regjistrimin në veri të vendit.

Numri i banorëve që jetojnë në Prishtinë është 198.214. Këto të dhëna janë publikuar sot.

Këto të dhëna, të cilat janë rezultate paraprake, u publikuan në takimin e sotëm që Enti i Statistikave mbajti me gazetarë. Rezultatet përfundimtare do të publikohen vitin e ardhshëm, në periudhën maj - qershor.

Sipas OKB-së, brenda vitit 2010 dhe 2012, popullsia botërore u rrit me 1,2 për qind, ndërsa rritja e natyrshme e vendeve evropiane kryesisht është negative. Një nga shembujt të rënies së natalitetit është Italia, vendi në të cilin është regjistruar shtimi më i vogël natyror që prej themelimit të këtij shteti në vitin 1861.

Lindjet në shumicën e vendeve evropiane janë më pak se dhjetë persona në njëmijë banorë.

Vetëm Kosova ka shënuar rritjen më të madhe vjetore të popullsisë prej 0,9 për qind, ndërsa në vendet e Evropës perëndimore udhëheq Luksemburgu, Mbretëria e Bashkuar, Belgjika dhe Franca.

Në rritjen e popullsisë evropiane mund të ketë ndikim një numër i madh në rritje i emigrantëve të rinj që vijnë në Evropë, në kërkim të një jete më të mirë shkruan Daily Telegraph.

Të dhënat e mëposhtme mbi të cilat është bërë harta vijnë nga Banka Botërore, ndërsa shfaq shkallën e lindjeve në Evropë, dhe vende të tjera të botës, shumë prej të cilave janë dukshëm përpara Evropës.

Ndarjet administrative

Pushteti vendor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga 30 njësi komunale, të përqendruara në qytete dhe qyteza.

Sipas analistit Ismet Azizi, përveç Kroacisë dhe Serbisë, dikur vendet më të populluara të ish-Jugosllavisë, edhe Republika Serbe, krijesa e Dejtonit, po ballafaqohet me rënie të lartë të natalitetit.

Statistikat kombëtare të Republikës së Serbisë dhe Republikës së Kroacisë, vendet me numër më të madh të popullsisë të dala nga e ish-Jugosllavia, nga aspekti nacional edhe më homogjene, tregojnë se të dy vendet po përballen me shkallë shumë serioze negative të rritjes natyrore të popullsisë. Një trend i tillë i lëvizjes së popullsisë, po e ndjek edhe Republikën Serbe.

Nataliteti në Republikën Serbe ka rënë nga viti 2000 deri në vitin 2012 për 30 për qind, ndërsa sipas statistikave, në këtë periudhë në R.Serbe lindin për çdo vit 355 foshnje më pak.

Në vitin 2000 janë lindur 14.250 fëmijë, ndërsa në vitin 2012, viti i fundit për të cilin ka të dhëna, 9970, ndërsa norma e vdekjeve është në rritje, dhe në Republikën Serbe në vitin 2012 kanë vdekur 13.800 persona, shkruan " Press RS".

Demografi Stevo Pashaliq beson se numri i foshnjave mund të rritet duke siguruar shuma të

konsiderueshme të shtesave fëmijërore, ndërsa masat indirekte përfaqësojnë trajtimin e sterilitetit me ndihmën e shtetit, mandej zgjatjen e pushimit të lehonisë dhe duke shpërblyer qiftet financiarisht.

Në Ministrinë e Familjes, Rinisë dhe Sporteve të Republikës Serbe thonë se kanë identifikuar këtë problem dhe në lidhje me të kanë marrë disa masa, por rezultatet e para mund të jetë të dukshme vetëm pas 15 deri 20 viteve pas aplikimit intensiv të tyre.

Demografët vlerësojnë se R. Serbe, në krahasim me të dhënat e para-luftës për numrin e lindjeve, gjatë një viti humb rreth 3,800 banorë, e cila është e barabartë me zhdukjen e një komune të madhësisë së Foqës, Novi Gradit apo Loparës. Demografi Stevo Pashaliq thotë, Republika Serbe shënon një pamje të pafavorshme demografike.

Popullsia po plaket, ne kemi rënie të shkallës së lindshmërisë për vite me radhë, fshatrat mbeten të shkreta, nxënës gjithnjë e më pak në shkolla. Për vetëm katër-pesë vite kemi humbur një brez të plotë të fëmijëve që do të regjistroheshin në shkolla. Në krahasim me periudhën e para 11 viteve, sot ne kemi rreth 30,000 nxënës më pak - tha Pashaliq.

Në Republikën Serbe shtimi është negativ, ndërsa në Federatën e B dhe H është pozitiv.

Bosnja dhe Hercegovina në vitin 2010 ka shënuar rritje negative të popullsisë prej 0.4 për qind, nga kjo Republika Serbe (RS) ka shkallë negative, ndërsa Federata e B dhe H ka shkallë pozitive.

Në Federatën e B dhe H, situata është dukshëm më ndryshe. Sipas vlerësimeve zyrtare, në Federatën e B

dhe H jetojnë rreth 2.3 milionë banorë dhe shënon një rritje të vogël të popullsinë me një normë prej 0.6 për qind (të dhënat nga 2011).

Rritje pozitive natyrore, sipas shifrave të fundit, është shënuar në kantonin e Tuzllës (TK). Kantoni i Sarajevës (KS) disa vjet me radhë ka një trend negativ, ndërsa në Gorazhdë vitin e kaluar është shënuar "mesatarja evropiane", gjegjësisht zero rritjes të numrit të popullsisë.

Shkalla më e lartë e lindjeve në Kosovë

Në krahasim me Serbinë , Kroacinë dhe një pjesë të Bosnjës, Kosova, Malit i Zi dhe Maqedonia, sipas statistikave tregojnë se popullsia e këtyre vendeve është në rritje.

Kosova sipas regjistrimit të fundit të popullsisë ka rreth 1 733 872, dhe sipas të dhënave të fundit zyrtare nga vit 2010, kishte një rritje të popullsisë prej 12 për qind.

Sa për ilustrim, po japim disa të dhëna dhe krahasuese sipas vlerësimeve të vitit 2010.

Struktura moshave të popullsisë në Serbi sipas vlerësimeve është: nga mosha 0-14 vjet : 15,2 për qind (në Kosovë 27.2 për qind), nga 15-64 vjet : 68,1 për qind (në Kosovë 66.1për qind). Ndërsa 65 vjeç e më tepër: 16,6 për qind (në Kosovë 6.7 për qind)

2.16.2015

MONUMENTI KULTUROR I MILOSHEVIQIT

(Kisha serbe në oborr të Universitetit të Prishtinës)

Fati i një kishe jo të përfunduar serbe në qendër të Prishtinës, e cila nuk është përdorur kurrë, është bërë përsëri një temë e debatit ndërsa kryekomunari Shpend Ahmeti po bën fushatë për të ndaluar ndërtimin e paligjshëm.

Ahmeti, i cili u zotua se do të ndalonte ndërtimet "e egra" që janë kthyer në një problem të madh në qytet pasia i mori këtë detyrë në vitin 2013, thotë se fati i kishës "Sveti Spas" ("Krishti Shpëtimtari") duhet të vendoset bashkë me fatin e ndërtimeve të tjera të paligjshme.

Drejtor i Urbanizmit në Komunën e Prishtinës, Liburn Aliu ka paralajmëruar se Kisha Ortodokse serbe

"Shën Nikolla" që gjendet në kampusin e Universitetit të Prishtinës, duhet t'i nënshtrohet procesit të legalizimit që të mos rrënohet.

Ai në një konferencë për media tha se, deri më tani askush nuk ka aplikuar për legalizim.

"Në bazë të dokumentacioneve tona ajo pjesë është pa leje dhe nëse nuk aplikon askush për legalizim deri në qershor, rrjedhimisht nuk do të trajtohet në periudhën për legalizim, do të hyjë në listën e rrënimit", ka deklaruar ai.

Në një emision të Radio Kosovës, kryeministri Hashim Thaçi, i pyetur për objektin e ngritur pa leje të kishës ortodokse serbe në ambientet e Universitetit të Prishtinës, e ka quajtur atë një vepër të shëmtuar.

Ai ka thënë se kjo kishë në fakt është monument i Sllobodan Millosheviqit.

Por kur është pyetur se cili duhet të jetë fati i saj, kryeministri ka dhënë një përgjigje diplomatike: "Kemi punë më të mëdha për të bërë, por do t'i vijë radha edhe asaj", është shprehur ai.

Kisha ortodokse serbe u ndërtua ë truallin e Universitetit të Prishtinës në vitet e '90-ta, në rrethana të pushtimit klasik të Kosovës nga Serbia.

Universiteti i Prishtinës ka paditur në shtator të vitit 2012 Kishën Ortodokse Serbe "Sveti Nikolla" në Prishtinë me pretendimin se kjo kishë është ndërtuar në hapësirën e cila i takon këtij universiteti dhe se kështu ajo në mënyrë jo-legjitime ka ndërhyrë në sistemin kadastral duke uzurpuar një sipërfaqe të përgjithshme prej 4.27 hektarë.

BIRN ka parë se lënda i është caktuar një gjyqtari në Gjykatën Themelore në Prishtinë, por ende nuk ka shqyrtim të kësaj lënde.

Nuhi Paçarizi, përfaqësues ligjor i Universitetit të Prishtinës, thotë se janë disa pika kyçe në të cilat mbështet bazën ligjore një padi e tillë.

Ndër to potencohet vendimi i marrë më 12 Dhjetor 1975 kur Kuvendi i Komunës së Prishtinës kishte miratuar Planin Detal Urbanistik të Qendrës Universitare në Prishtinë dhe kishte përcaktuar kufijtë e këtij plani.
Sipas këtij vendimi kufinjtë e tokës ndërtimore të përcaktuar për UP-në janë: nga lindja ish-rruga "Ramiz Sadiku", nga perëndimi ish-rruga "M. Tito", nga veriu kompleksi banues dhe nga jugu ish-rruga "Sremi".

"Ne fillimisht kemi kërkuar nga kadastra gjithë dokumentacionin, por për fat të keq kemi gjetur shumë pak, sepse dokumentacioni gjendet në Serbi, por atë çfarë kemi gjetur ia kemi bashkangjitur padisë", thotë avokati Paçarizi për Gazetën Jeta në Kosovë.

Padia thekson se si rezultat i suprimimit kundër kushtetues të Autonomisë së ish-Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, autoritetet shtetërore të Republikës së Serbisë pushtuan tërë infrastrukturën e administratës publike.

Nga kjo pasoi largimi me dhunë i organeve drejtuese, stafit akademik e studentëve në Universitetin e Prishtinës, vazhdon padia, duke nënvizuar se ky është një fakt i njohur publik .

"Kisha Ortodokse Serbe pas viteve 1992-93 duke i shfrytëzuar këto rrethana në mënyrë të kundërligjshme e arbitrare ka ndërtuar një tempull fetar në pronën e UP-

së duke uzurpuar një sipërfaqe e destinuar për objekt dhe oborr", shkruhet në padinë e UP-së.

Në pjesën finale të padisë, UP ka kërkuar nga Gjykata Themelore e Prishtinës që të vërtetohet se UP-ja është pronarja e vetme e ngastrës në të cilën është ndërtuar kjo kishë dhe t'i dorëzohet në posedim duke e kthyer në gjendjen e mëparshme.

Njëri nga përfaqësuesit e Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë, Igumani i Manastirit të Deçanit Sava Janjiq, i tha Gazetës Jeta në Kosovë se nuk kanë marrë njoftim zyrtar që UP-ja ka ngritur padi kundër kishës ortodokse dhe se një gjë të tillë e kanë mësuar vetëm nëpërmjet të mediave.

Megjithatë Igumeni Sava Janjiç tha se avokati i tyre bashkë me përfaqësuesit e OSBE-së dhe përfaqësuesit tjerë ndërkombëtarë kanë analizuar këtë dokumentacion.

"Kisha jonë në Kosovë është e gatshme të respektojë çdo vendim që do merret nga gjykata, por është e rëndësishme që gjykata të marrë në konsideratë të gjitha informatat relevante dhe dokumentacionin që ne posedojmë", tha Janjiq.

I pyetur nëse e konsideron korrekt faktin që një kishë është ndërtuar në mes të kampusit të një universiteti, Igumani Sava Janjiç thotë se kjo nuk paraqet ndonjë problem.

"Ekzistojnë dhjetëra universitete në mes të të cilave gjendet ndonjë kishë a faltore. Përderisa kjo ekziston në Europë nuk e di pse të mos mund të ekzistojë edhe në Kosovë", thotë Janjiq.

Gazeta ka kontaktuar dhe Nikola Gaon zëdhënës i OSBE-së për të komentuar këtë çështje mirëpo ai nuk ka pranuar të deklarohet meqë lënda është në vazhdim e sipër dhe se dhënia e deklaratave në këtë moment do të ishte e papërshtatshme.

Lidhur me këtë lëndë të ndjeshme, ka folur Artan Qerkini jurist i specializuar për çështje pronësore, i cili nuk është i involvuar në këtë proces.

Avokati Qerkini konsideron se një padi e tillë ka një bazë të shëndoshë juridike dhe se i plotëson të gjitha kushtet ligjore që gjykata të marrë vendim që t'ia njeh UP-së pronësinë mbi atë pjesë të tokës.

Ai argumenton se në bazë të rregullores së UNMIK-ut 1999ë24 të gjitha ligjet që janë nxjerrë pas 23 marsit të vitit 1989 e të cilat kanë pasur karakter diskriminues janë të pazbatueshme në Kosovë.

Sipas Qerkinit të pazbatueshme janë edhe të gjitha vendimet që janë produkt i atyre ligjeve e posaçërisht produktet e Ligjit mbi veprimin e Organeve Republikane në Rrethana të Posaçme i nxjerrë në vitin 1990 nga ana e Kuvendit të Serbisë.

"Para tjetërsimit prona ka qenë e Universitetit të Prishtinës. Organet e UP-së të cilat kanë vendosur ta bëjnë tjetërsimin e pronës nuk kanë qenë organe legjitime të cilat kanë pasur mundësi të marrin vendim të tillë sepse kanë vepruar në bazë të ligjeve diskriminuese."- thotë Qerkini për Gazetën Jeta në Kosovë.

Kisha e papërfunduar Ortodokse e rrethuar nga fakultetet e ndryshme të UP-së dhe nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës, nga popullsia shqiptare

perceptohet si ilegale sepse ishte ndërtuar në kohën kur Kosova ishte nën masa të dhunshme dhe me autonomi të suprimuar nga Beogradi.

Në periudhën e pasluftës në një rast është tentuar dëmtimi i kësaj kishe me bombë dore prej sulmuesve të panjohur.

Më vonë ajo u vendos nën mbrojtjen e paqeruajtësve të NATO-s për disa vite rresht.

Së fundi është diskutuar jo formalisht nga politikanë e figura tjera publike për këtë kishë dhe një nga propozimet ka qenë edhe mundësia e shndërrimit të saj në Muze Memorial të vuajtjeve të popullit të Kosovës.
Konstruktimi i Kishës ortodokse serbe "Shën Nikolla" ka filluar në vitin 1995, por ndërtimi i saj është ndërprerë gjatë luftës në vitin 1999.

Ai në një konferencë për media tha se, deri më tani askush nuk ka aplikuar për legalizim.

"Në bazë të dokumentacioneve tona ajo pjesë është pa leje dhe nëse nuk aplikon askush për legalizim deri në qershor, rrjedhimisht nuk do të trajtohet në periudhën për legalizim, do të hyjë në listën e rrënimit", ka deklaruar ai.

Qëndrimi i komunës është se "ky objekt do të trajtohet në të njëjtën mënyrë, sipas ligjit për legalizimin".
Ferid Agani, ministri i Kosovës për Mjedisin dhe Planifikimin, thotë se çështja e fatit të kishës po diskutohet nga një komision i posaçëm, "një bord mbikëqyrës për zbatimin dhe monitorimin, që përfshin edhe përfaqësues të Kosovës dhe BE-së".

Agani thotë se është një çështje e ndjeshme dhe "se duhet të trajtohet me kujdes, për të parandaluar tensione të mëtejshme mes serbëve dhe kosovarëve".

Çështja do të diskutohet më 9 shkurt nga ana e komisionit, i udhëhequr nga ai dhe Përfaqësuesi Special i BE-së Samuel Zbogar, vuri në dukje ai.

Opsionet përfshijnë legalizimin e planimetrisë për kishën, ndërtimi i të cilës filloi në territorin e Universitetit të Prishtinës në vitet 1994-1995 dhe u ndal në vitin 1999, kur konflikti në Kosovë u përshkallëzua. Mundësia tjetër do të ishte që kisha të shënohet në një listë objektesh që duhen shembur, nëse nuk paraqitet dokumentacioni i nevojshëm.

Kjo çështje ka ndezur debate mes dy grupeve kryesore etnike të Kosovës, duke qenë se pjesa më e madhe e popullsisë shqipëtare në vend e lidhin atë ndërtesë me regjimin e urryer të Sllobodan Millosheviçit. Që kisha të legalizohez, Kisha Ortodokse Serbe duhet të paraqesë një kërkesë për legalizim të shoqëruar me dokumentet që vërtetojnë se ajo ka marrë lejen e Universitetit të Prishtinës, duke qenë se terreni i takon universitetit.

Dioqeza Ortodokse e Rashka-Prizren pretendon ajo ka dokumentacionin e plotë për ndërtimin e kishës. Megjithatë, universiteti paraqiti kërkesë kundër Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë në vitin 2012, duke e akuzuar kishën se ka marrë në mënyrë të paligjshme mbi rreth 4 hektarë tokë që i takojnë universitetit.

Gjatë epokës së Jugosllavisë, universiteti ishte një institucion dy gjuhësh, duke ushqyer si nevojat e shqiptarëve ashtu edhe të serbëve. Megjithatë, nën

regjimin e Millosheviçit në vitet 1990, shqiptarët u nxorën me dhunë nga universiteti dhe mësimet mbaheshin vetëm në gjuhën serbe.

Që prej ndërhyrjes ushtarake të NATO-s në vitin 1999 dhe eksodin e mëvonshëm të pjesës më të madhe të serbëve nga Prishtina, universiteti ka funksionuar vetëm në gjuhën shqipe, ndërsa fakultetet në gjuhën serbe janë transferuar në gjysmën veriore të qytetit të Mitrovicës në Kosovë.

2.11.2015

BALLKANI, SERA EUROPIANE E DROGËS

Mali i Zi: 12.5 mln euro vlen 250 kg. kokainë që vinte nga Ekuadori në Shqipëri

Sasia e konsiderueshme e kokainës u sekuestruan sot në portin e Barit në Malin e Zi. Autoritetet saktësojnë se bëhet fjalë për substancë "jashtëzakonisht të pastër".

Autoritetet doganorë të Malit të Zi kapën 250 kilogramë kokainë që sipas të dhënave fillestare ishte nisur nga Ekuadori e fshehur në një ngarkesë bananesh që do të shpërndahej në Shqipëri.

Fillimisht "Preshevajonë" ishte agjencia e lajmeve që raportoi se policia malazeze e Portit në Bar ka konfiskuar sot sasinë e drogës të fshehur në banane.

Droga është gjetur në një nga tre kontejnerët që vinte në Shqipëri nga Ekuadori.

Sasia e madhe e kokainës është zbuluar përmes skanerit, ku oficerët e policisë doganore kanë zbuluar kokainën, e ndarë në 223 paketa, raportoi "preshevajonë". Vlera e llogaritur e shitjes së drogës arrin deri në 12.5 milionë Euro.

Vëmendje ky lajm ka marrë dhe nga gjermania "Bild", që shkruan se kjo është sasia më e madhe e drogës e kapur ndonjëherë në Malin e Zi.

Të njejtat burime saktësojnë se bëhet fjalë për substancë "jashtëzakonisht të pastër".

Për sasinë më të madhe të kokainës së pastër, të kapur në historinë e Malit të Zi, siç shkruajnë mediat malazeze ka folur edhe Drejtori i Autoritetit të Doganave, Vladan Jokoviç.

Ai tha se kontenieri është dërguar nga kompania "Vimticorp SA", nga Ekuadori, ndërsa marrësi ishte kompania shqiptare "Rrapo", shkruan "Vijesti".

Sipas zotit Jokoviç, droga u zbulua në një kontroll rutinë nga zyrtarët e Departamentit të Luftës Kundër Kontrabandës.

Sipas regjistrit zyrtar të Shqipërisë, "Rrapo" është një kompani e regjistruar në mars të vitit 2013 nga Nazike Rrapi.

Kompania u krijua për të importuar fruta dhe sipas regjistrit kjo është dërgesa e saj të parë.

Ajo që dihet është se bananet kishin si destinacion Shqipërinë, ndërsa ende nuk saktësohet se ku do të shpërndahej kokaina e pastër pasi të mbërrinte në Shqipëri

Deputeti demokrat Tritan Shehu ka deklaruar se po kryhen fluturime-fotografime të aviacionit ushtarak

italian mbi vendin tonë. Përmes një postimi në rrjetet sociale, Shehu shkruan se fluturimi i mjeteve ushatarake po bëhet për përcaktimin e zonave të mbjella me kanabis.
"Prej dy ditësh po kryhen fluturime-fotografime të aviacionit ushtarak italian mbi vendin tonë, për përcaktimin e zonave të mbjella me CANABIS.

Një zhvillim pozitiv, për tu përshendetur ky, në sajë të mbështetjes së Italisë në luftën tonë me krimin e trafiqet", shprehet Shehu.

Deputeti demokrat thekson se fluturimet fotografuese duhet të kryhen jo vetëm në zonat e rekomanduara nga policia shqiptare. Sipas Tritan Shehut, vendi është mbushur si kurrë më parë me sipërfaqe kanabisi. "Por që ky operacion të tregojë realitetin para opinionit, që të dhënat e tij të shërbejnë më tej për hapa konkrete në shkatërrimin e sipërfaqeve të mbjellla e goditjen e grupeve kriminale përgjegjese duhet:
– fluturimet fotografuese të zhvillohen jo vetem mbi zona të rekomanduara nga policia jonë, por shumë më gjërë bazuar kjo dhe mbi një mori informacionesh të tjera.
Një gjë është e qartë, vendi është mbushur si kurrë më parë me sipërfaqe të mbjella me Canabis.
– të dhënat nga fotografimet ajrore duhet që direkt nga partnerët italianë të vihen në dispozicion edhe të komisionit të sigurisë së kuvendit, për t'u bërë më tej transparente këto për opinionin." vijon më tej postimin deputeti demokrat.

Shehu sugjeron se duhet krijuar një grup ndërkombëtar ekspertësh për të përdorur rezultatet nga këto fluturime, në mënyrë që të bëhet koordinimi për shkatërrimin e drogës. "Deri ketu është faza e

identifikimit të drogës, më tej duhet të ndërmirren hapa konkrete e energjike për shkatërrimin e saj, ndryshe do të thotë të "rrahësh ujë në havan".
– për të pasur rezultate reale duhet që krahas përpunimit të të dhënave të fluturimeve nga strukturat italiane, të krijohet sa më parë një grup ndërkombëtar ekspertësh, psh me pjesëmarje italiane, amerikane, gjermane, greke etj, për t'i përdorur ato e koordinuar hapat e mëtejshme të shkatërrimit të drogës e luftës me krimin.

Kjo është e vetmja mënyrë për të minimizuar këtë rrezik të madh, që i kanoset vendit tonë, të rinjve tanë, të ardhmes sonë.

Ky kultivim masiv i canabisit është me pasoja shkatërruese jo vetem prej përdorimit të asaj droge, por dhe për kanosjen që i sjell në tërësi vendit e demokracisë forcimi e dominimi i krimit i lidhur me atë", përfundon deputeti demokrat Tritan Shehu.

Brenda Lazaratit, aty ku nuk ka këmbë polici

Lazarati është emër shumë i njohur në Shqipëri. Gjatë diktaturës njihej si fshat ballist, në demokraci si bastion i Partisë Demokratike dhe vitet e fundit si qendër e kultivimit të lëndëve narkotike.

Të gjitha këto janë të diskutueshme, por ka një fakt të pakundërshtueshëm, që do të mjaftonte për t'a bërë Lazaratin të famshëm, madhësia e tij. Me 5200 banorë dhe rreth 2000 emigrantë është fshati më i madh në Shqipëri.

Adrian Ll., lindur në Elbasan, prej tre muajsh është i punësuar në platacionet e hashashit në Lazarat, fshati që ndodhet vetëm 5 km larg qytetit të Gjirokastrës.

Ende pa lindur dielli, Adriani e gjen tek sheshi "Omonia" për të kapur furgonin e linjës Lazarat-Gjirokastër.

"Në Lazarat ka punë për të gjithë, mjafton të kesh krahë dhe dëshirë për të fituar lekë", pohon Adriani. Adriani thekson se sivjet hashashi është i mbarë. Puna është me normë, por edhe fitimi është i mirë.

"Ke fuqi të punosh gjithë ditën, askush nuk të ndalon", vijon Adriani. Sipas tij, gushti është muaji i procesit vendimtar të prodhimit të hashashit. "Lënda narkotike në Lazarat, thotë Adriani, është cilësor. Sivjet pritet prodhim i madh".

"Në pjesën perëndimore të fshatit janë mbjellë me mijëra bimë. Deri tani hashashi është dymetrosh, ndërsa në shtator pritet të korret", thekson Adriani, djali i vetëm i pesë motrave.

Adriani saktëson se çdo ditë nxjerrë 3 mijë lekë të reja, afro 80 mijë lekë në muaj. "Nuk ka ditë pushimi në këtë kohë. Vetëm të jesh budalla të mos punosh", specifikon Adriani, i cili shton se gjysmat e lekëve që nxjerrë në Lazarat i dërgon në shtëpi.

Adriani thotë se në Lazarat janë të punësuar mbi 700 persona, pjesa dërmuese janë nga Shqipëria e Mesme. "Lazarati është hambar për të gjithë ata që duan punë. Lekët i merr çdo ditë. Prodhuesit janë njerëz të mirë. Ata interesohen për gjithçka, por nuk të falin nëqoftëse i tradhëton", nënvizon Adriani.

Adriani tregon se çdo person që hyn në Lazarat është i monitoruar nga një grup njerëzish. "Të gjithë janë të "skeduar". Personat e padëshirueshëm identifikohen në kohë dhe dëbohen me forcë nga fshati Lazarat. Ka pasur

raste që "të padëshiruarit" janë larguar me dajak ose me kërcënimin e kallashnikovit", thotë Adriani.

Për herë të parë një ekip xhirimi i Deutsche Welle-s sjell pamje ekskluzive nga fshati i Lazaratit, i cilësuar si fshati i drogës. Gazetarët e DW biseduan me disa lazaratas dhe sollën këtë reportazh.

Një erë e rëndë të pret sapo hyn në fshatin e Lazaratit. Është era e mariuanës. Në fshatin në malet në jug të Shqipërisë, kultivohet droga shumë e kërkuar. Thuajse të gjithë këtu jetojnë prej saj, ndonëse edhe në Shqipëri kultivimi privat i mariuanës është i paligjshëm.
Zakonisht banorët e fshatit nuk pranojnë të flasin me të huajt. Ne jemi i pari ekip xhirimi që mund të shohë çfarë bëhet këtu, i pari qëkurse në fshat praktikohet kjo bujqësi e veçantë. Jemi miq tek një familje që tashmë prej dhjetë vjetësh merret me kultivimin e mariuanës. Kjo familje prodhon çdo vit rreth 1000 kilogramë mariuanë. Një biznes fitimprurës ky, por familja nuk ka dëshirë të flasë për shifra. Sidoqoftë nga vjelëset ne mësojmë se kjo punë ia vlen: ato fitojnë gjashtë herë më shumë nga sa mund të merrnin për punë të tjera. Çmimi për një kilogram mariuanë është rreth 300 euro.

Shpjegimet për pyetjen, se si është e mundur që mund të kultivojnë drogë pa pengesë në Lazarat, janë të pakta. Por sipas kultivuesve të mariuanës në Lazarat kjo është një mënyrë për të mbijetuar në fshatin me popullsi të madhe dhe pa perspektivë.

Autoritete të pafuqishme?

Sot Lazarati gëzon një status të veçantë. Deri tani nuk ka pasur asnjë arrestim, ligji dhe drejtësia këtu nuk vlejnë, na thonë banorët. Kontrolle policie ka vetëm në

fshatrat fqinjë. Katër tonë mariuanë u sekuestruan vitin e kaluar, një pjesë e papërfillshme në krahasim me sasinë që kontrabandohet në drejtim të Evropës. Një nga të intervistuarit tanë mendon se e di përse autoritetet nuk i japin fund situatës në Lazarat: Sipas tij ata e tolerojnë kontrabandën, sepse pas saj qëndrojnë kontrabandistë të fuqishëm droge nga Italia, Greqia dhe Gjermania. Disa të dhëna flasin për teorinë e tij: fshatarët në Lazarat e marrin farën për bimët e mariuanës ekskluzivisht nga Italia. Për të parë se sa është fitimi i mafies në këtë biznes, hetues fiskalë italianë kanë fluturuar me avionë matës mbi plantacionet e Lazaratit.

Biznes fitimprurës

Përmasat e biznesit të mafies: 900 tonë mariuanë prodhojnë fshatarët në Lazarat çdo vit. Vlera e përllogaritur e tregut: 4,5 miliardë euro. Sipas zërave që qarkullojnë në Shqipëri edhe disa politikanë të nivelit të lartë me gjasë përfitojnë nga tregtia e drogës, hotelet luksoze në bregdet janë në pjesën më të madhe objekte për larje parash dhe një raport i shërbimit të fshehtë për lidhjet e bosëve të mafies me politikanët mbahet prej tre vjetësh i mbyllur.

Gazetarët e huaj

Kohë më parë, tre gazetarë investigativë, dy shqiptar dhe një francez, u kërcënuan me vdekje, pasi ata tentuan të filmonin fshatin Lazarat. Jeta e tyre u vu në rrezik, ku një automjet tip “Ford”, me targa “Lazarat” u zuri rrugën. Jeta e tyre përpak sa nuk përfundoi tragjikisht. Fatmirësisht pa viktima.

Gjatë investigimit treditor, gazetarët konstatuan një organizim të përsosur të "vijës së gjelbërt". "Vetë shteti shqiptar do ta kishte zili këtë organizim të përkryer. Ata dinë të ruajnë kufinjtë e Lazaratit, më mirë se Policia e Shtetit", tregon Camille Le Pomellec, gazetari francez. Camille thotë se hashashi i Lazaratit tashmë është bërë i njohur në mbarë Europën për cilësinë e saj.

"Nuk ka të krahasur hashashi i Lazaratit. Shumë konsumatorë europianë janë gati ta paguajnë si "frëngu pulën" këtë lëndë narkotike", specifikon Camille. Sipas tij, shteti është dorëzuar pa kushte përpara Lazaratit. Në fakt, deklarata e tij, u vërtetua dy ditë më parë nga drejtuesit e lartë të policisë së shtetit.

Tregtia dhe fitimi

Plot 4.5 miliardë euro kushton tregëtia e hashashit, prodhuar nga Lazarati. Stefano Bastoni, drejtori i Repartit të Aviacionit të "Guardia di Finanza", e cilëson marramendëse vlerën, por banorët e fshatit mendojnë të kundërtën.

"4.5 miliard euro? Shumëëëë! Nuk them që "dhelprën ta lëjmë pa bisht", por të paktën të ulin vlerën, pasi ne nuk konkurrojmë shtetit", shprehet me humor R. A., banor i fshatit Lazarat, i cili preferoi të ngelet anonim. R. A, është një kultivues i bimës narkotike. Ai thotë se sivjet prodhimi dhe fitimi parashikohet të dyfishohet. Shkak u bënë zgjedhjet parlamentare.

"Një vit më parë policinë e kishin nëpërkëmbë. Sivjet u zhdukën, nuk u shfaqën fare", shprehet kultivuesi. "Unë nuk jam një person i dhunshëm. Thjesht dua të jetoj

pa vështirësi financiare. Prodhimin tim do ta mbroj si sytë e ballit", shton R. A.

Kryetari i Partisë Demokratike Lulzim Basha ka publikuar një hartë në lidhje me zonat e kultivimit të drogës në Shqipëri.

Basha ka publikuar pamjet e hartës së Shqipërisë së vitit 2013 dhe 2015, ku sipas tij, dy vite më parë si zona ku mbillej lënda narkotike mbillej në një zonë në Malësinë e Madhe,

Lazarati dhe Lumi i Vjosës.

Ndërsa në 2015, sipas hartës së publikuar nga Basha, rezulton se droga mbillet në cdo zonë të vendit

Corriere Della Sera:

Shqipëria, sera europiane e drogës

"Metastazat e drogës kanë pushtuar të gjithë vendin. Trafikantët nuk arrestohen në Shqipëri"

Shqipëria është sera europiane e drogës, kështu titullohet reportazhi më i fundit i italianes "Corriere della sera", e cila publikon shifrat për drogën "Made in Albania".

42 misionet përtej kufirit të policisë italiane që nga janari i këtij viti, kanë zbuluar 753 mijë bimë marijuanë në një territor prej 213 mijë hektarësh.

Kështu nis reportazhi i italianes "Corriere della sera" për Shqipërinë ku vendi ynë cilësohet si sera europiane e drogës.

Duke u kthyer në gushtin e 2004-ës, reportazhi tregon se si trafikantët – padronë të fshatit Lazarat shihnin të vinte një helikopter i policisë italiane, 400 metra mbi tokë, për të vëzhguar plantacionet e marijuanës. Sapo u afrua drejt tij u qëllua me

kallashnikov. Në bord ndodheshin dy hetues, një marshall i guardia di finanza dhe një zyrtar shqiptar i antidrogës. Për meritë të pilotit asnjë nuk u plagos, dhe pse plumbat qëlluan serbatorin kryesor, po helikopteri arriti të kthehej në bazë, që atëherë lartësitë kanë ndryshuar, por dhe gjeografia, mjetet, njerëzit dhe mënyrat e ofensivës. Teknikat e hetimit dhe në të njëjtën kohë niveli i trafikantëve. Por jo thelbi: Shqipëria është sera europiane e marijuanës.

Sipas marrëveshjes Itali – Shqipëri, avioni i Guardia di Finanza, nëj model i vjetër por i besueshëm Piaggio, fluturon çdo vit për të monitoruar 20 për qind të territorit, përjashto qytetet, malet dhe lumenjtë. Që nga muaji janar janë bërë vëzhgime në 213 mijë hektarë të mbuluar nga plantacionet. Avioni i cili fluturon në periudhën qershor – shtator, që është dhe periudha e rritjes së bimëve, nuk kalon më mbi Lazarat ku dy vjet më parë ndërhynë forcat e policisë për ta marër nën kontroll pas 20 ditësh betejë.

Metastaza tashmë ka pushtuar të gjithë vendin. Nga muaji janar i këtij viti në 42 misione janë zbuluar 753 mijë bimë marijuanë. Kudo. Duke llogaritur se një nga këto bimë prodhon mesatarisht dy kilogramë e gjysëm drogë, por ndonjëherë dhe dyfishin, llogaritet se vlera e saj është rreth 1300 euro për kilogramë. Kjo do të thotë se në treg ato bimë, që u shkatërruan nga policia e Tiranës do të kishin nxjerrë një fitim prej më shumë se 2 miliard eurosh. Pothuajse një të katërtën e prodhimit të brendshëm bruto të Shqipërisë.

Por ky nuk është momenti për të fajësuar një popull të tërë. Edhe pse me një përpjekje të vagët e që

përqendrohet në temën e drogës duke provokuar tensione, politikanët shqiptarë po lëvizin, përpiqen. Por nuk mund të lihet mënjanë përpjekja e madhe e guardia di finanza, në mënyrë të vecantë I grupit të misionit në Shqipëri nën drejtimin e kolonelit Joselito Minuto. Përkundrazi, vetëm në tre vitet e fundit, avioni Piaggio ka monitoruar 600 mijë hektarë territor dhe është rinovuar herë pas here për të mos humbur ritimin e trafikantëve. Këta të fundit kanë zgjedhur të nisen nga ishujt grekë për të qenë brenda Bashkimit Europian, duke pasur një rrjet të gjerë mbrojtjeje sidomos në Puglia, duke u bërë pasardhës të denjë të skafistëve të viteve '90, por më të mirë teknologjikisht, më të guximshëm, aventurierë që nuk kanë frikë të udhëtojnë dhe kur në Adriatik ka stuhi. Por fitimet që marrin nga kjo veprimtari në fund e justifikojnë këtë rrezik. Kërkesat për marijuanë janë të vazhdueshme dhe në rritje, e klanet reagojnë menjëgerë. Më pas në këto gomone, transportohen kokainë dhe armë por dhe muxhahedinë që bëjnë vajtje – ardhje për luftën e shenjtë në Lindjen e Mesme.

Avioni italian i monitorimit është i pajisur me sensorë që gjurmojnë territorin. Të dhënat që merren përpunohen në fakultetin e Arkitekturës së Universitetit të Studimeve në Napoli. Në këtë laborator teknikët dhe eksperti personal i financës lexojnë rezultatët e sensorëve. Lëvizja e rradhës ka të bëjë me shpejtësinë e reagimit. Brenda 48 orësh bimët shkatërrohen në mënyrë që të identifikohen dhe kriminelët që menaxhojnë këto plantacione. Piaggio, fluturon një mijë metra lart në një distancë të domosdoshme sigurie. Por në aparatin shqiptar ka raste korrupsioni. Pagat e agjentëve të

policisë janë të vogla, dhe pavarësisht ndjenjës për të nderuar uniformën dhe respektit për veten ka nga ata që janë blerë nga trafikantët. Trafikantë të pushtetshëm, mafiozë, të pasur dhe me njohje të rëndësishme.

Një nga hetuesit shprehet se problemi i marijuanës nuk ka pasur një rritje të papritur, por ka ekzistuar gjithnjë. Por është përmirësuar ndërgjegjësimi për këtë problem. Por tashmë është më e fortë dhe vetëdija se arrestimi i fshatarëve që kujdesen për plantacionet apo shoferëve të furgonëve që cojnë drogën tek gomonet, nuk mjafton. Duhen zbuluar drejtuesit e organizatave. Dhe në këtë rast krerët e këtyre prganizatave bëjnë vajtje – ardhje nga Shqipëria në Itali, kthehen atje dhe fshihen kur e shohin se situata është e trazuar dhe rrezikojnë arrestimin. Për cfarë arsye? Ndodh që një urdhër arresti i lëshuar nga autoritetet italiane, në Shqipëri nuk ekzekutohet dhe të kërkuarit në mënyrë të pabesueshme arratisen, dhe më pas zhduken. Ata mbrohen nga klanet, nga terrori, nga kërcënimet ndaj më të varfërve që detyrohen t'i fshehin edhe në shtëpitë e tyre madje, dhe më pas të heshtin. Dhe ai që refuzon, kërcënohet se do i vrasin një të afërm. Por ka një shifër: me 400 mijë euro një i arratisur arrin të jetojë i qetë dhe larg prangave. Çmimi i një kilogrami marijuana në Puglia është 1300 euro, nëse shitet në veri të Italisë, ky cmim rritet shkon në 1800 euro.

***

OKB: Fitimet nga droga në Shqipëri 340 milionë USD në vit, sa 2.6% e PBB-së.

Raporti i Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC), për vitin 2016, e rendit Shqipërinë një një ndër vendet kryesore të prodhimit të kanabisit në botë.

Raporti u referohet të dhënave të vitit 2014, si të dhënat e fundit zyrtare, sipas të cilave, në Shqipëri në atë vit u prodhuan 540 ton drogë dhe u zbuluan 551.414 bimë. Raporti nuk ka të dhëna mbi sipërfaqen reale të kultivuar. UNODC thotë se Shqipëria, Kolumbia, Xhamajka, Holanda dhe Paraguaji janë vende –burime të rëndësishme të kanabisit të shitur në tregjet ndërkombëtare [Reports by Member States over the period 2009-2014 indicate that Albania, Colombia, Jamaica, the Netherlands and Paraguay are important source countries of the cannabis herb sold in international markets].

Shqipëria zë vend kryesor në raportin e UNODC edhe përsa u përket fitimeve vjetore nga tregtia e paligjshme e drogave. UNODC thotë se kjo tregti zë 2.6 % të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), pra të sasi që prodhon ekonomia shqiptare në një vit.

Në raport thuhet se fitimi nga trafiku i drogës në Shqipëri është më i lartë se ato në vendet e zhvilluara, në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto. Në vendet e zhvilluara fitimet luhaten nga 0.07 – 0.19 % të PBB, ndërsa në vendet me PBB të vogël si Shqipëria (2.6 %), Irani (1.66 %) dhe Bullgaria (1.22 %), fitimet janë më të larta. [However, profits from the illicit opiate trade in those countries accounted for a significantly smaller proportion of GDP (0.07-0.19 per cent) than in countries with a relatively small GDP, such as Albania (2.60 per cent

of GDP), Iran (Islamic Republic of) (1.66 per cent) and Bulgaria (1.22 per cent) PBB e Shqipërisë është rreth 13 miliardë USD në vit. Fitimi nga drogat përllogaritet në rreth 340 milionë USD në vit. Revista Monitor, përllogarit se kjo është shuma vjetore e valutës që hyn në Shqipëri në një vit, ndërsa mënyra e përdorimit të tyre (si pastrohen këto para) është e panjohur. "Ky burim i paligjshëm hyrjesh valutore shpjegon edhe arsyen pse monedha vendase është e fortë në tregun e këmbimeve valutore, pavarësisht se vendi ka një deficit ndër më të lartit në rajon të llogarisë korente -diferencës së valutës që hyn dhe asaj që del- prej mbi 11% të PBB-së", shkruan ajo.
Raporti i UNODC thekson se fitimet nga tregtia e ligjshme e drogave përbëjnë nxitës të konsiderueshëm financiarë për grupet e rganizuara kriminale.

Një studim i fundi i UNODC zbuloi se të ardhurat e drogave të kontrabanduara nga Ballkani drejt Europës janë rreth 28 miliardë dollarë në vit. Pothuajse gjysma e këtyre fitimeve u gjeneruan në katër shtete europiane, që janë tregu më i madh ilegal për drogat: Franca, Gjermania, Italia dhe Mbretëria e Bashkuar.

UNODC: Pastrimi i parave të drogës

Në raportin e UNODC thuhet se pastrimi i parave kryhet me mënyra të ndyshme, nga përdorimi i teknikave të vogla të centralizuara, që përfshijnë dërgesat e parave apo remitancat, deri tek përdorimi i sofistikuar i bizneseve mbështetës; në të gjitha rastet, gjithësesi, të ardhurat nga trafiku i paligjshëm i drogës riqarkullohen përmes mjeteve të ligjshme.

Në shumë raste, këto të ardhura të paligjshme mund të injektojnë sasi të mëdha parash "cash" në ekonominë e një vendi dhe mund të kenë efekte të rëndësishme makroekonomike, si ndryshime në vlerat e monedhave dhe rritje të buxhetit dhe të vlerës monetare, siç ka ndodhur në një numër vendesh të Afrikës Perëndimore, disa prej të cilave janë ndikuar në mënyrë domethënëse nga trafiku i kokainës. Në Guinea-Bissau, për shembull, rezervat valutore të huaja u rritën nga 33 milionë dollarë në vitin 2003 në174 milionë dollarë në 2008; dhe në Gambia, vlera e dalasi u rrit me shpejtësi, pa ndryshime të dukshme në flukset e kapitalit.

Një pjesë e të ardhurave nga trafiku i drogës të gjenerruara nga vendet konsumatore transferohen në qendrat financiare, ku të ardhurat e kompanive, institucioneve financiare, rezidentëve dhe shërbimeve financiare profesioniste përdoren për të grumbulluar dhe shpërndarë flukset financiare.

Disa shembuj të fundit të pastrimit të parave ilustrojnë se si të ardhurat e paligjshme janë riqarkulluar përmes institucioneve të mëdha financiare në vendet e zhvilluar. Në vitin 2012, Departamenti i Drejtësisë në SHBA, gjobiti një bankë me bazë në Mbretërinë e Bashkuar me 1.9 milionë dollarë, për "dështime të mbikëqyrjes" duke lejuar pastrimin e të paktën 881 milion dollarëve të ardhura nga trafiku i drogës. Dështimet e tilla përfshirë dështimin për të monitoruar të paktën 670 trillion dollarë të transferuara në një bankë në Meksikë.

Paratë e kishin origjinën nga karteli Sinaloa në Meksikë, nga karteli Norte del Valle në Kolumbi dhe

organizata të tjera më të vogla të trafikut të drogës.Raporti thekson se fluksi i finacimeve të paligjshme mund të minojë integriretin e sistemit financiar të një vendi, përshirë sektorin financiar ndërkombëtar.

11.17.2016

LUFTA E TRETË BOTËRORE

Ndoshta të përmendet rreziku i një lufte të tretë botërore, siç ka bërë disa herë Papa Françesko, është një provokim. Por është e vështirë të mohohet se sistemi i Shteteve të Lindjes së Mesme ndodhet sot në një gjendje, së paku, po aq të rrezikshme sa ajo e Ballkanit në fillim të shekullit të shkuar e që është fatkeqësisht pranë shkatërrimit.

Siria, Iraku, Libia, Jemeni dhe Afganistani janë teatër luftërash civile (ose të autorizuara) që duken të pafundme. Terrorizmi kërcënon Egjiptin, Tunizinë, Libanin dhe vendet e Gjirit. I ashtuquajturi proces paqeje arabo–izraelit tashmë është një etiketë, së cilës nuk i beson aspak kërrkush, ndërsa kuadri politik i Palestinës dhe Izraelit është gjithnjë e më tepër rob i skajshmërisë ksenofobe.

Megjithë marrëveshjen e arritur nga 5+1 dhe nga Irani mbi dosjen bërthamore të Republikës islamike,

tensioni në zonë ndërmjet mbretërive sunite dhe Izraelit nga një anë, e Teheranit nga tjetra, nuk ka shenja pakësimi. Përkundrazi ngarkohet gjithnjë e më tepër. Shtetet e Bashkuara që, mbi themelin e kësaj marrëveshjeje do të donin të rindërtonin udhëheqjen e tyre rajonale, duhet të vërejnë se si ajo përfaqëson në sytë e aleatëve të tyre "gurin e skandalit".

Ndërkohë ISIS fuqizon praninë e tij në tokat e kalifatit, lëshon qortime për "felëshuesit" e Hamasit dhe Hezbollahut, krijon idhtarë në kampet e refugjatëve të Libanit dhe në rripin e Gazës, ashtu si në Somali, Libi, Tunizi, Egjipt, Nigeri, Afganistan, përveç Perëndimit. Por nëse një spikamë ka zotëruar faqet e gazetave verore dhe programet e qeverive europiane, ajo ka qenë dhe është "mësymja e refugjatëve" dhe jo ajo e shpërthimit të mundshëm të gjithë Lindjes së Mesme, me rrezikun e përzierjes së fuqive më të mëdha në plasjen e saj.

Po të ishim në një gjendje mirëkuptimi apo përputhje interesash ndërmjet mbifuqive planetare dhe kuadri makroekonomik të ishte i zbrazur nga shqetësimet e përhershme, kjo vëngërí mund të kuptohej edhe se nuk mund të falej. Por nuk është kështu. Shtetet e Bashkuara, Evropa dhe Rusia janë majë më majë mbas bashkëngjitjes së Krimesë nga ana e Moskës dhe politikës së Putinit në Ukrainë: presidenti rus ka zbuluar jo vetëm tonet, por edhe praktikat e luftës së ftohtë me dhunimet e vazhdueshme të hapësirës ajrore britanike dhe të vendeve skandinave nga bombarduesit e tij strategjikë. Kina që nxjerr në pah një nacionalizëm gjithnjë e më muskulor në Lindjen e Largët, duket se po i afrohet ndeshjes ndërmjet dy elementëve të papajtueshëm: një

rritjeje ekonomike të drejtuar nga zhvillimi i kërkesës së brendshme dhe ruajtjes së rolit zotërues të Partisë Komuniste (dhe të Ushtrisë Popullore të Çlirimit).

Evropa, nga ana e saj, është në vështirësi përballë të papriturave të rënda që peshojnë mbi të ardhmen e bashkimit të saj politik: nga euro në rritjen ekonomike, nga punësimi te politika me refugjatët, për të mos folur për politikën e mekur të jashtme e të sigurisë së përbashkët. Ndoshta diçka po ndryshon edhe se bëhet fjalë vetëm për deklarata synimesh: kryeministri anglez, David Cameron u tregua i gatshëm për sulme ajrore kundër forcave të ISIS-it në Siri, dhe presidenti francez, François Hollande po vlerëson nëse duhet të marrë pjesë në bombardimet. Por është pikërisht në Lindjen e Mesme që Evropa dhe Perëndimi bëjnë pak ose asgjë. Siç duket, në Washington, Londër, Paris dhe Berlin duhet të jenë të bindur se Al Bagdadi përbën një rrezik më të vogël sesa ai që përfaqësonte Ghedafi: sa arrogancë atëherë kundër Libisë, sa ndrojtje sot kundrejt Shtetit Islamik! Megjithëse kur u bombardua Ghedafi pa mëshirë, prej vitesh kishte pushuar së qeni një kërcënim për bashkësinë ndërkombëtare dhe një përkrahës i terrorizmit. Ndërsa nuk mund të thuhet e njëjta gjë për "kalifin e besimtarëve", katalizator për islamizmin më të dhunshëm e më skajor. Megjithëse nuk përbëjnë pjesën më të madhe të forcave kryengritëse që luftojnë kundër regjimit kriminal të Assadit (që ka bombarduar Alepin e "tij" me më shumë egërsi sesa ajo me të cilën Hitleri rrafshoi Varshavën), milicianët e Kalifit janë maja e tyre e diamantit: jo rastësisht janë ata, kundër të cilëve regjimi

ka përqendruar trupat e tij më të mirë dhe aleatët e tij më të çmuar, hezbollahët libanezë.

Pikërisht përzierja e tyre është duke vënë në një provë të fortë baraspeshën e brishtë të Libanit, të paralizuar nga më shumë se një vit për zgjedhjen e presidentit të ri (kristian maronit), të lodhur nga vala e më shumë se një milion e dyqind mijë refugjatësh nga Siria (në një popullsi pak më shumë se 4 milionë) dhe të sfiduar haptas nga një lëvizje ndërfetare e ndërklasore (You Stinck!) që, duke u nisur nga kriza e lindur me mbledhjen dhe bluarjen e plehrave, padit korrupsionin dhe pazotësinë e regjimit.

Mbi të gjitha, roli i luajtur nga hezbollahët në Siri rrezikon të tërheqë Izraelin në luftën civile siriane. Qeveria e Tel Avivit, mbasi ka pësuar dështimin e marrëveshjes mbi bërthamoren iraniane, sigurisht nuk i ka dorëzuar armët. Megjithë kritikat e shumta të rëna mbi kryet e Netanjahut për furinë me të cilën kërkoi të kushtëzojë në funksion kundër-Obama procesin politik amerikan (që simbas nja njëqind rabinëve amerikanë rrezikon të tërheqë mbi hebrenjtë e përtej Atlantikut akuzën e rëndë të pandershmërisë), kryeministri izraelit vazhdon ta interpretojë gjithë kuadrin rajonal në dritën e kërcënimit jetik të përfaqësuar nga një Iran teorikisht në gjendje të zhvillojë armën bërthamore (edhe se Izraeli është e vetmja fuqi bërthamore e Lindjes së Mesme, me më shumë bomba se Franca dhe Britania e Madhe).

Në këtë vështrim, të provokohet rënia e regjimit të Assadit dhe të nxirret jashtë luftimit Hezbollahu, aleatët e rëndësishëm të Iranit, është një objektiv që mund të ligjësojë “somalizimin” e Sirisë dhe infektimin e

Libanit. Në një perspektivë të tillë, rreziqet e një shkallëzimi të tensionit ndërmjet Iranit dhe Izraelit, me një përzierje të mundshme të mbretërive sunite të Gjirit nuk janë anësore; do të ngrihej tensioni i marrëdhënieve me Moskën, që sidoqoftë mbetet një aleate e Sirisë dhe një bashkëbiseduese e interesuar e Iranit. Marrëveshja mbi bërthamoren iraniane (Joint comprehensive plan of action, Jcpoa) parashikon një periudhë të gjatë përcaktimi (deri në 15 vjet) dhe faza të ndryshme në sendërtim. Kjo iu jep kundërshtarëve të saj mundësinë e një strategjie të përpunuar kundërshtie.

Por është periudha që shkon nga lëshimi i "certifikatës së mirësjelljes" Iranit nga ana e Aiea (Agjencia ndërkombëtare për energjinë bërthamore) në janar 2016 dhe hyrjes së administratës së re amerikane, më 20 janar të vitit pasues, që përfaqëson "dritaren e mundësive". Megjithëse marrëveshja është një sukses për firmuesit dhe një shenjë "e rrallë" bashkësie qëllimesh të 5 anëtarëve të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, mbetet fakti që është arritur me kundërshtimin e egër të aleatëve kryesorë amerikanë në rajon: Izraeli dhe Arabia Saudite, dy nga tri fuqitë rajonale (e treta është pikërisht Irani). Në vështrimin rajonal, fuqia e saj destabilizuese është e dukshme, së paku në kohë të shkurtra e të mesme: vetëm zbatimi me sukses (ose më mirë vërtetimi i heqjes dorë nga ana iraniane e çfarëdo dëshire bërthamore me karakter ushtarak) mund të ndihmonte qëndrueshmërinë e rajonit. Por që të ndodhë e gjithë kjo duhen vite.

Siç shihet, janë të gjithë elementët që një krizë shumë e rëndë rajonale të mund të kthehet në një konflikt të përmasave më të gjëra e të papërcaktuara. Në mënyrë

paradoksale, siç vërente edhe politologu amerikan, Jospeh Nye, është pikërisht baraspesha bërthamore, që ende zotëron sistemin ndërkombëtar në tërësinë e tij, që jep sigurinë më të mirë që një shkallëzim i mundshëm të ndalohet para se të arrijë të shkaktojë luftën e tretë botërore në pak më shumë se një shekull.

**Vittorio Emanuele Parsi është profesor i Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin katolik të Milanos. Nga 27 maji deri më 27 gusht ka kryer shërbimin si kapiten i një fregate të Rezervës së zgjedhur të Flotës Ushtarake pranë shtabit të përgjithshëm të Unifilit në Naquora (Liban), në misionin e OKB-së.*

"Mirror": Lufta e tretë botërore mund të jetë 30 sekonda larg

Koalicioni i sulmeve ajrore i udhëhequr nga SHBA-të ka njoftuar se brenda ditës kanë kryer 24 sulme kundër ISIS, përderisa Rusia pretendon se ka sulmuar 55 caqe të grupit ekstremist.

"Mund të jemi vetëm 30 sekonda larg fillimit të Luftës së Tretë Botërore, përderisa tensionet ndërkombëtare mbi Sirinë, e cila është fuqi baruti, kërcënojnë që ta ndezin luftën", shkruan "Mirror". Koalicioni i sulmeve ajrore i udhëhequr nga SHBA-të ka njoftuar se të shtunën ka kryer 24 sulme ajrore kundër militantëve të Shtetit Islamik, ndërkaq Rusia pretendon se ka sulmuar 55 caqe të ISIS dhe presidenti rus, Vladimir Putin, ka thënë se sulmet e Perëndimit nuk po japin rezultate.

Por rebelët në terren po pretendojnë se sulmet ajrore të Moskës, të kombinuara edhe me sulmet në

terren nga forcat besnike të presidentit sirian Bashar al-Assad, gjithashtu kanë sulmuar edhe grupet rebele që nuk kanë lidhje me IS-in, përfshirë këtu edhe grupe të luftëtarëve, të cilët janë trajnuar nga Shtetet e Bashkuara.

Përderisa hapësira ajrore mbi Sirinë është e mbingarkuar, komandantët ushtarakë kanë frikë se avionët ushtarakë, helikopterët, dronët dhe raketat mund të përplasen aksidentalisht dhe kjo gjë mund të ketë pasoja globale. Një ekspert ushtarak paralajmëron se, organizimi në një hapësirë të tillë komplekse nuk është i mundur.

"Duke pasur parasysh gjithë atë trafik ajror, ka shqetësime të vërteta se avionët mund të përplasen apo të goditen, gjë që mund të çojë në keqkuptime. Kjo do të thotë se për disa sekonda mund të eskalojë situata, e cila mund të çojë deri në fillimi i luftës". Adrew Foxall, ekspert rus, thotë se një gabim në hapësirën ajrore siriane mund të çojë deri tek incidentet diplomatike me përmasa katastrofike.

Por, makthi më i madh është nëse lufta fillon nga koalicioni global anti-ISIS kundër mbështetjes që Putini po u bën forcave të Assadit dhe kjo gjë do të shtronte terrenin që konflikti të shpërthente në të gjitha anët. "Rusia ka qëllime të ndryshme nga koalicioni i NATO-s dhe i Perëndimit, të cilët po luftojnë për demokraci dhe ndryshim të regjimit në Siri.

Qëllimi i Kremlinit është që në Siri të vazhdojë regjimi prorus", thotë Foxall. Por, një intervenim i Kinës do ta komplikonte më shumë situatën, për shkak të frikës se sulmet ajrore kundër ISIS mund të bëhen pretekst për të sulmuar grupet e rebelëve sirianë.

Lufta e Tretë Botërore

Forcat e Armatosura të Turqisë të martën kanë rrëzuar avionin rus afër kufirit turko-sirian dhe e ashpërsuan shumë konfliktin që po zgjerohet gjithnjë e më shpejt dhe gjithnjë e më paparashikueshëm, thuhet në një analizë më të gjerë të CNN.

Të kthehemi një hap pas dhe të shikojmë ç'e ka nxitur luftën në Siri: Vetëm disa ditë pas sulmeve në Paris, njëri nga sulmet më të mëdha terroriste në truallin evropian pas Luftës së Dytë Botërore – dhe derisa Brukseli, kryeqyteti jozyrtar i Bashkimit Evropian edhe më tej është paralizuar, një anëtar i NATO-s e ka rrëzuar avionin luftarak rus.

Po të kishte ndodhur kjo gjatë Luftës së Ftohtë, mund të kishte shpërthyer lufta bërthamore.

Për fat konflikti ka mbaruar. Në vend se të japë numrin e bërthamorëve, kryetari rus Vladimir Putin ka kërkuar mbledhje urgjente të Këshillit të Sigurimit, e edhe NATO po ashtu ka ftuar një mbledhje të veten urgjente.
Këta hapa nuk duhet interpretuar gabimisht si dëshmi qetësimi; Rusia e hidhëruar e ka quajtur Turqinë "ndihmëse e terroristëve", e Putin ka tërhequr vërejtjen për "pasoja serioze". Kjo është e fundit nga shumë ngjarjet që kanë nisur konfliktin më të komplikuar në botë, transmeton Koha.net.

Menjëherë pas masakrës në Paris, papa Françesku, ka deklaruar se sulmi terrorist është pjesë e Luftës së Tretë Botërore. Ndërsa ajo që merr formë të luftës botërore në këtë shekull është vetë lufta në Siri.

Konflikti sirian u bë fatal në vitin 2011, kur kryetari Assad thirrjeve për demokraci iu përgjigj me masakrim të demonstruesve dhe ai pastaj u shndërrua në spirale të dhunës globale. Ditë pas dite rritet numri i konflikteve që ndikojnë në shpërthimin e luftës në këtë pjesë të Levantit duke sjellë forcë të re të armatosur dhe më shumë rekrutë.

E gjitha filloi nga konfliktet e aktivistëve prodemokratë dhe të forcave të Assadit: Ai tërhoqi pas vetes të gjitha grupet e armatosura kundërshtare të opozitës. Ktheu të moderuarit kundër ekstremistëve dhe ekstremistët kundër ultraekstremistëve.

Tërbim ndërmjet shiitëve e sunitëve dhe ndërmjet arabëve e iranianëve, luftohet kundër milicive që përkrahin arabët në Gjirin Persik. Front al Nusra i Al Kaidës i konkurron Shtetit islamik, kurdët luftojnë kundër Shtetit Islamik dhe kundër Ushtrisë siriane, e Turqia lufton kundër kurdëve derisa me pavendosmëri lufton kundër Shtetit Islamik dhe instinktivisht e do largimin e Asadit.

Ka edhe shumëçka që tërheq pasojat gjeopolitike. Aty janë Rusia e ShBA si dhe "koalicioni kundër ISIS", e së shpejti edhe blloku i Francës për luftë kundër ISIS-it.

Edhe pse edhe Rusia e edhe Turqia lavdërohen se po luftojnë kundër ISIS-it, armikut të botës, është fakt se edhe njëra e edhe tjetra kanë qëllime të veta, për ç'shkak rrëzimi i avionit rus të martën nuk do të hedhet si rastësi në teatrin e luftës.

Rusia është në Siri jo për të fituar ISIS –in,por për të shpëtuar regjimin e Assadit si aleat afatgjatë i Rusisë.

Turqia ka dy qëllime: Dëshiron të thyejë krahun e kurdëve, të cilët synojnë pavarësinë dhe po ashtu të rrëzojë Assadin.

Dhe deri sa synimet e Turqisë dallojnë nga synimet e aleatëve të NATO –s, sidomos për shkak se Ankaraja kryesisht e ka injoruar ISIS –in, armikun e kurdëve, Aleanca e NATO-s pajtohet kur bëhet fjalë për antipatinë ndaj Assadit.

Në lojë është edhe roli më i madh gjeopolitik. Rusia punon që të shkatërrojë autoritetin amerikan në Lindjen e Afërt duke i dhënë nxitje planit të Putinit për provokim dhe sfidë Washingtonit.

Derisa Barack Obama përpiqet ta bindë Amerikën të jetë shumë e matur në mundjen dhe në degradimin e ISIS dhe që kjo luftë të japë rezultate, Putin ka dërguar forca të mëdha ushtarake në Siri dhe konfliktit i ka dhënë formë tjerë.

Assad ndoshta ka qenë buzë humbjes së pushtetit, por Putin, i cili lufton në anën e njëjtë sikur dhe Irani e Hezbollah, u përkujdes që kjo të mos ndodhë shpejt. Pas sulmeve të ISIS-it në Evropën Perëndimore, duket se gjasat janë edhe më të mëdha që Assadi të mbetet.

Ky është veçse fillimi. Të gjithë në këtë luftë kanë armiq e miq në anët kundërshtare.

Kështu duket lufta botërore: Aleatë të çuditshëm, plane ballafaquese, aleanca të krijuara me qëllime të caktuara.

Në "luftën e shenjtë të Sirisë" marrin pjesë shumë vende. Vjet ShBA krijuan koalicionin gjerë nga më shumë se 60 shtete. Nga Koreja Jugore tek

Australia,qeveritë e këtyre vendeve në shkallë të ndryshme kanë marrë pjesë në luftë kundër Shtetit Islamik.

Gjatë kësaj kohe Shteti islamik ka zgjeruar rajonin operativ. Ka degë të reja dhe pasuesit e tij po sulmojnë në gjithë botën. Organizata me seli në Siri jo vetëm kontrollon territore në Siri e Irak, pasuesit e tij kanë ndikim të madh në Libi, siujdhesën egjiptiane Sinaj, në Nigeri dhe në pjesë të tjera të Afrikës.

Lista e grupeve që pohojnë se janë besnikë të Kalifatit të vetëshpallur përfshinë dhjetëra mijëra kilometra katrorë e të tillë ka edhe në Afganistan, Indonezi, Pakistan, Algjeri e Filipine, transmeton koha.net.

Një numër i madh njerëzish nga kombe të ndryshëm kanë vdekur në Siri e Irak. Ndërsa, propaganda terroriste e Shtetit Islamik ka publikuar vrasje të amerikanëve, britanikëve, egjiptianëve, japonezëve, koreanëve, kinezëve e të civilëve të kombeve të tjera.

Refugjatët nga Siria kanë arritur deri në Uruguaj, e me sulmet terroristëve të individëve të lidhur me luftëtarët sirianë, janë vrarë jo vetëm njerëz në Siri, Irak, Liban e Turqi, por edhe në Kanada, Francë, Australi, Nigeri, Danimarkë, etj. Të mos harrohet Egjipti, ku para dy javësh, u binden edhe ekspertë e edhe autoritetet e Moskës se aeroplani rus i udhëtarëve u rrëzua qëllimisht.
A tingëllon si luftë botërore ?

Kur themi “luftë botërore” rëndom mendojmë në dy konflikte të mëdha të shekullit 20-të.

Vërehet se kësaj radhe ShBA refuzojnë të përfshihen – kjo është dëshirë e publikut që të mbetet jashtë konfliktit dhe thotë: “Kjo nuk është lufta jonë”.

"Nuk është sigurt sa do të zgjasë kjo. Por ndoshta duhet kujtuar se këto luftëra kanë përfunduar vetëm kur ShBA nuk kanë mundur të shtiren se atë nuk e godet konflikt brutal i cili po tërbohet mijëra kilometra larg brigjeve amerikane”, thekson CNN.

Donald Trump: Planet për Sirinë mund të çojnë në Luftën e Tretë Botërore

Donald Trump e sulmoi sërish kundërshtaren e tij, Hillary Clinton, duke shënjestruar këtë herë vizionin e saj në politikën e jashtme. Planet e Clintonit për Sirinë – tha kandidati presidencial republikan, – mund të çojne në fillimin e Luftës së Tretë Botërore.

Bindja e tij është se Shtetet e Bashkuara duhet të fokusohen më shumë te mposhtja e ISIS-it, sesa te përpjekjet për ta bindur presidentin sirian Bashar al-Assad të lërë pushtetin.

“Ajo nuk ka asnjë plan të qartë për Sirinë. Me Clintonin presidente do ta gjeni veten në Luftën e Tretë Botërore. Ajo nuk di çfarë bën, siç ndodhi edhe me Libinë dhe me çdo gjë tjetër që ka marrë përsipër. Siria sot nuk është më Siri. Siria është Rusia dhe Irani i ri, që ndërtuam me njërën prej marrëveshjeve më të këqija që unë kam parë ndonjëherë”, tha Trump.

Ish-Sekretarja e Shtetit i mëshon idesë së krijimit të një zonë ndalimfluturimi mbi Siri, çfarë sipas disa zërave rrezikon të shkaktojë konflikt me avionët rusë.

Ndihmësit e Clintonit reaguan me akuzën se Trumpi po shfrytëzon frikën e amerikanëve.

Miliarderi nuk sulmoi vetëm demokratët, por iu kthye edhe vet anëtarëve të partisë së tij, që nuk ia mbështetën kandidaturën. Ai nuk la pa fshikulluar dhe Barack Obamën, për të cilin tha se duhet hetuar për skandalin e "e-mail"-it privat të Clintonit, e iu rikthye edhe lajtmovitit të manipulimit të zgjedhjeve, duke thënë se mashtrimet me votën janë një fenomen mjaft i zakontë. Bota është shumë afër një Lufte të Tretë Botërore në 60 vitet e fundit, kanë paralajmëruar ekspertët. Rusia dhe Kina, dy shtete që në vitet e fundit kanë shpenzuar miliarda për ushtrinë, shumë shpejtë do të rivalizojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës nga aspekti i fuqisë dhe prestigjit ushtarak.

Këto shtete dëshirojnë të mbesin superfuqi botërore. Ato janë duke u përgatitur për luftë, raporton tabloidi britanik "The Sun". Të tre shtetet përbëjnë kërcënim për njëra-tjetrën në disa probleme globale, duke krijuar një balancë delikate që mund të çojë në kolaps.

Një numër ekspertësh kanë identifikuar disa arsye të cilat mund të shpien deri te fillimi i Luftës së Tretë Botërore. Sulmi i NATO-s dhe Rusisë mbi Sirinë, agresioni i Vladimir Putinit ndaj Europës Lindore, dhe lëvizjet e Kinës në Detin Jugor janë disa prej arsyeve për fillimin e Luftës.

Ekspertët gjithashtu kanë shprehur shqetësim për mungesën e stabilitetit të Pakistanit në fuqinë bërthamore, derisa grupet ekstremiste dhe terroriste po rriten dita-ditës në këtë shtet.

Parashikimi i studiuesit italian: Lufta e Tretë Botërore është afër, SHBA-të po bien.

Sipas studiuesit Luigi Bonanante, ISIS nuk është një tregues i çrregullimit në rritje ndërkombëtar, duke pasur parasysh rënien e SHBA-ve, kriza financiare, shpërthimit të BE-së, rritjen e Kinës dhe Rusisë, që nuk heqin dorë për t'u bërë një fuqi rajonale.

Sipas tij, Lufta e Tretë Botërore është afër dhe kjo dëshmohet nga arsyet që dhamë më lart.

Të gjithë e shohin ISIS si armikun e madh të njerëzimit. Por me siguri nuk është rreziku më i madh.
Sot SHBA-të janë në një fazë rënieje, ndërsa Kina po ngrihet. Dhe Rusia nuk heq dorë nga të qenit një fuqi rajonale. Një situatë tejet e paqëndrueshme.

Sot Shtetet e Bashkuara janë gjithnjë e më pak në qendër. Obama ndoshta është interpretuesi i kësaj rënieje. Nuk arrin ta qeverisë botën.

Nuk kemi më një rend ndërkombëtar solid. Pak nga pak kemi hyrë në një fazë anarkie në rritje. Nuk ka më asnjë pikë fikse, ka vetëm një shpërbërje të vazhdueshme.
Një degjenerim që shumë studiues mendojnë se në vitet '30 të këtij shekulli do të jetë edhe lufta e tretë botërore.
Jo një luftë lokale, ose e lidhur me një interes të veçantë – shih Vietnam apo Irakun – por një luftë që rikthen ekuilibrin e pushtetit, si lufta franko-prusiane e vitit 1870 ose si lufta e parë apo e dytë botërore.

ISIS është një nga shumë treguesit e shkatërrimit të botës sonë.
10.31.2016

PSE SHKOVE NË SERBI NEHAT THAÇI?

Drejtori i Policisë së Regjionit të Mitrovicës, Nehat Thaçi, është arrestuar mbrëmjen e të mërkurës në Beograd me pretendimin se akuzohet për terrorizëm.

Mediat kanë raportuar se Nehat Thaçi, është transferuar nga qyteti jugor i Nishit në Beograd, ku me rastin do të merret Prokuroria Speciale për Krim të organizuar. Gjithçka ka ndodhur në një kohë, kur Presidenti Hashim Thaçi flet për normalizim të marrëdhënieve me Serbinë. Dhe ajo cfarë është më e rëndë, se reagimi i Kosovës, në lidhje me arrestimin e kreut të Policisë së Mitrovicës ishte shumë i vakët.

Është dashur interesimi i mediave për të çuar në reagimin e institucioneve kompetente të Kosovës. Kështu pas interesimit të mediave, këshilltari politik në Ministrinë e Punëve të Jashtme, Bashmir Xhemaj ka thënë

se janë duke punuar shumë që të sqarohet rasti i arrestimit të zyrtarit policor kosovar, Nehat Thaçi, nga autoritetet serbe. Pyetja shtrohet, a duhet t'i zbutë qëndrimet Kosova ndaj Serbisë, apo duhet të reagojë me reciprocitet dhe të mos heqë dorë nga Mitrovica e Veriut? Pastaj çfarë rëndësie kanë bisedimet, kur qytetarët e Kosovës dhe për më tepër zyrtarë të lartë të shtetit, arrestohen sapo shkelin në teritorin ne Serbisë? Por, përderisa nuk ka patur transparencë rreth atyre që është biseduar në Bruksel, nuk mund të mbash shpresat tek dialogu, që tashmë po del në formën e blofit.

Deri kur do të rrejë Edita Tahiri ?

Opinioni publik në Kosovë shumë do që të besojë se institucionet e vendit të tyre, po bëjnë cmos për lirimin e zyrtarit të policisë, por deri më tani, gjithçka ka mbetur në kuadrin e fjalëve. Të enjten ministrja Edita Tahiri, nga Brukseli, është shprehur se ajo e ka konsideruar këtë arrestim, arbitrar dhe akt të papranueshëm.

Ajo ka thënë, se i ka bërë thirrje Bashkimit Evropian që të ndërhyjë tek Serbia për lirimin e Thaçit dhe që Serbia duhet të respektojë frymën e dialogut dhe normalizimit të marrëdhënieve në mes të dy shteteve.

Rrahim Pacolli: Qeveria e Kosovës si dhe faktori ndërkombëtar duhet të marr masa dhe të bëjë presion mbi shtetin serb për lirimin e menjëhershëm të nënkolonel Thaçi

Ndërkohë ka patur reagime edhe nga disa deputetë, për ndërhyrjen e menjëhershme te Qeverisë, si dhe thirrje kësaj të fundit i ka bërë edhe kryesuesi i delegacionit për kartonin e gjelbër Rrahim Pacolli.

Sipas të njëjtit, arrestimi i nënkolonel Nehat Thaçi është një tendencë perfide e palës serbe e cila në vazhdimësi tenton që me anë veprimeve të tilla ta rimarr kontrollin e plotë në veri të vendit duke patur parasysh se që nga ardhja e nënkolonel Thaçit në krye të Drejtorisë Rajonale të Policisë së Kosovës në Mitrovicë dukuritë negative si krimi, kontrabanda e shumë dukuri të tjera negative kanë shënuar rënie në atë zonë.

"Qeveria e Kosovës si dhe faktori ndërkombëtar duhet të marr masa dhe të bëjë presion mbi shtetin serb për lirimin e menjëhershëm të nënkolonel Thaçit", është shprehur Pacolli.

Heshtja e ministrive nuk mund të bëhet deri në infinit ?

Ministri i Punëve të jashtme Prof. Dr. Enver Hoxhaj dhe Ministri i Punëve të Brendshme Skënder Hyseni, deklaruan para kabinetit qeveritar, se po japin maksimumin, që drejtori i policisë Nenkolonel Nehat Thaçi të lirohet sa më shpejt.

Prof.Dr. Enver Hoxhaj tha se që nga dje janë marrë intenzivisht me këtë rast, duke pohuar se raste të tilla janë të papranueshme për Qeverinë e Kosovës.

Prof. Dr. Enver Hoxhaj: Po merremi intensivisht me rastin

"Ne jemi marrë intensivisht dje me rastin e arrestimit të drejtorit të policisë së Mitrovicës në jug, zotin Nehat Thaçi. Jemi marrë edhe në orët e hershme të mëngjesit. Zakonisht në kohë të tilla nuk bëjmë deklaratat për opinion publik. Se nuk është në natyrën e MPJ-së që

paralelisht me angazhimin diplomatik të bëjë deklaratat në proces. Por kryeministër dua t'iu siguroj edhe ju edhe qytetarët, se e kemi dhënë maksimumin prej anës sonë. Natyrisht se raste e tilla janë të papranueshme për ne si Qeveri e Republikës së Kosovës. Sikurse janë të papranueshme rritja e numrit të kërkesave nga ana e Serbisë në kuadër të Interpolit, ku shpesh herë qytetarët e Kosovës, pa asnjë të drejtë ndalen në kufij të shteteve fqinje", tha Hoxhaj.

Edhe ministri Skënder Hyseni tha se është e papranueshme, që në listat e Interpolit të figurojnë qytetarët e Kosovës që kane marrë pjesë ne luftë.

Prof. Skender Hyseni: Kjo është e papranueshme

"Gjatë gjithë ditës dje kemi koordinuar përpjekjet që në kanalet diplomatike, përmes MPJ-së që është instrument i shtetit, të interesohemi dhe të bëjmë që i arrestuari, në këtë rast komandanti i policisë në Mitrovicë te lirohet sa më shpejte. Ne bazë te informacioneve që kemi nuk ka asnjë mbështetje ligjore për mbajtjen e tij në arrest. Dje vërtetë kemi qenë në presion të madh të opinionit, që të deklarohemi ndërkohë që bëheshin të gjitha përpjekjet dhe po vazhdojnë të bëhen përpjekjet, për lirimin e tij. Është e pavend të bëjmë deklarime publike, që mund ta vështirësojnë gjitha përpjekjet, për lirimin sa më të shpejtë të zotit Nehat Thaçi. Është e papranueshme që në listat e Interpolit të figurojnë qytetarët e Kosovës që kane marrë pjesë ne luftë", tha ai.

Pse shkove në Serbi Nehat Thaçi?

Ndërsa ish ushtaraku Naim Maloku, ka reaguar pas arrestimit të drejtorit rajonal të Policisë në Mitrovicën Jugore, Nehat Thaçi.

Maloku në Facebook, ka pyetur se përse Nehat Thaçi ka shkuar në Serbi.

"Ish-ushtari i UÇK-së dhe tani drejtor i Policisë në rajonin e Mitrovicës Nehat Thaçi, arrestohet në Serbi? E çka lypi në Serbi?" ka shkruar ndër të tjera Maloku.
Nënkoloneli Nehat Thaçi, akuzohet nga Prokuroria Speciale serbe për krime kundër serbëve në Lipjan.

Në prill të vitit 2001, nga burgu i Nishit ishin liruar 126 të burgosur shqiptarë që së bashku me 17 shqiptarë të tjerë në burgjet serbe, u liruan me autobusë të organizuar drejt Kosovës. Njëri ndër ta ishte edhe Nehat Thaçi.

Nënkoloneli Nehat Thaçi, drejtor rajonal i Policisë së Kosovës në Mitrovicë, i cili është arrestuar sot në vendkalimin kufitar në Konçul, sipas medieve serbe dyshohet për krime kundër serbëve në Lipjan, në korrik të vitit 1999.

Arrestimi ka ndodhur në orën 20:00 teksa po merrte certifikatën në vendkalim, bazuar në një urdhër-arrest të Gjykatës së Lartë në Nish, për veprën penale – terrorizëm.

Nënkonoloneli që sipas zëdhënësit të Policisë së Kosovës, Daut Hoxha ishte duke udhëtuar drejt vendeve perëndimore nëpërmjet Serbisë. Bashkë me të është arrestuar edhe vëllai Agim Thaçi, ndaj të cilit, sipas Novostit, është një hetim i vitit 2009 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.

Gazeta nuk ka sqaruar se për çfarë rasti bëhet fjalë, por ka cituar zëdhënësen e Gjykatës së Lartë në Nish, Ivana Popoviq, të ketë thënë se urdhër-arresti i lëshuar në shtator të vitit 2010, raporton Insajderi.

Kjo Gjykatë sipas Popoviq, në dhjetor të vitit 2010 kishte vendosur që të pauzojë hetimet për shkak se të "dyshuarit nuk ishin në dispozicion të autoriteteve të Republikës së Serbisë".

Sipas gazetës ndaj Thaçit është një urdhër arrest qysh prej vitit 2002, kur në Gjykatën e Qarkut në Nish po akuzoheshin Vëllëzrit Mazreku, të cilët ishin dënuar me 20 vite burg.

Më pas një gjykatë tjetër e kishte anuluar këtë vendim. Përderisa Vëllezërit Mazreku dyshoheshin se kanë rrëmbyer 43 civil nga Malisheva dhe Rahoveci për t'u transferuar në Kleçkë, bashkë me disa viktima të tjera nga Lipjani, në rrëmbimin e të cilëve dyshohet të ketë marrë pjesë edhe nënkoloneli Thaçi.

Ky rast është pjesë e një rasti më të madh i njohur si rasti "Grupi i Gjakovës".

Në prill të vitit 2001, nga burgu i Nishit ishin liruar 126 të burgosur shqiptarë që së bashku me 17 shqiptarë të tjerë në burgjet serbe, i liruar me autobusë të organizuar drejt Kosovës. Njëri ndër ta ishte edhe Nehat Thaçi.

Në maj të vitit 2000, ky grup ishte dënuar nga Gjykata e ashtuquajtur e Pejës por e zhvendosur në Nish me gjithsejtë 1 mijë e 632 vite burg por që një gjykatë tjetër e kishte rrëzuar vendimin.

9.30.2016

1020 VETËVRASJE NË KOSOVË

Pas luftës në Kosovë, që nga qershori i vitit 1999 e deri më sot, kanë ndodhur 1020 vetëvrasje.

Për dallim nga koha e paraluftës, nga viti 1945 deri në vitin 1998, numri i vetëvrasjeve të raportuara është shumë i ulët në krahasim me sot.

"Nga viti 1945 e deri në vitin 1998, në Kosovë zyrtarisht në organet e sigurimit nuk janë shënuar më shumë se dhjetë vetëvrasje. Ishin të rralla, sepse kishte mistere. Familjet patriarkale i deklaronin vdekje të natyrshme", shkruan gazetari Bajram Mjeku.

Ai shton se as në periudhat mizore të tiranëve serbë, Aleksandër Rankoviq e Sllobodan Millosheviq nuk kishte vetëvrasje, pasi shqiptarët e konsideronin akt i ulët.

Se vetëvrasjet në Kosovë janë dukuri në rritje, këtë e vërtetojnë edhe shifrat zyrtare. Raportet e policisë tregojnë se që nga pas lufta e deri në vitin 2012, janë

evidentuar 768 raste të vetëvrasjeve dhe 2494 tentim-vetëvrasje.

Sipas burimeve, deri tash janë 44 ish-ushtarë të UÇK-së që kanë kryer këtë akt fatal.

Statistikat e Policisë së Kosovës tregojnë se vetëm në dy muajt e vitit 2012 kanë ndodhur tri vetëvrasje dhe 36 tentime për vetëvrasje. Në vitin 2011, 52 persona janë vetëvrarë dhe 306 persona kanë tentuar të vetëvriten.

Sipas të dhënave ekzistuese gjinia mashkullore prin me vetëvrasje, ndërsa për tentim-vetëvrasje është më e prira gjinia femërore.

Sipas statistikave të Policisë së Kosovës, që nga viti 2001 deri në vitin 2012, në Kosovë 731 persona kanë bërë vetëvrasje dhe 2485 persona të tjerë kanë bërë tentim-vetëvrasje.

Njohësit e kësaj dukurie shpjegojnë se përveç çrregullimeve të ndryshme, një nga shkaktarët e vetëvrasjeve në Kosovë mund të konsiderohet edhe zhgënjimi dhe humbja e shpresës për një jetë më të mirë.
Sipas Policisë së Kosovës, numri më i madh i vetëvrasjeve është kryer në rajonin e Prishtinës, duke përfshirë këtu edhe komunat si Podujeva, Fushë Kosova, Obiliqi, Lipjani, Drenasi, mirëpo nuk përjashtohen edhe rajonet e tjera.
Shqetësuese është fakti që mosha mesatare e këtyre personave është 18-40 vjeçare, ndërkaq shkaqet dhe motivet e këtyre akteve mbeten të ndryshme. Sa i përket gjinisë së personave, meshkujt janë në numër më të madh të vetëvrasjeve, ndërsa tentim-vetëvrasje janë personat e gjinisë femërore, shkruan ”Lajm”. Psikologu Aliriza Arenliu konsideron se fenomeni i vetëvrasjes është një

nga fenomenet më komplekse për t'u studiuar dhe se shkaktarët ndryshojnë nga individi në individ dhe nga një kulturë në tjetrën.

Mirëpo, sipas tij shkaktarët ndahen në tre faktorë: social, psikologjik dhe biologjik. "Është një trend i përgjithshëm që ky fenomen pason rritje në çdo shoqëri që del nga luftërat kjo është vërejtur edhe pas Luftës së Dytë Botërore dhe në disa vende të regjionit pas luftërave" duket se transformimet sociale shkaktojnë ndryshime të mëdha edhe në mënyrën e jetesës dhe të konstalacioneve të vjetra sociale të cilat shpërbëhen dhe personat që kanë një cenueshmëri më të lartë për çrregullime të ndryshme (shto këtu edhe pasojat e luftës) mbesin pa një përkrahje të duhur posaçërisht në vendin tonë ku shërbimet e shëndetit mendor janë ende të stigmatizuar dhe jashtëzakonisht të dobëta me kapacitet për të ofruar shërbime për shkak të numrit të vogël të psikiatërve dhe psikologëve në institucionet publike", shprehet Arenliu.

Sipas tij, në vendin tonë nevojiten studime të thella për këtë dukuri negative, ndërsa citon se institucionet përkatëse kanë bërë pak në këtë drejtim. "Para dy viteve zyra për qeverisje të mirë ka iniciuar një grup punues për hartimin e një planprogrami të parandalimit të vetëvrasjeve në Kosovë. Ky grup ka rezultuar me një propozim, i cili nuk e di se ku ka mbetur, por e di se ka mbetur i parealizuar", shprehet krejt në fund Arenliu.

9.28.2016

A DO TË BASHKOHEN SHQIPTARËT NË NJË SHTET

Pavarësia e Kosovës e cila u shpall me 17 Shkurt të vitit 2008 është njohur deri me tani zyrtarisht nga 111 prej gjithsejt 193 Shteteve anetare te UN-it. Nder këto janë 24 prej 28 shteteve te Bashkimit Evropian si dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Por shumë shqiptarë, megjithatë, besojnë se pavarësia e rajonit është një përfundim i pashmangshëm. Dhe hapi i parë drejt krijimit të Shqipërisë së Madhe, e cila, me përjashtim të Shqipërisë dhe Kosovës duhet të hyjë në disa zona të Maqedonisë, Malit të Zi, Serbi dhe Greqi.

Kosova, zyrtarisht Republika e Kosovës, është shtet i pavarur në Evropën Juglindore. Shtrihet në qendër të Gadishullin Ballkanik dhe kufizohet në veri me Serbinë, në juglindje me Republikën e Maqedonisë, në jugperëndim me Shqipërinë dhe në perëndim me Malin e Zi.

Ka sipërfaqe prej 10.887 km^2 dhe popullsi prej rreth 2 milion banorësh, prej të cilëve afro 300 mijë banojnë në Prishtinë, kryeqytetin dhe qendrën më të rëndësishme të vendit. Shumica dërmuese e popullsisë janë shqiptarë, ndërsa komunitetet tjera përfshijnë serbët, turqit, boshnjakët, romëtë, ashkalinjtë dhe goranët.

Ka disa vjetë që "Shtetet Ortodokse të Ballkanit", Serbia, Greqia, Bullgaria dhe Maqedonia, ndihen të frikësuara nga ideja e krijimit të "Shqipërisë së Madhe", e cila po qarkullon si ide në Ballkan.

Sipas asaj që raporton televizioni maqedonas "TV Sitel": *"në rast se SHBA-të do të mbështein Shqipërinë në të gjitha çështjet, siç ishe dhe rasti i Kumanovës dhe nëse BE-ja do të rrijë në heshtje për projektin e 'Shqipërisë së Madhe', atëherë shumë shpejt Serbia, Maqedonia, Bullgaria dhe Greqia, do të bashkohen në një 'Koalicion Ballkanik Orthodoks ' kundër këtij projekti".*

Frika e një Lufte të Tretë Ballkanike është përmenduar edhe në një raportë të Agjencisë CIA, në të cilin theksohet se shtetet e lartpërmendura mund të bashkohen në petkun e ortodoksisë dhe mund t'i shpallin luftë Shqipërisë, çka do të sillte një situatë të përgjakshme në rajon.

Ndarja e Rajonit

Përgatitja për ndarjen e rajonit ishte e gjatë.

Në vitin 2006, i dërguari special i OKB-së për Kosovën Marti Ahtisari paraqiti një plan ku morën vendimin "për të arritur pavarësinë, shqiptarët do të kufizojnë fuqinë e

përfaqësuesve të misioneve të BE-së, OSBE-së dhe OKB-së.

Një vit më vonë, u bënë zgjedhjet, të cilat nuk njihen nga Beogradi dhe nuk u pranuan nga serbët lokalë. Ish Kryeministri,tash Presidenti i Kosovëz ,z. Hashim Thaçi me shumë Liderë të tjerë politikë më dat 17 shkurt 2008, në Parlamentin e Kosovës (në mungesë të deputetëve serb) miratoi një deklaratë të pavarësisë.

Disa ditë më vonë, deklarata u pranua nga Shtetet e Bashkuara dhe shumica e shteteve të BE-së. Rusia, Kina, India, Brazili, si edhe Greqia, Spanja, Rumania dhe Sllovakia kanë refuzuar ta bëjnë këtë, duke deklaruar veprimin e shqiptarëve të Kosovës si shkelje flagrante të së drejtës ndërkombëtare.

Sipas rregullave të OKB-së, të drejtën për vetëvendosje të popujve pa shtetësi e kanë vetë shtetasit. Ish kryeministri Vojislav Koshtunica është shprehur se: "Shqiptarët e Kosovës kanë shtetin e tyre kombëtar. Quhet Shqipëri."

Rishikimi i kufijve

Po, kjo është kështu. Shqipëria u krijua në 1912, por kjo nuk solli bashkë të gjithë shqiptarët.

Dhe qysh atëherë autoritetet e këtij vendi kanë bërë thirrje për rishikimin e kufijve në Ballkan. Për shembull, Enver Hoxha ish-udhëheqës komunist i shkroi Stalinit në 1949: "Ne besojmë se Kosova dhe Metohija janë pjesë e kufirit me Shqipërinë, Maqedoninë, popullata shqiptare ... i duhet bashkuar Shqipërisë." Autoritetet e Kosovës kanë mohuar se planet e tyre kanë të bëjnë me bashkimin e Shqipërisë.

Por këtë duhet ta mohojnë edhe liderët në Tiranë. Por në vitin 2008, në kryeqytetin e Kosovës, në Prishtinë, u botua harta e një Shqipërie të Madhe hipotetike, e cila përfshin zona të gjera ngjitur me gjendjen aktuale të vendeve.

Por përkthimi i kësaj ideje në praktikë duhet të jetë i qëndrueshëm në numrin e minoritetit shqiptar. Në Maqedoni, në mbi gjysmë e një milion shqiptarë (rreth 25 për qind të popullsisë), Mali i Zi - 45 mijë (shtatë deri në tetë për qind).

Në tre komuniteteve në Luginën e Preshevës në Serbinë jugore - 60 mijë. Në Greqi, në Epir - gati 500 mijë (pesë për qind të popullsisë).

Së fundi, në Kosovë, pas 10 viteve të fundit kanë lënë rajonin një numër i madh serbesh dhe tani në Kosovë jetojnë më pak se dy milionë shqiptarëve, që përbëjnë jo më pak se 95 për qind të Republikës së Kosovës .

Mbi 500.000 shqiptarët jetojnë sot në Itali, Gjermani, Zvicër, Turqi, Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera. Shumë prej tyre kanë shumë ndikim.

Plani shqiptar

Për shembull, ish-drejtori i CIA-s George Tenet, ylli i kinematografisë hollivudiane James Belushi, dhe ish-kongresmeni nga Nju Jorku Joseph Diogardi, anëtarë të pasur të diasporës shqiptare po japin shuma të mëdha parash për të mbështetur një plan global të bashkëatdhetarëve të tyre në Ballkan për një Shqipëri të madhe.

Kjo është kërkesa e shqiptarëve në Kosovë bazuar në faktin se paraardhësit e tyre - ilirët - kanë jetuar në ato vende mijëra vjet.

Por shkenca është një marrëdhënie që provohet. Por dihet se në Pejë një qytet i Kosovës për shekuj (deri 1767) ishte selia e metropolitanisë serbe. Në provincë deri kohët e fundit, ishin vendosur më shumë se 1800 tempujt përfshi dhe manastiret e kishës ortodokse serbe.

Kaq shumë tempuj në një fashë të vogël, ka vetëm në Jeruzalem dhe në malin Athos. Objekti i kërkesës së shqiptarëve është vendosur edhe në jug të Serbisë në Luginën e Preshevës.

Nacionalistët shqiptarë

Nacionalistët në Maqedoninë fqinje pretendojnë gjysmën e territorit, duke përfshirë edhe kryeqytetin Shkup, i cili në kohët mesjetare ishte qendra e shtetit serb, si edhe si një pikë kyçe e shenjtë në të njëjtën kohë e Bullgarisë dhe Serbisë – Manastiri i Ohrit.

Në vitin 2001, shqiptarë të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK) filluan operacionet ushtarake kundër forcave maqedonase. Me ndihmën e Perëndimit konflikti u zgjidh, gjuha shqipe ka status zyrtar në pjesën më të madhe të vendit - në zonat ku folësit e saj janë jo më pak se 20 për qind të popullsisë.

Disa shqiptarë kanë qenë dhe ende janë pjesë e Qeverisë së Maqedonisë.

Në vitin 2005, në një numër vendesh u lejua ngritja e flamurit shqiptar. Në vitin 2008, nën presionin e autoriteteve lokale shqiptare, Maqedonia njohu pavarësinë e Kosovës. Megjithatë, ata vazhdojnë të

kërkojnë koncesione gjithnjë e më shumë, dhe disa prej organizatave të tyre bënë hapir thirrje për ndarjen e zonave perëndimore. Qetësia vazhdon ende në Mal të Zi.
Këtu, shqiptarët përbëjnë rreth tetë për qind të popullsisë. Por, duke pasur parasysh shkallën e lartë të lindjeve, pjesa e tyre është në rritje. Pra, ndoshta nuk është e largët ora kur shqiptarët lokal të marrin guximin të sulmojnë zonat e populluara jugore të vendit.

Sa për Greqinë, në vitin 1982, Ministri i jashtëm i Shqipërisë ngriti çështjen e identitetit në "zonat e lashta etnike shqiptare në veri-perëndim," dhe kërkoi diskutimin e problemit "të të drejtave të popullsisë shqiptare dhe qartësimin e kufijve të përbashkët." Dhe në janar të këtij viti, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë refuzoi të miratojë marrëveshjen midis dy vendeve mbi kufirin detar. Në një takim në Kosovë shkruhej parulla: "Nuk ka Kosovë dhe Shqipëri pa Çamëri !".

Çamëria – është pjesë e rajonit të Epirit grek, ku shqiptarët sot përbëjnë shumicën e popullsisë. Sa për Greqinë, në vitin 1982, Ministri i jashtëm i Shqipërisë ngriti çështjen e identitetit në "zonat e lashta etnike shqiptare në veri-perëndim," dhe kërkoi diskutimin e problemit "të të drejtave të popullsisë shqiptare dhe qartësimin e kufijve të përbashkët.

Prof.dr. Anja Filimonova : Serbia ne ankth, pas 5 vjetëve Kosova bashkë me Preshevën pjesë e Shqipërisë Natyrale.

“Shqipëria e Madhe” apo siç njihet Shqiperia Natyrale e cila do të përfshijë veç Kosovës edhe Preshevën nuk është bash diçka në ajër. Tashmë pesë vjet do të bëhet realitet.

Kjo do të fillojë një shqiptarizimi të plotë në Ballkan dhe populli serb do të jetë një periudhë prej 25 viteve të ardhshme me një perspektivë të errët..' ka thene në një intervistë per News-Front prof.dr. Anja Filimonova, eskperte nga Akademia e Institutit te Shkencave per Studime sllavene.

"Projeki i Shqipërisë së Madhe ka marrë një shtysë të re. Duket se Perëndimi ka kaluar nëpër fazën e parë e cila u përfundua në vitin 2008 me shpalljen e pavarësisë së Kosovës, dhe tani ka lëvizur në fazën e pavarësise së forcimit dhe zgjerimit në rajon.

Kjo është e qartë ndodh në disa nivele dhe në disa drejtime. Në rastin e Serbisë jugore, në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, te cilat komuna shqiptare ngadal por sigurt jane drejtuar kahg Kosova.." tha Filimonova.

Sipas ekspertes ruse Filimanova "Ajo qe duhet të shqetësoj aparatin shtetëror është fakti që sistemi arsimor i lidhur me Shqipërinë dhe Kosovën duke përfshirë ketu edhe Medsvegjen, Buanocit dhe Preshven aktulaish ne Serbinë jugore."

Ka edhe projekte ekonomike që lidhin Serbinë jugore me Kosovën, dhe që përfshin mbledhjet e përbashkëta të zyrtarëve të qeverisjes vendore me të Republikën e Kosovës,ka shtuar studiusja ruse.

Projekti më i madh në Shqipëri është zbatuar nga lidh Kosovën me Shqipërinë, e cila tregon në ceremoninë e hapjes së autostradës.

Kufiri mes Shqipërisë dhe Kosovës në fakt nuk ekzistojnë. Kjo mbtetet vetëm një çështje kohe kur territori i Shqipërisë dhe të Republikes se Kosovës që të

bashkohen. Mbetet të shihet nëse kjo do të zyrtarizohet, por në të vërtetë do të ndodhë ajo…" ka pohuar ne fund prof.dr. Anja Filimonova.

Projekti amerikan i krijimit të "Shqipërisë së Madhe" po realizohet ndër vite me mjete diplomatike dhe ushtarake.

Ekziston një histori e angazhimit amerikan në rajon, por kur është fjala tek ky projekt, duhet cekur disa detaje kyçe.

Këtu është bombardimi amerikan me NATO-n ndaj Serbisë më 1999, pas së cilës NATO në Kosovë ka dislokuar 50 000 trupa të armatosura mirë.

Këtu është edhe Marrëveshja e Ohrit, projekti i SHBA-së, me të cilin filloi procesi i reformave politike të Maqedonisë përmes ndryshimeve kushtetuese dhe me miratimin e një sërë ligjeve të reja që ofrojnë më tepër të drejta për shqiptarët e Maqedonisë.

Ndërsa, pika e tretë, është mbështetja e pavarësisë së Malit të Zi dhe Kosovës, me çka është dobësuar Serbia, është realizuar zbërthimi i saj, dhe është arritur një ekuilibër rajonal.

Politika amerikane, me këto angazhime ushtarake-diplomatike, përgatit projektin e Shqipërinë së Madhe", thotë analistja Jadranka Poloviq.

Politologia nga Spliti cek rëndësinë e Kosovës si pjesë të Evropës Juglindore. "Juglindja e Evropës, si në të kaluarën ashtu edhe sot, ka një domethënie të rëndësishme gjeopolitike dhe gjeostrategjike, që përcakton të ardhmen politike të rajonit.

E lidhur me Mesdheun, Lindjen e Mesme, malet e Kaukazit dhe Azinë Qendrore, si dhe rajonin e Danubit

dhe Evropën Qendrore, ka qenë gjithmonë subjekt i interesave të fuqive të mëdha.

Për shkak të rëndësisë së energjisë në gjeopolitikën e shekullit XXI, kjo hapësirë, ku janë rrugët e rëndësishme të transitit, bëhet një zonë e konkurrencës së fortë të qendrave të pushtetit botëror.

Në fakt, Evropa Juglindore është rruga më e shkurtë transiti midis Evropës Perëndimore dhe zonave të pasura me gaz e naftë në Azinë Qendrore dhe basenit Kaspik, dhe si i tillë është i aftë të bëhet pjesë e lojës së re të madhe gjeopolitike, pra një hapësirë ku ballafaqohen interesat e SHBA-së, Evropës, Rusisë dhe Turqisë", thekson Poloviq.

Ekspertja kroate shton se projekti i dominimit amerikan në Euroazi në fakt fillon në Evropën Juglindore me Shqipërinë, ndërsa përfundon në Kinë.

Shtetet e Bashkuara gjeostrategjinë e saj drejt Azisë Qendrore e mbështesin në rrjetin e shteteve proamerikane në Evropën Juglindore, si Maqedonia, Shqipëria, Rumania, Bullgaria, Turqia, Greqia, e në kontekstin e fundit edhe Kosova, si dhe shtetet e rajonit Kaspik - Azerbajxhani dhe Uzbekistani – por edhe Gjeorgjia dhe Ukraina, ku siç thotë ajo, përhapet strategjia e unifikimit të amerikanizimit botëror.

"Në fakt, shembulli i Kosovës, si shtet i ri i krijuar nga përdorimi i instrumenteve të politikës amerikane, është një tregues i dominimit të vazhdueshëm të SHBA-së në rajon dhe përpjekjet për të ruajtur udhëheqjen unipolare amerikane jo vetëm në juglindje të Evropës, por në të gjithë rajonin e Euroazisë", thotë Poloviq, duke shtuar se Kosova mbetet një shembull amerikan në

zotërimin e rregullave të demokracisë, tregut të lirë dhe të hapjes për investitorët e huaj.

"Politika amerikane tund të gjitha projektet në Kosovë. Është turp që zyrtarët amerikanë që mundën Serbinë tani privatizojnë pjesët më vitale të ekonomisë së Kosovës", thotë politologia kroate, e cila nuk pret trazira të reja në rajon.

"Udhëheqësit e lëvizjes kombëtare shqiptare këto ditë thanë se SHBA-ja dhe Rusia kanë rënë dakord për rishikimin e kufijve, në mënyrë që Presheva, Kosova, dhe unë besoj një pjesë e Maqedonisë dhe e Malit të Zi, do të gjenden brenda një Shqipërie të Madhe.

Unë ju besoj, sepse konfigurimi i deritashëm i rajoneve të ish Jugosllavisë është bërë në rrugën e dy proceseve integruese: anëtarësimin në NATO dhe në Bashkimin Evropian. Shtetet kombëtare e kanë humbur kuptimin, ndërsa akterët globalë avancojnë me projektet e zgjerimit të demokracisë, të drejtave të njeriut dhe tregut të lirë, që nënkuptojnë globalizimin e varfërisë në rajon. Shtetet e reja janë krejtësisht të varura nga kapitali i huaj, ndërsa këto ditë shohim Qeverinë kroate si shembull që adapton gjithçka që akterët e huaj u thonë".
Pas Greqisë, për krijimin e Shqipërisë së Madhe, ka dhënë alarmin edhe Rusia.

Mediat ruse e kanë interpretuar ngjarjen e Kumanovës, përplasjet mes Shqipërisë dhe Greqisë dhe deklaratat e kryeministrit Edi Rama, si paralajmërim për ndryshimin e kufijve.

Përmes një analize të gjerë, një ndër portalet më të mëdhenj rusë, "Boctok", ka argumentuar se krijimi i Shqipërisë së Madhe është një ide e Shteteve të

Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian, që synon aneksimin e të gjitha territoreve me popullsi shqiptare.
"Ideja e Shqipërisë së Madhe parashikon bashkimin e të gjitha territoreve ku ka shqiptarë. Ideologët e Shqipërisë së Madhe aspirojnë për marrjen e disa rajoneve në Serbinë Jugore, Maqedoninë Perëndimore, në Jug të Malit të Zi dhe një pjesë të territoreve të Greqisë veriore", shprehet portali. Në analizën e kësaj medie, theksohet se rreziku më i madh i kanoset Maqedonisë, duke thënë se ka dhe numrin më të madh të shqiptarëve.

"Në Preshevë jetojnë rreth 60 mijë shqiptarë, një numër i parëndësishëm krahasuar me rreth 7 milionë banorë që ka Serbia. Megjithatë në Preshevë dhe Bujanoc shumica përbëhet nga shqiptarë. Në Maqedoni situata është pak më ndryshe, pasi shqiptarët përfaqësojnë ¼ e popullsisë së saj, ose 25.17 për qind.

Ndërsa në Greqi numri i shqiptarëve është i luhatshëm nga 2-4 për qind, me përqendrim më të madh në zonën veri-perëndimore. Sipas të dhënave, edhe në Mal të Zi ka shqiptarë, që përbëjnë rreth 5 për qind të popullsisë", thuhet më tej.

Në portal theksohet se shkëndijat e para për Maqedoninë u dhanë në ngjarjen e Kumanovës, ku ndër të tjera theksohet se Shqipëria po synon ta shndërrojë në federatë këtë shtet.

Sa i përket Greqisë, thuhet se ka më pak rrezik, edhe pse theksohet se tensionet për kufirin jugor kanë rritur mjaft përplasjet.

Akuza SHBA-BE

Në analizën e portalit serb theksohet se realizimi i Shqipërisë së Madhe po bëhet nën kujdesin e

Uashingtonit dhe Brukselit, duke theksuar se atyre i intereson një gjë e tillë.

"Ekspansionizmi kaq agresiv i shqiptarëve nuk do të ndodhte kurrsesi nëse nuk do të kishte një mbështetje nga jashtë. Dhe në të vërtetë ata janë mbështetur nga SHBA dhe vëllai i saj i vogël BE.

Në situatën aktuale politike, me një shigjetë Uashingtoni ka arritur një sërë objektivash në Ballkan", thuhet më tej.

Në analizë renditen dhe arsyet se përse po synohet një gjë e tillë. Sipas portalit, SHBA dhe BE po përdorin Shqipërinë për të dhënë paralajmërime në drejtim të Greqisë dhe Serbisë për bashkëpunimin e tyre me Moskën.

Një tjetër arsye që përmendet është se Brukseli e Uashingtoni po përpiqen të dobësojnë rolin e Kinës dhe Rusisë në Ballkan.

Sipas portalit, Kina ka planifikuar ndërtimin e një hekurudhe nga Budapesti në Beograd dhe më pas zgjatimin në Maqedoni e Greqi. Theksohet se ndërtimi i kësaj hekurudhe do të bëjë që Kina të futet shumë kollaj në tregun e Evropës dhe SHBA-së e BE-së kjo nuk i intereson.

Megjithatë thuhet se arsyeja kryesore është paralajmërim i vendeve të rajonit lidhur me mbështetjen që mund t'i ofrohet Rusisë.

7.24.2016

RAMUSH HARADINAJ

Shumëkush që e njeh sadopak Kosovën, u trishtua dhe u befasua vërtet keqas nga gjuha mjaft e ashpër, me tone dhe konotacione krejtësisht paragjykuese, që u përdorur nga Kryeprokurorja e Tribunalit të Hagës, Karla Del Ponte, menjëherë pas rifillimit të procesit gjyqësor kundër njërit prej simboleve të rezistencës kosovare: Kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe ish-kryeministrit, Ramush Haradinaj.

Ai, që ajo e cilësoi "Kriminel i veshur me pushtet" mbetet njeri prej personaliteteve më të spikatura, jo vetëm në vendin e tij dhe në hapësirën mbarëshqiptare, por në të gjithë Ballkanin. Bëhet fjalë për njërin prej simboleve të rezistencës, për pinjollin e njërës prej

familjeve më patriotike të Kosovës (ndoshta e dyta në renditje pas legjendarëve Jashari), për atë që filloi dhe drejtoi luftën në njërën prej zonave operative më delikate, për themeluesin e një partie politike që theu mitin e Partisë Demokratike dhe që e para hyri në aleancë me rivalin tjetër të spektrit politik, Lidhjen Demokratike. Por, jo vetëm kaq.

Bëhet fjalë edhe për Kryeministrin më të suksesshëm dhe më efikas të vendit, pas konfliktit të armatosur. Pra, kjo fjali u drejtua ndaj, as më shumë dhe as më pak, por Heroit real të Kosovës moderne.

Tribunali i Hagës e akuzon zotin Haradinajn për vrasjen e 40 personave në 1998, gjatë konfliktit të armatosur. Dy prej bashkëpunëtorëve të tij më të ngushtë ndodhen gjithashtu me të në bankën e të akuzuarve. Për prokurorin e çështjes, ky është dhe mbetet njeri prej rasteve më komplekse. Sipas tij, vështirësia qëndron tek fakti se një pjesë e dëshmitarëve potencialë janë vrarë gjatë viteve dhe shumica e atyre që kanë vendosur të dalin përpara gjykatës, kanë kërkuar që të ruhet dhe të fshihet tërësisht identiteti i tyre. Sipas autoriteteve të gjykatës, bëhet fjalë për më shumë se një të dhjetën e tyre, duke vendosur kështu rekord për të gjitha çështjet penale të trajtuara deri më sot nga Tribunali.

Megjithatë, ky element përbën vetëm njërën pjesë të realitetit. Tjetra, ka të bëjë me qëndrimin që kanë mbajtur dhe mbajnë ndaj këtij procesi protagonistët kryesorë. Më konkretisht, dallimet konceptuale në këndvështrime mes prokurorëve të Tribunalit të Hagës nga njëra anë dhe diplomatëve perëndimorë dhe atyre të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, nga ana tjetër, që

pavarësisht se janë ndër përkrahësit kryesorë të tezës së nxjerrjes së kriminelëve përpara drejtësisë, e kundërshtojnë fort dhe me stoicizëm.

Për diplomatët e huaj, Ramush Haradinaj ishte ndër politikanët dhe partnerët më të rëndësishëm në përpjekjet e tyre për vendosjen dhe konsolidimin e paqes dhe të stabilitetit. Kjo është kaq e vërtetë, sa ata u përpoqën që çështja e tij të mos dalë përpara gjykatës. Ky tashmë është fakt i superkonfirmuar dhe jo vetëm hamendësi.

Menjëherë pasi u ngrit dhe u bë publike padia e tij, ishte vetë Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë që e mbrojti lirimin me kusht të ish-kryeministrit; dhe njëkohësisht kërkoi që ai të mund të vazhdonte të luante një rol në politikë, ndonëse disi më i tërhequr dhe pa dhënë intervista. Ky është rasti i vetëm në historinë e Tribunalit, që një i akuzuar për krime lufte të lejohet të kthehet në vendin e tij për një periudhë dyvjeçare dhe të mund të merret me politikë, cilado qoftë forma.

Kontrasti është mëse i plotë dhe mëse i qartë, po të njihesh me dy qëndrime vërtet të kundërta. Ish-përfaqësuesi i OKB- së në Kosovë, Soren Jesen Petersen, për protagonistin e kësaj çështjeje është shprehur se: “Ai e shtyu përpara procesin e demokratizimit të Kosovës më shumë se kushdo tjetër dhe në një mënyrë krejtësisht unikale. Ai ishte mendjehapur dhe mjaft i saktë dhe është një politikan me vlerë të pallogaritshme, që i duhet vendit të tij në këto situata që po kalon”.

Nga ana tjetër prokurorët në Kosovë dhe Hagë u shprehën se, si Misioni i Kombeve të Bashkuara në Prishtinë ashtu edhe qeveritë perëndimore, u përpoqën

që ta pengonin dhe frenonin gjykimin e tij. Zonja Del Ponte duke folur për këtë rast, u shpreh se kjo ishte "një çështje të cilën nuk donin të ndodhte dhe ishin shumë të paktë ata që e mbështetën, si në nivel lokal ashtu edhe ndërkombëtar".

Në Kosovë ai vlerësohet ndoshta si lideri më karizmatik, por njëkohësisht edhe si kryeministri më i suksesshëm, që brenda një periudhe të shkurtër kohore i dha ritëm, dinamikë dhe nivel të jashtëzakonshëm ekzekutivit. Mjafton të bisedosh me qytetarët për ta kuptuar një fakt të tillë.

E, ndërsa qeveria serbe e cilësoi si terrorist, zyrtarë të lartë ndërkombëtarë theksojnë se ai është tepër i rëndësishëm; madje edhe jetik, për të nxitur bashkëjetesën dhe mirëkuptimin e shpartalluar ndëretnik.

Pas zotit Veton Surroi ai ishte i pari që e kuptoi se serbët e Kosovës, në çfarëdolloj kombinacioni, do të ishin pjesë e Kosovës së re. Fjala e tij kishte peshë dhe vlerë të pallogaritshme, pasi askush, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, nuk mund ta akuzonte atë për mungesë patriotizmi apo se po e tradhtonte Kosovën. Kredencialet e tij ishin dhe mbeten të mrekullueshme dhe të pasfidueshme. Kontributi i tij është i jashtëzakonshëm, si përpara ashtu edhe pas mandatit të arrestimit.

Nuk duhet harruar për asnjë moment se, gjatë trazirave më të rënda etnike që përjetoi Kosova e paskonfliktit, pra ato të Marsit të 2004, sipas vetë Kishës Ortodokse Serbe ai ishte personi, që me reputacionin dhe largpamësinë e tij të paturbulluar nga epshet nacionaliste, që i frenoi grupet agresive shqiptare për djegien dhe

vandalizimin e disa prej manastireve dhe objekteve më të njohura serbe.

Akuza është e rëndë. Në të thuhet mes të tjerash, se njerëzit që kapeshin nga njësitë ushtarake që drejtoheshin nga komandant Haradinaj, lidheshin me tela me gjemba dhe tërhiqeshin me makina nëpër rrugë. Përkrahësit e zotit Haradinaj i kanë hedhur poshtë ato, duke i cilësuar trillime të trishta dhe të padenja për një tribunal.

Ata shtojnë se nuk ka prova që e lidhin emrin e ish-komandantit, me krime monstruoze të kësaj natyre. Sipas tyre, ka një dhe vetëm një arsye se përse është arrestuar zoti Haradinaj: dhe kjo ka të bëjë me faktin se Tribunali duhet të duket në opinionin e gjerë, si shumë i balancuar në punën e tij, pra, se nuk merret vetëm me krimet e kryera nga serbët, siç pretendon kryeministri serb, Vojisllav Koshtunica, por edhe të shqiptarëve.

Vetë zoti Haradinaj, si gjithnjë i drejtpërdrejtë në deklaratat e tij, është shprehur se përballjen me Hagën e sheh si mundësi jo për të mbrojtur veten, por historinë e lavdishme të UÇK-së. Dhe, ku ka më mirë që Heroi të mbrojë heroizmin!(Flori Bruqi, Floart-Press, 27 prill 2007).

Kush është Ramush Hilmi Haradinaj?

Ramush Haradinaj u lind më 3 korrik të vitit 1968, në fshatin Gllogjan të Deçanit. Është i martuar dhe ka dy fëmijë. Shkollimin fillore e kreu në vendlindje, kurse atë të mesëm në Gjakovë. Ishte dëshirë e tij të studiojë për astronomi. Por, zhvillimet politike të kohës, atë e

vendosën në një sferë tjetër të interesimeve dhe angazhimeve.

Në vitet 1998-99, Ramush Haradinaj ishte komandant i Zonës Operative të Dukagjinit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Zonën Operative të Dukagjinit.

Ka diplomuar në fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës dhe aktualisht ndjek studimet për Master i shkencave.

Ramush Haradinaj është ish-kryeministër i Kosovës, që doli pas zgjedhjeve të fundit nacionale në Kosovës (2004). Këtë përgjegjësi e mori më 6 dhjetor 2004, pas marrëveshjes për koalicion me Lidhjen Demokratike të Kosovës.

Më 8 mars 2005 Ramush Haradianaj jep dorëheqje nga posti i kryeministrit të Kosovës, pas aktakuzës që padrejtësisht iu ngrit nga Tribunali Ndërkombëtar i Hagës.

Ai, veç pas tre muajsh të akuzimit mori të drejtën e mbrojtjes në liri. Që nga qershori i vitit 2005 Haradinaj, mbrohet në liri. Kryen përgjegjësitë organizative dhe administrative si kryetar i AAK-së.

Është vëlla i tre dëshmorëve të kombit: Luan Haradinaj, vëlla i Ramush Haradinajt, ra në një betejë të UÇK-së me forcat serbe, më 6 maj të vitit 1997. Në ditët e fundit të luftës çlirimtare të UÇK-së, heroikisht ra vëllai tjetër i tij, Shkëlzen Haradinaj, një nga eprorët më të famshëm të UÇK-së.

Më 15 prill të vitit 2005, ka rënë në një pritë të organizuar vëllai i tretë i Hardinajve, Enveri, invalid i luftës së UÇK-së.

Ramush Haradinaj është aktualisht kryetar i AAK-së dhe pret lirimin e tij nga TPI-ja.

(keto info janë të huazuara nga faqja zyrtare e Aleances www.aleanca.info Hero në luftë - hero në paqë: Ramush Haradinaj)

Ndonëse i popullarizuar si ish kryeministër, ish komandanti i UÇK-së duhet ti mohojmë informatat e gazetave sllave, si dhe shumë informative tjera të MUP-it Jugosllavë si informative të rreme nga informatorët dhe bashëpunëtoret e komandant Ramushit, që gjeja gjenerali më trim i Kosovës, ka "patur" aktivitete kriminale në pjesëmarrjen e tij në vdekjen e civilëve.

Në Ballkan shpesh thuhet se heroi i një personi është kriminel për personin tjetër. Ky përshkrim nuk do të mund të ishte i saktë se në përshkrimin e ish kryeministrit të Kosovës Ramush Raradinaj, i cili në mënyrë dinjitoze dha dorëheqje me 8 mars 2005 pasiqë tribunali i Hagës lëshoi aktakuzën për krime të luftës kundër tij.

Për rrafshin e Dukagjinit,Ramush Haradinaj është hero i modelit klasik-djali i vrazhdë dhe trim nga fshati që bëri vepra të mira duke pasur guximin të luftojë për idealet e tij.

Por për popullatën serbe nëKosovë, Ramush Haradinaj është simbol i dhunës dhe padrejtësisë. Ai konsiderohet si bandit i paskrupullt- vrasës që mbizotëroi një regjim terrori në Dukagjin, regjionin perëndimor të Republikës së Kosovës në vitet 1998-1999 duke lënë nga

pas gjurmë të kufomave civile,sipas informacioneve të MUP-it Jugosllavë.

Njeriu që do të arrinte të ushtrojë respekt në masë të madhe nga ana e shqiptarëve dhe të nxisë hidhërim nga ana e serbëve ka lindur në fshatin Gllogjan më 3 korrik, 1968, fëmija i dytë nga nëntë femijë në familjen e tij.

Sikur të gjithë shqiptarët e Kosovës të lindur në vitet e gjashtëdhjeta, Ramush Haradinaj vijoi mësimet në shkollë etnikisht të përzier, dhe mësoi të flasë serbo-kroatisht.

Pas përfundimit të shkollës së mesme në vitin 1987, ai e kreu shërbimin e detyrueshëm ushtarak në APJ, duke treguar talent të mjaftueshëm ushtarak, gjë që çoi në gradimin e tij si oficer komandant-gjë e rrallë kjo për shqiptarët.

Pas ushtrisë, Ramush Haradinaj fillimisht deshi të studionte astronomi në Univerzitetin e Prishtinës, në atë kohë të udhëhequr nga rektori serb Radivoje Papoviç. Por ai deklaroi se i ishte pamundësuar një gjë e tillë për shkak se disa nga anëtarët e familjes së tij kishin pasur probleme me autoritetet komuniste në komunën e vogël Deçan, rrënzë Alpeve Shqiptare.

Në vend të studimit, ai shkoi në Lucern, Zvicër, ku së bashku me xhaxhanë e tij e krijoi një biznes për ndërtim. Gjatë një vizite të tij në Kosovë në mars të vitit 1991, Ramush Haradinaj u zu në mes të një vale protestash dhe kryengritjesh që po ndodhnin në Kosovë si reagim ndaj një numri të ligjeve anti-shqiptare të implementuara nën urdhërat e liderit serb Slobodan Millosheviq.

Ramush Haradinaj ishte mbajtur në paraburgim për një natë dhe ishte marrë në pyetje nga policia serbe e MUP-it të Deçanit dhe të Pejës. Pas lirimit të tij, ai u kthye në Zvicër ku u paraqit dhe më vonë iu dha azili politik.

Nga ekzili, Ramush Haradinaj përcjellte gjersa Sllobodan Miloseviq vazhdonte ta dezintegronte Kosovën duke i larguar shqiptarët nga universiteti dhe duke i përzënë ata nga pozitat shtetërore të punës.

Ai u inkuadrua në Lidhjen Popullore të Kosovës, LPK, grup radikal i shqiptarëve emigrantë me banim në Zvicër, të cilët që një kohë ishin duke thirrur shqiptarët të përdorin çdo mjet të mundshëm-përfshirë këtu kryengritjen e armatosur- për të siguruar pavarësinë e krahinës.

Gjatë kohës në ekzil, ai u dashurua me një femër finlandeze dhe filloi të jetonte me të. Nga koha në kohë, ai kthehej në Kosovë ilegalisht duke kaluar nëpër male nga Shqipëria, nganjëherë duke sjellur edhe armë me vete.

Në mars të vitit 1997, një varg investimesh mashtruese piramidale u shembën në Shqipëri, duke e sjellur vendin në një gjendje anarkie. Gjersa popullata atje ndërrmori një aksion të gjerë shkatërrimi-duke zbrazur arsenalet e miliona kallashnikovëve, granatave, minave tokësore, minahedhësve dhe municionit - Ramush Haradinaj fluturoi për në aeroportin e Rinasit, në Shqipëri dhe filloi grumbullimin e armëve. Ai e dinte se tragjedia në Shqipëri do të shërbente për pajisjet për ushtrinë çlirimtre të Kosovës, UÇK.

Ai mblodhi një grup të njerëzve, duke përfshirë këtu edhe vëllain e tij, Luanin, në aksion të bartjes së armëve përtej kufirit. Në maj të vitit 1997, grupi i Ramush

dhe Luan Haradinaj i ngarkuan armët në shpinë dhe kaluan kufirin për në Kosovë. Mirëpo pak pasiqë kaluan kufirin, ata u zunë në pritë nga trupat serbe. Luani u vra heroikisht nga soldateska serbe, dhe një nga personat tjerë u plagos rëndë.

Grupi u tërhoq dhe Ramush Haradinaj e barti trupin e vëllaut të tij përtej kufirit për ta varrosur dhe pastaj u kthye në Zvicër. "Kam qenë i humbur pas asaj ngjarje," i tha Ramush Haradinaj mediave më vonë. "Ndjehesha përgjegjës për vdekjen e vëllait tim. Doja të vazhdoja, por nuk mundesha gjatë asaj kohe."

Dy muaj më vonë, Haradinajt iu kthye vullneti. Ai u kthye në Shqipëri, kapërceu Alpet Shqiptaro-Shqiptare prapë për të ardhur në Kosovë dhe e themeloi bazën e tij në fshatin e lindjes në Gllogjan. Ai e shëndrroi shtëpinë e familjes së tij në bazë të UÇK-së dhe ndihmoi në ndërtimin e ushtrisë guerile të rajonit të Dukagjinit, duke e transformuar një grup të paorganizuar të djemve të rinjë në një forcë që do ta trondiste regjimin serb.

Në mars të vitit 1998, gjatë përpjekjeve të tyre për ta eliminuar UÇK-në, trupat serbe ndërrmorën një sulm në bazën rebele në Gllogjan, duke përdorur helikopterë dhe makina të blinduara.

Duke iu falenderuar një vargu të rastësive fatlume dhe konfuzionit nga ana serbe, grupi e mbijetoi sulmin, edhepse Ramush Haradinaj u plagos disa herë.

Gjatë dy viteve të ardhshme, Ramush Haradinaj do te humbte edhe vëlla tjetër dhe disa nga shokët e tij të ngushtë në luftime. Por gjersa UÇK shëndrrohej në një forcë guerrile, Ramush Haradinaj e fitoi reputacionin e një lufëtari që nuk i frikësohet asgjëje.

Së shpejti ai zhvilloi marrëdhënje me zyrtarët e SHBA-ve duke u bërë i vlefshëm për ta ushtarakisht dhe për intelegjencë.

Mirëpo, edhepse ai respektohej në mesin e bashkëluftëtarëve të tij dhe konsiderohej i vlefshëm nga amerikanët, ai ngjallte frikë tek secili që guxontë ti vinte në dyshim veprimet e tia.

Sipas scenareve të MUP-it të Beogradit, gjegjsisht krerëve të MUP-it të Pejës, Deçanit, Prishtinës thuhet se "…njësiti i UÇK-së i Ramush Haradinaj ka kidnapuar dhe vrarë 40 civilë serbë të cilët konsideroheshin të zhdukur në vitin 1998 dhe 1999. Disa nga këto kufoma gjëja janë gjetur në faza të ndryshme të dekompozimit në kanale që derdhen në liqen afër Gllogjanit. Trupat e disa civilëve tjerë janë gjetur në fund të puseve".

Gjithashtu,poashtu sipas mediave të Beogradit "… supozohet se njësiti i Ramush Haradinaj ka vrarë shqiptarë". Në fund të dhjetorit të 2002, vëllau i Haradinaj, Dauti, u dënua nga gjykata e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (në Pejë) me pesë vjetë burgim për pjesëmarrjen e tij në kidnapimin, torturimin dhe vrasjen e katër anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës (FARK), të cilët ishin rivalë të UÇK-së gjatë konfliktit. Dauti, para 5 muajsh u lirua nga burgu i Dubravës dhe u prit nga bashkëvendasit e tij për here të dytë si hero p popullit, ngase edhe është hero!

Pas luftës, Ramush Haradinaj u zgjodh zv. komandant i Trupave për Mbrojtjen e Kosovës (TMK), forcë kjo e krijuar sipas modelit të Gardës Kombëtare të SHBA-ve. Sidoqoftë, pas një kohe Haradinaj dha

dorëheqje nga posti i tij dhe e themeloi partinë e tij politike, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, AAK.

I rrjedhshëm në gjuhën frënge dhe angleze, politikani i ri la përshtypje të mira tek zyrtarët e huaj dhe gazetarët, dhe gjersa partitë tjera politike përqëndroheshin kryesisht në çështjen e pavarsisë, Ramush Haradinaj mbështeste rëndësinë e ndërtimit të rrugëve dhe shkollave.

Edhepse shumica e respektonin të kaluarën luftarake të Ramush Haradinaj, partia e tij politike në fillim nuk gëzonte përkrahje të gjerë popullore, dhe mbetej e treta në distancë pas partisë së Akademik Ibrahim Rugovës Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dhe partisë së liderit të UÇK Hashim Thaçi, Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

"Ramushi nuk është njeri i politikës," i tha IWPR një nga bashkëluftëtarët e tij në vitin 2000 kur Ramush Haradinaj hyri në skenën politike për herë të parë. "Kur flas me të, mund ta bëj të qesh një minutë, dhe ta bëjë të më vrasë minutën tjetër. Nuk mund të jesh emotiv në politikë."

Në fakt, gjatë garës për zgjedhjet komunale në Kosovë në vitin 2000, temperamenti i Ramush Haradinaj shpesh dilte jashtë kontrollit. Ramush Haradinaj përfundoi në një përleshje fizike me ushtarët rusë paqeruajtës në një kalim kontroll.

Disa muaj më vonë, ai ndërmorri një veprim politik të gabuar edhe më të madh. Pasi disa nga rivalët e tij nga koha e luftës-familja Musaj-e konfrontuan babanë e tij duke kërkuar të dijnë se ku ishin familjarët e tyre të zhdukur, Ramush Haradinaj u zemërua tej mase.

Ai dhe disa nga përkrahësit e tij udhëtuan tek shtëpia e familjes Musa në fshatin Strellc në ora një të mëngjesit, u ngjitën mureve dhe e konfrontuan familjen. Një shkëmbim zjarri pasoi në vijim ku u përdorën edhe granata, dhe Ramush Haradinaj përfundoi i plagosur.

Pas incidentit, Ramush Haradinaj u bart me helikopter në bazën ushtarake amerikane në Kosovë, dhe më vonë u trajtua për plagë të shkaktuara nga granatat në një spital ushtarak amerikan në Gjermani. Më vonë, zyrtarët amerikanë në Kosovë do të akuzoheshin për ndërhyrjen e tyre në hetimet e OKB-së të incidentit.

Në vitet që pasuan, stili i jetës së Ramush Haradinaj shkaktonte ngritje të vetullave në Kosovë. Ai u nda nga partnerja e tij finlandeze, u martua për së dyti dhe u vendos në një shtëpi luksoze në lagjën Arbëria në Prishtinë. Edhepse shtëpia thuhej ti ishtë dhënë nga miqtë e tij, shume anmiqë të tij politikë e vështronin një gjë të tillë me zili, ngase vetë Ramushi më vëllëzër dhe babain e tij e ndërtuan.

Ndërkohë, mediat e ndryshme si fjala vjen "Koha ditore" e Veton Surroit, shpifte më të madhe "se ai kishtë bërë krime lufte dhe ishte i përfshirë në tregëtinë e paligjshme të duhanit".

Përkundër komenteve kontraverze të Beogradit, kundërshtarëve të tij politikë, Ramush Haradinaj mbetej person më i popullarizuar në Rrafshin e Dukagjinit dhe në tërë Kosovë...

Biografia e tij në dy pjesë në formë të intervistës së zgjatur u publikua nga bashkëvendasi i tij, publicisti i shquar shqiptar Bardh Hamza, në "Zëri" të Prishtinës (nga

një ndër shtëpitë botuese më të famshme në Kosovë), dhe ishte ndër librat më të shitur.

Në Rrafshin e Dukagjinit, ai gëzonte përkrahje besnike. "Ne kemi njerëz tjerë për politikë," thonin fshatarët e rajonit të Dukagjinit. "Por nëse serbët kthehen, ne e kemi Ramushin."

Pas zgjedhjeve, AAK hyri në koalicion me partinë në udhëheqje LDK dhe Ramush Haradinaj u zgjodh kryeministër i Kosovës.

Emërimi i tij i zemëroi si serbët, kundërshtarët politikë tjerë, poashtu edhe diplomatët perëndimorë, shumica prej të cilëve i bënë thirrje Misionit të OKB-së në Kosovë të pengojnë emërimin e tij. Gazeta "The New York Times" kritikoi ashpër emërimin e tij në një editorial.

Mirëpo, Soren Jessen-Pettersen, shefi i Misionit të OKB-së në Kosovë, refuzoi të intervenojë, duke deklaruar se, "Nëse unë do ti thoja Jo këtij emërimi, unë do ti thoja Jo demokracisë."

Sipas të gjitha burimeve, pasiqë u emërua, Ramush Haradinaj dëshmoi të jetë një lider efektiv dhe dinamik, duke mbështetur një pilot projekt që i ofronte Kosovës një pavarësi (të kushtëzuar).

Më 8 mars 2005, pasi gjykata për krime të luftës pranë OKB (Hagë) e konfirmoi aktakuzën kundër tij, Ramush Haradinaj e shpalli dorëheqjen e tij prej kryeministri dhe u betua se do të udhëtonte për në Hagë të ndeshej me akuzat e Karla Del Pontës, kundër tij.

Gjatë dorëheqjes, Ramush Haradinaj thirri popullin për qetësi dhe apeloi kundër protestave të dhunshme.

Por kur ai do të thirret të përgjigjet për të kaluarën e tij si komandant i forcave guerrile, shumë frikësohen se temperamenti i tij do të del në sipërfaqe, gjë që mund të sjellë trazira dhe mund ti japë fund paqes së brishtë në Kosovë.

"Ai mund të jetë në paraburgim nga tribunali, por përkrahësit e tij vetëm janë duke bërë plane," thoshin banorët e fshatit tim, Isniqit, në një tubim masiv kur u burgos Ramushi.

Ramushi gjatë vitit 2007 duhet edhe një here të përballohet më akuzat e Tribunalit të Hagës, por gjithsesi ai do të lirohet nga aktakuza ngase gjenerali, guerili dhe heroi i Dukagjinit nuk ka bërë krime lufte, por ka mbrojtë popullin nga soldateska e satrapit dhe kriminelit Sllobodan Millosheviqit.

Ramush Haradinaj u kthye nga beteja e Hagës me 5 prill ku u shpall i pafajshem nga te gjitha akuzat.

Amerikanët e cilësojnë si një hero të gjallë sepse shkoi si kryeministër dhe u kthye si hero.

ARKANI NË KOSOVË

Vuk Drashkoviq, e kishte përgatitur një formacion për pjesëmarrje në këto luftëra të përbërë prej 11 mijë vetëve me të cilët ka komanduar Gjorgje Bozhiq, Gisha e më pas Çeko Daçeviq.

Garda Nacionale Serbe e Ripërtrirjes Popullore Serbe (SNO) e Mirko Joviqit kishte përgatitur 3000 njerëz, me të cilët ka komanduar Dragosllav Bokan.

Partia Radikale Serbe (SRS) dhe Lëvizja Çetnike Serbe kishin organizuar formacionin "Shqiponjat e Bardha". Kishin 3000 njerëz të cilët i komandonte togeri Branisllav Vakiq. Me këtë formacion vepronte edhe formacioni i kapiten Draganit, i cili numëronte 500 njerëz dhe afër 100 pjesëtarë të “kninxhinjëve”, paramilitarë që kishin vepruar në Knin, të komanduar nga Millan Martiq nga Knini.

Partia e Unitetit Serb (SSN) kishte përgatitur gardën vullnetare me të cilën ka operuar Zhelko Razhnjatoviq - Arkan, zëvendës i të cilit ishte Mihajlo Ulemek.

Këto formacione paraushtarake dhe paramilitare serbe, pjesëmarrëse në krimet kryesore në Bosnjë, Kroaci dhe Kosovë ishin sajuar nga partitë politike serbe. Këto njësi ishin të parapara si formacione paramilitare, të cilat kishin për detyrë spastrimin etnik të popullatës joserbe në ish Jugosllavi. Sipas shumë burimeve Arkani e kishte vrarë drejtorin e Rafinerisë së Naftës INA të Zagrebit Dragolub Gjurkoviqin, edhe pse zyrtarisht është thënë se këtë vrasje e ka bërë Gjorgje Bozhoviq Gishka. Është karakteristike se një fat kriminal e gjen edhe gazetaren e njohur Dada Vujasinoviq, e cila pas botimit të teksteve me biografi të Arkanit ishte gjetur e vrarë vetëm disa ditë pasi Arkani ia kishte tërhequr vërejtjen. Arkani kishte vjedhur ari me vlerë të pakufizueshme nga viktimat në Kroaci, Bosnjë dhe Kosovë.

Arkanit dhe Zoran Stefanoviqit, shefat e KOS-it u kishin dhënë detyrë organizimin e kryengritjes në krahinën e Kninit dhe ballafaqimin e parë me kroatët, në mënyrë që forcat e armatosura serbe të kenë pretekst për ndërhyrje. Arkani dhe Stefanoviqi pas kryerjes së një varg aksionesh në Republikën Kroate, hetohen nga shërbimi sekret kroat dhe pas një kohe të shkurtër arrijnë t'i kapin në vepra konkrete, me ç'rast i arrestojnë. Mirëpo, shumë shpejt qarqet e KOS-it dhe MUP-it federativ, i cili edhe më tutje ishte valid në Kroaci arrijnë t'i lirojnë këta kriminelë ordinerë në kushte dhe rrethana krejtësisht të paqarta. Arkani dhe Zoran Stefanoviqi me urdhëra të KOS-it

ushtarak, në Kroaci kishin kryer operacionin “Tuneli”, i cili kishte për qëllim sulmin e befasishëm të reparteve të UJ-së, me qëllim që forcat e UJ-së pastaj të kenë hapësirë veprimi. Po ashtu këta të dy, kuptohet me urdhër të KOS-it, e udhëhoqën edhe operacionin tjetër të shifruar “Opera”. Shumica e pjesëtarëve të këtyre operacioneve arrestohen nga forcat e sigurimit kroat në vitin 1994, respektivisht 1995, me ç’rast gjatë hetimeve të zhvilluara kundër tyre, sigurimi kroat arrin ta zbulon edhe operacionin e njohur “Shpegel” dhe ta ndriçoje operacionin “Tuneli”.

Në fillim të prillit të vitit 1992 në Bosnjë, në hyrje të Belinjës u bë një masakër masive mbi popullatën vendase. Njësia e Arkanit që e kreu këtë veprim kishte të bëjë me inicimin e konfliktit mes serbëve dhe boshnjakëve. Boshnjakët në pamundësi për të rezistuar, u detyruan të ikin e pastaj Arkani hyn duke e plaçkitur këtë vend. Gjatë këtij konflikti qytetar Arkani arrin ta plaçkitë shërbimin e kontabilitetit në Belinjë. Pas këtij akti e lë Belinjën dhe kalon në Zvornik. Arkani në Bosnjë e ka drejtuar edhe operacionin “Ballafaqimi” i cili u aplikua në Bosnjën Qendrore, për krijimin e kampeve të përqendrimit ku grumbulloheshin njerëzit e ndryshëm të përkatësisë boshnjake e kroate kinse me qëllim të mbajtjes nën kontroll. Të gjithë shefat e kampeve të përqendrimit ishin anëtarë aktivë apo rezervë të strukturave të KOS-it ushtarak.

Fillimisht Radovan Karagjiq kishte formuar organizatën famëkeqe "Tajfun" e cila mblidhte informata për njerëz dhe e bënte likuidimin e tyre. Kësaj organizate iu bashkangjit edhe njëri ndër figurat më të fuqishme të

KOS-it Dragan Devedllaka, i cili u takonte njerëzve kryesorë të shërbimit të sigurimit shtetëror të Ministrisë së Brendshme të BH-së, i cili qëndroi në këtë organizim deri në fund të luftës. Devedllaka ishte shef në shtabin e njësisë të cilën e komandonte Arkani. Nga këto formacione dhe pakënaqësitë e shkaktuara për shkak të vrasjeve të shumta të nëntokës serbe si dhe nga pakënaqësitë e luftëtarëve serbë pjesëmarrës në luftërat e ndryshme, shikuar këtu edhe gjendjen materiale dhe rrjedhën e zhvillimeve politike në Serbi, u krijua organizata terroriste e ashtuquajtur Ushtria Çlirimtare Serbe. Qëllimet e kësaj organizate pretendojnë të jenë sulmet ndaj qeverisë së Beogradit - të njerëzve të Millosheviqit në tri faza, likuidimi i personaliteteve të njohura serbe si dhe restaurimi i monarkisë serbe.

Bojkotimi dhe sabotimi nëpër qytetet kryesore të Serbisë, depërtimi i tyre nëpër gjykata dhe stacione policore, përgatitja e gjeneratave të reja me koncepte të reja të formimit të Serbisë së Madhe në Evropën e Bashkuar, krijimi i njësive të UÇS-së në Mal të Zi, Bosnjë, Maqedoni, Kosovë, Kosovë Lindore etj. Sipas të gjitha gjasave bartësit e kësaj organizate terroriste, direkt ose indirekt e kishin marrë bekimin për veprime të tilla nga Momçillo Perishiq, ish shef i ushtrisë jugosllave, më vonë udhëheqës i opozitës dhe person kritik i Millosheviqit. E ashtuquajtura UÇS kishte marrë obligim se do të bënte edhe përmirësimin e kushteve të luftëtarëve serbë. Grupi i UÇS-së kishin planifikuar forma të veprimeve sabotuese edhe në Kosovë.

Grupe të ndryshme që vepronin dhe veprojnë në kuadër të të ashtuquajturës UÇS kishin planifikuar edhe

vrasjen e Millosheviqit dhe të Nebojsha Pavkoviqit. Sigurimi serb kishte arritur të arrestonte pjesëtarët e një celule të kësaj organizate terroriste, shumica prej të cilëve ishin ish oficerë të armatës, ish pjesëtarë të MUP-it serb, kuadra të shërbimeve informative, punëtorë operativë etj. E ashtuquajtura UÇS ishte deklaruar si organizim ushtarak në tetor të vitit të 2000 pasi mori përsipër vrasjen e katër opozitarëve serbë të regjimit të Beogradit si dhe një varg të aksioneve të kryera në Kosovë.

Nacionalistët serbë janë të hidhëruar sidomos për kalimin e Kosovës nën mbikëqyrjen e UNMIK-ut. Siç është bërë e ditur, shantazhet edhe më tutje mbeten element i dorës së parë për shërbimet serbe.

Ndër proceset me prioritet të shërbimeve serbe ka të dhëna se është ta dezorientojnë TMK-në, dhe përmes aferave të ndryshme ta kopromitojnë edhe si strukturë edhe si institucion.

Pastaj kanë përgatitur dhe po përgatisin konflikte të cilat qojnë tek konfrontimet e shqiptarëve me bashkësinë ndërkombëtare.

Është punuar edhe në nxitjen e problemeve ndëretnike me qëllim që të krijohet përshtypja se ne nuk jemi të aftë për të vetëqeverisur. Siç është thënë edhe më herët, shërbimet serbe kanë përgatitur një kuadër të përsosur mobil, të trajnuar gjatë për lansimin e dezinformatave për ta përgatitur opinionin kundër nesh. Në këtë drejtim punojnë ekipe të tëra. Përmes ish kuadrove, lidhje të mëhershme të Arkanit dhe ish punëtorëve tjerë të sigurimit që kanë vepruar në Kosovë, është përgatitur dhe ngritur rrjeti i mafiozëve të cilët e

kanë organizuar nëntokën kosovare e kanë përsosur botën e krimit e cila kontrollohet nga qarqet e shërbimeve serbe.

Edhe droga, prostitucioni, falsifikimet e ndryshme, kalimet ilegale dhe linjat tjera kladestine janë të organizuara dhe të drejtuara nga shërbimet serbe, e që në këto rrjete edhe shqiptarët e Kosovës, Shqipërisë, Malit të Zi, Maqedonisë, Preshevës etj, janë mjaft të kyqur në këto linja.

8.07.2012

A PO NGJALLET NOSTALGJIA PËR PERANDORINË OSMANE

(Tekstet e historisë në Kosovë përkëdhelin pushtuesin osman)

"Turqisë nuk i pëlqen që kosovarët të mësojnë historinë e interpretuar nga Tito dhe Enver Hoxha", është shprehur Ahmet Davutoglu, ministër i Punëve të Jashtme të Turqisë, gjatë vizitës së tij në Kosovë më 26 gusht 2011. Edhe Omer Dincer, ministri i Arsimit, i ka kërkuar ministrit të Arsimit, Ramë Buja, që nga librat e historisë së Kosovës të largohen paragrafët, të cilat përmbajnë fyerje për Turqinë dhe personalitetet e këtij vendi. E njëjta gjë është kërkuar edhe nga ambasadorja e Turqisë në Kosovë, Songul Ozan: "Lloje të tilla të punimeve, të cilat synojnë largimin e shprehjeve të pakëndshme në librat e historisë, ekzistojnë jo vetëm ndërmjet

Gjermanisë dhe Francës, por edhe shumë shteteve, përfshirë edhe vendin tim e posaçërisht ndërmjet vendeve, të cilat kanë marrëdhënie fqinjësore".
Kështu që në heshtje librat e historisë në Kosovë kanë filluar të korrigjohen.

Nga klasa e 5-të deri në të 13-ën del se Perandoria Osmane gjatë shekujve të pushtimit të viseve të banuara me shqiptarë nuk ka vrarë, nuk ka ushtruar dhunë dhe nuk ishte e ashpër. Në vend të këtyre shprehjeve, sipas korrigjimeve, sulltanët me ushtrinë dhe administratën tyre sunduan, burgosën dhe ushtruan ndërhyrje ushtarake.

Në hulumtimin tona vihet re se fjalët "dhunë " dhe "vrasje" janë fshirë duke u zëvendësuar me "pushtim" dhe "burgosje"; fjala "ashpërsi" është shndërruar në "ndërhyrje ushtarake"; "sundimi i egër osman" në "pushtimi osman", etj.

Një delegacion nga Turqia pritet ta vizitojë Kosovën në fund të këtij muaji për të biseduar me autoritetet arsimore kosovare për trajtimin që i bëhet Perandorisë Osmane në librat e historisë .

Teksa në Ministrinë e Arsimit një vizitë të tillë e shohin në kuadër të shkëmbimit të përvojave, historianët e cilësojnë si formë presioni.

Autori i një libri shkollor të historisë në arsimin parauniversitar dhe bashkautori i shumicës së teksteve të këtij niveli, Frashër Demaj, konsideron se delegacioni ka për qëllim mbikëqyrjen e komisionit të caktuar nga MASHT-i. "Delegacioni nga Turqia vjen për presion dhe për asgjë tjetër.

Si të tillë nuk e njoh edhe as që kisha dashur të takohesha me ta", ka thënë Demaj. Ky s'e njeh as komisionin vendës, të themeluar për këtë çështje nga MASHT-i.

"Punën time e bëj të pavarur, prandaj nuk njoh asnjë komision që provon të prekë çështjet shkencore", ka thënë Demaj. Ky thekson se MASHT-i nuk i ka konsultuar autorët e librave kur e ka themeluar atë komision, ndërsa ka zënë ngoje kryetarin e komisionit, Shkëlzen Raça. Për të ka thënë se është historian, por jo tekstshkrues i librave të historisë në arsimin parauniversitar.

"Ai që nuk ka përvojë në tekstshkruarje të librave të arsimit fillor nuk mund të japë vërejtje të qëndrueshme, mund të bëjë vetëm vërejtje kozmetike", ka theksuar Demaj. Ky i fundit ka shtuar se me tekstshkruarje të librave parashkollorë të historisë merret që nga viti 2002 dhe se librat në të cilët ka punuar janë të përshtatshëm dhe pa gjuhë të urrejtjes. Megjithëkëtë, Demaj thekson se edhe vetë është për ndonjë shikim të këtyre teksteve, por jo me presion.

Delegacioni nga Turqia ka planifikuar të vijë në Kosovë për rishikimin e librave të historisë, porse vizita është shtyrë për në fund të muajit mars. Në Ministrinë e Arsimit ndërkaq theksojnë se komisioni vendës e ka përfunduar fazën e parë të punës.

"Ai e ka përgatitur një raport në të cilin janë të përfshirë disa rekomandime, i cili gjendet në Divizionin e Sigurimit të Cilësisë dhe i cili në të ardhmen jo shumë të largët do të organizojë debat të hapur me ekspertë të teksteve shkollore", ka thënë këshilltari i ministrit të Arsimit, Ramë Buja, Arbër Morina. Sipas tij, pas këtyre

debateve do të organizohen takime me autorët e teksteve përkatëse, në mënyrë që bashkërisht të debatohen rekomandimet e komisionit dhe ato nga debatet e hapura. "Vetëm me pëlqimin e autorëve mund të bëhen ndryshimet", është shprehur ai, teksa ka mohuar që komisioni që do të vijë nga Turqia do të ndërhyjë në punët kosovare.

"Ardhja e ekspertëve nga Republika e Turqisë nuk e nënkupton ndërhyrjen në punët tona, por ky do të jetë një shkëmbim përvojash, ashtu siç ka ndodhur e do të ndodhë në takimet e tjera që kemi pasur me ekspertë të vendeve të tjera evropiane", ka përfunduar ai.

Vitin e kaluar MASHT-i kishte themeluar një komision për rishikimin e prezantimit të historisë, gjeografisë dhe kulturës osmane e turke në tekstet shkollore parauniversitare në Republikën e Kosovës. Komisioni përbëhet nga gjuhëtarë, letrarë, historianë, muzikologë etj. Puna e komisionit është përfunduar në fund të vitit të kaluar dhe janë dhënë të gjitha rekomandimet se ku do të duhej të ndryshoheshin tekstet shkollore parauniversitare, kudo që flitet për Perandorinë Osmane.

Nga lënda e historisë janë prekur tekstet Historia 5 e autorëve, Fehmi Rexhepi, Frashër Demaj, botuar nga "Libri Shkollor" më 2007; Historia 6 e po të njëjtëve autorë dhe po të njëjtit botues (2004), Historia 7 e autorëve Isa Bicaj, Arber Salihu (2004); Historia 8 e autorëve Izber Hoti, Jetullah Krasniqi (2005): Historia 10 (Gjimnazi Gjuhësor) e autorëve, Isa Bicaj e Arber Salihu (2004); Historia 10 (Gjimnazi Informatikë – Matematikë) i autorëve, Jusuf Bajraktari, Frashër Demaj (2003), Historia 10 (Gjimnazi

Gjuhësor) -Isa Bicaj e Arbër Salihu (2003) Historia 11 (Gjimnazi Përgjithshëm) –Jusuf Bajraktari, Isa Bicaj (2004); Historia 11 (Gjimnazi Gjuhësor) – Fehmi Rexhepi, Frashër Demaj (2004), Historia 11 (Gjimnazi Shoqëror), Ramiz Abdyli, Emine Bakalli (2004) dhe Historia 12 (Gjimnazi i Përgjithshëm) dhe Jusuf Bajraktari e Arbër Salihu (2005), që të gjithë të botuar nga "Libri shkollor" 2005.

Mirëpo autori dhe bashkautori i disa librave të historisë në sistemin parauniversitar, Demaj, ka thënë se ai zyrtarisht nuk ka marrë raport të komisionit të MASHT-it për të parë se ku është ndërhyrë. "Krejt çka kam mësuar në propozimet për ndryshime janë ato që i kam parë në medie", ka thënë Demaj. Nga ana tjetër, kryetari i komisionit të themeluar nga MASHT-i, Shkëlzen Raça, ka mohuar që komisioni nga Turqia vjen për të bërë ndonjë presion. Ai po ashtu ka theksuar se edhe raporti që e ka nxjerrë komisioni nuk është përfundimtar, pasi që edhe ai duhet të rishikohet.

Ndërkaq autori i studimit te teksteve mësimore të historisë Kosovë-Shqipëri-Serbi, me titull: Kosova 1912-2000 në tekstet mësimore të historisë së Kosovës, Shqipërisë dhe Serbisë", Shkëlzen Gashi, mendon se tekstet mësimore të historisë për shkollat fillore dhe të mesme në Kosovë duhet të ndryshohen rrënjësisht dhe urgjentisht.

"Madje këto ndryshime duhet bërë jo vetëm sa i takon prezantimit të periudhës kur Kosova dhe shqiptarët në përgjithësi kanë qenë nën Perandorinë Osmane, dhe jo siç kërkojnë palët e përfshira, por duke u bazuar në dokumente, dëshmi, fakte, argumente etj.", ka

thënë Gashi. Pra, sipas tij, duhet të eliminohet gjuha e urrejtjes, shpifjet, etiketimet, hiperbolizimet. Ndryshe, ka thënë ai, duhet ruajtur nga çdo trysni politike.

Dy vjet pas vizitës së Kryeministrit të Turqisë në Kosovë, Recep Tayyip Erdogan, janë ndryshuar librat e ciklit parauniversitar në raport me kohën e Perandorisë Osmane. Në versionin ri të historisë Perandoria Osmane është një pushtues, por jo një sundues i egër.

Kosova ka lidhur deri tani 13 marrëveshje me Turqinë, por kjo e fundit ka kërkuar bashkëpunim edhe në fushën e arsimit: autoritetet turke kërkojnë pastrimin e librave të historisë.

Tani që ndryshimet janë bërë, zyrtarët shtetërorë turq vlerësojnë se me këtë veprim do të fuqizojnë marrëdhëniet e shkëlqyeshme ndërshtetërore.

Ambasadorja e Turqisë në Kosovë, Songul Ozan, tha se ndryshimet në librat e historisë do t'i kontribuojnë marrëdhënieve Kosovë-Turqi të cilat, sipas saj, janë të shkëlqyeshme. Ajo kujton se ngjashëm kanë vepruar edhe shtete tjera, "të cilat kanë jetuar në të kaluarën një histori të përbashkët".

Komisioni i ngritur nga ministri Buja dorëzoi para më shumë se gjashtë muajsh rekomandimet se në cilat pjesë duhet të korrigjohen librat e historisë. Nga korrigjimet e librave të historisë nga klasa e 5-të deri në të 13-të, del se Perandoria Osmane përgjatë shekujve të pushtimit të viseve të banuara me shqiptarë, nuk ka vrarë, ushtruar dhunë apo se ishte e ashpër. Në vend të këtyre shprehjeve, sipas korrigjimeve, sulltanët me ushtrinë e administratën e tyre sunduan, burgosën dhe ushtruan ndërhyrje ushtarake.

Neve kemi gjetur gjithashtu disa prej ndryshimeve konkrete që kanë pësuar librat e historisë nga klasa e pestë deri në klasën e trembëdhjetë. Shembujt e paraqitur në këtë rast u takojnë librave të historisë së klasës së pestë, gjashtë dhe tetë. Në librin aktual të historisë së klasës së pestë, në faqen 62, fjalët "dhunë" dhe "vrasje" në raport me Perandorinë Osmane janë fshirë.

Në vend të tyre janë vendosur "pushtim" dhe "burgosje". Në faqen 48 të librit aktual, në lidhje me marrjen e pronave dhe pasurisë së shqiptarëve janë fshirë fjalët "…hakmarrje" dhe "…vrasje". Në vend të tyre është vendosur fjalia "…marrja e pronave, vendosja e taksave si dhe depërtimi i një pjese të popullatës vendëse…"!

Fjalia "…osmanët vranë shumë shqiptarë…" është fshirë tërësisht kurse në faqen 69 të librit aktual, fjala "..ashpërsi" është shndërruar në "…ndërhyrje ushtarake". Ndryshimet e tjera janë bërë në faqen 83 të librit të historisë së klasës së 6-të, ku fjalia "…sundimi i egër osman…", është shndërruar në "…pushtimi osman". Vijë i është rënë edhe pjesëve të librit të historisë së klasës së 8-të si në faqen 68, ku fjalia "…merreshin masa të rrepta ndaj atyre që nuk ishin të fesë islame…", tash ka tjetër kuptim. "…

Në praktikë të gjithë shtetasit në viset e tyre të pushtuara nga Perandoria Osmane, në jetën e përditshme ishin të barabartë para ligjit. Natyrisht ndonjëherë shfaqeshin keqpërdorimet e nëpunësve lokalë osmanë në kuadrin e reformave të tanzimatit". "Sa i përket muzikës, pala turke mund të ketë pasur vërejtje, si për himnizim të figurës së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut", ka thënë

kryesuesi i komisionit. Ai thotë se nuk i kujtohet në detaje çfarë ndryshimesh janë bërë në këtë rast. Emri zyrtar i plotë i komisionit është "Komisioni për Rishikimin e Prezantimit të Historisë, Gjeografisë dhe Kulturës Osmane e Turke".

Agjencioni Floripress ka siguruar një raport të punës së këtij komisioni, kryetar i të cilit ishte prof. dr. Shkëlzen Raça (historian), me anëtarë prof. dr. Ruzhdi Pllana (gjeograf), prof. dr Hysen Matoshi (kulturë osmane dhe turke-gjuhë e letërsi), Mr. sc. Astrit Mustafa (kulturë osmane e turke-muzikë) dhe sekretar i komisionit, Mr. sc. Avni Rexha.

Komisioni për Rishikimin e Teksteve të Historisë, i formuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ka përpiluar një raport, i cili para finalizimit do të shikohet dhe nga ekspertë nga Turqia.

Në muajin mars, një grup ekspertësh nga shteti turk do të vijnë në Kosovë për të konstatuar nëse janë hequr termat në tekstet e historisë që qeveria e tyre kishte kërkuar të ndryshohen me arsyetimin se ofendohej e kaluara e këtij shteti – Perandorisë Osmane.

Por, këtë ata do ta bëjnë në konsultim me anëtarët e Komisionit për Rishikimin e Teksteve të Historisë, e pa mohuar as autorët e teksteve, mendimi i të cilëve sipas MASHT- it nuk do të anashkalohet asnjëherë.
Përfaqësues të Ministrisë së Arsimit kanë konfirmuar se ky bashkëpunim bëhet në frymën e zhvillimeve akademike të të gjitha vendeve evropiane që të mos ketë gjuhë të urrejtjes në tekste, por që ajo të jetë miqësore. Sipas tyre ekspertët nga Turqia do të jenë të kënaqur me propozimet që kanë bërë ekspertët e MASHT. Ndërsa,

kanë mohuar se mund të ketë ndërhyrje nga këta ekspertë.

Në kuadër të vizitës së ekspertëve turq do të organizohen edhe debate lidhur me këtë "problem" në tekstet e historisë si dhe rekomandimet e grupit të ekspertëve kosovarë.

Zëvendësministri i Arsimit, Nehat Mustafa, ka theksuar se do të mbahet një takim ndërmjet ekspertëve të Kosovës që janë marrë me rishikimin e teksteve dhe atyre nga Turqia. "Ekspertët turq do të vijnë në fund të muajit tjetër. Kjo po bëhet më qëllim që tekstet tona të kenë sa më pak gjuhë të urrejtjes. Kjo nuk do të thotë që është duke ndodhur vetëm me Turqinë, por kjo do të ndodhë edhe me të gjithë popujt dhe shtetet e tjera, sepse përfundimisht gjuha e urrejtjes duhet të hiqet nga tekstet shkollore", ka theksuar Mustafa, sipas të cilit nuk do të bëhet asnjë ndryshim pa u konsultuar me autorët e teksteve shkollore.

"Grupi i ekspertëve turq do të shikojnë disa nga sugjerimet që kanë dhënë ekspertët e Kosovës dhe do të japin kontributin e tyre, në mënyrë që tekstet tona të jenë të përshtatshme duke përmbushur kriteret".

Ai ka bërë të ditur se edhe autorët e teksteve do të përfshihen në debate. Mustafa ka hedhur poshtë çdo pretendim se do të ndryshohet historia. Sipas tij, kjo nuk mund të ndodhë në asnjë rrethanë. "Qytetarët e Kosovës nuk duhet të kenë frikë se do të ndryshohet historia e popullit shqiptar në përgjithësi dhe e popullit shqiptar të Kosovës në veçanti. Nuk është ministria ajo që e shkruan historinë, por janë historianët ata që e shkruajnë historinë".

Ai ka marrë si shembull se në tekstet shkollore gjenden terma si “hordhitë” kur flitet për ushtarët e huaj, një term që Mustafa e sheh të përdorshëm më shumë për grupe të kafshëve. “Ekziston mundësia që ku thuhet hordhitë të thuhet repartet ushtarake”.

Mustafa ka thënë se ardhja e ekspertëve turq nuk duhet të keqinterpretohet. “Nuk do të thotë se ata do të vendosin si të jenë tekstet tona, por këtë po e bëjmë thjesht për të treguar gatishmërinë tonë për të bashkëpunuar jo vetëm me Turqinë, por edhe shtetet e tjera”.

BILANCI ZYRTAR I LUFTËS NË KOSOVË:
- HUMBËN JETËN 11.840 PERSONA

Deri më tash për Luftën e Kosovës është thënë " Lufta e Kosovës ishte një konflikt i armatosur në Kosovë që filloi në 28 shkurt të vitit 1998, pas sulmit jugosllav në fshatërat Likoshan dhe Qirez në Drenicë të Kosovës, deri në 11 qershor 1999.

Lufta u zhvillua mes forcave të Republikës Federale të Jugosllavisë, (në atë kohë, Konfederata e Serbisë dhe Malit të Zi) dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me ndihmë ajërore nga NATO, (nga 24 marsi 1999), dhe mbështetje tokësore nga Shqipëria.

Në këtë luftë u dëbuan 800000 shqiptarë, u vrane 15000 persona, nga të cilët 2400 luftëtar të UÇK-së e të tjerët civilë. Gjatë luftës janë zhdukur rreth 5000

njerëz, fati i shumicës prej tyre është zbardhur deri në vitin 2007, por i madh ka mbetur numri i rasteve të pasqaruara."

Sulmet e UÇK-së shtohen, me në qendër luginën e Drenicës në afërsi të banesës së Adem Jasharit. Disa ditë pasi Robert Gelbard e quajti UÇK-në grup terrorist, policia serbe sulmon UÇK-në në zonën e Likoshanit, dhe ndoqën disa prej luftëtarëve deri në Cirez, duke vrarë 16 luftëtarë shqiptarë dhe u vranë 4 policë serbë.

Pavarësisht akuzave për vrasje selektive dhe vrasjes së civilëve, dënimet e kryeqyteteve perëndimore nuk ishin aq të ashpra sa do të bëheshin më vonë. Policia serbe ndoqi Jasharin dhe bashkëluftëtarët e tij deri në fshatin Prekazi i Poshtëm. Një sulm masiv mbi shtëpinë e Jasharit solli masakrimin e 60 shqipëtarëve, shumica familarë të Adem Jasharit, nga të cilët 18 ishin gra dhe 10 fëmijë. Ngjarja e 5 marsit 1998 shkaktoi irritim të thellë në kryeqytetet perëndimore. Madeleine Albright tha se tashmë "kjo krizë nuk është një çështje e brendshme RFJ". Në 24 mars forcat Jugosllave rrethuan fshatin e Glloxhanit dhe sulmuan luftëtarët e UÇK-së. Pavarësisht fuqisë më të madhe të zjarrit, forcat jugosllave dështuan në shkatërrimin e njësisë së UÇK-së i cili ishte objektivi i tyre. Megjithëse kishte disa të vdekur dhe shumë të plagosur nga UÇK, Beteja e Glloxhanit ishte një rezistencë e suksesshme.

Një qeveri e re u formua në Jugosllavi, e drejtuar nga Partia Socialiste e Serbisë dhe Partia Radikale Serbe. Kryertari i Partisë Ultra-nacionaliste Radikale Vojislav Sheshel u bë zëvendës kryeministër. Kjo shtoi

pakënaqësinë në pozicionin e vendit ndërmjet diplomatëve perëndimorë.

Në fillim të prillit, Serbia organizoi një referendum për çështjen e ndërhyrjes së jashtme në Kosovë. Votuesit serbë refuzuan vendosshmërisht kundër ndërhyrjes së huaj në këtë krizë. Ndërkohë, UÇK fitoi shumë territor përreth Deçanit dhe kishte territore nën kontroll në Glloxhan. Kështu që, në 31 maj 1998, Ushtria Jugosllave dhe policia e Ministrisë së Brendshme serbe filluan operacionin për spastrimin e kufirit të kontrolluar nga UÇK. Përgjigjja e NATOs ndaj kësaj ofensive ishte operacioni i mesit të qershorit i quajtur Operation Determined Falcon (Operacioni Fajkoi i Vendosur), një parakalim ajëror mbi kufijtë Jugosllavë.

Gjatë kësaj kohe, Presidenti Jugosllav Millosheviç arriti një marrëveshje me Presidentin e Rusisë Boris Jelcin për ndalimin e operacioneve ofensive dhe pregatitjen e bisedimeve me Shqiptarët. Ku më pas u arrit takimi midis Millosheviçit dhe Ibrahim Rugovës në 15 maj në Beograd, dy ditë pasi u njoftua nga Richard Holbrooke. Një muaj më vonë, Holbrooke, pas një udhëtimi në Beograd ku ai kërcënoi Millosheviçin që nëse nuk bindeshte, "çfarë ka mbetur nga vendi juaj do të shpërthejë", ai vizitoi zonat kufitare të prekura nga luftimet në fillim të qershorit, nga ku u fotografua me ushtarët e UÇK-së. Publikimi i këtyre imazheve fotografike i dërgoi një sinjal UÇK-së, mbështetësve dhe simpatizantëve, dhe vëzhguesve në veçanti, se SHBA-të do të mbështesnin vendosshmërisht UÇK-në dhe popullsinë shqiptare në Kosovë.

Marrëveshja e Jelcinit përfshinte lejimin nga Millosheviçi të përfaqësuesve ndërkombëtarë të ngrinin një mision në Kosovë në mënyrë që të monitoronin situatën. Ky ishte Kosovo Diplomatic Observer Mission (KDOM), (Misioni Diplomatik Vëzhgues në Kosovë), i cili filloi të veprojë në fillim të korrikut. Qeveria amerikane e mirëpriti këtë marrëveshje, por denoncoi thirrjen e iniciativës për armëpushim të përbashkët. Pasi Amerikanët kërkonin tërheqjen e trupave jugosllave.

Gjatë gjith qershorit dhe deri në mes të korrikut, UÇK-ja mbajti avantazhin e vet. UÇK rrethoi Pejën, Gjakovën, dhe kishte caktuar kryeqytet provizor qytetin e Malishevës. Trupat e UÇK-së u futën në Therandë (Suharekë), dhe në veri-perëndim të Prishtinës. Më pas u futën në Rahovec dhe në fshatrat përreth.

Pas disa sulmeve të UÇK-së në mes të gushtit, trupat jugosllave nisën operacione ofensive në jug të rrugës Prishtinë-Pejë. UÇK filloi një ofensivë në 1 shtator në rrethinat e Prizrenit, duke rritur aktivitetin usharak të ushtrisë jugosllave. Në Pejë, një ofensivë jugosllave rrezikoi një karvan njerëzish të dëbuar, veprim i cili u dënua nga oficerët ndërkombëtarë.

Në mes të shtatorit, për herë të parë UÇK-ja arriti në veri të Kosovës përreth Podujevës. Në fund, në fund të shtatorit, një përpjekje e vendosur nga jugosllavët nisi për largimin e UÇK-së nga veriu dhe qëndra e Kosovës po ashtu edhe nga lugina e Drenicës. Gjatë kësaj kohe shumë kryeqytete perëndimore dënuan sulmin, por sulmet u intensifikuan. Në 28 shtator, kur u gjetën kufomat e gjymtuara të një familjeje nga KDOM jashtë fshatit Abria e Epërme. Pikërisht Masakra në Abri të Epërme siguroi

ndërkombëtarët për genocidin ndaj shqiptarëve në Kosovë, ky imazh i gjakosur shtyu luftën në një nivel tjetër...

***

Tash pas përfundimit të luftës në Kosovë, kanë ardhur shifrat zyrtare mbi pasojat e këtij konflikti të përgjakshëm. "Krimet e Serbisë në Kosovë 1998-1999", "Krimet e Serbisë ndaj fëmijëve në Kosovë 1998-1999", botime të Agjencisë Shtetërore e Arkivave të Kosovës, të promovuara në Akademinë e Shkencave në Tiranë.

Historianët Beqir Meta, Maringlen Verli e të tjerë e quajtën një ngjarje botimin e këtyre dy librave, që dëshmuan për herë të parë, përmes shifrash zyrtare, masakrat serbe në Kosovë.

Për drejtorin e Arkivave kosovare, dr. Jusuf Osmani, grumbullimi i të dhënave mbi vrasjet, dhunimet, shkatërrimet, dëbimet nuk ka qenë i thjeshtë.

Sipas tij, puna për grumbullimin e të dhënave është bërë në grup, me bashkëpunëtorë nga treva të ndryshme dhe me vizita pothuaj në çdo vendbanim të Kosovës. "Qëllimi themelor i botimit të këtyre librave është prezantimi i fakteve, që paraqesin dokumentacionin për krimet e Serbisë në Kosovë ndaj popullatës kosovare e posaçërisht ndaj fëmijëve gjatë viteve 1998-1999. Politika antishqiptare e serbëve është manifestuar me shekuj, me programe gjenocidale, duke filluar që nga Naçertania e Garashaninit, më 1844, e deri te programi "Patkoi", më 1999, me synim zbrazjen e tokave nga popullsia shqiptare dhe serbizimin e tyre. Kjo luftë u zbatua nga formacionet ushtarako-policore dhe

paramilitare serbe, të cilët vranë, masakruan, zhdukën, dhunuan, dëbuan dhe deportuan popullsinë civile shqiptare, i plaçkitën, dogjën dhe rrënuan shtëpitë, objektet fetare, shkollore, kulturore, ekonomike, e të tjera, si dhe vendbanime të tëra shqiptare, me synim spastrimin etnik", tha Osmani, raporton gazeta Panorama. Ai shtoi se publikimi i këtyre shifrave është një detyrim ndaj viktimave dhe familjarëve të tyre. Sipas dr. Osmanit, opinioni ndërkombëtar ende është shumë pak i informuar mbi krimet gjenocidale që janë ushtruar mbi popullsinë e Kosovës. "Regjistri i fëmijëve të vrarë, të pafajshëm dhe të paaftë për vetëmbrojtje është gati i pabesueshëm. Nga janari deri më 12 qershor 1999 janë vrarë ose evidentohen të zhdukur 1 396 fëmijë, nën moshën 18-vjeçare, apo më tepër se 11 për qind e viktimave të përgjithshme të të vrarëve në Kosovë. Kjo statistikë për dhunën mbi fëmijët është më tragjikja në historinë e re të Evropës", tha ai. Sipas të dhënave të grumbulluara, në Kosovë nga janari 1998 deri më 12 qershor 1999 ka pasur 12 843 viktima të nacionalitetit shqiptar, prej tyre 1 741 femra, ndërsa në altarin e lirisë kanë rënë 2 261 dëshmorë, në mesin e tyre 68 dëshmorë e martirë nga Shqipëria. Veç vrasjeve, janë shkatërruar më se 188 mijë objekte banimi, janë dëbuar nga Kosova më se 1 milion banorë.

Bilanci i luftës në Kosovë

Krimet e Serbisë në Kosovë 1998-1999

– Vrasjet, masakrimet
– Dëbimi i popullatës shqiptare nga Kosova
– Varrezat masive

– Vrasjet e të rinjve, femrave, pleqve, fëmijëve, intelektualëve, etj.
– Dhunimet e femrave
– Rrëmbimi i të rinjve dhe të tjerëve, dërgimi dhe vrasja në Serbi.
– Helmimet
– Rrënimi i objekteve të banimit, objekteve ndihmëse, objekteve ekonomike, arsimore, kulturore, fetare etj.
Shkatërrimet e shtëpive dhe objekteve të tjera
Shtëpi të shkatërruara – dëmtuara të popullatës shqiptare: 100589
Shkolla të shkatërruara – të dëmtuara me dokumentacion: 358
Zyra të vendit: 71
Shtëpi kulture: 30
Biblioteka publike dhe shkollore: 93
Objekte shëndetësore: 123
Objekte fetare (xhami, teqe, tyrbe): 215
Kisha katolike: 5
Objekte ndihmëse – përcjellëse: 88.101.
Pasojat e luftës
Okupimi klasik i Kosovës
Sjellja e forcave të mëdha ushtarake në Kosovë
Masakra të mëdha
Vrasje e organizuar, madje edhe të familjeve të tëra.
Periudha janar 1998 – 12 qershor 1999:
Vrarë: 11840 viktima nga Kosova,
– 1392 fëmijë deri në 18 vjeç.
– 296 fëmijë deri në 5 vjeç.
– 1739 femra
– 1882 të moshuar mbi moshën 65-vjeçare.

– 1450 banorë ende janë të pagjetur.
Janë dhunuar 20400 femra shqiptare.
Sipas të dhënave të UNCHR, në fillim të qershorit 1999, nga refugjatët e dëbuar prej Kosove:
Janë dëbuar nga Kosova rreth 1 milion banorë
443300 ishin vendosur në Shqipëri;
247800 në Maqedoni,
69300 në Mal të Zi;
21700 në Bosnjë-Hercegovinë, gjithsej 782100.
Në vendet e tjera të botës u vendosën gjithsej 76475 refugjatë, duke përfshirë
13639 në Gjermani
7581 në Turqi
5829 në Itali
5730 në SHBA
pastaj në Francë, Norvegji, Suedi, Britani të Madhe, Poloni, Spanjë, Portugali, Finlandë, Zvicër, Izrael etj.

MANASTIRI I DEÇANIT, OBJEKT I KISHËS SERBE, APO TRASHËGIMI ILIRE?

(Manastiri i Deçanit i rindërtuar mbi themelet e një kishe ilire nga gurskalitësi shqiptarë, Fra Vita Kuçi nga Kotorri)

Dyndjet serbe apo dyndjet sllave siç njihen në histori, sipas informacioneve konkrete të histografisë shqiptare dhe asaj botërore, kanë sjellur serbët në Gadishullin Ballkanik në shekullin IX dhe jo siç pretendon histografia serbe, dy shekuj më herët, thotë Shkodran Imeraj duke rrëfyer se, me ardhjen e pushtuesve të ri, dinastisë serbe, ata kanë përvetësuar gjithçka çka ata pushtuan si territor dhe me këtë rast kanë përvetësuar prona dhe institucione fetare, duke përfshirë edhe manastirin.

"Manastiri i Deçanit është i rindërtuar mbi themelet e një kishe ilire, pasi që zona ku ndodhet Manastiri i Deçanit, disa metra në perëndim shtrihet lokaliteti i vjetër arkeologjik i cili nuk është i hulumtuar në detaje dhe që quhet Kulla e Qelisë, ku është një lokalitet arkeologjik që dëshmon se kjo pjesë ka qenë e populluar para se të popullohet pjesa e Deçanit dhe Rrafshit të Dukagjinit. Aty i kemi informacionet e para të një qytetërimi ilir" thotë Imeraj dhe shton se informata e dhënë për emrin e mjeshtrit që e ka rindërtuar manastirin është e pasaktë.

"Manastiri i Deçanit është i rindërtuar që nga viti 1327 deri në vitin 1335 dhe është rindërtu në themelet e një kishe ilire nga ana e Fra Vita Kuqit, në tokën e Hak Kuqit nga Deçani. Fra Vita Kuqi ka qenë një gurskalitës shqiptar me origjin nga Kotorri (Mali i Zi). Ai bashkë me 30 gurskalitës të tjerë fillon dhe e rindërtojnë Manastirin e Deçanit për t'i kryer rritet fetare popullsia vendase."

Duke e shpjeguar historinë e ndarjes së Perandorisë romake në dy pjesë, në atë të Lindjes, me qendër në Konstantinopoj (Stambollin e ardhshëm) dhe Perandorinë Romake të Perëndimit me qendër në Romë, historiani Imeraj shpjegon se tokat shqiptare që ndodheshin përtej Adriatikut dhe Detit Jon, kaluan nën sovranitetin e Perandorisë Bizantine ndërsa, më 1054, kur vjen deri tek ndarja e Kishës në dy rite, atë ortodoks dhe katolik, shqiptarët i takuan ritit ortodoks dhe gjatë mesjetës, ruajtën fenë ortodokse si besimin e vet fetar.

Imeraj këtë e argumenton me Defterin e Regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485, dokumentacion turk i botuar në Tiranë , në vitin 1974 nga

ana e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Shqipërisë, ku hasën emrat shqip si: Gjon, Gjin, Lekë, Kol, Gegë, Progron, Tole, Lesh apo Llesh, Bardo, Kolsh, Gectë, Tanush, Bushat, Lulo, Mazrek, Pal, Dukë, Kal, etj. Sipas tij, këta janë emra autokton ortodoks shqiptar dhe nuk kanë të bëjnë me pretendimet e histografisë serbe se kinse Kosova është ripopulluar me popullsi shqiptare.

– Kristobula e Manastirit të Deçanit, fillim i sherrit

Manastiri i Deçanit kishte përfunduar së rindërtuari, në vitin 1335, ndërsa pesë vite më herët kemi Kartën e cila njihet si Kristobula e Manastirit të Deçanit.

"Sipas disa informacioneve , që ne i disponojmë dhe janë zbuluar tash në Francë, Karta e Deçanit apo Kristobula e Manastirit të Deçanit është një dokument i falsifikuar pasi që ndodhet në katër versione" thotë Imeraj duke shtuar se katër versionet sjellin katër informacione të ndryshme për popullsinë vendase të Deçanit, ku njëra ndër to thotë se, kjo pjesë ka qenë e populluar me popullsi serbe dhe shqiptarët kanë qenë të ardhur, mirëpo këtë e përgënjeshtron Defteri i Regjistrimit të Sanxhakut së Shkodrës 1485.

"Kjo demantohet me anë të dokumenteve osmane, pasi që dokumentet apo Defteri i Regjistrimit të Sanxhakut së Shkodrës i jep në detaje të dhënat për gjithsecilin fshat dhe vendbanim , si dhe për Manastirin e Deçanit, për sa i përket ardhjes apo prejardhjes serbe në Deçan" thotë Imeraj duke demantuar edhe pohimet për etimologjinë e emrit Deçan, që sipas serbëve buron nga kupola e Manastirit dhe thotë "Po të rridhte emri Deçan në vitin 1330 apo 1335, po ta kishte marr emrin sipas

kupolës së manastirit të Deçanit atëherë si është quajtur Deçani në lashtësi?"

Ai thotë se ky është një pretendim jo i bazuar në fakte sepse Deçani është i banuar që në kohën ilire dhe kjo dëshmohet me anë të lokaliteteve arkeologjike të cilat janë në terren dhe të cilat mund të shihen ndërsa emri Deçan rrjedh nga trajta e fjalës 'dash' apo 'desh' sepse Deçani në kohën ilire është shquar për prodhimtari blegtorale. Këtu ai i referohet punimeve të akademik Mark Krasniqit, si dhe studiuesi Muharrem Carrabregu në librin "Hartografia 2".

– *Manastiri i Deçanit kurrë nuk ka pasur 700 hektar tokë*

Lidhur me madhësinë e pronës së Manastirit të Deçanit dhe pretendimeve të atit Sava Janjiq dhe fakteve të cilat i përdor Kisha Ortodokse Serbe se, manastiri ka pronë prej 700 hektarëve, Imeraj thotë se kjo e pavërtet mund të hidhet lehtë poshtë nëse studiohen me kujdes faktet se, me ardhjen e Perandorisë Osmane në Ballkan, Kisha Ortodokse dhe Kisha e Deçanit e pranojnë vasalitetin ndaj Perandorisë Osmane dhe se, ata që kanë pasur tokë kanë qenë edhe spahi, kalorës të zgjedhur të Perandorisë Osmane.

"Me që manastiri i Deçanit sipas një broshure që ata e kanë botuar, thuhet se kanë qenë spahi të Perandorisë Osmane, atëherë rrjedh pyetja: sa i kanë dhënë Perandorisë Osmane ushtar? – Që është një disbalancë i të vërtetës, sepse murgjit në atë kohë nuk kanë qenë kalorës të Perandorisë Osmane, siç potencojnë

në broshurën që e kanë publikuar kohë më parë" shpjegon historiani Imeraj duke theksuar se Perandoria Osmane nuk ka lejuar që manastiret apo kishat të kenë prona aq të mëdha sepse Perandoria i ka marr taksat dhe ka caktuar një shumë vjetore të pagesës të cilën është dashur me e kryer, prandaj ai pyet se "ku e mori burimin Manastiri që të paguaj për pronën që e ka poseduar?"

Duke e shpjeguar kopjen e fermanit të Sulltanatit, nga viti 1794, ku banorëve të fshatit Isniq ju dhurohet një pjesë e Bjeshkës nga Perandoria Osmane, historiani Shkodran Imeraj vërteton se Manastiri i Deçanit dhe kishat në kuadër të Perandorisë nuk kanë zotëruar shumë tokë dhe se kanë zotëruar vetëm me objektet përcjellëse.

"Se a ka pasur pronë të zgjeruar shumë apo jo, manastiri i Deçanit, flasin edhe faktet e mëvonshme, respektivisht flet një fotografi e vitit 1962 e cila e pasqyron qartë pronën e Manastirit të Deçanit. Këtë e argumentojmë me shemën e cila është një shemë që tregon rreth pronave dhe objekteve përcjellëse të Manastirit të Deçanit, sipas territorit nuk ka më shumë se 8 hektar tokë. Kjo është pronë që e ka trashëguar, sepse po të kishte 700 hektar tokë, që nga koha e Perandorisë Osmane , ai do t'i kishte edhe sot. Do të thotë, është një e pavërtetë" rrëfen Imeraj dhe e dokumenton këtë me një gravurë që daton nga vitit 1764, si dhe me një fotografi ku shihet se, në vitin 1962, ajo pjesë ishte ripyllëzuar me anë të mbjelljes së pishave.

Një fakt tjetër argumentues është regjistrimi i parë Osman në territorin e Deçanit, në vitin 1485, kur jepen informacione për igumanët , priftërinjtë apo

shërbëtorët që kanë shërbyer në kuadër të Manastirit të Deçanit dhe të cilët kishin emra të trajtës jo ortodokse. Sipas Imerajtë, kjo tregon se territori i komunës së Deçanit ka qenë i banuar nga popullsia edhe ortodokse edhe katolike shqiptare e cila gjithmonë ka qenë e lidhur me tempujt e tyre fetar dhe në histori njihet si respektuese e monumenteve fetare.

– *Apiko dhe Ilira s'mund të tjetërsohen nga Manastiri i Deçanit*

Imeraj ka reaguar edhe në pretendimet e Manastirit për pronat e Apikos dhe Ilirisë, dy gjigantëve të mëdhenj ekonomik, jo vetëm të Deçanit por edhe të Kosovës, në kohën e Jugosllavisë dhe se, marrja e tyre do të shkaktonte bllokim ekonomik të komunës së Deçanit. Për më tepër, ai e kundërshton aktgjykimin e 28 Dhjetorit 2012, kur Gjykata Supreme e Kosovës, respektivisht Dhoma e Veçantë merr vendim duke u bazuar në dy dokumente, sipas tij të papranueshme: Masat e Dhunshme të vitit 1993 dhe 1997, sipas të cilëve, pronat në fjalë i bëhen dhuratë Manastirit të Deçanit, nga ana e institucioneve të Republikës së Serbisë.

Lidhur me këtë, Lidhja e Historianëve të Kosovës ka kërkuar në vitin 2012 dhe kërkon edhe sot, që Kuvendi i Kosovës t'i nxjerr urgjentisht tri ligje: Ligjin për distancimin ndaj Masave të Dhunshme, që do t'i hudhte poshtë gjitha vendimet nga 28 marsi 1989 kur suprimohet autonomia e Kosovës e deri më 12 qershor 1999 kur Kosova vendoset nën admisnitrimin e Kombeve të Bashkuara; Ligjin e Reformës Agrare, për të rishikuar

historinë e tokave dhe Ligji i Lustracionit apo Ligji i Pastërtisë Publike

– *Ne e kemi respektuar dhe do ta respektojmë çdo herë Manastirin e Deçanit*

Manastiri i Deçanit është respektuar dhe ruajtur , përherë, nga deçanasit sepse, kanë qenë popullsia vendase me gurskalitësit nga Kotorri ata që e kanë rindërtuar këtë manastir dhe deri në fillim të viteve të ’90-ta, në Manastirin e Deçanit ka ekzistuar Vojvoda apo Rojtari, rrëfen historiani Imeraj dhe shton se, Vojvoda e fundit ka qenë familja e Sali Rrustës nga Deçani.

Me këtë, Imeraj bënë me dije se, shqiptarët e Deçanit, pa marr parasysh bindjet fetare, e kanë respektuar dhe e respektojnë Manastirin e Deçanit si një monument të rëndësishëm të kaluarës historike shqiptare dhe për këtë thirret edhe në vet dokumentet serbe. “Arhimani i Manastirit të Deçanit, Serafin Ristiç, në vitin 1864 e boton librin e tij ‘Deçanski spomenici’, në Beograd, i cili përshkruan disa zakone të Kishës së Deçanit dhe ndër të tjera thekson që, murgeshat kur i kanë kryer lutjet dhe meshat në manastirin e Deçanit, kanë kënduar me këto fjalë: ‘O Patriarkan, manastir i famshëm, në trevën e Dardanisë, qëndron qysh moti. Domethënë, ky është një argument të cilin e pranojnë edhe vet ish drejtuesit e Manastirit të Deçanit se, ai i takon një të kaluarës historike Dardane” citon Imeraj burimet serbe që dëshmojnë se, ky manastir ishte i ndërtuar në Dardani, pjesën e Ilirisë antike, vendit të

shqiptarëve dhe ishte kult fetar i popullsisë vendase shqiptare.

– Gjatë luftës në Kosovë në Manastir ishin strehuar shqiptarë, kolaboracionista

Lidhur me deklaratat e Igumenit Janiq se, gjatë luftës në Kosovë në vitet 1998-1999, ai ka strehuar shqiptar, historiani Imeraj thotë se, ati Sava është duke i shtrembëruar faktet dhe se Manastiri i Deçanit ka qenë vend strehim i atyre shqiptarëve që kanë qenë kolaboracionist dhe i kanë shërbyer regjimit serb të asaj kohe dhe jo vetëm atyre.

"Ne e dimë që gjatë luftës fundit, në vitet 1998 dhe 1999, janë strehu edhe personel ushtarak i uniformuar, gjë e cila dëshmohet edhe me anën e kësaj fotografie ku shihen policët e uniformuar serb dhe në mesin e tyre shihet edhe një nga personeli i Manastirit të Deçanit" rrëfen Imeraj .

Njëherësh, ai ja rikujton atit Sava Janiq se gjatë viteve 1998-1999, në këtë manastir janë mbajtur edhe mesha kishtare duke u tymosur dhe lagur me ujë qindra policë e paramilitarë serb të cilët më pas kryen krimet më të rënda në territorin e Deçanit dhe më gjerë. Për këtë, Imeraj tha se, më së miri flasin faktet, incizimet dhe fotografitë e kohës dhe se nuk është mirë që Igumeni Sava Janiq po mundohet të shtrembërojë.

– Manastiri i Deçanit të hapet edhe për historianët shqiptarë

"Unë personalisht e kam një mesazh për fund që, Manastiri i Deçanit gjithmonë ka qenë një monument i respektuar prej shqiptarëve dhe do të vazhdon të respektohet prej shqiptarëve sepse është ruajtur nga shqiptarët" përfundoi historiani Shkodran Imeraj i cili shprehi dëshirën që arkivi i Manastirit të hapet edhe për studiuesit shqiptarë, në mënyrë që edhe ata të kenë qasje në dokumentacionin të cilin e disponon Manastiri. Si historian, ai është shumë i gatshëm ta vizitojë Manastirin pasi që, personalisht, në këtë moment e ka të pamundur me shkua dhe me e vizitua atë monument të historisë shqiptare.

Historianët i rikthehen çështjes së pronave të Manastirit të Deçanit

Kryesia e Lidhjes se Historianëve të Kosovës "Ali Hadri" dega në Deçan, thotë se me kujdes të veçantë është duke e përcjell rastin juridik pran Gjykatës Themelore të Pejës dega në Deçan, në lidhje me çështjen kontestuese në mes të Ndërmarrjeve shoqërore "Apiko" dhe "Ilriia" në njërën anë dhe Sava Janjiçit nga Manastiri i Deçanit në anën tjetër.

"Sipas burimeve tona pran Gjykatës Themelore të Pejës dega në Deçan, një seancë e thirrur për këtë çështje ka dështuar me mos prezence fizike të Igumanit Janjiq. Kryesia e Lidhjes se Historianëve të Kosovës 'Ali Hadri' dega në Deçan, i bënë thirrje drejtueseve të Gjykatës dhe njëherësh trupit gjykues të kësaj lënde që të mos bie pre e trysnive ndërkombëtare e vendore për këtë kontest dhe që me punën e tyre trupa gjykues të marrë vendim të drejtë dhe konform ligjeve të Republikës se Kosovës", thuhet në reagimin e LHK-së.

Kryesia e LHK "Ali Hadri" dega në Deçan, e ripërsërit qëndrimin e saj se është kundër legjitimit të ligjeve të kohës se masave të dhunshme gjegjësisht kundër ligjeve të kohës se Millosheviqit.

"Ne, bëjmë thirre që këto prona të kthehen në prona komunale dhe që asetet ekonomike Kompleksi 'Iliria' dhe Ndërmarrja 'Apiko' të riaktivizohen".

Po ashtu nëpërmjet kësaj komunikate Kryesia e LHK "Ali Hadri" dega në Deçan, i benë thirrje Presidentit të Republikës se Kosovës Hashim Thaçi, që të shkarkojë nga detyra e saj Kryetaren e Gjykatës Kushtetuese të Republikës se Kosovës, Arta Rama-Hajrizi sepse, sipas LHK-së "ajo e ka shkelur rendë Kushtetutën e Republikës se Kosovës me anë të vendimit të 3 dhjetorit të vitit 2015, për vendosjen e masës se përkohshme ndaj çështjes kontestues në mes të Ndërmarrjeve shoqërore 'Apiko' dhe 'Ilriia' në njërën anë dhe Sava Janjiqit nga Manastiri i Deçanit në anën tjetër".

Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi ka reaguar ndaj kërkesës së historianëve të Kosovës dega "Ali Hadri" në Pejë, për shkarkimin e kryetares së Gjykatës Kushtetuese, Arta Rama-Hajrizi, lidhur më pronat e ndara për manastirin e Deçanit.

Lidhur më këtë, presidenti Thaçi ka thënë përmes një postimi në rrjetin social Facebook se vendimi i Gjykatës Kushtetuese rreth pronës së manastirit në Deçan është i bazuar në Kushtetutë dhe me Konventa Evropiane.

"Vendimi i Gjykatës Kushtetuese rreth pronës kishtare në Deçan është i bazuar në Kushtetutë të Shtetit dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kosova

është shtet ligjor ku vendimet gjyqësore respektohen. Prona është e patjetërsueshme, e kujtdo qoftë ajo", ka shkruar Thaçi në Facebook.

Shpresa nga vendimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për pronat në Deçan

Pritet që pronat publike në një sipërfaqe prej tetëqind hektarë të uzurpuara nga ana e Manastirit të Deçanit qe pesëmbëdhjetë vite ti kthehen Deçanit.

Në regjionin e pasur dhe atraktiv me ajrin e pastër që lëshohet nga Bjeshkët e Nemuna, florën dhe faunën e pasur, cila mbulon kodrat dhe luginat nga të cilat rrjedh uji i ftohtë si akulli, gryka piktoreske e Deçanit, bukurit tjera të rralla e atraktive dekada më radhë ishin viset me tërheqëse për fëmijët, të rinjtë, punëtoret dhe qytetaret tjerë që vinin nga të gjitha anët e Kosovës dhe më larg në Deçanin turistik për të pushuar shpirtin e tyre gjatë pushimeve verore të cilat filluan dhe stinët tjera të vitit. Kapacitetet e këtij kompleksi të mirënjohur turistik në Kosovë dhe jashtë kufijve të saj për të cilin do të bëjmë fjalë në këtë shkrim, kuptohet pas vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës që pronat publike të uzurpuara nga ana e Manastirit të Deçanit që pesëmbëdhjetë vite i takojnë komunës së Deçanit.

BIOGRAFI E SHKURTË E AUTORIT
FLORI BRUQI

Flori Bruqi u lind më 29 qershor të vitit 1952 në Isniq të Deçanit, Kosovë.

Studimet e Defektologjisë i kreu në Universitetin e Beogradit, ndërsa ato postdiplomike (Magjistraturë) në Universitetin e Prishtinës - në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe Sportit (2004). Bashkëpunoi më shtypin e përditshëm e periodik të vendit dhe të jashtëm që nga viti 1974 e deri me tash ("Bota e re" - Prishtinë, "Rilindja" - Prishtinë, "Danas" - Zagreb, "Dello" - Lubjanë, "Dnevnik" - Lubjanë, "Veqer" - Maribor, "Le Mond", "Corriera della Sera" etj).
Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës (2000).
Është menaxher i kompanisë "Flomed" nga Prishtina dhe menaxher gjeneral për Kosovë në distribucion të preparateve farmaceutike të "Schulke-Mayr-"it të Gjermanisë dhe "Borer Chemie AG" të Zvicres.
Flori Bruqi, mbrojti punimin e magjistraturës më titull "Dallimet në disa ndryshore fiziologjike ndërmjet studentëve sportistë dhe jo sportistë, para dhe pas vrapimit 400 metra para komisionit shkencor - të Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit në Prishtinë, në përbërje - Prof. Dr. sc. Hasim Rushiti, kryetar, Prof. Dr. Hysni Daka, mentor, Prof. Dr. sc. Mustafë Aliu, anëtar.
Magjistri i tashëm i shkencës së "Fiziologjisë kineziologjike", Flori Bruqi ka zbatuar një metodologji të avancuar shkencore gjatë këtij hulumtimi të tij në 22 parametra morfologjikë - fiziologjikë duke përdorur kriteret e avancuara të "Programit biologjikë ndërkombëtar" të Weiner-it dhe Louri-esë ; "Praktikumin e antropologjisë biologjike" të Buzin-ës më bashkëpunëtorë; "Parktikumin e fiziologjisë sportive", të Heimer-it më bashkëpunëtorë; "Udhëzuesit Kombëtarë të Asociacionit Shëndetësor Amerikan" etj.
Punimi i magjistraturës të Flori Bruqit, është vlerësuar lartë nga komisioni shkencorë dhe i cili ka shfrytëzuar burime më të reja të literaturës (citon 49 referenca librash më të rinj nga kjo lëmi

shkencore) si dhe ka përdorur 17 web-adresa portale relevante që merren më këto hulumtime të "Fiziologjisë kineziologjike" botërore.
Veprat e botuara :
Deri më tash ka botuar këta libra :
1. Zjarri i diellit, poezi, Prishtinë, 1995.
2. Ndërgjegjja, roman, Prishtinë, 1995.
3. Vrasësit e liridonëve, roman, Prishtinë, Tiranë, 1996.
4. Ringjallja, roman, Tiranë, Prishtinë, 1996.
5. Gjarpërinjtë e pallatit, roman, Tiranë, Prishtinë, 1996.
6. Dorëzeza, roman, Tiranë, Prishtinë, 1997.
7. Tokë e djegur, roman, Shkodër, Tiranë, Prishtinë, 1998.
8. Burri dhe gruaja, libër shkencor, Tiranë, Prishtinë, 2000.
9. Pallati i akereonit, roman, Tiranë, Prishtinë, New York, 2000.
10. Vademecum DDD, libër shkencor, Prishtinë, 2002.
11. Struktura faktoriale e dimensioneve antropometrike dhe fiziologjike, Prishtinë, 2004.
12. Ndikimi i sportit në personalitetin e njeriut, libër shkencor, Prishtinë,2004.
13. Delinkuenca e të miturve dhe ushtrimet fizike, Prishtinë, 2004.
14. Vademecum për preparate higjenike të "Schulke – Mayr"– it, libër shkencor, Prishtinë, 2004.
15. Dallimet në disa ndryshore fiziologjike ndërmjet studentëve sportistë dhe jo sportistë para dhe pas vrapimit 400 metra (Punim magjistrature, Prishtinë 2005).
16. Antropometri-Jakov Milaj "Raca shqiptare", recension i zgjëruar i botuar në Floart, 2005.
17. Si ta njofim internetin, Flomed, tetor-2005.
18. Sëmundjet infektive seksuale, Floart, tetor-2005.
19. Udhëzues i shkurtër i preparative dezinfektuese, Flomed, 2006.
20. Merruni me sport dhe ushtrime fizike për t'u relaksuar, Floart, janar 2006.
21. Kosova nuk është i berzë e zezë, Floart, dhjetor 2005.
22. Fshehtësitë dhe të vërtetat për virusin avian', Flomed, 2005.
23. THE ECONOMIC ASPECTS OF SPORTS RECREATION AND HEALTH, Sport ritmi-zemrës, janar 2006, etj.
24. DETERMINANTAT SOCIO-PSIKOLOGJIKE TË USHTRIMIT FIZIK (Hulumtim socio-psiko–kineziologjikë më studentët e Universitetit të Prishtinës), Flomed, 2006.

25. Guxim shqiptar, Prishtinë, 2008.
26. Olimpi shqiptar, Rugova-Art, Prishtinë, 2009.
27. Triumfi shqiptar, Rugova-Art, Prishtinë ,2009.
28. Polemika shqip, Rugova-Art, Prishtinë 2009.
29. "Antika greke"-Homeri, Eskili, Sofokliu, Aristofani dhe Aristoteli, Albemigrant, 2009.
30. Nëse kam ditur të guxoj, Rugova-Art, Prishtinë, 2012
31. Delikuenca e të miturve në Kosovë në periudhën 2003-2004, Prishtinë, 2012
32. Vademecum për dezinfektues të "Borer chemie AG", Prishtinë, 2013.
33. Vademecum për dezinfektues të "Schülke-Mayr", Prishtinë 2013.
34. Diademë letrare, Rugova-Art, Prishtinë 2013.
35. Diademë letrare II, Tiranë, 2014.
36. Atdheu im s'më vret, poezi, Tiranë, 2015.
37. Diademë letrare III, Tiranë,2015.
38. Vademecun për dezinfektues 1, Prishtinë, 2016. (internet)
39. Vademecum për dezinfektues 2, Prishtinë, 2016 (internet)
40. Moderniteti në letrat shqipe, Tiranë,2016(internet).
41. Praktikat e pastrimit dhe dezinfektimit të mjediseve spitalore dhe ambulantore në Kosovë (Doracak përdorimi), "Flomed", Prishtinë, 2017.

Ka botuar 21 fejtone publicistiko-shkëncore në gazetën "Rilindja" të Prishtinës, në përiudhën 1974-1982, si dhe mija punime në shumë web faqe interneti (2003-2016).

Nga viti 2005 është Editor si dhe Kryeredaktor përgjegjës i web faqës elektronike " Agjencioni Floripress" .

Nga korriku i vitit 2017 është pranuar Akademik,në Akademinë e Shkencave dhe Arteve në New York (AAAS-ALBANIAN AMERICAN ACADEMY OF SCIENCE)

http:wwfloripress.blogspot.com

http:wwfloripress.blogspot.al

Përmbajtja:

PARATHËNIE: NJË PLAGË E HAPUR QË S'PO GJEN SHËRIM / 7
KUR NATO GJUNJËZONTE SERBINË / 27
KËRKO FALJE CARLA DEL PONTE ! / 47
TERRORIZMI VETEVRASES / 54
AKADEMIKËT E KRIMIT / 61
"PATKOI" I MILOSHEVIQIT / 68
NJË LISTË KRIMESH E KRIMINELËSH / 112
UKSHIN HOTI, KU JE ?! / 159
MIDIS ORAKUJVE DHE PROFECIVE SERIOZE / 177
A PO PLAKET POPULLSIA NË KOSOVË / 209
MONUMENTI KULTUROR I MILOSHEVIQIT / 217
BALLKANI, SERA EUROPIANE E DROGËS / 225
LUFTA E TRETË BOTËRORE 241
PSE SHKOVE NË SERBI NEHAT THAÇI? / 255
1020 VETËVRASJE NË KOSOVË / 261
A DO TË BASHKOHEN SHQIPTARËT NË NJË SHTET / 264
RAMUSH HARADINAJ / 276
ARKANI NË KOSOVË / 291
A PO NGJALLET NOSTALGJIA PËR PERANDORINË OSMANE / 297
BILANCI I LUFTËS NË KOSOVË: - HUMBËN JETËN 11.840 PERSONA / 307
MANASTIRI I DEÇANIT, OBJEKT I KISHËS SERBE, APO TRASHËGIMI ILIRE? / 315
BIOGRAFI E SHKURTË E AUTORIT FLORI BRUQI / 327

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Bruqi, Flori
Dëshmi të krimit të pandëshkuar / Flori Bruqi ;
red. Izet Duraku. – Tiranë : Grand prind, 2017
332 f. ; 14x21 cm.
ISBN 978-9928-154-67-5

1.Çështja e Kosovës 2.Krime të luftës 3.Terrorizmi

323.1(=18:497.115)